



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute

# **DORACAKU I GJYQTARËVE PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**



Ky publikim u mundësua me përkrahjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID.

**HEQJE PËRGJEGJËSIE** Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara



## Përmbajtje

<b>AKRONIMET</b> .....	<b>13</b>
<b>FJALA E AUTORËVE</b> .....	<b>16</b>
<b>1 KOMPETENCA E GJYKATËS</b> .....	<b>19</b>
1.1 Kompetenca e Gjykatës Themelore.....	19
1.2 Kompetenca lëndore.....	19
1.3 Roli i gjyqtarit lidhur me kompetencën lëndore .....	19
1.3.1 Kriteret që e rregullojnë kompetencën lëndore	19
1.3.2 Shembuj të rasteve pa kompetencë lëndore	20
1.3.3 Kompetenca territoriale	21
1.3.4 Roli i gjyqtarit në vlerësimin e kompetencës së përgjithshme territoriale	21
1.3.5 Kompetenca e veçantë territoriale	22
1.4 Kompetenca territoriale ndihmëse dhe shembuj të rasteve lidhur me këtë kompetencë .....	26
1.5 Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata më e lartë .....	28
1.6 Marrëveshja mbi kompetencën territoriale .....	29
1.7 Konflikti në lidhje me kompetencën.....	30
1.8 Zgjidhja e konfliktit për kompetencën.....	31
1.9 Përfundimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi .....	32
1.9.1 Rrethanat të cilat qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi	32
1.9.2 Procedura	32
1.9.3 Autoriteti kompetent që vendosë lidhur me kërkesën për përfundimin dhe rekuizimin e gjyqtarit	33
1.9.4 Kërkesat e palejuara	33
1.10 Formularët praktikë për kompetencën e gjykatës .....	37
Formulari 1 – Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ja dërgon Departamentit për Çështje Administrative.....	37
Formulari 2 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore dhe lëndën ja dërgon Departamentit për Çështje Ekonomike.....	38
Formulari 3 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore dhe lëndën ja dërgon Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës .....	39
Formulari 4 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore dhe e hedh poshtë padinë si të palejuar .....	41
Formulari 5 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore, i shpallë të pavlefshme veprimet e kryera dhe e hedh poshtë padinë si të palejuar .....	43
Formulari 6 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente territoriale ekskluzive.....	45
Formulari 7 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente territoriale.....	46
Formulari 8 - Kërkesë për delegim të kompetencës .....	47
Formulari 9 - Mënyra e hapjes së konfliktit të kompetencës.....	48
Formulari 10 - Aktvendim me të cilin pranohet kërkesa për përfundimin e gjyqtarit .....	49
<b>2 PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE</b> .....	<b>51</b>
2.1.Kuptimi i palëve në procedurën kontestimore .....	51
2.1.1.Kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore	51
2.1.2.Kush e përfaqëson palën me pazotësi procedurale	52
2.2.Përfaqësuesi ligjor .....	52
2.2.1.Përfaqësuesi i përkohshëm	53
2.2.2.Përfaqësuesit e autorizuar të palëve	54
2.2.3.Mos përfaqësimi i duhur i palës nga ana e avokatit apo personit tjetër	54
2.2.4.Mënyrat e dhënies së autorizimit	54
2.2.5.Revokimi i deklaratës së të autorizuarit nga ana e vetë palës	55
2.2.6.Vëllimi dhe përmbajtja e autorizimit	55
2.2.7.Parashtrimi i autorizimit	56
2.2.8.Revokimi dhe denoncimi i autorizimit	56
2.3.Gjuha në procedurë.....	56

2.4	Formularët praktikë për palët dhe përfaqësimin .....	59
	Formulari 1 - Vendimi mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm .....	59
	Formulari 2 - Shpallja e aktvendimit mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm .....	60
	Formulari 3 - Aktvendimi mbi hedhjen e padisë dhe abrogimin e të gjitha veprimeve procedurale .....	61
	Formulari 4 - Autorizimi i dhënë ndaj avokatit .....	62
	Formulari 5 - Autorizimi i dhënë ndaj personit i cili nuk është avokat .....	63
	Formulari 6 - Parashtrësë mbi tërheqjen e autorizimit të dhënë ndaj avokatit.....	64
	Formulari 7 - Parashtrësë mbi denoncimin e autorizimit nga ana e avokatit.....	65
<b>3</b>	<b>PARASHTRËSAT DHE DËRGIMI I SHKRESAVE .....</b>	<b>67</b>
3.1.	Parashtrësat.....	67
3.2.	Mënyra e dërgimit të shkresave .....	68
3.3.	Formularët praktikë për parashtrësat .....	75
	Formulari 1 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia .....	75
	Formulari 2 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia .....	76
	Formulari 3 – Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia .....	77
	Formulari 4 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia .....	78
	Formulari 5 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia .....	79
	Formulari 6 – Aktvendimi me të cilin është konsideruar e tërhequr padia pasi që nuk është plotësuar .....	80
	Formulari 7 - Aktvendimi me të cilin është hedh poshtë padia pasi që i është kthyer gjykatës e pa plotësuar.....	81
	Formulari 8 - Lajmërimi për palën sipas të cilit lajmërohet për tërheqjen e shkresës (ftesë, vendim etj...).....	82
	Formulari 9 - Aktvendimi për afishim në tabelën e gjykatës të shkresave për paditësin .....	83
	Formulari 10 -Aktvendimi për afishim në tabelën e gjykatës të shkresave për paditësin .....	84
<b>4</b>	<b>SEANCAT DHE AFATET.....</b>	<b>87</b>
4.1.	Seancat.....	87
4.2.	Afatet .....	88
4.3.	Llogaritja e afatit .....	88
4.4.	Kthimi në gjendjen e mëparshme .....	88
4.5.	Formularët praktikë për seancat dhe afatet .....	91
	Formulari 1 - Aktvendimi me të cilin është vendosur që seanca të mbahet jashtë ndërtesës së gjykatës .....	91
	Formulari 2 - Aktvendimi me të cilin hedhet si i pa afatshëm propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme.....	92
	Formulari 3 - Aktvendimi me të cilin është lejuar kthimi në gjendjen e mëparshme .....	93
	Formulari 4 - Aktvendimi me të cilin është refuzuar kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme .....	94
<b>5</b>	<b>VENDIMET GJYQËSORE .....</b>	<b>97</b>
5.1.	Aktgjykimi.....	97
5.1.1.	Përmbajtja e aktgjykimit.....	97
5.1.2.	Disa udhëzime rreth arsyetimit të aktgjykimit.....	98
5.1.3.	Metodologjitë bashkëkohore të shkrimit dhe arsyetimit ligjor.....	99
5.1.4.	Aktgjykimi i pjesshëm.....	102
5.1.5.	Aktgjykimi në bazë të pohimit.....	102
5.1.6.	Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia.....	104
5.1.7.	Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë.....	105
5.1.8.	Aktgjykimi për shkak të mungesës.....	106
5.1.9.	Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes.....	107
5.1.10.	Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore.....	108
5.1.11.	Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore.....	109
5.1.12.	Aktgjykimi plotësues.....	109
5.2.	Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit.....	110
5.3.	Korrigjimi i aktgjykimit.....	111
5.4.	Forma e prerë e aktgjykimit.....	111
5.5.	Aktvendimi .....	112
<b>6.</b>	<b>MJETET E RREGULLTA TË GODITJES.....</b>	<b>115</b>

6.1.Mjetet e zakonshme të goditjes.....	115
6.2.Procedura sipas ankesës.....	117
6.3.Procedura sipas ankesës në gjykatën e shkallës së dytë .....	118
6.4.Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë .....	119
6.5.Mënyrat e vendosjes sipas ankesës.....	119
6.6.Ankesa kundër aktvendimit .....	122
6.6.1.Baza për ankesë dhe efektet.....	122
6.6.2.Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë për ankesat kundër aktvendimeve.....	122
6.7.Formularët praktikë për mjetet e rregullta të goditjes.....	125
Formulari 1 – Aktvendim me të cilin kthehet ankesa për plotësim .....	125
Formulari 2 - Aktvendim me të cilin hedhet poshtë si jo e plotë ankesa e paditësit .....	126
Formulari 3 - Aktvendim me të cilin hedhet poshtë ankesa e paditësit si e pasafatshme .....	127
Formulari 4 - Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe hedhet poshtë padia e paditësit.....	128
Formulari 5 - Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin pranohet ankesa e paditësit, priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda kthehet në rigjykim.....	130
Formulari 6 -Aktgjykimi Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.....	132
Formulari 7 - Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin pranohet ankesa e të paditurit dhe ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.....	134
<b>7.MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES .....</b>	<b>139</b>
7.1.Revizioni .....	139
7.2.Përsëritja e Procedurës.....	140
7.2.1.Shkelja e dispozitave procedurale:.....	140
7.2.2.Afati për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës.....	141
7.3.Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë .....	142
7.3.1.Shkaqet e goditjes për goditjen e vendimit më kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë .....	142
<b>8.PADIA .....</b>	<b>145</b>
8.1.Padia .....	145
8.1.1.Padia pavarësisht nga lloji i saj duhet të përmbajë.....	145
8.1.2.Kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesat aksesore.....	145
8.1.3.Faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën.....	145
8.1.4.Provat me të cilat vërtetohen faktet e padisë.....	145
8.1.5.Vlera e kontestit.....	146
8.1.6. Baza juridike.....	146
8.1.7. Taksa gjyqësore për padi.....	146
8.2.Llojet e padive .....	146
8.2.1.Kundërpadia.....	147
8.2.2.Llojet dhe shembujt e kundërpadive.....	147
8.3.Fazat dhe kushtet për lejimin e kundërpadisë .....	148
8.3.1.Ndryshimi i padisë.....	148
8.3.2.Çka përbën ndryshimi i padisë.....	148
8.3.3.Fazat në të cilat mund të bëhet ndryshimi i padisë.....	150
8.4.Tërheqja e padisë.....	151
8.4.1.Fazat dhe kushte për tërheqjen e padisë.....	151
8.5.Gjyqvarësia (litispendenca) .....	152
8.6.Formularët praktikë lidhur me padinë .....	155
Formulari 1 - Formular i vërejtjes (së parë) për pagesën e taksës gjyqësore .....	155
Formulari 2 - Formular i vërejtjes (së dytë) për pagesën e taksës gjyqësore .....	156
Formulari 3 - Aktvendim me të cilin është konsideruar e tërhequr padia e paditësit për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.....	157

Formulari 4 - Aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit.....	158
Formulari 5 -Aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit.....	159
Formulari 6 – Aktvendim me të cilin është hedhur poshtë padia e paditësit për shkak të gjyqvarësisë (litispencës).....	160

**9. BASHKËNDËRGJYQËSIA DHE PJESËMARRJA E PERSONAVE TË TRETË NË PROCEDURËN KONTESTIMORE .....163**

9.1.Kuptimi dhe llojet e bashkëndërgjyqësisë (litis consortium).....	163
9.2.Bashkëndërgjyqësia .....	163
9.2.1.Bashkëndërgjyqësia e thjeshtë.....	163
9.2.2.Bashkëndërgjyqësia e domosdoshme.....	163
9.2.3.Bashkëndërgjyqësia eventuale.....	164
9.2.4.Deri në cilën fazë dhe kur mund të iniciohet bashkëndërgjyqësia.....	164
9.3.Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin kontestimor .....	165
9.3.1.Ndërhyrësi i thjeshtë.....	165
9.3.2.Ndërhyrësi kryesor.....	165
9.3.3.Personat të cilët mund të ndërhyjnë në procesin kontestimor.....	166
9.3.4.Emërimi i paraardhësit juridik.....	166
9.3.5.Njoftimi i personit të tretë për procesin gjyqësor.....	167
9.4.Formularët praktikë për bashkëndërgjyqësinë dhe personat e tretë.....	169
Formulari 1 - Parashtrësë e ndërhyrësit - ndërhyrësi i thjeshtë.....	169
Formulari 2 - Padi e personit të tretë kundër të dy palëve – ndërhyrësi kryesor .....	170
Formulari 3 - Parashtrësë e të paditurit për emërimin e paraardhësit juridik.....	172
Formulari 4 - Parashtrësë mbi njoftimin e personit të tretë mbi procesin gjyqësor .....	173
Formulari 5 - Aktvendim mbi refuzimin e ndërhyrësit të thjeshtë.....	174

**10 NDËRPRERJA DHE PUSHIMI I GJYKIMIT .....177**

10.1.Ndërprerja dhe pushimi .....	177
10.2.Çka nënkupton ndërprerja e gjykimit (procedurës)? .....	177
10.3.Kur ndërpritet gjykimi (procedura) .....	177
10.4.Rastet e tjera të ndërprerjes së gjykimit (procedurës).....	178
10.5.Pasojat e ndërprerjes së gjykimit (procedurës) .....	178
10.6.Kur fillon procesi i ndërprerë gjyqësor ?.....	178
10.7.Afatet.....	179
10.8.Ankesa kundër aktvendimit për ndërprerjen e gjykimit (procedurës) .....	179
10.8.1.Pushimi i gjykimit.....	179
10.8.2.Dallimi në mes të ndërprerjes së gjykimit (procedurës) dhe pushimit të gjykimit (procedurës).....	180
10.9.Formularët praktikë për ndërprerjen dhe pushimin e gjykimit .....	183
Formulari 1 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së paditësit .....	183
Formulari 2 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së të paditurit .....	184
Formulari 3 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të likuidimit të të paditurës .....	185
Formulari 4 -Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të përfshirjes së autoritetit publik në cilësinë e palës së paditur .....	186
Formulari 5 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake .....	187
Formulari 6 - Aktvendim mbi pushimin e procedurës për shkak të vdekjes së të paditurit .....	188

**11 DHËNIA E NDIHMËS JURIDIKE .....191**

11.1 Ndhurma juridike.....	191
11.1.1 Dhënia e ndihmës juridike gjykatës së vendit.....	191
11.1.2 Dhënia e ndihmës juridike gjykatës së huaj.....	191
11.2 Procedura lidhur me dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare.....	192
11.2.1 Veprimi në rastet kur lutja e shtetit të huaj për ndihmë juridike bie në kundërshtim me rendin juridik të vendit tonë.....	192
11.2.2 Lutjet nga gjykata e vendit drejtuar gjykatave të huaja.....	193

<b>12 MOSRESPEKTIMI I GJYKATËS.....</b>	<b>195</b>
12.1.Mosrespektimi i gjykatës.....	195
12.2.Roli i gjyqtarit në rastet kur palët dhe pjesëmarrësit në procedurë keqpërdorin të drejtat procedurale.....	195
12.3.Rastet e keqpërdorimit të drejtave procedurale .....	196
12.3.1.Roli i gjyqtarit në rastet kur palët dhe pjesëmarrësit në procedurë e fyejnë gjykatën dhe pjesëmarrësit në procedurë përmes parashtrësës apo në seancë gjyqësore.....	196
12.3.2.Roli i gjyqtarit në rastet kur dëshmitari dhe eksperti nuk e respektojnë gjykatën.....	197
12.3.3.Rasti kur dëshmitari nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës apo pa leje dhe ndonjë arsye largohet nga vendi ku duhet të dëgjohet.....	197
12.3.4.Rasti kur dëshmitari refuzon të dëshmojë apo të përgjigjet në pyetjen konkrete.....	197
12.3.5.Rasti kur eksperti nuk e dorëzon brenda afatit konstatimin dhe mendimin e vet, apo pa arsye nuk vjen në seancë dhe refuzon ekspertimin.....	198
<b>13 SIGURIMI I KËRKESËPADISË.....</b>	<b>202</b>
13.1.Kuptimi dhe përmbajtja.....	202
13.2.Kushtet për caktimin e masave të sigurimit.....	203
13.3.Llojet e masave të sigurimit.....	204
13.4.Pasojat e mosrespektimit të masave me të cilat sigurohet kërkesëpadia.....	205
13.5.Mënyra e paraqitjes dhe përmbajtja e propozimit për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë .....	206
13.5.1.Njoftimi i kundërshtarit të propozimit në lidhje me masën e propozuar.....	206
13.5.2.Masat e përkohshme të sigurimit.....	206
13.5.3.Përmbajtja e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit.....	207
13.5.4.Mundësia e caktimit të masës së sigurimit para se të jetë ngritur padia.....	208
13.5.5.Kohëzgjatja e masës së sigurimit.....	208
13.5.6. Mjetet juridike kundër aktvendimit për caktimin e masës së sigurimit dhe aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.....	209
13.5.7.Autorizimet e gjykatës në lidhje me sendet e siguruara.....	209
13.5.8.Autorizimet e palëve ndërgjyqëse në lidhje me masat e propozuara.....	209
13.5.9.Autorizimet e gjykatës në lidhje me procedurën dhe aktvendimin e nxjerrë.....	210
13.5.10.Shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës për sigurimin e kërkesëpadisë.....	210
13.5.11.Pasojat e mosrespektimit të masës për sigurimin e kërkesëpadisë.....	210
13.6 Kush i ekzekuton masat e sigurimit?.....	211
13.7 Formularët praktikë lidhur me kërkesëpadinë .....	213
Formulari 1 - Aktvendim mbi detyrimin e paditësit për deponimin e garancionit për masën e propozuar të sigurisë .....	213
Formulari 2 - Aktvendim mbi refuzimin e masës së sigurisë për shkak të mos pagesës së garancionit .....	215
Formulari 3 -Aktvendim mbi refuzimin e caktimit të masës së sigurisë, si dhe anulimin e aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, për shkak të mos pagesës së garancionit .....	216
Formulari 4 - Aktvendim mbi caktimin e masës së sigurisë.....	218
Formulari 5 - Aktvendim mbi refuzimin e masës së përkohshme të sigurimit .....	221
Formulari 6 - Aktvendim mbi refuzimin e masës së përkohshme të sigurisë e cila ka të bëjë me ruajtjen e pasurisë apo ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave .....	223
Formulari 7 - Aktvendim mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.....	225
Formulari 8 - Aktvendim mbi anulimin e masës së përkohshme të sigurimit me propozimin e palës paditëse – propozuese.....	227
Formulari 9 - Aktgjykim refuzues me të cilin është vendosur që masa e sigurimit të mbetet në fuqi deri në plotfuqishmëri të kontestit .....	228
<b>14.MJETET PROVUESE DHE MARRJA E PROVAVE .....</b>	<b>231</b>
14.1.Veprimet.....	231
14.2.Barra e të provuarit.....	231
14.2.1.Faktet që nuk kanë nevojë të provohen.....	232
14.2.2.Marrja e provave.....	233
14.3.Sigurimi i provës (parapropa).....	234



14.4.Mjetet provuese veç e veç .....	235
14.4.1 Këqyrja ne vend.....	235
14.4.2 Shkresat.....	236
14.4.3 Dëshmitarët.....	238
14.4.4 Ekspertët.....	242
14.4.5 Dëgjimi i palëve.....	244
14.5 Formularët praktikë lidhur me mjetet provuese dhe marrjen e provave .....	247
Formulari 1 - Aktvendimi për caktimin e ekspertit-ekspertizës.....	247
<b>15 PËRGATITJA E SHQYRTIMIT KRYESOR.....</b>	<b>249</b>
15.1 Faza përgatitore e shqyrtimit kryesor .....	249
15.1.1 Faza e shqyrtimi paraprak të padisë.....	250
15.1.2 Hedhja poshtë e padisë si e palejueshme.....	250
15.1.3 Shpallja jokompetente e gjykatës.....	250
15.1.4 Shtyrja e vendosjes për disa çështje.....	251
15.1.5 Përgjigja në padi.....	251
15.1.6 Udhëzimet e gjykatës për të paditurin me rastin e dërgimit të padisë për përgjigje.....	251
15.1.7 Kthimi i përgjigjes në padi në korrigjim dhe plotësim.....	251
15.1.8 Pasojat e mos korrigjimit dhe plotësimit të përgjigjes në padi.....	251
15.1.9 Vendimet të cilat mund të jepen pas përgjigjes në padi.....	252
15.2 Seanca përgatitore .....	252
15.2.1 Shqyrtime të përgjithshme.....	252
15.2.2 Veprimet dhe autorizimet e gjykatës.....	252
15.2.3 Format e mbajtjes së seancës përgatitore.....	253
15.2.4 Caktimi dhe mbajtja e seancës përgatitore.....	253
15.2.5 Çka ndodh nëse njëra nga palët nuk paraqitet në seancën përgatitore?.....	255
15.2.6 Caktimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.....	255
15.3 Ndërmjetësimi dhe Pajtimi Gjyqësor.....	256
15.3.1 Ndërmjetësimi në procedurën gjyqësore.....	256
15.3.2 Pajtimi gjyqësor.....	257
15.3.3 Konvokimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.....	259
15.4 Zhvillimi i shqyrtimit kryesor.....	260
15.4.1 Hapja e seancës për shqyrtim kryesor.....	260
15.4.2 Zhvillimi i shqyrtimit kryesor në rastet kur nuk është mbajtur seanca përgatitore.....	261
15.4.3 Drejtimi i shqyrtimit kryesor.....	262
15.4.4 Zhvillimi i procedurës në shqyrtim kryesor.....	262
15.4.5 Mënyra e marrjes në pyetje të palëve në shqyrtim kryesor.....	263
15.4.6 Rrjedha e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve në shqyrtim kryesor.....	263
15.4.7 Roli i gjyqtarit me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve.....	263
15.4.8 Shtyrja dhe vazhdimi i seancës gjyqësore për shqyrtim kryesor.....	264
15.5 Formularët praktikë lidhur me shqyrtimin kryesor.....	267
Formulari 1- Aktvendim për përgjigje në padi .....	267
Formulari 2 - Aktvendim më të cilin i kthehet në plotësim paditësit padia .....	268
Formulari 3 - Aktvendim mbi inkompetencën lëndore.....	269
Formulari 4 - Aktvendim për shpalljen absolutisht inkompetente të gjykatës dhe hudhjen poshtë të padisë.....	270
Formulari 5 -Aktvendim për shpalljen absolutisht inkompetente të gjykatës dhe hedhjen poshtë të padisë .....	271
Formulari 6 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së paditësit .....	272
Formulari 7 - Aktvendim për detyrim të të paditurit për të dhënë përgjigje në padi .....	273
Formulari 8 -Aktvendim me të cilin konstatohet e tërhequr padia dhe kundërpadia .....	274
Formulari 9 - Aktvendim me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit – të kundërpaditurit, si dhe me të cilin konstatohet e tërhequr kundërpadia e të paditurit – kundërpaditësit.....	275
Formulari 10 - Aktvendim me të cilin konstatohet tërheqja e padisë së paditësit.....	276
Formulari 11 - Aktvendim me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit.....	277
Formulari 12 – Aktvendim me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit .....	278
Formulari 13 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake .....	279
Formulari 14 - Aktvendim mbi hedhjen poshtë të padisë për shkak të çështjes së gjykuar – res judicata.....	280

Formulari 15- Kërkesë Komunës për verifikimin e faktit të vdekjes.....	281
Formulari 16 - Kërkesë për verifikimin e faktit të marrëdhënies së punës .....	282
Formulari 17 - Kërkesë për shikim në shkresat e lëndës të cilat gjenden pranë organit administrativ .....	283
Formulari 18 – Model i vendimit të Gjykatës për referimin e rastit për ndërmjetësim.....	284
Formulari 19 – Model i Marrëveshjes për Ndërmjetësim <sup>286</sup> .....	285
Formulari 20 -Model i Marrëveshjes për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar <sup>287</sup> .....	286
Formulari 21 - Raport për moszgjidhjen e rastit.....	287
Formulari 22 – Model i vendimit të gjykatës për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar .....	288
Formulari 23 - Pajtimi i arritur në procedurën gjyqësore .....	289
Formulari 24 - Procesverbali i seancës gjyqësore në të cilën refuzohet pajtimi gjyqësor i propozuar nga palët...	291
Formulari 25 - Aktvendimi i posaçëm mbi refuzimin e pajtimit gjyqësor të propozuar nga palët .....	293
<b>16 SHPENZIMET PROCEDURALE .....</b>	<b>297</b>
<b>16.1 Shpenzimet .....</b>	<b>297</b>
16.1.1 Parapagimi i shpenzimeve procedurale.....	297
16.1.2 Pagimi definitiv i shpenzimeve procedurale.....	297
16.1.3 Vendimi për shpenzimet e procedurës në shkallë të parë.....	298
16.1.4 Vendimi për shpenzimet e procedurës në procesin sipas mjetit të goditjes.....	298
16.1.5 Lirimi nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.....	299
16.1.6 Lirimi i plotë nga shpenzimet e procedurës.....	299
16.1.7 Lirimi i pjesshëm nga shpenzimet e procedurës.....	299
16.1.8 Vendimi i gjykatës kompetente sipas propozimit të palës për lirim nga shpenzimet gjyqësore.....	299
16.1.9 Mundësia e anulimit të aktvendimit për lirim nga shpenzimet e procedurës dhe mbi emërimin e përfaqësuesit.....	300
<b>16.2 Formularët praktikë për shpenzimet procedurale .....</b>	<b>303</b>
Formulari 1 - Aktvendim me të cilin pranohen shpenzimet e procedurës .....	303
Formulari 2 - Aktvendim me të cilin refuzohen shpenzimet e procedurës .....	304
Formulari 3 - Aktvendim për lirim nga shpenzimet e procedurës .....	305
Formulari 4 -Aktvendimi me të cilin refuzohet kërkesa për lirim nga shpenzimet e procedurës .....	306
<b>17 PROCEDURAT E POSAÇME KONTESTIMORE.....</b>	<b>309</b>
<b>17.1 Llojet e procedurave .....</b>	<b>309</b>
17.1.1 Procedura në kontestet nga marrëdhënia e punës.....	309
17.1.2 Procedura në kontestet për shkak të pengimit të posedimit.....	309
17.1.3 Procedura në kontestet e vlerës së vogël.....	310
17.1.4 Procedura e dhënies së urdhërpagesës.....	311
17.1.5 Procedura në kontestet tregtare.....	313
<b>18 BIOGRAFIA E AUTORËVE .....</b>	<b>316</b>
<b>19 LITERATURA E KONSULTUAR DHE E PËRDORUR .....</b>	<b>318</b>
<b>20 AKTE, KODE, LIGJE, RREGULLORE DHE RAPORTE .....</b>	<b>319</b>



Botuar nga:

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK)

Botimi i këtij doracaku është mundësuar nga USAID/EROL.

Autorë:

Muharrem Shala, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Albert Zogaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Valon Totaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren

Zenel Leku, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Kontribuues në emër të IGjK-së:

Besim Morina, Koordinator i Programit

Valon Jupa, Udhëheqës i Programit për Trajnime të Vazhdueshme



## **Doracak i gjyqtarëve për procedurën kontestimore**

Të drejtat e autorit © 2015 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK) nuk pranon çfarëdo detyrimi sa i përket përmbajtjes së këtij doracaku dhe nuk është përgjegjës për temat e trajtuara, korrektësinë, tërësinë ose cilësinë e informatave të paraqitura. Prandaj, kërkesat në lidhje me dëmin e shkaktuar për shkak të përdorimit të çfarëdo informate të dhënë, duke përfshirë çfarëdo informate e cila nuk është e plotë ose e saktë do të hedhen poshtë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGjK).

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme ose e saktë, përmbajtja ose vlefshmëria e pjesëve tjera mbetet e pandikuar nga ky fakt.

## **Akronimet**

AKM – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

DBJN - Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar

EROL - Efective Rule of Law

IGJK - Instituti Gjyqësor i Kosovës

IPVQ - Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës

IRAC – Issue Rule Analise Conclusion

LMD – Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

LF – Ligji mbi Familjen

LPJK - Ligji për Procedurën Jo Kontestimore

LPK - Ligji për Procedurën Kontestimore

LPP - Ligji për Procedurën Përmbartimore

LZKL-Ligji mbi Zgjidhjen e Konflikteve të Ligjeve

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

NSh – Ndërmarrje Shoqërore

PSSP – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

RK – Republika e Kosovës

UNMIK – United Nations Mission in Kosovo

USAID - United State Agency for International Development

ZRRE - Zyra e Rregullatorit për Energji

Të nderuar lexues, (Drejtori i IGJK)

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka mision përkrahjen e zhvillimit të gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet me të larta ndërkombëtare, si dhe në funksion të zbatimit të programeve të trajnimit për gjyqësorin e Republikës së Kosovës.

Ky Doracak i hartuar me mbështetjen e ekspertizës së ofruar nga USAID/EROL, përmes ekspertëve me përvojë të madhe në këtë lëmi është një nga mjetet praktike përmes të cilit gjyqtarëve, ju mundësohet për të qenë më produktiv, t'i sfidojnë vështirësitë praktike dhe t'i inspirojnë në arritjen e zgjidhjeve të drejta. Ky Doracak nuk ka për qëllim të jetë një komentuar në procedurën civile apo ligjet tjera substanciale të Kosovës.

Që nga momenti kur vendosëm të përgatisim një doracak të tillë kishim në mendje idenë e ofrimit të një mundësie më tepër për t'iu shërbyer gjyqtarëve në gjetjen e zgjidhjeve në mënyrë më efikase, dhe lehtësuese në procesin e menaxhimit të rasteve.

Gjetja e zgjidhjes së duhur është procesi më i vështirë në bërjen e drejtësisë, ndërsa zgjidhja e shpejtë është motivimi më adekuat në krijimin e besimit në drejtësi.

Doracaku u hartua nga grupi punues i themeluar nga IGJK në përbërje të gjyqtarëve me përvojë në gjyqësorin e Kosovës, ku secili nga ta ka bërë një punë substanciale duke i dhënë energji këtij projekti, të ndihmuar edhe nga stafi i IGJK. Me këtë rast atyre u shprehim mirënjohje dhe falënderime të sinqerta. Gjithashtu shprehim mirënjohje respekt të lartë për ndihmën e stafit të IGJK-së në këtë proces.

Doracaku i gjyqtarit për procedurën kontestimore ka për qëllim të ofrojë udhëzime praktike ndaj situatave me të cilat ndeshen gjyqtarët gjatë punës së tyre. Doracaku përfshin procedurat që kërkohen nga Ligji i Procedurës Kontestimore. Gjyqtarët e rinj në veçanti do të përfitojnë nga ky publikim, por edhe gjyqtarët me përvojë mund të gjejnë se ky ju shërben si përkujtues i dobishëm se si të merren me gjërat rutinë, duke propozuar çështje më komplekse ose pikënisje të dobishme kur të ndeshen me situata për herë të parë.

Ky është botimi i parë i Doracakut të Gjyqtarëve për Procedurën Kontestimore, i cili si i tillë, përfaqëson një pikë referimi për proceset civile. Pa dyshim këto procedura dhe praktika do të zhvillohen me kalimin e kohës. Veprimet praktike të sugjeruara këtu parashohin vetëm rekomandimet e grupit punues. Informacionet që jepen konsiderohen më të qarta dhe më me vlerë, por nuk kanë për qëllim të shërbejnë si autoritet ligjor.

Ne jemi të nderuar që ju keni zgjedhur të lexoni dhe përdorni këtë doracak i cili synon të ju ndihmojë në gjetjen e përgjigjeve në shumë nga pyetjet dhe situatat sfiduese në praktikën tuaj, duke besuar se ky doracak do të ndihmojë që profesionalizmi, shkathtësitë dhe aftësitë tuaja të jenë të standardeve më të larta.

Ju dëshirojmë suksese në punën tuaj!





## Fjala e autorëve

Për shkak të reformave rrënjësore në legjislacion në përgjithësi dhe reformave në sistemin e drejtësisë në veçanti, praktika gjyqësore është sfiduar në masë të madhe nga pamundësia e zbatimit adekuat të normave ligjore, nga mos zbatimi unik i normave ligjore, nga mos zbatimi dhe realizimi efikas i procedurave ligjore dhe nga pamundësia e zbatimit unik të procedurave gjyqësore nga të gjitha gjykatat e Kosovës.

Duke i pasur parasysh problemet e shumta me të cilat përballen gjykata lidhur me zbatimin adekuat të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), nga rrjedhin një numër i madh i rasteve në të cilat konstatohet se ka pasur shkelje të dispozitave të LPK-së, me anë të këtij doracaku është bërë një përpjekje modeste që të ndihmohen gjykatat në zbatimin adekuat të LPK-së.

Puna e gjykatave lidhur me zbatimin adekuat të LPK-së deri më tani, është ndihmuar nga punime të ndryshme shkencore e profesionale dhe komentarit të LPK-së, por përmes këtij doracaku synohet që të sigurohet një burim i vetëm për adresim të çështjeve civile të cilat mund të lindin derisa gjyqtari është duke e bërë një shqyrtim paraprak të padisë, duke e mbajtur një seancë gjyqësore, përgatitore apo të shqyrtimit kryesor, duke e nxjerr një vendim procedural jashtë seance, duke vendosur për një prapësim të natyrës procedurale apo edhe duke vendosur në mënyrë meritore për një rast.

Doracaku është projektuar të jetë një referencë e shpejtë, jo një diskutim akademik dhe teorik i instituteve apo i çështjeve procedurale civile. Në këtë kontekst është bërë përpjekje që teksti i doracakut të jetë i organizuar dhe strukturuar në atë mënyrë që secili përdorues të ketë qasje të lehtë në të, në mënyrë që me lehtësi të gjejë secilën temë që i intereson dhe secilën zgjidhje të kërkuar, pasi që një ndër sfidat ka qenë organizimi i tekstit dhe strukturimi i tij.

Ky doracak, ka përmbledhur temat më të rëndësishme që janë të rregulluara me LPK-në, e që mundë të ndihmojnë përdoruesin e këtij doracaku për të kuptuar konceptet gjithëpërfshirëse rreth të cilave doracaku është i organizuar. Doracaku nuk i është përmbajtur me saktësi trajtimit të çështjeve civile sipas strukturës së LPK-së, që do të thotë se në parim është përcjell struktura e LPK-së, por jo kapitull për kapitull dhe dispozitë për dispozitë.

Fokusi i doracakut është në ofrimin e zgjidhjeve procedurale e jo materiale. Diskutimi i çdo teme është projektuar për të kaluar nga e përgjithshmja në të veçantën. Teksti i doracakut i mbulon çështjet rutinë me të cilat përballët një gjyqtar dhe çështje jo të zakonshme më të cilat mund të përballët një gjyqtar e që kërkojnë kujdes të veçantë në gjetjen e zgjidhjeve adekuate.

Standard i punës së çdo gjyqtari është që të tregojë performancë të lartë të sjelljes profesionale dhe personale e cila drejtpërdrejtë ndikon në autoritetin e gjyqtarit dhe rrjedhimisht edhe në besueshmërinë e publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë kuptim synim i doracakut është që si mundësi praktike ti ofrojë gjyqtarëve mundësinë që me kompetencë dhe autoritet të sjellin vendosjet dhe zgjidhjet adekuate të cilat mund të lindin si një sfidë gjatë trajtimit të një rasti, pa pasur nevojë për përpunim masiv të materialeve.

Për ta bërë më të lehtë qasjen e përdoruesve të këtij doracaku në tekst janë ofruar raste hipotetike të cilat paraqitën më shpesh në praktikën gjyqësore.

Pjesë e doracakut janë edhe një numër i formuluarve të cilët gjithashtu janë paraqitur në funksion të qëllimit të këtij doracaku që gjyqtarëve tu ofrohen zgjidhje të shpejta e praktike për çështje që ata kanë në shqyrtim. Tërheqim vërejtjen së formularët e ofruar nuk janë ofruar si një model unik por si një mundësi praktike e mënyrës së veprimit të gjykatës në situatat për të cilat janë ofruar formularët. Formularët e ofruar në fund të fundit janë një mënyrë e shkrimit dhe arsytimit ligjor, në këtë kontekst theksojmë se mënyrat e shkrimit dhe arsytimit ligjor nuk janë të kufizuara vetëm në mënyrën se si janë shkruar dhe ofruar këta formularë në këtë doracak.

Dhe në fund duke e marrë parasysh faktin se në vendin tonë për herë të parë prezantohet një doracak i këtij modeli dhe formati, ne do të dëshironim që ky doracak të shikohet si një hap i parë i cili ka nevojë të pasurohet me komentet, sugjerimet, vërejtje apo kritikata e juaja.

Natyra e këtyre doracakëve kërkon që të njëjtit kohë pas kohe të përpunohen në kuptimin e trajtimit të rasteve të reja, ofrimit të zgjidhjeve për dilemat dhe përcjelljes së standardeve të praktikës gjyqësore.

Autorët

**KAPITULLI I**  
**KOMPETENCA E GJYKATËS**

## **1 KOMPETENCA E GJYKATËS**

### **1.1 Kompetenca e Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore u krijua me Ligjin për Gjykatat (Ligji nr.03/2-19), ku sipas nenit 9 të tij, kjo gjykatë është gjykatë e shkallës së parë.<sup>1</sup>

Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.<sup>2</sup>

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është kompetencë e një departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.<sup>3</sup>

### **1.2 Kompetenca lëndore**

Kompetenca lëndore është ajo në bazë të së cilës gjykatat e një kategorie kanë të drejtë dhe detyrë të gjykojnë disa çështje juridike për shkak të llojit, natyrës dhe vlerës së objektit të kontestit.

### **1.3 Roli i gjyqtarit lidhur me kompetencën lëndore**

Edhe në rastet kur çështja e kompetencës nuk është ngritur nga palët, gjyqtari i çështjes duhet që menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë gjithë procedurës, ta shikoj dhe të kujdeset se zgjidhja e kontestit hyn apo jo në kompetencën lëndore të gjykatës në të cilën është paraqitur.

Përcaktimi i kompetencës lëndore është kusht i domosdoshëm, ngase nga kjo varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, që do të thotë se në rast se gjykata për çështjen e shtruar para saj nuk është kompetente, atëherë nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural rreth asaj çështje.

Detyrimi i gjykatës që ta vlerësoj zyrtarisht kompetencën menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor përcaktohet me dispozitat nga neni 17.1, 18.1 dhe 19, 20.1 dhe 21.1 të LPK-së.

Gjykatësi e vlerëson kompetencën lëndore duke u bazuar në thëniet e paditësit dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura vet gjykatësi.

Në të gjitha rastet e jo kompetencës lëndore, gjyqtari i çështjes duhet të vendosë me aktvendim. Ky lloj vendimi gjyqësor parashihet me dispozitën e nenit 387 par 1, pika u) të LPK-së.

#### **1.3.1 Kriteret që rregullojnë kompetencën lëndore**

Për caktimin e kompetencës lëndore janë të njohura dy kriteret:

- Objekti i kontestit dhe
- Vlera e Objektit të Kontestit (vetëm për përdorim të mjetit të jashtëzakonshëm-revizioni).

Këto kriteret konsiderohen në bazë të përmbajtjes së padisë. Kompetenca e gjykatës paraqet prezumim procedural ngase në mungesë të këtij kushti gjykata nuk mund të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë.

---

<sup>1</sup> Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, shpallur me datën 09.08.2010, GZ.79/24.08.2010, që ka hyrë në fuqi me 01.01.2013. Me këtë ligj rregullohet organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave në Republikën Kosovës.

<sup>2</sup> Neni 11 i Ligjit për Gjykatat, parasheh: Juridiksionin e Gjykatës Themelore sipas lëndës.

<sup>3</sup> Neni 16 Ligjit për Gjykatat.

### 1.3.2 Shembuj të rasteve pa kompetencë lëndore

Jo kompetenca lëndore e gjykatave mund të paraqitet:

- a) në raport me jo kompetencën e ndonjë gjykate tjetër
- b) në raport me organin administrativ
- c) në raport me jo kompetencën e gjykatës së vendit
- d) në raport me jokompetencën kur palët kanë kontraktuar arbitrazhin

a) Jo kompetenca lëndore në raport me gjykatën tjetër

Ky rast praktikisht ndodhë kur çështja është shtruar para Gjykatës Themelore-Departamentit të Përgjithshëm ndërsa kompetent mund të jetë Departamenti për Çështje Administrative, Departamenti për Çështje Ekonomike apo Dhoma e Veçante e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjyqtari i çështjes ka kompetencë që menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë zhvillimit të procedurës ta shikojë kompetencën lëndore dhe në rast se vlerëson se çështja e shtruar nuk është në kompetencë të gjykatës para të cilës është shtruar, por e ndonjë gjykate tjetër, atëherë me aktvendim e shpallë gjykatën jo kompetente dhe lëndën ja dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi.<sup>4</sup>

b) Jo kompetenca lëndore në raport me organin administrativ

Në praktikë mund të ndodhë që pranë gjykatës të paraqiten çështje për të cilat nuk është kompetente gjykata por ndonjë organ administrativ.

Nëse pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe gjatë gjithë zhvillimit të procedurës gjyqtari arrin në vlerësimin se çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencë gjyqësore por është çështje për të cilën kompetent është organi administrativ, atëherë nxjerr aktvendim për inkompetencë dhe padinë e hedhë si të palejueshme.<sup>5</sup>

Në qoftë së gjykata është lëshuar në shqyrtim dhe ka ndërmarrë veprime procedurale, atëherë nxjerrë aktvendim për inkompetencë, i anulon veprimet e ndërmarra dhe padinë e hedhë si të palejueshme.<sup>6</sup>

Në këto raste lënda nuk i dërgohet organit administrativ për të vendosur lidhur me çështjen e shtruar në padinë e paraqitur në gjykatë.<sup>7</sup>

c) Jo kompetenca e gjykatës së vendit

Në praktikë ndodhë që para gjykatës të shtrohen çështje me element të huaj, ku vlerësimi i kompetencës lëndore ka të bëjë me atë që zgjidhjen e çështjes duhet ta ndërmerr gjykata e vendit apo ndonjë gjykatë e vendit të huaj.

---

<sup>4</sup>Neni 392 pika (b) e LPK. Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularëve numër 1.2.3. Në formularin numër 1 është paraqitur jo kompetenca e gjykatës Themelore-Departamentit të Përgjithshëm në raport me Departamentin për Çështje Administrative, në formularin numër 2 në raport me Departamentin për Çështje Ekonomike dhe në formularin numër 3 në raport me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

<sup>5</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 4.

<sup>6</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 5.

<sup>7</sup>Neni 18.2 i LPK-së,

Nëse gjyqtari konstaton se për zgjidhjen e kontestit kompetente është ndonjë gjykatë e ndonjë vendi tjetër e jo gjykata vendore, atëherë gjyqtari me aktvendim e shpallë gjykatën vendore inkompetente, anulon veprimet procedurale të kryera deri në atë fazë dhe padinë e hedhë poshtë. Gjykatësi nuk do të veprojë kështu në rastet kur i padituri jep pëlqimin që gjykata vendore mund të shqyrtojë dhe të vendosë në lidhje me çështjen.<sup>8</sup>

d) Jo kompetenca lëndore kur palët kanë kontraktuar arbitrazhin

Gjykatat mund të përballen me situata ku palët për zgjidhjen e një kontesti të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin. Gjykata, të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas kundërshtimit të palës së paditur për kompetencën do të shpallet in-kompetente, do t'i anulojë veprimet e kryera në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Gjykata nuk vepron kështu vetëm po që se konstaton se kontrata mbi arbitrazhin nuk është e vlefshme, se ka pushuar vlefshmëria e saj apo se nuk mund të realizohet.<sup>9</sup>

e) Jo kompetenca në rastet e procedurave jokontestimore

Në këto raste, gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore.

Nëse gjyqtari gjatë shqyrtimit të lëndës mbi çështjen kryesore konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore, me anë të aktvendimit për in kompetencë do të përfundojë procedurën kontestimore. Në këto raste gjyqtari nuk e hedhë poshtë padinë por çështjen e dërgon tek gjykata kompetente për zhvillimin e procedurës jokontestimore. Duhet të kihet parasysh se veprimet e kryera nga gjykata gjatë procedurës kontestimore (këqyrja direkte, ekspertiza, dëgjimet e dëshmitarëve etj.), si dhe vendimet e marra nga kjo gjykatë nuk shpallen të pavlefshme dhe nuk do të kryhen rishtas.<sup>10</sup>

### 1.3.3 Kompetenca territoriale

Kompetenca territoriale përcakton së cila gjykatë e kompetencës lëndore brenda ndonjë territori të caktuar do të vendos lidhur më një rast konkret. Kompetenca territoriale mund të jetë si kompetencë e përgjithshme e gjykatës dhe kompetencë e veçantë.

### 1.3.4 Roli i gjyqtarit në vlerësimin e kompetencës së përgjithshme territoriale

Gjyqtari me rastin e marrjes në shqyrtim të rastit e vlerëson kompetencën e përgjithshme territoriale të gjykatës duke marrë për bazë vendbanimin apo vendqëndrimin e palës së paditur, ndërsa kur bëhet fjalë për personat juridik kompetenca e përgjithshme territoriale përcaktohet në bazë të territorit të selisë së personit juridik.

Kur para gjykatës jo kompetente paraqitet për objekt shqyrtimi ndonjë çështje e kompetencës së përgjithshme territoriale, atëherë gjyqtari i çështjes mund të marrë aktvendim me të cilin gjykatën e shpallë jo kompetente vetëm pas prapësimit të palës së paditur dhe atë më së voni deri në seancën

---

<sup>8</sup> Neni 18.3 i LPK-së,

<sup>9</sup> Neni 20.1 i LPK-së,

<sup>10</sup> Shih nenin 21 të LPK-së.

përgatitore e në rast së nuk mbahet seanca përgatitore deri në seancën e shqyrtimit kryesor.<sup>11</sup> Nëse tërhiqet propozimi konsiderohet së nuk është paraqitur fare.

Në rastet e përcaktuara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, për procedimin e çështjes është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale edhe gjykata tjetër e caktuar, e cila ndërlidhet më kriteret për caktimin e kompetencës së veçantë.

### 1.3.5 Kompetenca e veçantë territoriale

Kompetenca e veçantë territoriale mund të jetë:

- a) territoriale ekskluzive,
- b) territoriale e zgjedhur dhe
- c) territoriale ndihmëse

- a) Kompetenca territoriale ekskluzive

Kompetenca territoriale ekskluzive e përjashton kompetencën e përgjithshme territoriale dhe asnjë gjykatë tjetër nuk mund të gjykojë në kontestet e tilla.

Rastet kur vjen në shprehje kompetenca territoriale ekskluzive e gjykatës janë përcaktuar me nenin 41, 42 dhe 43 të LPK-së:

Nëse ndonjëri prej këtyre rasteve paraqitet si objekt shqyrtimi para gjykatës e cila nuk ka kompetencë territoriale ekskluzive, atëherë gjyqtari i çështjes sipas detyrës zyrtare pa prapësimin e palës merr aktvendim me të cilin gjykatën e shpallë jo kompetente dhe lëndën ja dërgon gjykatës për të cilën mendon së është kompetente.<sup>12</sup>

- b) Kompetenca territoriale e zgjedhur dhe shembuj të rasteve lidhur me këtë kompetencë

Në rastet e kompetencës territoriale të zgjedhur, pala paditëse mund të zgjedh se ku dëshiron të paraqes padinë dhe atë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore ose ndonjë gjykatë tjetër që mund të jetë kompetente sipas kompetencës tokësore të zgjedhur.

Kompetenca territoriale e zgjedhur mund të vije në shprehje në këto raste:

- a) Kompetenca territoriale e zgjedhur në kontestet martesore
- b) konstatimi i ekzistimit dhe mosekzistimit të martesës,
- c) anulimi i martesës dhe zgjidhja e martesës,

Në këto dy raste pala paditëse ka të drejtë të zgjedhë se a do ta paraqesë padinë në gjykatën e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale apo në gjykatën ku palët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

---

<sup>11</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 6.

<sup>12</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 7.



a. Kompetenca në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e atësisë apo amësisë

Në kontestet e tilla kur palë paditëse është fëmija, atëherë fëmija ka të drejtë që të paraqesë padi ose në gjykatën e kompetencës së përgjithshme ose në gjykatën, në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

Ky rregull për kompetencën e zgjedhur vlen vetëm në qoftë së fëmija është palë paditëse, ndërsa në qoftë se palë paditëse është i ati ose e ëma atëherë vlejnë rregullat e kompetencës së përgjithshme.

b. Kompetenca në kontestet për ushqimin ligjor

Në kontestet e tilla paditësi që kërkon alimentacion ka të drejtë që padinë ta paraqesë përveç në gjykatën e kompetencës së përgjithshme edhe në gjykatën ku paditësi e ka vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin.

c. Kompetenca në kontestet për shpërblimin e dëmit

Edhe te ky rast i kompetencës pala paditëse ka mundësi që ta zgjedhë kompetencën tokësore duke ju drejtuar gjykatës së kompetencës së përgjithshme apo gjykatës tjetër kompetente.

Lidhur me këtë kompetencë paraqiten dy situata:

**Situata e parë:** *i referohet kontesteve lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin nga e cila rrjedh se përveç gjykatës së përgjithshme territoriale kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmit.*

**Situata e dytë:** *i referohet kontesteve kur dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo lëndimit të rëndë trupor nga e cila rrjedh se përveç kompetencës si në situatën e parë kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi ka vendbanimin respektivisht vendqëndrimin.*

Këto rregulla vlejnë për rastet e auto-përgjegjësisë:

**Përshkrimi praktik i situatës së parë:** *Subjekti X me vendbanim nga Prishtina përderisa lëvizë me veturën e tij në qytetin e Pejës, rruga “Haxhi Zeka”, për shkak të pakujdesisë del nga rruga duke u përplasur në murin e jashtëm të shtëpisë së subjektit Y, me ç’rast subjektit Y i shkaktohet dëm material.*

*Në këtë rast subjekti Y, në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë (sipas vendbanimit të të paditurit) apo para gjykatës së zgjedhur në Pejë (sipas vendit ku është kryer veprimi dëmtues).*

**Përshkrimi praktik i situatës së dytë:** *Subjekti X, me vendbanim në Prishtinë, përderisa lëvizë me veturën e tij në qytetin e Prizrenit, rruga “Lidhja e Prizrenit”, për shkak të shpejtësisë së madhe humb kontrollin mbi veturë dhe përplasët me një shtyllë elektrike ku si pasojë e përplasjes vije deri të lëndimi i rëndë i bashkudhëtarit Y i cili është me vendbanim nga Gjilani.*

*Në këtë rast subjekti Y, në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë (sipas vendbanimit të të paditurit), para*

*gjykatës së zgjedhur në Prizren (sipas vendit ku është kryer veprimi dëmtues), apo para gjykatës tjetër të zgjedhur në Gjilan (sipas vendbanimit të palës paditëse).*

d. Kompetenca në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë së prodhuesit

Për gjykim në konteste të tilla përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme (selia e të paditurit) është kompetente edhe gjykata me kompetencë territoriale për shitësin (vendi ku është shitur sendi), kur rasti ka të bëjë me garancinë shkresore.

**Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:** *Subjekti X, me seli në Gjilan merret me prodhimin e radiatorëve të cilët kanë garancion pesë vjeçar. Radiatorët e prodhuar në Gjilan janë shitur nga kompania Y, në Gjakovë e të cilët i ka blerë kompania Z sipas garancionit të prodhuesit X. Pas vendosjes së radiatorëve në punë ka rezultuar se të njëjtit kanë të meta pasi që e rrjedhin ujin.*

*Në këtë rast subjekti Z (blerësi), në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Gjilan (sipas selisë së të paditurit) apo para gjykatës së zgjedhur në Gjakovë (sipas vendit ku është shitur sendi).*

e. Kompetenca në kontestet nga marrëdhënia e punës

Për gjykim në kontestet e tilla kur paditës është punëtori, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhet, si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

**Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:** *Subjekti X nga Peja, është punësuar në ndërmarrjen publike KEK-Prishtinë, mirëpo marrëdhënien e punës e ka themeluar në distriktin e Pejës të kësaj ndërmarrje, ndërsa detyrat e punës si instalues i njehsorëve elektrikë i kryen në territorin e Komunës së Klinës. Subjektit X i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga punëdhënësi për shkak të performancës së dobët.*

*Në këtë rast subjekti X për mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (sipas selisë së të paditurës), para gjykatës së zgjedhur në Pejë (sipas vendit ku ka themeluar marrëdhënien e punës) apo në Klinë (sipas vendit ku ka kryer punët).*

f. Kompetenca sipas vendit të pagesës

Paditësi si posedues i kambialit ose çekut mund të vendos nëse dëshiron që për konteste lidhur me kambialin ose çekun të paraqes padi në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore për nënshkruesin ose në gjykatën në territorin e së cilës duhet të bëhet pagesa nga kambiali dhe çeku.

**Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:** *Subjekti X, është posedues i kambialit apo çekut të lëshuar nga subjekti Y me seli në Prishtinë, si nënshkrues i kambialit apo çekut, ndërsa në kambial apo çek është shënuar vendi i pagesës Gjilan. Nëse vije deri të mos realizimi i pagesës, në këtë rast subjekti X si posedues i kambialit apo çekut, ka të drejtë të paraqes padinë kundër nënshkruesit të kambialit apo çekut-subjektit Y dhe atë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (selia e të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Gjilan (vendi i pagesës).*

g. Kompetenca sipas vendit ku ndodhet njësia e personit juridik

Në kontestet kundër personit juridik paditësi ka të drejtën e paraqitjes së padisë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore ose në gjykatën, në territorin e secilës ndodhet njësia e personit juridik.

**Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:** *Subjekti X, nga Mitrovica, ka lidhur kontratë me Postën dhe Telekomën e Kosovës Prishtinë-(PTK), njësia në Mitrovicë që PTK të shpërndajë rrjetin kabllor në objektin e subjektit X i cili gjendet në Mitrovicë, ku sipas kontratës parashihet se shpërndarja e rrjetit kabllor për internet duhet të përfundojë brenda një muaji nga dita e nënshkrimit të kontratës, në të kundërtën për çdo ditë vonese është kontraktuar kushti penal 0.001 % të vlerës së kontratës. PTK është vonuar pa fajin e subjekti X, në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Në këtë rast subjekti X ka të drejtë të paraqesë padinë kundër PTK-së, në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (selia e të paditurës) apo në gjykatën e zgjedhur në Mitrovicë (vendi ku gjendet njësia e të paditurës).*

h. Kompetenca në konteste për shkak të pengim-posedimit mbi sendin e luajshëm

Në këtë rast paditësi si person i penguar në posedimin e fundit të sendit të luajshëm, mund të zgjedhë që padinë ta paraqesë në gjykatën e kompetencës tokësore të përgjithshme ose në gjykatën, në territorin e së cilës është bërë pengimi.

**Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:** *Subjekti X, nga Prishtina, në territorin e komunës së Gjilanit, subjektit Y ja ka marrë automjetin e markës Audi, tipi 80, të cilin e ka pasur në posedim deri në atë kohë. Në këtë rast subjekti Y ka drejtë të paraqesë padinë kundër X, në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (vendbanimi apo vendqëndrimi i të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Gjilan (vendi ku ka ndodhur pengimi i posedimit).*

i. Kompetenca në kontestet nga marrëdhëniet kontraktuese në kontestet lidhur me:

- ekzistimin ose mosekzistimin e kontratës;
- me përmbushjen ose zgjidhjen e kontratës;
- lidhur me zhdëmtimet e shkaktuara nga mos përmbushja e kontratës.

Në raste të tilla paditësi mundë të zgjedhë që padinë ta paraqesë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore apo në gjykatën në territorin e të cilës pala e paditur ka marrë për obligim që ta përmbushë prestimin në bazë të kontratës.

**Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:** *Subjekti X, nga Prishtina ka lidhur kontratë me subjektin Y nga Prishtina, sipas të cilës subjekti Y për llogari të subjektit X do të bëjë çmontimin e pajisjeve për përpunimin e zhavorrit nga lokacioni i njohur me emrin “Kulla në Ferizaj” dhe të njëjtat pajisje duhet t’i montojë në lokacionin tjetër të njohur me emrin “Kodra” në Ferizaj.*

*Subjekti Y ka dështuar në përmbushjen e kontratës.*

*Në këtë rast subjekti X ka të drejtë që për përmbushjen e kontratës të paraqesë padi në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (vendbanimi apo vendqëndrimi i të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Ferizaj (vendi i përmbushjes së kontratës).*

j. Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet trashëgimore - juridike

Në konteste të tilla paditësi ka të drejtë të paraqesë padinë përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme tokësore edhe në territorin e gjykatës që zbaton procedurën trashëgimore.

Në rastet e tilla padia rëndom do duhej të paraqitet para gjykatës e cila është me kompetencë të përgjithshme territoriale, mirëpo dispozita e nenit 54 të LPK-së, lejon mundësinë që padia të paraqitet edhe në territorin e gjykatës e cila zbaton procedurën trashëgimore. Janë të mundshme situatat kur kontesti mund të iniciohet edhe para gjykatës e cila nuk është e kompetencës së përgjithshme territoriale por është gjykatë e zgjedhur pasi që sipas dispozitës së nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK) parashihet mundësia që në rastin kur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk ka pasur vendbanim e as vendqëndrim të territorin e Kosovës, si kompetente territoriale për shqyrtimin e trashëgimisë të jetë gjykata ku gjendet pasuria trashëgimore e tij.

***Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:*** Në qoftë se subjekti X ka vdekur në Francë dhe i njëjti ka masë trashëgimore në Kosovë por nuk ka vendbanim e as vendqëndrim në Kosovë, atëherë procedura e shqyrtimit të trashëgimisë mund të fillojë në territorin e gjykatës ku gjendet masa trashëgimore. Deri sa nuk përfundon me vendim të formës së prerë procedura e trashëgimisë e iniciuar para gjykatës ku gjendet masa trashëgimore, për gjykim në konteste nga marrëdhënia trashëgimore si dhe në kontestet lidhur me kërkesat e kreditorëve ndaj trashëgimlënësve përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme (vendbanimi apo vendqëndrimi i trashëgimlënësit - Francë) është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata që zbaton procedurën trashëgimore-Kosovë.

#### **1.4 Kompetenca territoriale ndihmëse dhe shembuj të rasteve lidhur me këtë kompetencë**

Nëse lidhur me çështjen që do të paraqitet para gjykatës nuk gjejmë zgjidhje se cila gjykatë do të jetë kompetente sipas dispozitave që rregullojnë kompetencën tokësore të përgjithshme, ekskluzive dhe të zgjedhur atëherë vijnë në shprehje dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencën territoriale ndihmëse që i mundësojnë palës paditëse realizimin e të drejtës në mënyrë më të lehtë.

Kompetenca ndihmëse mund të vije në shprehje në këto raste:

a. kompetenca territoriale ndihmëse për bashkë-ndërgjyqësit

Në rastet kur në cilësinë e palës së paditur paraqitën disa bashkë-ndërgjyqës, kompetenca tokësore e lidhur më njërin palë të paditur vlen për të gjitha palët tjera të paditura, që paraqitën në cilësinë e bashkë-ndërgjyqësve.

Rregullat e kësaj kompetence gjejnë zbatim vetëm për bashkë-ndërgjyqësit pasiv, kur paraqiten si të paditur.

***Përshkrimi praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:*** Subjekti X ka një ordinancë stomatologjike në Prishtinë dhe nga puna e stomatologut ka realizuar të hyra mujore në shumë prej 5000 Euro. Subjektet Y dhe Z me veprimet e tyre të përbashkëta kanë përhapur të dhëna të rrejshme për veprimtarinë e subjektit X gjoja se i njëjti nuk është i kualifikuar për punën që bënë dhe për shkak të

*këtyre të dhënave të rrejshme, subjektit X i është zvogëluar puna, ashtu që tani realizon vetëm 1000 Euro të hyra mujore. Subjekti Y e ka vendbanimin në Ferizaj ndërsa subjekti Z e ka vendbanimin në Gjilan. Në këtë rast për shkak të cilësisë së bashkë ndërgjyqësve pasiv<sup>13</sup> që kanë të paditurit, subjekti Y dhe Z, atëherë paditësi, subjekti X mundet që padinë ta paraqes qoftë në gjykatën Themelore në Ferizaj ose në gjykatën Themelore në Gjilan.*

b. kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet martesore

Në këto konteste kompetenca ndihmëse vjen në shprehje ngase përveç kompetencës së përgjithshme territoriale (ku i padituri e ka vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë), kompetencës së zgjedhur (ku palët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë), vjen në shprehje kompetenca ndihmëse e cila përcakton mundësinë që pala paditëse ta paraqesë padinë në vendin ku e njëjta e ka vendbanimin.

c. kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet e raporteve pasurore-juridike të bashkëshortëve

Në konteste të natyrës së tillë kompetenca tokësore ndihmëse vjen në shprehje pasi që padia mund të paraqitet në territorin e Kosovës përkatësisht në gjykatën në territorin e së cilës pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në kohën e paraqitjes së padisë edhe nga shkakut e pasuria e bashkëshortëve ndodhet në Kosovë.

d. kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e amësisë apo atësisë

Kjo kompetencë i referohet kontesteve me element të huaj por që kompetente është gjykata e vendit tonë, për shkak se pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Kosovë në momentin e ngritjes së padisë, ndërsa kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku paditësi e ka vendbanimin (në territorin e cilës gjykatë brenda Kosovës).

e. kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet për ushqim ligjor

Kjo kompetencë i referohet kontesteve me element të huaj por që kompetente është gjykata e vendit tonë, për shkak se pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Kosovë në momentin e ngritjes së padisë, ndërsa kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku paditësi e ka vendbanimin (në territorin e cilës gjykatë brenda Kosovës).

Po që se kjo kompetencë është e gjykatës së vendit tonë nga shkakut se i padituri e ka pasurinë në Kosovë, nga e cila mund të realizohet ushqimi ligjor, atëherë kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku ndodhet pasuria e të paditurit nga e cila mund të realizohet ushqimi ligjor.

f. kompetenca territoriale ndihmëse për personat për të cilët në Kosovë nuk ekziston gjykata e kompetencës territoriale

---

<sup>13</sup>Bashkë-ndërgjyqësinë e gjeni më hollësisht të trajtuar në kapitullin IX të këtij doracaku.

Në qoftë së kjo kompetencë i referohet kërkesave pasurore juridike kundër personit, për të cilin nuk mund të përcaktohet kompetenca ndërkombëtare e vendit tonë, kompetente është gjykata në territorin e së cilës ndodhet çfarëdo pasurie e palës së paditur apo sendi që kërkohet me padi.

Në qoftë së kjo kompetencë i referohet shkakut se detyrimi është krijuar gjatë qëndrimit të palës së paditur në Kosovë, atëherë është kompetente gjykata në territorin e së cilës është krijuar detyrimi.

Në qoftë së kjo kompetencë i referohet vendit të përmbushjes, atëherë kompetente do të jetë gjykata në territorin e së cilës detyrimi do të përmbushet.

g. kompetenca territoriale ndihmëse sipas vendit ku ndodhet përfaqësia e personit juridik

Për të vendosur lidhur me kontestet kundër personave fizikë apo edhe juridik, të cilët e kanë vendbanimin respektivisht selinë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, por detyrimet janë krijuar apo duhet të përmbushën në Kosovë, atëherë kompetente do të jetë gjykata në territorin e së cilës ndodhet përfaqësia e këtij personi të huaj juridik apo qendra e ndonjë organi të këtij personi juridik, organ të cilit i është besuar kryerja e punëve të tij.

Kjo kompetencë përveç se është ndihmëse, është e karakterit subsidiar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në qoftë se për subjektin e cekur më lartë nuk mund të themelohet kompetenca sipas cilësdo kompetencë të veçantë.

## 1.5 Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata më e lartë

Caktimi i kompetencës të një gjykate nga ana e një gjykate më të lartë ose nga ana e Gjykatës Supreme realizohet përmes institucioni të delegimit dhe ordinimit.

a) Delegimi i domosdoshëm i kompetencës

Në praktikë mund të paraqiten raste kur gjykata kompetente për shkak të përjashtimit të gjyqtarëve apo për shkaqe tjera nuk mund të procedoj me çështjen. Në këto raste gjykata e cila nuk mund të procedojë me çështjen duhet ta njoftojë gjykatën e shkallës më të lartë me qëllim që e njëjta të caktojë gjykatë tjetër nga territori i vet, por që është e kompetencës lëndore për çështjen konkrete.

Rastet më të shpeshta praktike të delegimit të domosdoshëm të kompetencës:

- a) kur kryetari i gjykatës apo ndonjë gjyqtar është palë në procedurë,
- b) kur ndonjë punëtorë i gjykatës është palë në procedurë,
- c) kur gjyqtarët për shkak të përfshirjes në procedura tjera nuk u lejohet të marrin pjesë në gjykimin e çështjes, (gjyqtari që ka marrë pjesë në pajtimin gjyqësor me të cilin ka përfunduar procedura, nuk mund të vendos sipas padisë për anulimin e pajtimit gjyqësor dhe nëse nuk ka gjyqtar tjerë atëherë lënda dërgohet për delegim) etj.

Në këto raste por edhe në raste tjera të mundshme gjyqtari i çështjes duhet që përmes kryetarit të gjykatës të kërkojë nga gjykata më e lartë delegimin e lëndës.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 8.

Pasi që lënda t'i dërgohet gjykatës më të lartë për delegim, kryetari i gjykatës më të lartë (për gjykatat themelore vendos Gjykata e Apelit – Kryetari i Gjykatës së Apelit) me aktvendim vendos për delegimin e lëndës tek gjykata tjetër kompetente.

b) Delegimi i arsyeshëm

Përveç rasteve të cekura te delegimi i domosdoshëm mund të paraqiten rrethana të cilat bëjnë që shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë tjetër të ishte shumë më i lehtë dhe më efikas.

Si rrethana të cilat e bëjnë një gjykatë tjetër më efikase për shqyrtimin e çështjes mund të jenë: kur provat ose shumica e provave gjenden në territorin e gjykatës ku delegohet çështja, p.sh. këqyrja e drejtpërdrejtë e objektit nga gjykata të cilës i është deleguar çështja.

Kur paraqiten arsyt apo rrethanat për delegim të arsyeshëm, propozimin për delegim të arsyeshëm mund ta paraqet pala apo gjykata kompetente. Për të vendosur sipas propozimit të palës apo edhe të vet gjykatës kompetente, kompetente është vetëm Gjykata Supreme e Kosovës.

Delegimi i një çështje juridike prej një gjykate kompetente në ndonjë gjykatë tjetër mund të bëhet vetëm në pikëpamje të kompetencës tokësore dhe jo në aspektin lëndorë. Sipas kësaj nuk mund të bëhet bartja e lëndës nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Çështje Administrative apo në atë për Çështje Ekonomike.

c) Ordinimi

Koncepti i ordinimit vjen në shprehje dhe është i lejueshëm vetëm në rastet kur dihet me saktësi se gjykata e vendit tonë është kompetente në pikëpamje lëndore por nuk dihet se cila gjykatë është kompetente në pikëpamje tokësore.

Procedura për ordinimin vihet në lëvizje në bazë të kërkesës së palës paditëse. Kompetent për të paraqitur këtë kërkesë është vetëm pala paditëse, që mund të jetë edhe prokurori i shtetit.

Gjykata Supreme pasi që t'i vlerësoj rrethanat e paraqitura në kërkesën për ordinim dhe ato sipas detyrës zyrtare, me anë të aktvendimit vendos që ta caktojë gjykatën kompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur.

## 1.6 Marrëveshja mbi kompetencën territoriale

Palët mund të merren vesh që çështjen e tyre juridike ta gjykojë gjykata, e cila sipas rregullave ligjore për kompetencën tokësore nuk do të ishte kompetente për një gjë të tillë. Palët mund të merren vesh vetëm për kompetencën territoriale të gjykatës dhe asnjëherë për kompetencën lëndore të gjykatës.

### **Rastet kur palët mund ta kontraktjnë kompetencën:**

- a) kompetenca mund të kontraktohet vetëm në pikëpamje territoriale,
- b) për çështjet që nuk janë kompetencë ekskluzive e një gjykate tjetër,
- c) për çështjet që kompetente janë dy gjykata territoriale të vendit tonë.
- d) gjykata për të cilën kontraktohet kompetenca duhet të jetë kompetente lëndore.

### **Kushtet për kontraktim të kompetencës:**

- a) marrëveshja e vlefshme e palëve
- b) marrëveshja t'i bashkëngjitet padisë

## **1.7 Konflikti në lidhje me kompetencën**

Paraqitet në rastet kur gjykata së cilës i është dërguar lënda për vendosje konsideron se nuk është kompetente për të vepruar sipas saj, por që është kompetente për të vepruar gjykata e cila ja ka dërguar lëndën ose ndonjë gjykatë tjetër.

Në këtë rast gjykata të cilës i është dërguar lënda, pa dhënë aktvendim për in-kompetencën e saj, nxjerr aktvendim me të cilin e hap konfliktin e kompetencës,<sup>15</sup> dhe në afatin brenda tri ditësh ja dërgon lëndën gjykatës më të lartë<sup>16</sup> në mënyrë që ajo të vendosë lidhur me konfliktin e kompetencës.

- f) Mundësia e gjykatës që të mos kërkojë që të vendoset lidhur me konfliktin e kompetencës

Në rastin kur ka ndodh ndonjë gabim i hapur nga gjykata e parë për kompetencën (kjo vjen në shprehje të rastet e kompetencës territoriale ekskluzive), ku qartazi shihet se kompetente do të ishte ndonjë gjykatë tjetër.

Në vazhdim do të paraqitet një rast praktik kur gjykata ka mundësi që ta rikthejë lëndën te gjykata e shkallës së parë apo te gjykata tjetër pa hapur konflikt për kompetencë.

**Përshkrimi praktik i një situatë të tillë:** *Nëse Gjykata Themelore në Prishtinë ja ka dërguar lëndën Gjykatës Themelore në Pejë, edhe pse kompetente do të ishte Gjykata Themelore në Prizren, për shkak se kontesti ka të bëjë me paluajtshmërinë që gjendet në territorin e kësaj gjykate, atëherë Gjykata Themelore e Pejës, mundet lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore në Prishtinë, pa hapur konflikt të kompetencës pasi që ta vërejë se Gjykata Themelore e Prishtinës, gabimisht e ka dërguar lëndën në Gjykatën Themelore në Pejë.*

- g) Veprimi obligativ i vendimit të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me kompetencën

Nëse pala ka bërë ankesë kundër aktvendimit të gjykatës e cila është shpallë jo-kompetente në pikëpamje tokësore dhe lëndën ja ka dërguar gjykatës kompetente dhe nëse ky vendim bëhet i formës së prerë për shkak se është vërtetuar me vendimin e shkallës më të lartë, atëherë vendimi i gjykatës së shkallës së lartë e obligon edhe gjykatën e dytë të e cila është dërguar lënda nga gjykata e parë.

Kur gjykata nxjerr vendim lidhur me inkompetencën lëndore dhe pala ka bërë ankesë kundër atij vendimi, nëse gjykata kompetente lidhur me konfliktin e kompetencës e refuzon ankesën e palës dhe e

---

<sup>15</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 9.

<sup>16</sup> Në qoftë se konflikti i kompetencës ka lindur në mes të dy gjykatave themelore apo degëve të këtyre gjykatave, atëherë lënda i dërgohet gjykatës së Apelit si gjykata me e lartë për të dy gjykata, ndërsa në qoftë se konflikti është hapur në mes të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, atëherë lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykata me e lartë për të dy gjykatat. Në praktik shumë rrallë mund të ndodhë që të hapët konflikti i kompetencës në mes të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë pasi që me riorganizimin e sistemit gjyqësore është e qartë se gjykatat e shkallës së parë i shqyrtojnë të gjitha çështjet në shkallë të parë ndërsa në gjykata e Apelit, çështjet dërgohen sipas mjeteve të goditjes.



vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, atëherë ky aktvendim i gjykatës së shkallës së parë lidhur me konfliktin për kompetencën i obligon të gjitha gjykatat<sup>17</sup>.

## 1.8 Zgjidhja e konfliktit për kompetencën

Në praktikë ndodhë që konflikti për kompetencën të lindë në atë mënyrë kur dy gjykata pretendojnë se janë kompetente lidhur me shqyrtimin e një çështje kryesore (ky konflikt në shkencën juridike njihet si konflikti pozitiv) ose nëse gjykatat pretendojnë se nuk janë kompetente për zgjidhjen e një çështje konkrete (si konflikti negativ).

### a) Lindja e konfliktit të kompetencës në mes të gjykatave të llojit të njëjtë

Në rast se lindë konflikti lidhur me kompetencën në mes të gjykatave të llojit të njëjtë atëherë kompetente për të vendosur lidhur me këtë është gjykata më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt.<sup>18</sup>

Në rast të lindjes së konfliktit lidhur me kompetencën në mes të gjykatave themelore, kompetent për të vendosur lidhur me këtë do të jetë Gjykata e Apelit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe në rastet e konfliktit të kompetencës në mes të departamenteve të të njëjtës Gjykatë.

### b) Lindja e konfliktit të kompetencës në mes të gjykatave të llojit të ndryshëm

Nëse konflikti i kompetencës lindë në mes të gjykatave të llojit të ndryshëm, kompetent për të vendosur lidhur me zgjidhjen e këtij konflikti është Gjykata Supreme e Kosovës.

Një situatë e tillë do të vije në shprehje nëse lindë konflikti për kompetencën në mes të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

Duhet të kihet parasysh se deri sa është i hapur konflikti lidhur me kompetencën, gjykata e cila e ka pranuar lëndën nga gjykata e parë duhet të ndërmer veprimet e duhura procedurale, nëse ato janë të ngutshme dhe nëse në rast të mosndërmarrjes së këtyre veprimeve procedurale do të shkaktoheshin dëme të pa riparueshme për palët. Një rast i tillë mund të vije në shprehje të çështja e sigurimit të provës, nga e cila provë varet zgjidhja e kontestit ose sqarimi i tij, kur ka rrezik që të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj.<sup>19</sup>

Gjykata kompetente për të vendosur lidhur me konfliktin për kompetencën ka mundësi që të vendos pa shqyrtim gojor të çështjes, pra mund të vendos për konfliktin e kompetencës edhe nëse palët fare nuk janë deklaruar lidhur me kompetencën.

Kundër aktvendimit me të cilin vendoset për konfliktin për kompetencën nuk lejohet përdorimi i mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme.<sup>20</sup>

---

<sup>17</sup>Neni 24.3 i LPK

<sup>18</sup> Nëse konflikti ka lindur në mes të dy gjykatave të llojit të njëjtë, Shembull: Në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj, atëherë për konfliktin e kompetencës do të vendos Gjykata e Apelit si gjykatë me e lartë për të dy gjykatat.

<sup>19</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 74.

<sup>20</sup> Neni 26.par 3 i LPK-së.

## 1.9 Përjashtimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Për të pasur një proces të rregullt gjyqësor kërkohet që gjyqtari me rastin e zgjidhjes së kontestit në mes të palëve të jetë objektiv dhe i paanshëm.

Sa i përket sjelljes së gjyqtarit gjatë kryerjes së detyrave të tij, për këtë shih Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë.<sup>21</sup>

Rrethanat të cilat qojnë deri të përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi janë përcaktuar me nenin 67 të LPK.

Këto janë rrethana të cilat sipas dispozitës ligjore të lartshënuar janë numëruar shprehimisht dhe taksativisht e që duhen të merren për bazë me rastin e përjashtimit të një gjyqtari nga një rast konkret. Për këto rrethana është detyrë e gjyqtarit të çështjes që t'i paraqesë me kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi para kryetarit të gjykatës.

### 1.9.1 Rrethanat të cilat qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Paragrafi g i nenit 67 të LPK, nuk ka rregulluar as shprehimisht as taksativisht rastet e rekuizimit të gjyqtarit, por vetëm ka përmendur faktin nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit në vendosjen e çështjes të shtruar para tij.

Mund të ekzistojnë rrethana të tjera të cilat nuk klasifikohen si shkaqe që në mënyrë automatike gjyqtari të përjashtohet nga gjykimi (rrethanat e parapara nga par. a deri te par. f, të nenit 67 të LPK) por janë rrethana të tilla që mund të sjellin në dyshim paanësinë dhe jo objektivitetin e tij në proces gjyqësor. Në këto raste, nëse gjyqtari i çështjes vlerëson se janë paraqitur rrethana për të cilat duhet të përjashtohet gjyqtari, gjithmonë duke e pasur në vëmendje edhe standardin e kodit të etikës, përmes kërkesës së arsyetuar duhet të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës përjashtimin e vet nga gjykimi.<sup>22</sup>

Si rrethana të cilat mund të vlerësohen si të mjaftueshme për rekuizimin e gjyqtarit nga një proces, mund të jenë:

- Fakti që gjyqtari qëndron në miqësi apo armiçësi me palën;
- Fakti që gjyqtari ka shprehur mendimin e tij se si do të përfundoj procesi para gjykatës (këtu duhet të përfshihet edhe mendimi i dhënë në ambientet private);
- Fakti që gjyqtari më herët ka marrë pjesë në negociim në mes të palëve, lidhur me të njëjtën çështje që është objekt shqyrtimi në procesin konkret;
- Shoqëria shumë e ngushtë në mes të gjyqtarit dhe personit, i cili ka vendosur lidhur me të njëjtën çështje juridike.

Këto janë disa nga rrethanat të cilat me ligj nuk janë paraparë shprehimisht dhe taksativisht por si të tilla u japin mundësi palëve në procedurë që të kërkojnë rekuizimin e gjyqtarit nga procesi gjyqësor.

### 1.9.2 Procedura

Pala duke nënkuptuar edhe secilin bashkë-ndërgjyqës dhe vet-ndërhyrësin ka të drejtë të paraqes kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit kur ka mësuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet për përjashtim. Këtë të drejtë pala mund ta shfrytëzoj deri në përfundim të shqyrtimit kryesor apo deri në nxjerrjen e

---

<sup>21</sup>Parimet e përgjithshme sipas Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, më 25 prill 2006

<sup>22</sup>Për rrethanat që njihen si rrethana për rekuizim të gjyqtarit, në praktikën gjyqësore ka një standard sipas të cilit në mënyrë parimore dihet se kur do të përjashtohet një gjyqtar nga gjykimi dhe kur nuk do të përjashtohet. Në këtë kuptim gjyqtarët asnjëherë nuk guxojnë ta përdorin mundësinë e përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi më qëllim që tu shmangën dosjeve komplekse, por mundësia e përjashtimit të gjyqtarit gjithmonë duhet të vije në shprehje në rastet kur ekzistojnë arsye të vërteta që e sjellin në dyshim paanësinë dhe objektivitetin e gjykatës.

vendimit meritor. Pala mundet që edhe në mjetin e goditjes së vendimit përfundimtar por edhe në përgjigje të mjetit të goditjes t'i theksojë rrethanat që kanë të bëjnë me përjashtimin e gjyqtarit nga një proces gjyqësor.

Edhe vet gjyqtari ka për detyrë që të vlerësoj ex officio se a ekzistojnë shkaqe për përjashtimin e tij nga një proces konkret.<sup>23</sup>

Kur janë në pyetje rrethanat për përjashtimin e gjyqtarit sipas paragrafit a, deri te par f të nenit 67 të LPK, mjafton vetëm paraqitja e të dhënave që dëshmojnë ekzistimin e raportit që është paraparë në ligj. Ndërsa kur janë në pyetje rrethanat nga paragrafi g, i këtij neni, që ka të bëjë me arsyet për rekuizimin e gjyqtarit, nga pala që kërkon rekuizimin e gjyqtarit duhet që të paraqes fakte të ndryshme dhe prova për ta dëshmuar se ekziston baza për rekuizimin e gjyqtarit.

Gjyqtari ka për obligim që ta ndërpres çdo veprim procedural posa ta kuptoj se është shtruar kërkesa rrethanë për përjashtimin e tij (kjo ka të bëjë vetëm me rrethanat nga paragrafi a deri te paragrafi f i nenit 67 të LPK) dhe për këtë ta njoftoj Kryetarin e Gjykatës.<sup>24</sup>

Kur kërkohet përjashtimi i gjyqtarit për rrethanat e parapara në nenin 67 pika g, që kanë të bëjnë me rekuizimin e gjyqtarit, gjyqtari i çështjes për këtë e njofton kryetarin e gjykatës por ka mundësi që të ndërmarr veprime të caktuara, nëse ndërmarrja e atyre veprimeve nuk mund të shtyhet.

### **1.9.3 Autoriteti kompetent që vendosë lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit**

Autoriteti kompetent që vendos për përjashtimin e gjyqtarit nga një proces nuk duhet të pranojë shumë lehtë kërkesa për përjashtim, përndryshe palët do të kenë sukses për të ndikuar në mënyrë efektive në zgjedhjen e gjyqtarit në rastin e tyre.

Para se të vendoset lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, merret deklarata e gjyqtarit me qëllim të vërtetimit të rrethanave sipas rregullit të të provuarit, rezultati i të cilit e bën të besueshëm ekzistimin e shkakut për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi konkret. Lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit vendos kryetari i gjykatës pranë së cilës gjykatë është shtruar çështja.<sup>25</sup> Nëse kërkohet përjashtimi apo rekuizimi i kryetarit të gjykatës për këtë vendos kryetari i gjykatës më të lartë. P.sh. nëse kërkohet përjashtimi ose rekuizimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për këtë vendos Kryetari i Gjykatës së Apelit. Ndërsa lidhur me kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit vendos Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa për kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme vendos Seanca e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Kundër aktvendimit me të cilin aprovet apo refuzohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk lejohet ankesa.

### **1.9.4 Kërkesat e palejuara**

Në praktikë ndodh që palët me qëllim të zvarritjes së procesit dhe ndërprerjes së punës së gjykatës të bëjnë kërkesa të ndryshme për përjashtim dhe rekuizim të gjyqtarit, dhe atë:

- kërkojnë përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës së caktuar që të gjykojnë në një kontest të caktuar;
- kërkesën për të cilën është vendosur njëherë, si dhe

---

<sup>23</sup> Nëse gjyqtari konstaton se ekzistojnë rrethanat për të cilat ai duhet të përjashtohet nga gjykimi, i njëjti duhet të përgatisë kërkesën me shkrim për përjashtim të tij nga gjykimi dhe të njëjtën të ja paraqes kryetarit të gjykatës.

<sup>24</sup> Neni 71.1 i LPK.

<sup>25</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 10 te këtij doracaku

- kërkesa që nuk përmbajnë arsyetim lidhur me kërkesën për përjashtimin ose rekuizimin e gjyqtarit.

Lidhur me këto kërkesa të palejuara kompetent për të vendosur është gjyqtari që është duke e proceduar çështjen. Gjyqtari bie aktvendim të veçantë me të cilin e hudh kërkesën për përjashtim, kundër të cilit vendim nuk lejohet ankesë e veçantë.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**

## 1.10 Formularët praktikë për kompetencën e gjykatës

### Formulari 1 – Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ja dërgon Departamentit për Çështje Administrative

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, duke vendosur jashtë seancës, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, Departamenti i Përgjithshëm shpallet jo kompetentë në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit \_\_\_\_\_ me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.
- II. Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

#### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 25.06.2007, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen, anulim i vendimit.

Departamenti i Përgjithshëm i kësaj gjykate, duke u kujdesur për kompetencën lëndore, vlerësoi se për të vendosur në këtë çështje juridike kompetente në pikëpamje lëndore është Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin paraprak të padisë, gjeti se çështja e cila është objekt i saj, në rastin konkret përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës Departamenti i Përgjithshëm i kësaj gjykate nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij kontesti është kompetent Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kjo nga arsyet në vijim:

Sipas Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me nenin 14 është paraparë që: “kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi”.

Meqë kërkesa e paditësit ka të bëjë me vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe duke u nisur nga dispozita ligjore e lartshënuar ku për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të këtij organi mund të iniciohet konflikti administrativ, atëherë mbi këtë bazë u vendos që Departamenti i Përgjithshëm i kësaj gjykate të shpallet jo kompetentë në pikëpamje lëndore dhe lënda t’i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë e në bazë të neneve 17 dhe 19 e lidhur me nenin 391 par. 1 pika “a” e LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, me dt. \_\_\_\_\_

G j y q t a r i

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

**Formulari 2 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore dhe lëndën ja dërgon Departamentit për Çështje Ekonomike**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, duke vendosur jashtë seancës, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike.

II. Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Departamentit \_\_\_\_\_ për Çështje Ekonomike të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_, ka ushtruar padi ndaj të paditurave \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore vlerësoi se për të vendosur në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Departamentit për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate.

Në bazë të ligjit për gjykatat neni 13, paragrafi 1.5 parashihet se kompetencë e Departamentit për Çështje Ekonomike është edhe mbrojtja e të drejtave pronësore dhe të pronës intelektuale.

Në rastin konkret objekt i kërkesëpadsisë është kompensimi për shkak të shkeljes së të drejtave të autorit, përkatësisht shfrytëzimi i paautorizuar i të drejtës autoriale.

Në bazë të neneve 17 dhe 19, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet që gjykata gjatë tërë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore, andaj edhe duke u bazuar nga sa u cek më lartë, ky departament i kësaj gjykate është shpallur jo kompetent në pikëpamje lëndore për ta gjykuar këtë çështje juridike kontestimore.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e duke u bazuar në nenin 17,19, lidhur me nenin 392 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

G j y q t a r i,

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.



### **Formulari 3 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore dhe lëndën ja dërgon Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, duke vendosur jashtë seancës, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

I. Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të gjykuar këtë çështje kontestimore, sipas padisë me numër C.nr. \_\_\_\_\_.

II. Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

#### **A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_, nga Podujeva, ka ushtruar padi ndaj të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore vlerësoj se për të vendosur në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në bazë të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.04/L-033, i datës 31.08.2011, sipas neneve 4.1.4, 4.1.5, 4.1.5.1, Dhoma e Posaçme ka kompetencën ekskluzive për kërkesat kundër një Ndërmarrje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrative të AKM-së apo Agjencisë, kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ etj.

Ndërsa sipas nenit 4.4 pika (i), thuhet se nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, nuk ka marrë ndonjë aktvendim substancial në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë pushon së pasuri kompetencë mbi lëndën dhe i kthen të gjitha dokumentet dhe shkresat e lëndës tek Dhoma e Posaçme.

Andaj, duke pasur parasysh padinë e parashtruar nga pala paditëse në pajtim me dispozitat e cekura më lartë, për gjykimin e kësaj çështje juridike kontestimore, kompetente lëndore është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke u bazuar në Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L-033 i datës 31. 08. 2011.

Në bazë të neneve 17 dhe 19, të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet që gjykata gjatë tërë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore, andaj edhe duke u bazuar nga sa u cekë më lartë, kjo gjykatë është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për t'a gjykuar këtë çështje juridike kontestimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 17, 19, lidhur me nenin 392 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr \_\_\_\_\_, me dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLA JURIDIKE:**

kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

## Formulari 4 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore dhe e hedh poshtë padinë si të palejuar

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, duke vendosur jashtë seancës, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_ shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit \_\_\_\_\_, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.
  
- II. HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR padia e paditësit \_\_\_\_\_, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin paraprak të padisë gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje administrative, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij kontesti është kompetent Zyra e Rregullatorit për Energji, kjo nga arsyet në vijim:

Sipas Ligjit Nr. 03/L-185 Për Rregullatorin e Energjisë, me nenin 16 par.1 pika 3 është paraparë që Zyra e Rregullatorit për Energjinë ka kompetencat për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë edhe ankesat në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmisionit apo shpërndarjes së energjisë elektrike. Ndërsa me nenin 25 par. 1 pika e të njëjtit ligj, Zyra e Rregullatorit ka kompetencë që të nxjerr vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 16 të këtij ligji.

Me nenin 25 par 3 të po këtij ligji është paraparë se: “aktet individuale të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen procedurave të shqyrtimit administrativ brenda Zyrës së Rregullatorit për Energji. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit administrativ, pala e pakënaqur mund të fillojë procedurën administrative për zgjidhjen e kontestit në gjykatën kompetente në Kosovë, në pajtim me nenin 43 të këtij ligji dhe me Ligjin mbi Procedurën Administrative”.

Edhe sipas Rregullit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të hartuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me datën 29.08.2011, me neni 18 pika 5 është paraparë që kundër vendimeve të Bordit të ZRRE-së konsumatorët apo të licencuarit mund të iniciojnë konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda (30) ditësh kalendarike nga data e pranimi të vendimit apo publikimit në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, rezulton se kjo gjykatë është inkompetente për vendosjen lidhur me kërkesën e paditësit, prandaj për këtë arsye, e në bazë të neneve 17, 18, 19, 29 dhe lidhur me nenin 391 par. 1 pika “a” e LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, me dt. \_\_\_\_\_.

Gjyqtari,

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

**Formulari 5 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente lëndore, i shpallë të pavlefshme veprimet e kryera dhe e hedh poshtë padinë si të palejuar**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, duke vendosur jashtë seancës, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditësit \_\_\_\_\_, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.
- II. SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e kësaj gjykate në këtë çështjen kontestuese.
- III. HEDHET SI E PALEJUAR padia e paditësit \_\_\_\_\_, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

**A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_ ka ushtruar padi në këtë gjykate me dt. \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin paraprak të padisë të njëjtën i ka dërguar për përgjigje palës së paditur. I padituri me përgjigje në padi e ka kundërshtuar padinë duke theksuar së e njëjta është e pa lejuar pasi që objekti i kontestit ka të bëjë me çështjen administrative e jo me çështje gjyqësore.

Pasi që gjykata vlerësoj prapësimin e të paditurës gjeti se çështja e cila është objekt i kontestit përfaqëson çështje administrative, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij kontesti është kompetent Zyra e Rregullatorit për Energji, kjo nga arsyet në vijim:

Sipas Ligjit Nr. 03/L-185 Për Rregullatorin e Energjisë, me nenin 16 par.1 pika 3 është paraparë që Zyra e Rregullatorit për Energjinë ka kompetencat për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë edhe ankesat në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmissioinit apo shpërndarjes së energjisë elektrike. Ndërsa me nenin 25 par. 1 pika e të njëjtë ligj, Zyra e Rregullatorit ka kompetencë që të nxjerr vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 16 të këtij ligji.

Me nenin 25 par 3 të po këtij ligji është paraparë se: “aktet individuale të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen procedurave të shqyrtimit administrativ brenda Zyrës së Rregullatorit për Energji. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit administrativ, pala e pakënaqur mund të fillojë procedurën administrative për zgjidhjen e kontestit në gjykatën kompetente në Kosovë, në pajtim me nenin 43 të këtij ligji dhe me Ligjin mbi Procedurën Administrative”.

Edhe sipas Rregullit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të hartuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me datën 29.08.2011, me neni 18 pika 5 është paraparë që kundër vendimeve të Bordit të ZRRE-së konsumatorët apo të licencuarit mund të iniciojnë konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të vendimit apo publikimit në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, rezulton se kjo gjykatë është inkompetente për vendosjen lidhur me kërkesën e paditësit, prandaj për këtë arsye, e në bazë të neneve 17, 18, 19, 29 dhe lidhur me nenin 391 par. 1 pika “a” e LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat në kuptim të dispozitës së nenit 17, 18.1, 18.2, 19 dhe 391 të LPK-së , vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i,

**KESHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

## Formulari 6 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente territoriale ekskluzive

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditëses \_\_\_\_\_, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson \_\_\_\_\_, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_ gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtimin përgatitor – kryesor, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, SHPALLET JOKOMPETENTE EKSKLUZIVE në pikëpamje territoriale për procedimin e kësaj çështje juridiko-civile.
  
- II. Pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, padia i dërgohet në kompetencë Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ ka parashtruar padi kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen vërtetimi i të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri, e cila gjendet në Ferizaj e identifikuar si ngastër me numër \_\_\_\_\_, sipërfaqja \_\_\_\_\_.

Me nenin 41.1 të LPK-së, përcaktohet se: “Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria”.

Sipas nenit 17.1 të LPK-së është përcaktuar se “Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur”. Ndërsa sipas dispozitës së nenit 22.3 të LPK-së “Gjykata mund të shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale sipas detyrës zyrtare kur ekziston kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate tjetër”.

Në rastin konkret gjykata konstatoj se prona gjendet në territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, në mbështetje të nenit 17.1, 22.3, 44.1, 387 dhe lidhur me nenin 392 të LPK-së si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_ me dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afatin pre 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën së Apelit në Prishtinë.

## Formulari 7 - Aktvendimi me të cilin gjykata shpallet jo kompetente territoriale

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditëses \_\_\_\_\_, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson \_\_\_\_\_, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_ gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtimin përgatitor – kryesor, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, SHPALLET JOKOMPETENTE në pikëpamje territoriale për procedimin e kësaj çështje juridike.
  
- II. Pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, padia i dërgohet në kompetencë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

### A r s y e t i m

Paditësja \_\_\_\_\_ ka parashtruar padi kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Në bazë të nenit 49 të LPK-së, për gjykim të kontesteve nga marrëdhënia e punës është kompetente, përpos të gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer ose gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar kompetencën territoriale të kësaj gjykate për të vendosur lidhur me padinë e paditëses.

Gjykata pasi ka vlerësuar kundërshtimin e të paditurës dhe pasi konstatoi faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune, - ka kryer punën si mësimdhënëse në territorin e Komunës së \_\_\_\_\_, duke ju referuar nenit 22. 49, 387 e lidhur me nenin 392 të LPK u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_ me dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afatin pre 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.



## Formulari 8 - Kërkesë për delegim të kompetencës

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C. nr. \_\_\_\_\_

Prishtinë, me datë \_\_\_\_\_

Për: Gjykatën e Apelit në Prishtinë

Kryetarit të Gjykatës Z. \_\_\_\_\_

Nga: Gjykata Themelore në Prishtinë

Kryetari, z. \_\_\_\_\_

Lënda: Kërkesë për caktim të kompetencës territoriale në një gjykatë tjetër

I nderuar z. Kryetar, ju njoftoj se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjendet lënda me shenjën C.nr. \_\_\_\_\_, e iniciuar sipas padisë së paditëses \_\_\_\_\_, nga Prishtina, kundër të paditurve:

- Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe
- N \_\_\_\_\_ N \_\_\_\_\_, nga Prishtina, punëtor i kësaj gjykate

Sipas renditjes kjo lëndë i është ndarë gjyqtarit \_\_\_\_\_, i cili më ka njoftuar se nuk mund ta procedojë lëndën me qenë se të paditur janë, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe N \_\_\_\_\_ N \_\_\_\_\_ punëtor i kësaj gjykate.

Z. Kryetar, me qenë se në këtë rast ekzistojnë kushtet për përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Prishtinë, kërkojmë nga ju që në kuptim të dispozitës nga neni 63 i Ligjit për Procedurë Kontestimore, të caktoni një gjykatë tjetër nga territori i gjykatës së Apelit, si gjykatë kompetente territoriale për çështjen kontestuese në fjalë.

Përveç të tjerave caktimi i një gjykatë tjetër si kompetente territoriale, në këtë çështje kontestuese do të ndikojë pozitivisht edhe në besimin e opinionit ndaj gjykatës sonë.

Kryetari i Gjykatës

## Formulari 9 - Mënyra e hapjes së konfliktit të kompetencës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, duke vendosur jashtë seancës, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_, nga Ferizaji, ka ushtruar padi në Gjykata Themelore në Ferizaj, me datën 25.06.2014, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve \_\_\_\_\_ Prishtinë, për kompensim dëmi, për aksidentin e datës 02.02.2014, i cili ka ndodhur në Malishevë, e si pasojë e të cilit paditësi ka pësuar lëndime trupore.

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin e datës 05.07.2014, është shpallur jokompetente territoriale dhe lëndën e ka dërguar për vendosje në Gjykata Themelore në Prishtinë, me arsyetim së në kuptim të dispozitave nga neni 47 i LPK-së, kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë, sipas kompetencës së përgjithshme pasi që selia e të paditurës është në Prishtinë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, sipas dispozitës së nenit 24 të LPK-së, e hap konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që vlerëson së në rastin konkret është kompetente pikërisht gjykata që është shpallur jo kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridike kontestimore.

Kjo gjykatë gjen se LPK me dispozitën e nenit 47.1 parasheh se gjykatë e kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit, ndërsa me par. 2 të nenit 47 parashihet se në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është, përpos gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet.

Në rastin konkret sipas vlerësimit të kësaj gjykate me qenë së paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore e në kuptim të dispozitave të lartë cituara kompetente është gjykata Themelore në Ferizaj, pasi që paditësi më që bëhet fjalë për kompetencë të zgjedhur ka të drejtë të vendos së ku do të parashtrij padinë dhe në këtë rast paditësi ka vendosur të parashtrijë padinë në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Mbi bazën e të dhënave si më lartë e në bazë të nenit 24 e lidhur me nenin 47, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, me dt. \_\_\_\_\_

G j y q t a r i

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 10 - Aktvendim me të cilin pranohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_

Kryetari i Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_, pasi shqyrtojë kërkesën e dt. \_\_\_\_\_, ushtruar nga paditësja \_\_\_\_\_ nga Prishtina, për përjashtimin e gjyqtarit \_\_\_\_\_ në çështjen kontestuese kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, pasi mori deklaratën e gjyqtarit lidhur me këtë çështje, në bazë të nenit 70 të LPK-së, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Pranohet kërkesa e dt. \_\_\_\_\_ e paditëses \_\_\_\_\_ nga Prishtina, PËRJASHTOHET gjyqtari \_\_\_\_\_ nga gjykimi në lëndën C.nr. \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Me kërkesën e dt. \_\_\_\_\_ pala paditëse ka kërkuar që lënda gjyqësore C.nr. \_\_\_\_\_ e cila i është ndarë për gjykim gjyqtarit \_\_\_\_\_, t'i ndahet një gjyqtari tjetër pasi që ekziston mundësia që pala e paditur në ndërkohë të paraqes kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, pasi që i njëjti para se të emërohet në pozitën e gjyqtarit, në cilësinë e avokatit ka përfaqësuar në disa çështje familjen e paditëses - paraqitëses së kërkesës \_\_\_\_\_. Ka shtuar se çështja në fjalë është urgjente ngase edhe veprimi sipas kërkesës për masë sigurimi është urgjent.

Kryetari i Gjykatës pasi që shqyrtoi kërkesën bëri shikimin në shkresat e lëndës dhe pasi që mori deklaratën e gjyqtarit, duke i analizuar në kuptim të dispozitave të LPK-së gjeti se kërkesa është e bazuar. Kjo nga fakti se edhe gjyqtari i çështjes i ka pohuar rrethanat se me herët në cilësinë e avokatit ka përfaqësuar familjen e paditëses – paraqitëses së kërkesës \_\_\_\_\_.

Kryetarit vlerëson se përjashtimi i gjyqtarit, në këtë fazë të procedurës do të ndikojë pozitivisht në rritjen e besimit të palët për objektivitetin e gjykatës.

Nga arsyet e paraqitura del se në rastin konkret ekzistojnë rrethana që e sjellin në dyshim paanësinë e gjyqtarit \_\_\_\_\_ në këtë gjykim, ashtu siç parashihet në nenin 67 pika (g) e LPK-së .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_, C.nr. \_\_\_\_\_

Dt. \_\_\_\_\_

Kryetari i Gjykatës

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## KAPITULLI II

# **PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE**

## 2 PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE

### 2.1 Kuptimi i palëve në procedurën kontestimore

Procedura kontestimore është procedurë dypalëshe. Asaj i paraprinë kontesti në mes të palëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre nga marrëdhënia e caktuar juridike. Në fakt, Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK), nuk e përkufizon në mënyrë të qartë termin palë, por për të kuptuar këtë term mund të merret ajo se;

- a) Padiësi, është ai i cili nga gjykata kërkon mbrojtjen e të drejtës së tij subjektive, ndërsa
- b) I padituri, është ai ndaj të cilit kjo mbrojtje realizohet<sup>26</sup>.

Edhe me nenin 2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, është e paraparë se shprehja palë nënkupton kreditorin apo debitorin në procedurën përmbartimore.

#### 2.1.1 Kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore

Secili person fizik dhe juridik mund të jetë palë në procedurën kontestimore. Kjo është ajo që njihet si aftësia juridike e cila tek personat fizik arrihet me lindje (bile edhe para lindjes te marrëdhëniet juridike – trashëgimore nëse fëmija lind i gjallë), ndërsa tek personat juridik kjo aftësi fitohet në bazë të rregullave të veçanta materialo juridike, përkatësisht me regjistrimin e personit juridik pranë organit kompetent. Personat juridik duhet të kenë pasurinë e tyre e cila është e përshtatshme për përmbartim gjyqësor, si dhe që përmes akteve të përgjithshme, këtij personi juridik, t'i jetë pranuar cilësia e tillë e personit juridik si bartës i pavarur i të drejtave dhe obligimeve në qarkullimin juridik.

Cilësinë e personit juridik e kanë edhe komunat si njësi administrativo–territoriale,<sup>27</sup> përmes të cilave realizohet vetëqeverisja lokale, ndërmarrjet publike, si dhe entitetet e tjera, përkatësisht bashkësitë e tjera të personave të cilat në bazë të ligjit mund të jenë palë në procedurë, apo ato forma të bashkimit të cilave gjykata ua njeh cilësinë e palëve, me kusht që ato forma të bashkimit t'i përmbushin kushtet e nevojshme që të jenë bartës të pavarur të drejtave dhe obligimeve në marrëdhëniet juridiko-civile dhe që të disponojnë me pasuri e cila mundë të jetë e përmbartueshme.<sup>28</sup>

Sipas mendimit juridik të Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës<sup>29</sup>, pranë Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkatësisht Departamentit për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës së Apelit, si palë mund të paraqiten edhe:

- a) biznesi individual;
- b) ortakët e shoqërisë së ortakërisë, ortakët e përgjithshëm dhe të kufizuar të shoqërisë komandite;
- c) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar;
- d) shoqëria aksionare;
- e) drejtori apo drejtorët menaxhues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe
- f) bordi i drejtorëve të shoqërisë aksionare<sup>30</sup>.

Gjykata është e obliguar që gjatë të gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, të kujdeset në lidhje me zotësinë juridike të palëve respektive. Nëse palët nuk e kanë këtë zotësi, atëherë procedura nuk mund zhvillohet më tutje dhe nëse edhe përkundër ftesës së gjykatës, kjo mangësi nuk evitohet, padia do të hidhet poshtë, ndërsa veprimet e ndërmarra më parë, do të abrogohen.<sup>31</sup>

Përveç zotësisë juridike, si parakusht procedural për zhvillimin e procesit kontestimor, paraqitet edhe zotësia për të vepruar, përmes të cilës pala mundet që vetë dhe në mënyrë të pavarur të ndërmerr

---

<sup>26</sup>Shih "Praktikum za parnicu", Vukasin Ristic, Milosin Ristic, Beograd, 2000, faqe 35.

<sup>27</sup> Shih nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

<sup>28</sup>Shih nenin 73.3 të LPK-së.

<sup>29</sup> Mendimi Juridik Nr. 217/13 i datës 25.03.2013

<sup>30</sup> Shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.217/13, të datës 25.03.2013

<sup>31</sup> Shih nenin 78.4 i LPK-së.

veprime në procedurën kontestimore (e cila ndryshe njihet edhe si zotësia procedurale). Zotësia për të vepruar tek personat fizik përputhet në tërësi me zotësinë e plotë punuese e cila rregullohet me dispozitat materialo-juridike.

Personi fizik zotësinë për të vepruar dhe zotësinë e plotë punuese e arrin në moshën 18 vjeçare, apo para kësaj, nëse në bazë të lejes së gjykatës kompetente që të lidhë martesë.

LPK parasheh se i mituri i cili nuk e ka fituar plotësisht zotësinë për të vepruar, ka zotësi procedurale brenda kufijve në të cilët i njihet zotësia për të vepruar.<sup>32</sup> Deri në moshën 14 vjeçare, personi fizik nuk e ka zotësinë punuese (nuk e ka zotësinë procedurale), e pasi që të mbushë 14 deri 18 vite, ai është pjesërisht i aftë. Me arrijtjen e moshës 15 vjeçare, i mituri mund të themelojë marrëdhënie pune, të disponojë me të ardhurat, si dhe mundet që para gjykatës të paraqitet si palë, apo të përpiloj testament.

Kur personi madhor privohet në tërësi nga zotësia e tij për të vepruar, ai më nuk e ka as zotësinë procedurale dhe i njëjti barazohet me personin e mitur nën 14 vjet. Por personi madhor të cilit i është kufizuar pjesërisht zotësia për të vepruar, e ka zotësinë procedurale në kufijtë e zotësisë së tij për të vepruar (neni 74.2 i LPK). Në këto raste, organi i kujdestarisë<sup>33</sup> i cakton punët juridike të cilat ky person mund t'i ndërmerr në mënyrë të pavarur, si dhe përcakton se për cilat veprime ai e posedon zotësinë procedurale.

### 2.1.2 Kush e përfaqëson palën me pazotësi procedurale

Palën e cila nuk e ka zotësinë procedurale, e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor. Ai përcaktohet me ligj apo me aktin e organit shtetëror kompetent të marrë në bazë të ligjit.<sup>34</sup>

Pala e cila e ka zotësinë procedurale, veprimet në procedurë mund t'i ndërmerr personalisht apo nëpërmes të personit të cilin e autorizon (i autorizuari).

Personat juridik nuk e kanë zotësinë procedurale. Ata në procedurë i përfaqësojnë përfaqësuesit e tyre të cilët caktohen në bazë të ligjit dhe rregullave të tjera. Komunitat i përfaqësojnë Avokatët Publikë, si përfaqësues ligjorë në bazë të Ligjit mbi Avokaturën Publike Komunale<sup>35</sup>, ndërsa organet qendrore shtetërore, divizioni për përfaqësimin e Ministrisë së Drejtësisë. Pas aprovimit të Ligjit nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.8, të datës 08.04.2013, autoritetet publike të Republikës së Kosovës, pranë organeve gjyqësore, të arbitrazhit apo ato administrative, i përfaqëson Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, avokati shtetëror, apo personi i autorizuar i punësuar pranë Avokaturës Shtetërore apo pranë organit tjetër të administratës shtetërore, e i cili e ka të dhënë provimin e jurisprudencës.<sup>36</sup>

Personat fizikë madhor të cilët në tërësi janë të privuar nga zotësia për të vepruar, i përfaqësojnë kujdestarët të caktuar nga ana e organeve të kujdestarisë, kurse kujdestari mund të caktohet edhe për personat të cilët pjesërisht janë të privuar nga zotësia për të vepruar, varësisht nga lloji i kontestit i cili mund të zhvillohet para gjykatës.

Personat e mitur, në rastet kur ata janë plotësisht të paaftë në aspektin e veprimit (u mungon zotësia procedurale), apo kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të tyre, sipas ligjit i përfaqësojnë prindërit e tyre.

## 2.2 Përfaqësuesi ligjor

Sipas rregullit, përfaqësuesi ligjor i ka të gjitha autorizimet dhe detyrimet e palës në procedurën kontestimore. Por në rastet e caktuara, me rregulla të veçanta mund të parashihet që përfaqësuesi ligjor

---

<sup>32</sup> Shih neni 74.3 i LPK-së.

<sup>33</sup> Organi i Kujdestarisë në kuadër të Qendrave për Punë Sociale.

<sup>34</sup> Shih nenin 75.2 të LPK-së.

<sup>35</sup> Ligji për Avokaturën Publike (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.9/83).

<sup>36</sup> Shih nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.8, e datës 08.04.2013.

duhet të ketë autorizim të veçantë për ndërmarrjen e veprimeve individuale kontestimore, të cilat kanë ndikim esencial në rrjedhën dhe fatin e procedurës.

Rastet e tilla janë p.sh. në:

- a) parashtrimin apo tërheqjen e padisë;
- b) pranimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- c) lidhjen e ujdisë dhe të tjera, kur përfaqësuesi ligjor për ndërmarrjen e këtyre veprimeve duhet të ketë autorizim të posaçëm.<sup>37</sup>

Gjykata është e detyruar që gjatë gjithë procedurës të kujdeset sipas detyrës zyrtare se a janë përmbushur prezumimet procedurale në raport me zotësinë juridike dhe atë të veprimit (zotësinë procedurale) të palës në procedurë, në rregullsinë e përfaqësimit të palës e cila nuk e ka zotësinë e veprimit nga ana e përfaqësuesit ligjor, në rregullsinë e autorizimit të tij të veçantë në rastet kur ky autorizim është i nevojshëm dhe të ndërmerr masat e nevojshme që këto mangësi të mënjanohen. Procedura nuk mund të vazhdojë deri sa këto mangësi nuk eliminohen sepse çfarëdo vendimi gjyqësor i cili do të përmbante këto mangësi, do të prishej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë të parapara me nenin 182 par.2 pika (k) të LPK-së. Për këtë arsye në këto raste gjykata do të duhej t'i abrogonte veprimet e ndërmarra deri atëherë dhe ta hedhë padinë.<sup>38</sup>

### 2.2.1 Përfaqësuesi i përkohshëm

Nëse procedura rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për personin (të paditurin) me pazotësi të veprimit (pazotësi procedurale) nga ana e organit të kujdestarisë do të zgjaste shumë dhe do të mund të prodhonte pasoja të dëmshme për cilëndo palë, LPK ka paraparë mundësinë që gjykata e shkallës së parë t'ia caktojë atij (të paditurit pra) përfaqësuesin e përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në procedurë i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor dhe këto të drejta dhe detyrime i ushtron derisa i padituri apo i autorizuari i tij nuk paraqiten në gjykatë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.<sup>39</sup>

Gjykata do t'ia caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm në rastet të cilat janë të saktësuara me ligj dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë organin kompetentë të kujdestarisë si dhe palët kur një gjë e tillë është e mundshme.

Nëse të paditurit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga arsyeja se vendbanimin e ka të panjohur, kurse nuk ka të autorizuar, si dhe nëse ai dhe përfaqësuesi i tij ligjor gjenden në botën e jashtme kurse nuk kanë të autorizuar në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe nëse dorëzimi nuk ka mundur të kryhet, gjykata brenda afatit prej shtatë (7) ditësh do të jap shpallje e cila do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa që shpallja do të afishohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës së çështjes, e sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.<sup>40</sup> Në këtë rast procedura do ta vazhdojë deri sa i padituri nuk lajmërohet në gjykatë respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.<sup>41</sup>

Shpenzimet e shpalljes për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në rastet e parapara sikurse në nenin 79.3 të LPK-së, (shpenzimet e botimit të shpalljes në ndonjë gazetë), duhet t'i deponojë paditësi. Në këtë rast, paditësi duhet t'i deponojë edhe shpenzimet për pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm për pjesëmarrje në seancat gjyqësore, të llogaritura sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës,

---

<sup>37</sup> Shih nenin 77 të LPK-së.

<sup>38</sup> Shih nenin 78.4 të LPK-së, si dhe formularin praktik me nr.3.

<sup>39</sup> Shih nenin 82 të LPK-së.

<sup>40</sup> Shih nenin 83 të LPK-së.

<sup>41</sup> Shih formularin praktik nr. 1.

për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve, përkatësisht nr. tarifor 7, të ekstraktit të bashkëngjitur kësaj tarife.<sup>42</sup>

### 2.2.2 Përfaqësuesit e autorizuar të palëve

Në të drejtën tonë nuk është i paraparë detyrimi i palëve që të drejtat e tyre medoemos duhet t'i realizojnë përmes të autorizuarve, të cilët janë persona me kualifikime profesionale – avokatët. Ata mundën që vetë ta udhëheqin kontestin, respektivisht në rastet kur janë të paditur, mbrojtjen dhe kundërshtimet t'i paraqesin personalisht apo nëpërmes të të autorizuarve.

### 2.2.3 Mos përfaqësimi i duhur i palës nga ana e avokatit apo personit tjetër

Ekziston detyrimi i gjykatës që ta informoj palën me pasojat e dëmshme të cilat mund të lindin për të, në rastet kur atë e përfaqëson në mënyrë jo të duhur i autorizuari i cili nuk është avokat.<sup>43</sup>

Por edhe në rastet kur gjykata konstaton se përfaqësuesi i palës i cili është avokat, nuk e kryen detyrën në pajtim me Ligjin mbi Avokaturën, mbi të rëndon detyrimi që për një gjë të tillë ta njoftojë Odën e Avokatëve.

### 2.2.4 Mënyrat e dhënies së autorizimit

Pavarësisht faktit se kënd e autorizon, pala mund ta jep autorizimin në dy mënyra:

- a. me shkrim, apo
- b. me gojë në procesverbal para gjykatës.

Pala e cila nuk di shkrim/lexim ose e cila nuk është në gjendje të nënshkruhet, do të vejë në autorizimin e shkruar shenjën e gishtit tregues. Nëse një autorizim i këtillë i jepet personit i cili nuk është avokat, është e nevojshme që të jenë prezentë dy dëshmitarë të cilët do të nënshkruhen në autorizim.<sup>44</sup>

Në rastet kur dyshohet në vërtetësinë e autorizimit, gjykata me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa, do të urdhërojë që të parashtrohet autorizim i verifikuar.<sup>45</sup> Kur pala ka të autorizuar, gjykata është e detyruar që dorëzimin t'ia bëjë të autorizuarit.

Pala mund të ketë më shumë përfaqësues të autorizuar, të cilët janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur t'i ndërmarrin veprimet kontestimore, e të cilat veprime nuk mund të jenë në kundërshtim me veprimet e të autorizuarve të tjerë. Në këto raste dorëzimi i shkresave mjafton që t'i bëhet vetëm njërit nga të autorizuarit.<sup>46</sup>

Te rastet e administrimit të provave edhe përmes dëgjimit të palëve, dorëzimi i ftesës për këtë seancë duhet t'i bëhet personalisht palëve.<sup>47</sup>

Veprimet kontestimore në procedurë për palën i ndërmerr i autorizuari i tij, por gjykata mund ta ftojë palën që të deklarohet personalisht lidhur me faktet të cilat duhet të vërtetohen. Është e drejtë e palës që të kërkojë nga gjykata që t'i mundësojë dhënien e deklaratave lidhur me lëndën e kontestit edhe pranë deklaratës së dhënë nga i autorizuari i tij.<sup>48</sup>

---

<sup>42</sup>Shih Tarifën për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve, si dhe ekstraktin nga tarifa e avokatëve, numri tarifor 7 – përfaqësimi në seancat për çështje civile dhe të tjera.

<sup>43</sup> Shih nenin 88 të LPK-së.

<sup>44</sup> Shih Ligjin për Noterinë.

<sup>45</sup> Shih nenin 92.3 të LPK-së.

<sup>46</sup> Shih nenin 107.2 të LPK-së.

<sup>47</sup> Shih nenin 376 të LPK-së.

<sup>48</sup> Shih formularët nr. 4 dhe 5.



## 2.2.5 Revokimi i deklaratës së të autorizuarit nga ana e vetë palës

Pala mundet që deklaratën e të autorizuarit të saj të dhënë në seancë:

- a) ta ndryshojë, apo
- b) ta revokojë

Mund të ndodhë që i autorizuari në seancë në të cilën pala nuk ka qenë prezente e ka pranuar ndonjë fakt, apo e ka pranuar në parashtrësë, e pas kësaj pala këtë pranim ta ndryshojë apo revokojë. Në këtë rast gjykata sipas vlerësimit të lirë, e duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, do të vendosë se cilës deklaratë do t'ia fal besimin, e cilës jo.<sup>49</sup>

## 2.2.6 Vëllimi dhe përmbajtja e autorizimit

Se cilat veprime do të jetë i autorizuar t'i ndërmerret përfaqësuesi i autorizuari i palës, varet nga vëllimi i autorizimit të cilin e cakton pala si autorizim dhënës.

Autorizimi mund të jetë:

- a) i përgjithshëm (gjeneral), apo
- b) i veçantë.

Në rastet kur bëhet fjalë për autorizimin e përgjithshëm, autorizimet e të autorizuarit sipas përmbajtjes janë të ndryshme, varësisht nga fakti se a është personi i autorizuar avokat, apo jo.

I autorizuari i cili është avokat dhe i autorizuar me autorizim të përgjithshëm, ka të drejtë t'i kryej të gjitha veprimet në procedurë, e sidomos:

- ta parashtrorë dhe ta tërheqë padinë;
- të parashtrorë përgjigjen në padi;
- që të pohojë kërkesëpadinë apo të heqë dorë nga ajo;
- që të lidhë pajtim gjyqësor;
- që të parashtrorë mjetin e goditjes së vendimit si dhe të heqë dorë nga kjo e drejtë, apo ta tërheqë mjetin e parashtruar;
- të propozoj caktimin e masave të përkohshme të sigurimit të kërkesave;
- të parashtrorë kërkesën për ekzekutimin ose sigurimin dhe të kryej veprime të nevojshme lidhur me kërkesat e tilla;
- që nga pala kundërshtare t'i pranoj shpenzimet procedurale të caktuara nga gjykata,
- të autorizojë avokatin tjetër me shkrim që të kryej disa veprime të caktuara procedurale, por jo edhe që të veprojnë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës, avokatit i nevojitet autorizim i veçantë, vetëm nëse nga koha kur vendimi është bërë i formës së prerë kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj.

Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë.<sup>50</sup> Por nëse i autorizuari i palës nuk është avokat, ndërsa që pala në autorizim nuk ia ka caktuar atij më hollësisht autorizimet, i autorizuari në këtë rast mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale, por gjithmonë i nevojitet autorizim shprehimor për:

- a) tërheqjen e padisë;
- b) për pohimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- c) për lidhjen e pajtimit gjyqësor;
- d) për heqje dorë nga e drejta e paraqitjes së mjetit të goditjes së vendimit,

---

<sup>49</sup> Shih nenin 87 të LPK-së.

<sup>50</sup> Shih nenin 90 të LPK-së.

- e) apo për tërheqjen e tij dhe për kalimin e autorizimit një personi tjetër, si dhe parashtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve<sup>51</sup>.

Përfaqësues i autorizuar i palës mund të jetë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar (zotësi procedurale).

### 2.2.7 Parashtrimi i autorizimit

I autorizuari i palës është i detyruar që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë, ta paraqesë autorizimin (me rastin e parashtrimit të padisë, përgjigjes në padi etj.). Gjykata mund t'ia lejoj personit të tillë përfaqësimit e palës edhe pa parashtrimin e autorizimit, mirëpo do t'ia caktojë atij një afat të caktuar që ta parashtrij autorizimin.

Nëse ky person nuk vepron sipas urdhrorit të gjykatës, procedura do të vazhdojë sikurse ai fare të mos ishte paraqitur para gjykatës në cilësinë e të autorizuarit të palës dhe pa i marrë në konsideratë veprimet e kryera nga ai.

Veprimet të cilat i ka ndërmarr ky person në procedurë gjykata do t'i anulojë, me përjashtim të atyre për të cilat pala më vonë e jep pëlqimin.<sup>52</sup>

Shkelja e këtyre rregullave paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika k të LPK, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe si pasojë e të cilave shkelje do të duhet që të priset vendimi i gjykatës së shkallë së parë. Po ashtu për shkak të kësaj shkelje mund të paraqitet edhe mjete të jashtëzakonshëm juridik – revizioni.<sup>53</sup>

### 2.2.8 Revokimi dhe denoncimi i autorizimit

Pala mund të revokojë autorizimin kurse i autorizuari të denoncojë atë në çdo kohë. Revokimi dhe denoncimi i autorizimit bëhet në mënyrë të shkruar apo gojarisht në procesverbal para gjykatës pranë së cilës zhvillohet procedura, kurse prodhon efekt juridik kundrejt palës së kundërt, nga koha kur asaj i është komunikuar. Megjithatë, i autorizuari i palës, është i detyruar që edhe për 15 ditë të kryejë veprime procedurale për palën që e ka autorizuar atë, po që se është nevoja që të evitohet ndonjë dëm që mund t'i shkaktohet palës brenda kësaj kohe.<sup>54</sup>

Me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe autorizimi të cilën ai e ka dhënë.<sup>55</sup>

Në rastin e falimentimit, autorizimi i dhënë nga debitori në falimentim shuhet në momentin në të cilin sipas dispozitave në fuqi shkaktohen pasojat juridike të hapjes së procedurës për falimentim.<sup>56</sup>

## 2.3 Gjuha në procedurë

Bazuar në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë:

- a) gjuha shqipe, dhe
- b) gjuha serbe,

---

<sup>51</sup> Shih nenin 91 të LPK-së

<sup>52</sup> Shih nenin 93.4 të LPK-së.

<sup>53</sup> Shih nenin 9 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.04L-118.

<sup>54</sup> Shih nenin 94.4 të LPK-së, si dhe formularët praktik me nr.6 dhe 7.

<sup>55</sup> Shih nenin 95 të LPK-së, si dhe nenin 18 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së nr.04L-118.

<sup>56</sup> Shih nenin 95.2 të LPK-së.

Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome, kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose do të mund të jenë në përdorim zyrtar në cilin do nivel në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.<sup>57</sup>

Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK) përcakton se pala dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.<sup>58</sup>

Nëse procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, respektivisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që ata e kuptojnë, i të gjitha parashtrësive dhe provave shkresore si dhe i asaj që parashtrëhet në seancë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë do të njoftohen me të drejtën që procedurën verbale ta ndjekin në gjuhën e tyre me anë të përkthyesit. Ata mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit, nëse deklarojnë se e njohin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në procesverbal do të shënohet se atyre u është dhënë udhëzimi për të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, si dhe deklarata e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë lidhur me udhëzimin e dhënë nga gjykata.

Përkthimin e bëjnë përkthyesit, ndërsa shpenzimet e përkthimit mbeten në ngarkim të buxhetit të gjykatës.

Shkelja e rregullave të përdorimit të gjuhës në procedurën kontestimore, paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (j) të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset si pas detyrës zyrtare, ndërsa vendimi i cili bazohet në këto shkelje, duhet të priset.

---

<sup>57</sup> Shih Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>58</sup> Shih nenin 96 të LPK-së.

# **FORMULARËT PRAKTIKË**

## 2.4 Formularët praktikë për palët dhe përfaqësimin

### Formulari 1 - Vendimi mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësve \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni rr. “Jeta e re”, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre \_\_\_\_\_ paditësi \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Jeta e re”, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, \_\_\_\_\_ nga Prizreni tani në adresë të panjohur, \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Anton Çeta”, \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Sami Frashëri”, dhe \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Xhemali Berisha”, për shkak të vërtetimit të së drejtës së servitutit, vlera e kontestit 200 euro, me datën 17.08.2013, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Të paditurës \_\_\_\_\_, nga Prizreni, të cilës tani nuk i dihet adresa e saktë, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

#### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni rr. “Jeta e re”, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre paditësi \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Jeta e re”, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, \_\_\_\_\_ nga Prizreni tani në adresë të panjohur, \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Anton Çeta”, \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Sami Frashëri”, dhe \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Xhemali Berisha”, për shkak të vërtetimit të së drejtës së servitutit.

I autorizuari i paditësve, përgjatë shqyrtimit gjyqësor gjykatës i ka propozuar që të paditurës \_\_\_\_\_, t’i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, pasi që të njëjtës nuk i dihet adresa e saktë, ndërsa nuk ka përfaqësues të autorizuar.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit të lartcekur dhe se përfaqësuesi i përkohshëm av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurin e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh

pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 2 - Shpallja e aktvendimit mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.nr. \_\_\_\_\_

DATË: \_\_\_\_\_

### GAZETËS SË PËRDITSHME INFORMATIVE “ \_\_\_\_\_ ” PRISHTINË

Ju lutemi që në njërin nga numrat e ardhshëm të gazetës tuaj, në faqen e shpalljeve, të shpallni shpalljen me përmbajtje si në vijim:

“Gjykata Themelore në Prizren, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në kuptim të nenit 83 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK):

#### Sh p a ll

Se në çështjen juridike C.nr.378/08, me paditës \_\_\_\_\_ etj., që të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre \_\_\_\_\_ paditësi \_\_\_\_\_ nga Prizreni , kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, \_\_\_\_\_ nga Prizreni tani në adresë të panjohur, \_\_\_\_\_ nga Prizreni , \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Sami Frashëri” , dhe \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Xhemali Berisha” , për shkak të vërtetimit të së drejtës së servitutit, me aktvendimin C.nr. \_\_\_\_\_, të datës 17.08.2012, të paditurës \_\_\_\_\_, nga Prizreni, të cilës tani nuk i dihet adresa e saktë, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni.

Përfaqësuesi i përkohshëm detyrën e vet të përfaqësimit të të paditurës në këtë procedurë, do ta kryejë deri në momentin kur i padituri ose i autorizuari i tij, të mos paraqiten në gjykatë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta lajmërojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin”.

Në kuptim të nenit 81.2 të LPK-së, shpenzimet e shpalljes i bartë paditësi.

Gj y q t a r i

### **Formulari 3 - Aktvendimi mbi hedhjen e padisë dhe abrogimin e të gjitha veprimeve procedurale**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, gjyqtari \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Dragashit, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, për shkak të borxhit, me datën 29.07.2013, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

ABROGOHEN të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë dhe padia e paditësit hedhet poshtë.

#### **A r s y e t i m**

Paditësi në padi ka theksuar se i padituri i ka borxhe atij në emër të kompensimit të dëmit material, shumë në lartësi prej 500 euro, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e tij ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

I padituri përmes përgjigjes me shkrim në padi, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se e njëjta është tërësisht e pabazuar, ngase nuk është aspak e vërtetë se ai i ka borxhe paditësit.

Përgjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, është paraqitur dyshimi në aftësinë e veprimit (procedurale) të paditësit, andaj gjykata sipas detyrës zyrtare, i ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për sqarimin e kësaj rrethane.

Në bazë të raportit të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, nr.774/13, të datës 25.07.2013, është vërtetuar fakti se paditësit \_\_\_\_\_, me aktvendimin e kësaj gjykate Ndr.nr.14/13, të datës 15.03.2013, i është marrë në tërësi aftësia e veprimit, gjë që është vërtetuar edhe me shikimin e shkresave të kësaj gjykate Ndr.nr.\_\_\_\_\_. Po ashtu është konstatuar se me vendim të posaçëm, paditësi është vendosur nën përkujdesje të Organit të Kujdestarisë.

Organi i Kujdestarisë e ka informuar gjykatën se si përfaqësues ligjor i paditësit në këtë çështje juridike, nuk e jep pëlqimin për parashtrimin e padisë nga ana e paditësit, ngase konsideron se nuk ka arsye për iniciimin e kësaj procedure.

Duke pasur parasysh se në rastin konkret, padia është parashtruar nga ana e personit me pazotësi të veprimit (pazotësi procedurale), ndërsa që kjo e metë nuk ka mundur të evitohet, sepse përfaqësuesi ligjor i paditësit nuk e ka dhënë pëlqimin për padinë e parashtruar të paditësit, e as për veprimet të cilat ai i ka ndërmarrë në këtë procedurë, bazuar në nenin 78 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.

## Formulari 4 - Autorizimi i dhënë ndaj avokatit

### A U T O R I Z I M

Autorizoj avokatin \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Adem Jashari” , që të më përfaqësoj në lëndën kontestimore C.nr. \_\_\_\_\_, e cila zhvillohet pranë Gjykatës Themelore në Prizren.

I autorizuari im ka të drejtë që t’i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme në procedurë, e posaçërisht që ta tërheq padinë, të heqë dorë nga kërkesëpapia, të lidhë ujdj gjyqësore, që të parashtojë mjetin e goditjes, që të heqë dorë nga e drejta e parashtrimit të mjetit të goditjes apo që të njëjtin ta tërheqë, që të parashtojë propozimin për caktimin e masës së përkohshme apo të sigurisë.

Gjithashtu i autorizuari im ka të drejtë që të parashtojë kërkesë për përmbarim apo sigurimin e provës si dhe që t’i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me atë kërkesë dhe që nga pala e kundërt ti pranojë shpenzimet e caktuara të procedurës.

Këtë autorizim i autorizuari im mund ta bartë në avokatin tjetër në tërësi apo që atë ta autorizojë në ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në procedurë.

Prizren,  
Dt. \_\_\_\_\_

Autorizim dhënësi  
\_\_\_\_\_



## Formulari 5 - Autorizimi i dhënë ndaj personit i cili nuk është avokat

### A U T O R I Z I M

Autorizoj \_\_\_\_\_ nga Peja rr. "Ismet Jashari" nr.\_\_\_\_\_, me numër të letërnjoftimit \_\_\_\_\_ të lëshuar nga MPB – Prishtinë, që të më përfaqësojë si paditës në lëndën kontestimore C.nr.\_\_\_\_\_, e cila zhvillohet pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Peja, rr. "Haxhi Zeka", për shkak të borxhit.

I autorizuari im ka të drejtë që në emrin tim dhe në llogarinë time t'i ndërmer të gjitha veprimet juridike në procedurë, e posaçërisht e autorizoj që:

- Të tërheq padinë, nëse e vlerëson se kjo është në interesin tim;
- Të heqë dorë nga kërkesëpadia, nëse e vlerëson se kjo është në interesin tim;
- Të lidhë ujdj gjyqësore;
- Të parashtrijë ankesë apo ndonjë mjet tjetër juridik të goditjes;
- Të heqë dorë nga parashtrimi i ankesës apo që të njëjtën ta tërheq;
- Të parashtrijë kërkesë për përmbarrim dhe të ndërmer veprime të tjera të nevojshme juridike në lidhje me këtë procedurë;
- Të paguajë apo pranojë shumën e shpenzimeve të gjykuara procedurale.

Këtë autorizim i autorizuari im mund ta bart vetëm në ndonjë avokat dhe jo edhe në ndonjë person tjetër.

Pejë,

Autorizim-dhënësi

Dt. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## Formulari 6 - Parashtrësë mbi tërheqjen e autorizimit të dhënë ndaj avokatit

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Paditësi: \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, rr. "Isa Boletini" nr. \_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica.

I padituri: \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, rr. "Zahir Pajaziti" nr. \_\_\_\_.

Objekt i kontestit: Vërtetim i të drejtës së pronësisë

Parashtrësë e paditësit

Përmes kësaj parashtrëse e informoj gjykatën dhe palën kundërshtare se e tërheq autorizimin e dhënë ndaj avokatit \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, andaj i propozoj gjykatës që në të ardhmen të më ftojë personalisht në seanca gjyqësore dhe që të më dorëzojë të gjitha parashtrësat në lidhje me këtë procedurë.

Përndryshe gjykatën e informoj se në lidhje me këtë tërheqje të autorizimit personalisht e kam informuar të autorizuarin e deri tanishëm.

Mitrovicë,

Dt. \_\_\_\_\_

Paditësi

## Formulari 7 - Parashtrësë mbi denoncimin e autorizimit nga ana e avokatit

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykatës Themelore në Gjiilan

Paditësi: \_\_\_\_\_ nga Gjiilani, rr."Isa Boletini" nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.  
\_\_\_\_\_ nga Gjiilani.

I padituri: \_\_\_\_\_ nga Gjiilani, rr." Zahir Pajaziti" nr.\_\_\_\_.

Objekt i kontestit: Pengim Posedim

### Parashtrësë e të autorizuarit të paditësit

Përmes kësaj parashtrëse e informoj gjykatën se e denoncoj autorizimin të cilin ma ka dhënë paditësi \_\_\_\_\_ në këtë çështje kontestimore.

Përndryshe gjykatën e informoj se në lidhje me këtë denoncim të autorizimit, personalisht e kam informuar paditësin (autorizim-dhënësin), ndërsa kërkoj nga gjykata që për këtë ta informojë edhe palën e paditur.

Gjiilan,  
Dt. \_\_\_\_\_

I autorizuari i paditësit  
Av. \_\_\_\_\_

KAPITULLI III

**PARASHTRESAT DHE DËRGIMI I  
SHKRESAVE**

### 3 PARASHTRESAT DHE DËRGIMI I SHKRESAVE

#### 3.1 Parashtrës

Parashtrës nënkupton veprimin procedural me shkrim të palës drejtuar gjykatës me qëllim që të vihet në lëvizje procesi civil. Këto veprime procedurale kryhen jashtë seancave me shkrim dhe në seancë me gojë.

Parashtrës janë:

- Padi
- Përgjigja në padi
- Mjetet e goditjes së vendimit dhe deklaratat tjera
- Propozimet dhe njoftimet (që bëhen jashtë seancave gjyqësore)<sup>59</sup>

Për të vepruar gjykata sipas parashtrësve ato duhet të jenë të kuptueshëm dhe sidomos të përmbajnë:

- Emrin e gjykatës,
- Emrin dhe mbiemrin e palës (emërtimin e personit juridik),
- Vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) të palëve,
- Emrin dhe mbiemrin si dhe vendbanimin apo vendqëndrimin e përfaqësuesve të palëve,
- Objektin e kontestit,
- Përmbajtjen e deklaratës dhe
- Firmën e parashtrësit (nënshkrimin).

Në qoftë së parashtrës drejtuar gjykatës përmban ndonjë deklaratë si kërkesë, atëherë parashtrësi duhet që në parashtrësë t'i tregoi faktet në mënyrë të qartë dhe të thuktë dhe të ofrojë provat në lidhje me to.

a) Veprimi i gjykatës në rastet kur parashtrës nuk është e kuptueshme dhe e plotë

Gjatë shqyrtimit të parashtrës nëse gjykata vlerëson se nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 99 par 2 të LPK-së, atëherë gjykata me aktvendim të veçantë do ta thërras personin që e dërgon që ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën.

Në raste të tilla gjykata e udhëzon palën që brenda tri ditësh ta evitojë të metën e parashtrës duke e udhëzuar për korrigjimin dhe plotësimin.

b) Shembuj të rasteve kur gjykata e udhëzon palën për plotësimin-korrigjimin e parashtrës

- Plotësimi i parashtrës lidhur me të dhënat e palëve<sup>60</sup>
- Kur përmbajtja e deklaratës është e paqartë<sup>61</sup>
- Kur në parashtrës ka kërkesë por nuk janë treguar faktet
- Kur fakte nuk mbështeten në prova<sup>62</sup>

---

<sup>59</sup>Neni 99 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore

<sup>60</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 1.

<sup>61</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 2.

<sup>62</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 3.

- Kur parashtrësia nuk përmban firmën (nënshkrimin) e palës<sup>63</sup>
- Kur parashtrësia nuk përmban numrin e mjaftueshëm të ekzemplarëve<sup>64</sup>

h. Pasojat e mos plotësimit-korrigjimit të parashtrësës

Në qoftë së pala nuk e plotëson-korrigjon parashtrësën varësisht nga të metat për të cilën është kthyer në plotësim dhe atë brenda afatit të caktuar (tre ditor) përkundër njoftimit të gjykatës për pasojën juridike, do të konsiderohet se parashtrësia është tërhequr. Në raste të tilla gjyqtari merr aktvendim të veçantë me të cilin konsideron së është tërheq parashtrësia.<sup>65</sup>

Në rastet kur parashtrësia i kthehet gjykatës pa u plotësuar-korrigjuar si dhe në rastin kur parashtrësia apo dokumentet që i bashkëngjiten parashtrësës nuk i janë dorëzuar gjykatës në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, atëherë gjyqtari merr aktvendim me të cilin parashtrësën do ta hedh poshtë.<sup>66</sup>

### 3.2 Mënyra e dërgimit të shkresave

Komunikimi i shkresave ka karakter të veprimit procedural, të cilin sipas detyrës zyrtare është e detyruar ta kryejë gjykata.

Gjykata shkresat ua dërgon palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë përmes postës. Këto shkresa mund të jenë të zakonshme, rekomande dhe shkresa për fahun postar. Dërgimi i shkresave mund të bëhet edhe përmes personit të cilin e autorizon gjykata për dërgimin e shkresave palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë. Një gjë të tillë mund të bëhet edhe përmes shërbimit kompetent të Kuvendit Komunal. Dërgimi i shkresave mund të bëhet edhe përmes personit juridik të regjistruar dhe të autorizuar për kryerjen e punëve të komunikimit. Sipas kësaj, që ndodh edhe në praktikë, gjykatat kanë mundësinë që përveç komunikimit me postë, dërgimin e shkresave të ndryshme ta bëjnë edhe përmes personave juridik të cilët ofrojnë shërbime të tilla postare. Dërgimi i shkresave mund të bëhet drejtpërsëdrejti edhe në gjykatë.

Kjo do të thotë se nëse pala ose pjesëmarrësi në procedurë gjendet në gjykatë, ndërsa shkresa ka të bëjë me të, nuk ka pengesë që aty të bëhet dorëzimi i shkresës. Këto mënyra të dërgimit të shkresave janë rregulluar me nenin 103.1 të LPK-së.

h) Problemet që mund të paraqiten lidhur me komunikimin e shkresave

Në disa raste personi që i adresohet shkresa dhe marrësi i shkresës nuk është i njëjtë. Kjo praktikisht ndodhë në rastet kur adresati është person juridik dhe kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit.

i) Rastet kur adresati është person juridik

Në rastet kur shkresa i adresohet organeve shtetërore dhe personave juridik, komunikimi me këta persona bëhet në atë mënyrë që shkresa i dorëzohet personit të autorizuar për pranimin e shkresave ose punëtorit në ambientet e personit juridik ose të organit shtetëror (neni 103.1).

Është paraparë edhe mundësia që komunikimi me personin juridik të bëhet edhe nëpërmjet njësisë së tij, vetëm atëherë kur kjo njësi është përfshirë në proces direkt ose indirekt. Sipas kësaj komunikimi konsiderohet i rregullt në momentin e dërgimit të shkresës në këtë njësi (neni 104).

---

<sup>63</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 4.

<sup>64</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 5.

<sup>65</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 6.

<sup>66</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 7.

Në rastet e tilla të komunikimit me organe shtetërorë dhe persona juridik nuk vlejnë rregullat për shkresat që duhet dorëzuar personalisht adresatit nga neni 110 të LPK-së, ngase komunikimi konsiderohet se është kryer në rregull në rast se shkresat i janë dorëzuar personave në kuptim të nenit 104.1 të LPK.

Në rastet kur ka ndonjë letërthirrje për seancë nga ana e gjykatës dhe adresati është ushtarak, punonjës i policisë, punonjës në institucione të komunikacionit ajror ose tokësorë, atëherë komunikimi konsiderohet se është në rregull nëse shkresa e tillë i dorëzohet komandës apo eprorit direkt të këtyre personave. Në rastet kurë pjesëmarrja e këtyre personave në këto institucione është e vazhdueshme dhe me prezencë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, përveç letërthirrjes për seancë gjyqësore sipas nevojës në këtë mënyrë tu dërgohen edhe shkresat tjera (neni 104.4).

j) Komunikimi i shkresave personave të privuar nga liria

Komunikimi i shkresave me persona të tillë bëhet përmes drejtorisë së burgut apo drejtorisë së institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe për kundërvajtje (neni 106). Kjo dispozitë gjen zbatim në praktikë edhe në rastet e personave që gjenden në paraburgim ose edhe janë në vuajtje të dënimit me heqje lirie. Kjo dispozitë vlen edhe për personat që gjenden në ndonjë institucion shëndetësorë apo korrektues e që janë të varur nga urdhrat e ndonjë eprori.<sup>67</sup>

k) Rastet kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit

Në rastet kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit ligjor apo me prokurë, shkresa nuk i dërgohet palës, edhe pse ajo është adresat, por përfaqësuesit të saj ligjor dhe me prokurë.

Si do të veprohet në rastet kur palës i dërgohet shkresa edhe pse është e përfaqësuar qoftë nga përfaqësuesi ligjor ose me prokurë si dhe në rastet kur ka më tepër përfaqësues ligjorë dhe me prokurë?

Në rastet të tilla vetëm dërgimi i shkresës te pala e përfaqësuar edhe pse pala përfaqësohet nga përfaqësuesi ligjor respektivisht me prokurë nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Dorëzimi konsiderohet se është kryer me rregull vetëm atëherë kur shkresa i është dërguar përfaqësuesit ligjor, respektivisht përfaqësuesit me prokurë.

Edhe në rastet kur pala ka më tepër përfaqësues ligjor ose me prokurë, komunikimi i shkresës vetëm palës së përfaqësuar është i pavlefshëm dhe se komunikimi i shkresave konsiderohet se është kryer në rregull nëse shkresa i është dërguar njërit prej tyre.

Kur përfaqësuesi i palës është avokat, komunikimi konsiderohet i rregullt kur shkresa i dorëzohet atij personalisht ashtu edhe kur i dorëzohet të punësuarit në zyrën e tij (neni 108.1 i LPK-së).

Për shkresat që kanë rëndësi më të madhe për procedurën kontestimore është paraparë komunikimi personalisht adresatit. Sipas nenit 110 të LPK, është paraparë që padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, përkatësisht përfaqësuesit ligjor ose me prokurë.

Sipas kësaj dispozite ligjore komunikuesi ka për detyrë që të bëjë edhe një tentim që shkresën t'ia dorëzojë personalisht adresatit, para se t'ia dorëzojë atë personit tjetër.

---

<sup>67</sup> Neni 106 i LPK-së.

***Si do të veprohet në rastet kur personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi?***

Në raste të tilla komunikuesi ka për obligim që me anë të një shkrese-njoftim, të cilin ja len ndonjë personi të paraparë për komunikim sipas nenit 111 të LPK, ta njofton atë se në cilën periudhë kohore dhe ditë duhet të ndodhet në banesë apo në vendin e punës me qëllim që shkresa t'i dorëzohet personalisht.<sup>68</sup>

Në rast se as herën e dytë komunikuesi nuk e gjen adresatin në kohën dhe vendin e përcaktuar me njoftim, atëherë edhe për shkresat që duhet dërguar personalisht do të veprohet në atë mënyrë që ato të dërgohen në mënyrë të zakonshme, duke ua dorëzuar shkresat personave të cilët janë të autorizuar për komunikim të zakonshëm sipas nenit 111 të LPK.

Nëse komunikimi i shkresës është bërë nëpërmjet gjykatës atëherë depozitimi i shkresës bëhet në gjykatë. E nëse komunikimi i shkresës është bërë nëpërmjet postës, atëherë depozitimi i shkresës bëhet në postën e vendbanimit ose vendqëndrimit të palës.

Depozitimi i shkresës sipas nenit 115 të LPK vjen në shprehje vetëm në ato raste kur komunikimi i shkresës nuk mund t'i bëhet personalisht adresatit sipas nenit 110 të LPK dhe as personave të tjerë konform nenit 111 dhe 113 të LPK.

Kur plotësohen kushtet për depozitimin e shkresës, atëherë komunikuesi e lë njoftimin në derë, përkatësisht në arkën postare të adresës së adresatit.

a) Çka duhet të përmbajë njoftimi?

Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna se ku depozitohet shkresa, se shkresa mund të merret brenda afatit prej 15 ditësh, nënshkrimin e komunikuesit si dhe të dhëna se pse depozitohet shkresa dhe data e lënies së njoftimit.

Do të konsiderohet se shkresa është dorëzuar në ditën kurë është lënë shkresa, nëse shkresa nuk merret në vendin e depozituar brenda afatit prej 15 ditësh. Për këtë mënyrë të komunikimit duhet të njoftohet gjykata që e ka urdhëruar dërgimin e shkresës.

b) Komunikimi i zakonshëm

Me qëllim që mos të vije deri te zvarritja e procedurës, me ligj është paraparë se shkresa, për të cilën nuk parashihet komunikimi personal, mund t'i dorëzohet personit tjetër, apo mund të lihet në vendin e caktuar me efekt sikur ajo t'i ishte dorëzuar adresatit.

Mënyra e dorëzimit të shkresave personit i cili nuk gjendet në banesën e tij apo vendin e punës është përcaktuar me nenin 111 të LPK-së.

Kundërshtari i adresatit në proces është secili person, kundër të cilit person adresati ka paraqitur ndonjë pretendim në proces dhe secili person, i cili ka paraqitur ndonjë pretendim në proces kundër adresatit. Shembull, nëse adresati është paditësi atëherë kundërshtar në këtë kuptim është pala e paditur ose secili bashkë-ndërgjyqës në anën e palës së paditur si dhe ndërhyrësi në anën e palës kundërshtare.

---

<sup>68</sup>Njoftim – formulari numër 8



c) Dërgimi i shkresave nga vet palët

Komunikimi i shkresave parimisht dhe zakonisht bëhet ekskluzivisht nëpërmjet gjykatës, mirëpo përjashtimisht lejohet komunikimi i shkresave direkt nga pala tek pala tjetër.

Një mënyrë e tillë e komunikimit të shkresave është e lejuar vetëm nëse kemi të bëjmë me shkresa, të cilat nuk duhen të dorëzohen personalisht.

Procedura e dorëzimit të shkresave nga vet palët është përcaktuar me nenin 120 të LPK-së.

d) Refuzimi i pranimit të shkresës dhe veprimi në rastet e tilla

Me nenin 112 të LPK është paraparë rasti kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa.

Në raste të tilla komunikuesi, shkresën e lenë në banesën apo lokalin në të cilin punon personi që e refuzon pranimin e shkresës, ose e afishon atë në derën e banesës apo lokalit të punës. Komunikuesi në fletë dërgesë e komunikimit shënon orën, ditën dhe shkahun e refuzimit të pranimit, si dhe vendin në të cilin është lënë shkresa dhe kështu konsiderohet se është kryer komunikimi në mënyrë të ligjshme.

Në rastet kur dërguesi i shkresës merr ndonjë informatë nga anëtarët e familjes apo të afërmit se adresati është i paarrtshëm dhe se personat e përmendur në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 nuk do kenë mundësi që shkresën t'ia dërgojnë me kohë, atëherë komunikuesi do ta kthejë shkresën në gjykatë. Raste të tilla kemi kur adresati është i paarrtshëm për shkak se ka emigruar nga vendi dhe supozohet se për një kohë relativisht të gjatë nuk do të jetë i arrtshëm në këtë adresë (neni 113 LPK). Kjo dispozitë ligjore e përjashton zbatimin e dispozitave të neneve 110, 111 dhe 112 të LPK.

e) Problemet që mund të paraqiten në dërgimin e shkresave në rast të ndërrimit të adresës

Është detyrim i palës, përfaqësuesit të palës, por edhe i pjesëmarrësve të tjerë në një proces kontestimor, siç janë secili bashkë-ndërgjyqës ose edhe secili ndërhyrës, që në rast të ndërrimit të adresës në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave që për këtë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.

Në rastet kur pala nuk vepron në këtë mënyrë, e komunikuesi nuk ka dijeni për adresë të re të palës, gjykata do të urdhërojë që në të ardhmen palës së tillë komunikimi i shkresave t'i bëhet duke u afishuar ato në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Në raste të tilla gjykata merr aktvendim me të cilin urdhëron që komunikimi me palën të bëhet duke u afishuar shkresat në tabelë të shpalljes së gjykatës dhe duke e caktuar njëherit edhe afatin. Sipas kësaj konsiderohet se komunikimi është kryer në mënyrë të rregullt pas kalimit të afatit prej shtatë ditëve pas afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve të gjykatës (neni 116 LPK). Lidhur me këtë shih rastin praktik<sup>69</sup>.

f) Rasti kur subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet dorëzimi i shkresës në adresën e treguar në regjistër

Në rastet kur adresati nuk është person fizik por ndonjë subjekt që në mënyrë të veçantë është evidentuar në regjistër publik, atëherë komunikimi i shkresave bëhet në atë mënyrë që shkresa i

---

<sup>69</sup>Aktvendim për komunikim të shkresave në tabelle të shpalljeve të gjykatës- formulari numër 9.

dorëzohet në adresën e treguar në regjistr dhe nëse dorëzimi i shkresës nuk mund t'i bëhet në adresën e tij, atëherë komunikuesi e kthen shkresën në gjykatë duke shënuar në fletë dërgesë arsyet e kthimit të shkresës në gjykatë. Pasi që gjykata ta vërtetojë se vërtetë adresati ka deklaruar atë adresë, atëherë gjykata me aktvendim do ta afishoj këtë shkresë në tabelë të shpalljes së gjykatës.

Sipas kësaj konsiderohet se komunikimi është kryer në mënyrë të rregullt pas kalimit të afatit prej shtatë ditëve pas afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve të gjykatës (neni 114 LPK). Lidhur me këtë shih rastin praktik.<sup>70</sup>

---

<sup>70</sup>Aktvendim për afishimin e shkresës në tabele të shpalljeve në gjykatë për subjektin e regjistruar në regjistrin publik-formulari numër 10.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**

### 3.3 Formularët praktikë për parashtrirat

#### Formulari 1 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË-\_\_\_\_\_Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance me datë 19.01.2011 mori këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. Paditësit i KTHEHET në plotësim padia e datës \_\_\_\_\_, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë për vërtetimin e të drejtës së servitutit, me adresën e saktë të të paditurit \_\_\_\_\_.
- II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

#### A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me datë 12.07.2004, kundër të paditurit për vërtetimin e të drejtës së servitutit.

Gjykata i ka dërguar të paditurit ftesën për seancë, mirëpo fletëkthesa është kthyer me arsyetimin se i padituri nuk gjendet në adresën e cekur në padi.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të dispozitave nga 99.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË-\_\_\_\_\_Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

KËSHILLA JURIDIKE  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 2 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance me datë \_\_\_\_\_ mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Paditësit \_\_\_\_\_ i KTHEHET në plotësim padia e datës \_\_\_\_\_, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë-precizojë padinë duke e rregulluar petitumin e padisë dhe duke e përcaktuar qartë kërkesëpadinë.
  
- II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

### A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me datë 25.11.2010, kundër të paditurës për kontest pune.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjeti se e njëjta nuk përmban kërkesë të qartë në petitumin e padisë, ashtu që nuk i plotëson kushtet në kuptim të dispozitës së nenit 253 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që të veprohet sipas saj.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të dispozitave nga 99.2, 102, lidhur me 253 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.

Gj y q t a r i

KËSHILLA JURIDIKE  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesë

### Formulari 3 – Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. Paditësit \_\_\_\_\_ i KTHEHET në plotësim padia e datës \_\_\_\_\_, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë me provat e propozuara me padi.
  
- II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia poqë së nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

#### A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me datë 23.10.2003, kundër të paditurit, për lirimin dhe dorëzimin e palujtshmërisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjeti se e njëjta nuk është e pajisur me provat e propozuara si në padi.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të dispozitave nga 99.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm,

C.nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

#### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 4 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance me datë \_\_\_\_\_ mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Paditësit i KTHEHET në plotësim padia e dt. \_\_\_\_\_, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë duke e nënshkruar.
- II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

### A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me dt. 15.03.2004, kundër të paditurës për pagesën e premisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjeti se e njëjta nuk është e nënshkruar.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë së paditësit, në kuptim të dispozitave nga 99.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm,

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.



## Formulari 5 - Aktvendimi me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

- I. Paditësit i KTHEHET në plotësim padia e dt. \_\_\_\_, në afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, me qëllim që gjykatës t'ia dorëzojë të gjitha provat me të cilat posedon e që kanë të bëjnë me çështjen konkrete juridike sipas padisë së tij, në së paku dy kopje (një për gjykatën e një për palën kundërshtare, palën e paditur), nën kërcënimin e pasojave procedurale.
- II. Paralajmërohet paditësi se, në qoftë se brenda afatit të caktuar si në al. I të këtij aktvendimi nuk i dorëzon në gjykatë provat e duhura, gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta hedh poshtë padinë e tij në kuptim të dispozitës së nenit 102.3 dhe 102.4 të LPK-së.

### A r s y e t i m

Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, në ekzaminimin paraprak të padisë, ka vlerësuar se padia e paditësit është jo e plotë ngase paditësi nuk ka dorëzuar provat e përmendura në padi e që kanë të bëjnë me çështjen konkrete sipas padisë së tij.

Meqë gjykata nuk ka mundësi të procedoj lidhur me çështjen aktuale pa prova, të cilat duhet t'i dërgohen bashkë me padi edhe të paditurit për përgjigje në padi, prandaj në pajtim me dispozitat e nenit 99, 100, 101 dhe 102 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C. nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.

**Formulari 6 – Aktvendimi me të cilin është konsideruar e tërhequr padia pasi që nuk është plotësuar**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET se është tërhequr padia me numër C.nr. \_\_\_\_\_, e dt. \_\_\_\_\_, e paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit, lidhur me çështjen për pagimin e qirasë.

**A r s y e t i m**

Paditësi kundër të paditurës ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt.27.01.2005, lidhur me çështjen për pagimin e qirasë.

Në adresën e shënuar në padi gjykata nuk ka mundur që palës së paditur t’ia dorëzojë ftesën për seancën e datës 27.03.2013, ngase fletë kthesa e gjykatës është kthyer me konstatim se e paditura është shpërngulur nga adresa e mëparshme dhe nuk e di se ku e ka zyrën. (Provë: fletë kthesa në shkresat e lëndës).

Për këtë arsye, gjykata me Aktvendimin e datës 27.03.2013, në seancën përgatitore, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, paditësit ia kthen padinë në plotësim dhe përmirësim drejtimit qëllim të saktësimit të adresës së të paditurit, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se palës paditëse i është dorëzuar aktvendimi konform nenit 112 të LPK-së dhe meqenëse pala paditëse brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e ka plotësuar dhe përmirësuar padinë sipas aktvendimit të lartshënuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditësit e konsideron si të tërhequr.

Gjykatësi i çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102.3 dhe 387.1 pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit , përmes kësaj gjykate.

## **Formulari 7 - Aktvendimi me të cilin është hedh poshtë padia pasi që i është kthyer gjykatës e pa plotësuar**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, kundërtë paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen pagim i borxhit, jashtë seancës gjyqësore, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Hedhet poshtë e palejuar padia me numër C.nr. \_\_\_\_\_, e paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen e pagimit të borxhit.

### **A r s y e t i m**

Paditësi ka ushtruar propozim për përmbarrim me dt.13.05.2003, që tani në këtë procedurë e ka karakterin e padisë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën 507.50 €

Në adresën e shënuar në padi nga paditësi gjykata nuk ka mundur që të paditurit t'ia dorëzojë Aktvendimin për përgjigje në padi të datë 11.11.2010, ngase fletë kthesa e gjykatës është kthyer me konstatim se adresa është jo e plotë dhe se në këtë adresë paditësi është i panjohur.

Për këtë arsye, gjykata në Aktvendimin e datës 10.05.2011, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, paditësit ia kthen padinë në plotësim dhe përmirësim me qëllim të cilësimit të drejtë dhe saktësisht të adresës së të paditurit e në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Duke ju referuar këtij aktvendimi pala paditëse me parashtrësën e dt. 20.05.2011 ka shënuar të njëjtën adresë të palës së paditur - e në të cilën adresë gjykata herën e parë nuk ka mundur ta ftoj në mënyrë të rregullt, me këtë parashtrësë është kthyer brenda afatit por e pa korrigjuar.

Meqë gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë së paditësit për shkak se paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata e ka kthyer parashtrësën e pa korrigjuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 dhe 391 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### **KESHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit përmes kësaj gjykate

**Formulari 8 - Lajmërimi për palën sipas të cilit lajmërohet për tërheqjen e shkresës (ftesë, vendim etj...)**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

Nr. i lëndës \_\_\_\_\_

Me dt. \_\_\_\_\_

Prishtinë

L A J M Ë R I M

LAJMËROHET \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, që me dt. \_\_\_\_\_, në ora \_\_\_\_\_ të vije në Gjykatën Themelore në Prishtinë (zyra nr. \_\_\_\_\_), për të marrë \_\_\_\_\_.

Afati për marrjen e shkresës është 15 ditë nga dita e lënies së këtij lajmërimi, në kuptim të nenit 115 të LPK.

VEREJTJE: Nëse nuk i përgjigjeni këtij lajmërimi përkatësisht ftesës së gjykatës, gjykata shqyrtimin do ta mbajë në mungesën tuaj në kuptim të dispozitës së nenit 409 lidhur me nenin 423 të LPK-së.

Fletëdorëzuesi,

\_\_\_\_\_

## Formulari 9 - Aktvendimi për afishim në tabelën e gjykatës të shkresave për paditësin

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen pagim i borxhit, jashtë seancës gjyqësore, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

I. TË GJITHA DORËZIMET paditësit \_\_\_\_\_, do t'i bëhen përmes afishimit, publikimit në Tabelën e Shpalljeve të kësaj Gjykate.

II. Dorëzimet do te konsiderohen të kryera në afat prej 7 ditësh nga dita e publikimit në këtë Tabelë.

III. Ky Aktvendim publikohet në Tabelën e Shpalljeve të kësaj gjykate sot me dt. \_\_\_\_\_ bashkë me thirrjen për seancën e caktuar me dt. \_\_\_\_\_, në ora \_\_\_\_\_.

IV. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

### A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me datë \_\_\_\_\_, kundër të paditurit, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata ka provuar që paditësit t'ia dorëzoj ftesën për seancën përgatitore të caktuar me datën \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_, në adresën e tij në \_\_\_\_\_ por që fletë-kthesa e gjykatës u kthye me konstatimin e fletë dorëzuesit, e sipas informatës së banuesit \_\_\_\_\_, se ai është zhvendosur nga kjo banesë në adresë të panjohur për të.

Pasi që gjykata nuk ka mundësi që palës paditëse t'ia dërgoj ftesën për seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës së nenit 116 par 1 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, e cila ka paraparë detyrimin e palës që të informojë gjykatën për ndërrimin e adresës ku i janë dërguar shkresat e gjykatës, vendosi që konform nenit 116 par.5 dhe 6, paditësit komunikimi i shkresave t'i bëhet përmes afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

## Formulari 10 -Aktvendimi për afishim në tabelën e gjykatës të shkresave për paditësin

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen pagim i borxhit, jashtë seancës gjyqësore, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

I. TË GJITHA DORËZIMET paditësit \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_, do t'i bëhen përmes afishimit, publikimit në Tabelën e Shpalljeve të kësaj Gjykate.

II. Dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej 7 ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

III. Edhe ky Aktvendim bashkë me Aktgjykimin C.nr. \_\_\_\_\_, i dt. \_\_\_\_\_ do të publikohen në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate sot me dt. \_\_\_\_\_.

IV. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

### A r s y e t i m

Paditësi ka ushtruar padi me datë \_\_\_\_\_, kundër të paditurit, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata ka provuar që paditësit (subjektin juridik) \_\_\_\_\_ t'ia dorëzojë Aktgjykimin C.nr. \_\_\_\_\_, i dt. \_\_\_\_\_, në adresën e tij të dhënë në padi dhe në regjistrin në të cilin është evidentuar ky subjekt, pasi që komunikuesi i shkresave e ka kthyer shkresën në gjykatë me konstatim se subjekt paditës nuk gjendet në adresën e përshkruar në padi.

Pasi që gjykata ka vërtetuar se subjekti paditës nuk gjendet në adresën e shënuar në padi, në kuptim të dispozitës së nenit 114 të LPK, vendosi që shkresa me Aktgjykimin C.nr. \_\_\_\_\_, i dt. \_\_\_\_\_ t'i dorëzohet paditësit duke e afishuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari



## KAPITULLI IV

# **SEANCAT DHE AFATET**



## 4 SEANCAT DHE AFATET

### 4.1 Seancat

Seanca është një termin i caktuar nga ana e gjykatës që i shërben takimit të përbashkët të gjykatës me palët dhe subjektet tjerë për ndërmarrjen e veprimeve procedurale.

Varësisht nga ajo se çfarë aktiviteti është dashur të kryhet në seancë, dallojmë:

- Seancën përgatitore;
- Seancën për shqyrtim kryesor;
- Seancën për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme;
- Seancën për marrjen e provës;

#### a) Mënyra e caktimit të seancës gjyqësore

Gjykata me aktvendim konkludent (të nënkuptueshëm – jo formal) e cakton seancën sa herë që një gjë e tillë parashihet me ligj ose kur e kërkojnë nevojat e procedurës.

Gjykata për seancën i njofton palët dhe pjesëmarrësit tjerë me anë të letërthirrjes duke i njoftuar për pasojat ligjore në rast të mos ardhjes në seancë.

Në rastet kur palës bashkë me letërthirrje i dërgohet edhe parashtrësia që i ka dhënë shkas caktimit të seancës, në letërthirrje tregohet vendi, lokali dhe koha e mbajtjes së seancës.

Ndërsa në rastet kur palës nuk i dërgohet së bashku me letërthirrje edhe parashtrësia, atëherë në letërthirrje do të tregohen palët ndërgjyqëse, objekti i kontestit si dhe aktivitetet që do të zhvillohen në seanca.

Në rastet kur pala paraqitet në seancë pas fillimit të seancës nuk mund të kërkojë përsëritjen e veprimeve procedurale të kryera në mungesë të saj.

#### b) Vendi i mbajtjes së seancës

Seanca zakonisht mbahet në ndërtesën e gjykatës por ekzistojnë raste kur gjykata vendos që seanca të mbahet në një vend tjetër, jo në ndërtesën e gjykatës, nëse gjykata e vlerëson si të nevojshme, e që lehtëson qasjen për cilën do palë ose kursen kohën, përpjekjet dhe shpenzimet procedurale.<sup>71</sup>

Për mbajtjen e seancës jashtë ndërtesës së gjykatës vendoset me anë të aktvendimit ndaj të cilit nuk lejohet ankesë.<sup>72</sup>

---

<sup>71</sup>Nëse gjykata e sheh të arsyeshme mund të mbaj seancën edhe në një vend tjetër jashtë ndërtesës së gjykatës, shembull nëse Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, ka një çështje ku të gjithë paditësit dhe të paditurit janë duke vuajtur një dënim me burg, në burgun e Dubravës Istog, gjykata mund të vendos që seancën ta mbaj në ndërtesën e burgut pasi që shumë më ekonomike do të jetë mbajtja e seancës në ndërtesën e burgut se sa dërgimi i të gjithë palëve në ndërtesën e gjykatës kur dihet së të burgosurit duhet të bartën nën masa të larta të sigurisë. Shembull tjetër mund të jetë nëse Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur të dëgjojë në cilësinë e dëshmitarëve tre persona të cilët gjenden në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës Prishtinë, për shkak të frakturave të shumta të gjymtyrëve. Në këtë rast gjykata mund ta bëjë dëgjimin e tyre në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës Prishtinë, pasi që bartja e këtyre personave deri në ndërtesën e gjykatës mund të jetë e vështirësuar.

<sup>72</sup> Aktvendimi për mbajtje të seancës jashtë ndërtesës së gjykatës, - formulari numër 1.

## 4.2 Afatet

Afatet janë distanca kohore brenda së cilës duhet të kryhet apo mund të kryhet veprimi procedural i caktuar.

Afatet janë të caktuara me ligj mirëpo varësisht nga rrethanat e rastit konkret mund të caktohen edhe nga gjykata.

Afatet ligjore nuk mund të zgjaten nga ana e gjykatës, ndërsa afatet gjyqësore mund të zgjaten me propozimin e personit të interesuar.

Kundër aktvendimit me të cilin pranohet apo refuzohet propozimi për zgjatjen e afatit gjyqësor nuk lejohet ankesë e veçantë.

## 4.3 Llogaritja e afatit

Afatet llogariten në ditë, muaj dhe vite.

Në qoftë se afati është caktuar me ditë, atëherë nga llogaritja përjashtohet dita, në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.

Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati.

Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.<sup>73</sup>

## 4.4 Kthimi në gjendjen e mëparshme

Në rastet kur pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, nëse e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.

Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës, në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.

Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkak i mosveprimit, e nëse pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin, ndërsa pas kalimit të afati prej 60 ditësh nga dita e mos veprimit nuk mund të kërkohet më kthimi në gjendjen e mëparshme.

Në rastet kur kthimi në gjendjen e mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'i bashkëngjisë veprimin e shkruar, (për shembull ankesën kundër aktvendimit ose aktgjykimit).

---

<sup>73</sup> Në çdo rast kur dita e fundit e afati bie në ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, atëherë afati mbaron në ditën e parë të punës pas ditës së festës, ditës së diel apo ditës kur nuk punon gjykata. Edhe kur dita e fundit bie në ditën e shtunë, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit, pasi që ditën e shtunë nuk punon gjykata, pavarësisht së LPK në mënyrë eksplicite e ka theksuar vetëm ditën e diel.

Gjykata nuk do të lejojë kthimin në gjendjen e mëparshme nëse propozuesi nuk e ka paraqitur brenda afatit propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme si dhe në rastin kur nuk ka ardhur në seancën e caktuar për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit.<sup>74</sup>

Për të vendosur lidhur me propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata cakton seancë vetëm kur një gjë të tillë e propozon pala shprehimisht. Mirëpo përkundër propozimit të palës gjykata nuk do të caktojë seancë për të vendosur lidhur me propozimin nëse faktet në të cilat mbështetet propozimi janë të ditura botërisht (notore) gjykata nuk cakton seancë në asnjë rast. Po në këtë mënyrë gjykata vepron edhe kur faktet, në të cilat mbështetet propozimi janë qartë të pajustificueshme, por edhe kur gjykata ka prova të mjaftueshme në dosjen e lëndës për dhënien e vendimit sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Kur gjykata e aprovon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.<sup>75</sup>

Në qoftë se nuk plotësohen kushtet për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata me aktvendim e refuzon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme.<sup>76</sup>

Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet apo refuzohet propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme nuk lejohet ankimi i veçantë.

Lejohet ankesa vetëm në rastin kur gjykata refuzon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme nga shkak i dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës së palës së paditur nga seanca gjyqësore.

---

<sup>74</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 2.

<sup>75</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 3.

<sup>76</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 4.

# **FORMULARËT PRAKTIKË**

#### 4.5 Formularët praktikë për seancat dhe afatet

### Formulari 1 - Aktvendimi me të cilin është vendosur që seanca të mbahet jashtë ndërtesës së gjykatës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson \_\_\_\_\_, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_ gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtimin kryesor, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Që seanca e shqyrtimit kryesor e datës \_\_\_\_\_ të mbahet jashtë ndërtesës së kësaj gjykate, përkatësisht në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës – Reparti i Ortopedisë.

#### A r s y e t i m

Në këtë gjykatë është duke u zhvilluar procesi kontestimor sipas padisë së paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

I autorizuari i paditësit në seancën përgatitore i ka propozuar gjykatës që gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të bëhet nxjerrja e provës me dëgjimin e dëshmitarit \_\_\_\_\_, nga \_\_\_\_\_, i cili është i sëmurë dhe gjendet për shërim në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës – Reparti i Ortopedisë.

Me nenin 124.2 të LPK-së, përcaktohet se “Gjykata mund të vendosë që procesi të zhvillohet në një vend tjetër, jo në ndërtesën e gjykatës, nëse kjo vlerësohet e nevojshme, nëse kjo e lehtëson qasjen për cilëndo palë, ose nëse kjo kursen kohë, përpjekje dhe shpenzime procedurale.”

Meqenëse prania e dëshmitarit \_\_\_\_\_ në gjykatë është e pamundur për shkak të gjendjes së tij shëndetësore ndërsa marrja e tij në pyetje në këtë proces gjyqësor është e nevojshme, duke ju referuar nenit 124 të LPK, gjykata e vlerësoi si të nevojshme që seanca e shqyrtimit kryesor e datës \_\_\_\_\_ të mbahet jashtë ndërtesës së kësaj gjykate përkatësisht në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës – Reparti i Ortopedisë, me qëllim të marrjes në pyetje të dëshmitarit të lartpërmendur.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr \_\_\_\_\_ me dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

## Formulari 2 - Aktvendimi me të cilin hedhet si i pa afatshëm propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme, datë \_\_\_\_\_, i paraqitur nga \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Gjykata lidhur me çështjen konkrete juridike sipas padisë se paditësve ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 10.05.2011, në të cilën nuk ka qenë prezent i autorizuari i paditësit. Pas kësaj gjykata merr Aktvendimi me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, me të cilin padinë e paditësit e ka konsideruar të tërhequr sipas nenit 423. par. 3 të LPK.

I autorizuari i paditësit me dt. 10.06.2011, përmes postës ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme dhe ka kërkuar që procedura të vazhdohet në procedurë të rregullt, me arsyetim se në seancën gjyqësore të dt.10.05.2011 nuk ka mundur të marrë pjesë për faktin se në këtë ditë ka qenë prezent ku ka nënshkruar deklaratën për operimin-amputimin e këmbës për nënën e tij.

Me dispozitën ligjore të nenit 130.2 të LPK-së është paraparë se propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mos veprimit. Në këtë rast te paditësi ka pushuar shkaku i mos veprimit të tij qysh me dt.10.05.2011 kur nuk ka mundur me marr pjesë në këtë seancë gjyqësore ndërsa propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme e ka paraqitur me dt.10.06.2011. Nga këto arsye gjykata vlerësoj se propozim është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Prandaj gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 133.1 të LPK-së vendosi që ta hedh poshtë si i paraqitur pas afati propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.

### Formulari 3 - Aktvendimi me të cilin është lejuar kthimi në gjendjen e mëparshme

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

LEJOHET kthimi në gjendjen e mëparshme, për shkak të lëshimit të seancës së datës \_\_\_\_\_ dhe priset vendimi për veprimet procedurale të ndërmarra në seancë e datës \_\_\_\_\_.

#### Arsyetim

Paditësi \_\_\_\_\_ ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore e ka caktuar seancën me datë 24.019.2013, me fillim në ora 10:30, në të cilën nuk kanë prezantuar pala e paditur gjegjësisht e autorizuara e të paditurës dhe në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës gjykata ka mbajtur seancën dhe e ka shpallur të përfunduar gjykimin.

E paditura me parashtresë me datë 25.07.2013, i ka propozuar gjykatës kthimin në gjendjen e mëparshme, me arsyetim së përfaqësuesja e të paditurës e autorizuar për këtë çështje juridike kontestimore ka qenë në pushim vjetor dhe ka qenë e pamundur zëvendësimi i saj për shkak të volumit të madh të punëve dhe numrit të seancave gjyqësore në të gjitha gjykatat e Kosovës. Gjykatës i janë dorëzuar edhe dëshminë për pushim vjetor të përfaqësueses \_\_\_\_\_.

Me qenë se ekziston arsyetimi për lëshimin e mos pjesëmarrjes në seancën e datës \_\_\_\_\_, gjykata lejoj kthimin në gjendjen e mëparshme dhe prishi aktvendimin për veprimet procedurale të ndërmarra në seancën e datës \_\_\_\_\_.

Sipas të cekurave më lartë e në kuptim të dispozitës së nenit 129 dhe 130 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

KËSHILLË JURIDIKE:  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 4 - Aktvendimi me të cilin është refuzuar kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET kërkesa e të paditurës \_\_\_\_\_, për kthim në gjendjen e mëparshme sa i përket afatit shtesë për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë.

### A r s y e t i m

Gjykata me aktvendimin e datës 21.03.2013, e ka hudhur poshtë ankesën e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme Prishtinë, e dt. 16.11.2012, e ushtruar kundër aktgjykimit me numër C.nr. 995/12 të dt. 02.10.2012, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për ankesë.

E paditura me kërkesën e datës 05.04.2013, e pranuar në gjykatë me datë 08.04.2013, i ka kërkuar gjykatës kthimin në gjendjen e mëparshme me kërkesë që t'i lejohet afat shtesë me arsyetim se fillimisht kontrata kolektive nuk është e zbatueshme pastaj e paditura ka theksuar së vendimi i gjykatës për hedhjen e ankesë për shkak të mos pagesës së taksës për ankesë mbështet në Udhëzimin Administrativ 2008/2, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i cili është në kundërshtim me Ligjin mbi Tasat, pasi që sipas këtij ligji e paditura është e liruar nga taksa gjyqësore. Në këtë kuptim gjykata sipas të paditurës ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Në kuptim të cekurave i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme.

Gjykata shqyrtojë kërkesën e të paditurës për kthim në gjendjen e mëparshme dhe pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve gjeti së kërkesa e palës së paditur për kthim në gjendjen e mëparshme është e pabazuar pasi që sipas dispozitës së nenit 129.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se “në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”, ndërsa në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkak i arsyeshëm të cilin gjykata do të mund ta pranonte për lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme.

Gjykata ka gjetur se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e të paditurës më tepër përmban pretendime se vendimi i gjykatës është i kundërligjshëm se sa arsye për kthim në gjendjen e mëparshme, prandaj gjykata vlerëson së këto pretendime mund të paraqitën me ankesë nga ana e të paditurës e jo me kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme.

Sipas të cekurave më lartë e në kuptim të dispozitës së nenit 129 dhe 130 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.





# KAPITULLI V

## **VENDIMET GJYQËSORE**

## 5 VENDIMET GJYQËSORE

### 5.1 Aktgjykimi

Me aktgjykim gjykata vendos për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore gjykata është e lidhur më kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendos për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjkata me rastin e vendosjes meritorë ka për detyrë që të vendos për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë.

#### 5.1.1 Përmbajta e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të përmbajë pjesën formale dhe materiale. Përmbajtjen formale e përbëjnë pjesët e aktgjykimit, ndërsa përmbajtjen materiale e përbën PËRMBAJTJA e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet aktgjykimi.

##### *Përmbajtja formale e aktgjykimit*

- Pjesa Hyrëse

Sipas nenit 160.2 të LPK-së, pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban këto dhjetë (10) lloje të informacioneve:

- emrin e gjykatës,
- emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit,
- emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve,
- identifikimin e përfaqësuesve ligjorë dhe me prokurë të palëve,
- përshkrimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij,
- ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor,
- përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim,
- ditën kur është dhënë aktgjykimi.

Gjkata Themelore e [ ... ]

Numri i lëndës: [ ... ]

Data: [ ... ]

Gjkata Themelore e [...] [Emri / mbiemri i gjyqtarit]

[Emri / mbiemri i palëve dhe vendbanimi apo vendqëndrimi i palëve]

[Emri / Mbiemri i përfaqësuesve ligjorë dhe të autorizuar të palëve që janë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor]

[Përshkrimi i objektit të kontestit dhe vlerës së kërkesës]

[Dita e shqyrtimit kryesor]

[Përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim]

[Kohën dhe datën kur është dhënë aktgjykimi]

a) Dispozitivi

Sipas nenit 160.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmban:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.

b) Pjesa e arsytimit

Në pajtim me nenin 160.4 të LPK-së, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, gjykata duhet të përfshijë rezultatet e veprimeve të mëposhtme:

- Kërkesat e palëve;
- Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët;
- Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte;
- Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte;
- Nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato;
- Kualifikimin juridik të veprës dhe dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit;
- Pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë.

d) Udhëzimi mbi të drejtën në ankesë

Sipas nenit 160.1 të LPK-së, aktgjykimi duhet të përmbajë udhëzimin mbi të drejtën në ankesë.

e) Nënshkrimi

Neni 159 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari.

### 5.1.2 Disa udhëzime rreth arsytimit të aktgjykimit

- arsytimi i aktgjykimit ka një kronologji shpjegimi dhe vlerësimi qoftë të analizës së fakteve qoftë të analizës së normës juridike.
- Gjkata duhet të përshkruajë pretendimet përfundimtare të palëve të kontestit të cilat pretendime duhet të paraqitën si një sintezë e kërtimeve të paditësit ose e kundërshtimeve të të paditurit, mbi bazën e analizës së provave të secilës palë.
- Pretendimet e fundit të paraqitura nga palët e kontestit e të cilat duhet të përshkruhen në arsytim të aktgjykimit duhet të kenë për qëllim që tek gjykata të krijojnë një bindje juridike të

brendshme sa më afër të vërtetës në mënyrë që vendimi i gjykatës të jetë sa më ligjor sa më i drejtë i paanshëm dhe bindës për palët e kontestit.

- Në pjesën arsyetuese gjykata duhet të përshkruajë veprimet procedurale të kryera gjatë gjykimit, qëndrimet dhe vendimet procedurale në lidhje me çështjet paraprake dhe procedurale, kërkesat procedurale të palëve që janë pranuar dhe që janë refuzuar, me shpjegime se cilat rrethana kanë ndikuar në aprovimin apo refuzimin e tyre.
- Gjykata duhet të tregojë edhe rrethanat e çështjes ashtu siç i ka pranuar ajo (në proces kronologjik) dhe mbi bazën e tyre të tregojë se në çfarë përfundimi ka arritur.
- Aktgjykimi i shkruar duhet të citojë dhe interpretoj normat ligjore të aplikuara në zgjidhjen e kundërthënies që janë ngritur në një rast të caktuar.
- Gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin.
- Aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtën subjektive të parashtruesit të kërkesës.
- Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje.
- Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke respektuar rregullat dhe ligjet. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikison të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

### 5.1.3 Metodologjitë bashkëkohore të shkrimit dhe arsyetimit ligjor

**IRAC** është një ndër metodologjitë më bashkëkohore e cila gjen zbatim në praktikën ligjore të shumë vendeve të cilat kanë sistem të përparuar të drejtësisë sa i përket shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

**IRAC** është një shkurtesë në gjuhën angleze për një proces analitik katër-hapësh (që do të thotë Çështja-Rregulla-Analiza-Përfundimi), i cili është ilustruar më poshtë:

- **Identifikimi i çështjes**, që fokusohet vetëm në çështjet që potencialisht zgjidhin të gjithë ose një pjesë të kontestit para gjykatës.
- **Identifikimi i rregullës**, që fokusohet në një rregull kushtetuese, ligjore, apo rregull tjetër që është (ose janë) e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.
- **Analiza**, përfshin përcaktimin nëse çdo element i rregullës (apo rregullave) përkatëse aplikohet ndaj fakteve, të cilat shpesh përfshijnë përdorimin e fjalëve “këtu” dhe “sepse” si pjesë kyçe të analizës për të parë nëse çdo element thelbësor i rregullës është (ose, nuk është) i kënaqur me aspekte të veçanta të dhënave faktike.
- **Konkluzioni**, është hapi përfundimtar në procesin e arsyetimit, dhe përbëhet nga një deklaratë përfundimtare mbi atë se si kjo çështje është zgjidhur (pjesërisht ose plotësisht) nga rezultatet e analizës.

Se si mund të përdoret metoda IRAC në shkrimin dhe arsyetimin e aktgjyqimeve, ndiq sugjerimet në vijim:

Komente mbi aplikueshmërinë e Metodologjisë IRAC në hartimin e aktgjykimit në lëndët civile

- Ne duhet të kemi parasysh se përmes aktgjykimit të shkruar gjykata vendos për bazën e padisë, përderisa IRAC paraqet një metodë për të perfeksionuar të shkruarit dhe arsyetimit ligjor. Aktgjykimi i shkruar është akt që lëshohet nga gjykata kur ajo e zgjidh një çështje. Metodologjia IRAC është një vegël që ndihmon gjykatën në arsyetimin e vendimit i cili përshkruhet në aktgjykimin e shkruar. LPK e përshkruan formën, strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit të shkruar të cilën duhet ta përdor gjykata. Në anën tjetër, metoda IRAC përmban procedurën me katër faza, e cila siguron që aktgjykimi i shkruar të ketë përmbajtje cilësore, analizë të strukturuar të fakteve, dhe analizë të arsyeshme ligjore.

- Ne mund të vërejmë dallime strukturore në mes të aktgjykimit të shkruar dhe metodës IRAC. Aktgjykimi i shkruar strukturohet bazuar në pjesët e tij integrale duke filluar me hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimet për të drejtën për parashtrimin e ankesës kundër aktgjykimit. Metoda IRAC paraqet një proces analitik me katër faza: faza e parë është identifikimi i çështjes duke u fokusuar vetëm në çështjet që potencialisht zgjidhin tërë ose një pjesë të kontestit në gjykatë. Faza e dytë është identifikimi i rregullës, që fokusohet në rregullat kushtetuese, ligjore ose rregulla të tjera që janë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës. Faza e tretë përfshinë analizën dhe përfshinë përcaktimin e secilit element të një rregulle të caktuar e cila mund të aplikohet për faktet. Kjo fazë shpesh përfshinë edhe përdorimin e fjalëve “këtu” dhe “për arsye se” si pjesë kyçe të analizës; për të parë se a është përmbushur (apo jo) secili element thelbësor i rregullës me aspektet e caktuara të informatave faktike. Faza e katërt dhe përfundimtare në procesin e arsyetimit është përfundimi (konkluzioni) dhe ai përbëhet nga deklarimi përfundimtar i cili sqaron se si janë zgjidhur “çështjet” (pjesërisht ose tërësisht) si rezultat i analizës.
- Pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të shkruar është pjesë e cila është më e ngjashme me fazën e tretë të procesit analitik të metodës IRAC – analizës. Arsyetimi i aktgjykimit të shkruar në një lëndë civile duhet të përshkruajë kërkesat/pretendimet e palëve, të numërojë faktet që palët theksojnë se mbështesin pretendimin dhe dëshmitë e propozuara nga ta. Arsyetimi duhet të përshkruajë gjetjet faktike të gjykatës në mënyrën e cila është në përputhje me kushtet që duhet të përmbush arsyetimi. Kur të bëj këtë, gjykata duhet të theksojë në mënyrë të qartë dhe shteruese se cilat fakte ajo mendon se janë vërtetuar e cilat jo, si dhe arsyet për ato përcaktime. Në fakt, pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të shkruar, elementet subjektive dhe objektive të kontestit duhet të jenë të qarta, si dhe arsyet që kanë bërë që gjykata të marrë vendimet e paraqitura në dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.
- Arsyetimi i aktgjykimit të shkruar duhet të ketë një sqarim kronologjik dhe vlerësim si të analizës së fakteve ashtu edhe analizës së zbatueshmërisë së normave ligjore. Në këtë aspekt, gjykata duhet të përshkruajë pretendimet përfundimtare të palëve në kontest, pretendimet që duhet të paraqiten si sintezë e kërkesave të parashtruesit të kërkesës ose vërejtjet e palës së paditur, bazuar në analizën e dëshmive të secilës palë. Pretendimet përfundimtare të paraqitura nga palët në kontest, të cilat duhet të përshkruhen në arsyetimin e aktgjykimit, duhet të synojnë që të krijojnë një opinion të brendshëm ligjor brenda gjykatës i cili do të jetë sa më afër të vërtetës që të jetë e mundur, në mënyrë që vendimi i gjykatës të jetë ligjërish i qëndrueshëm, i drejtë, i paanshëm dhe bindës për palët në kontest.
- Aktgjykimi duhet të përshkruajë veprimet procedurale të ndërmarra gjatë gjykimit, qëndrimet dhe vendimet procedurale lidhur me çështjet paraprake dhe procedurale, mocionet (kërkesat) e aprovuara dhe të refuzuara të palëve, përfshirë edhe sqarimet se cilat rrethana kanë ndikuar në aprovimin apo refuzimin e kërkesave të tilla. Gjukata duhet të sqarojë rrethanat e rastit ashtu siç janë pranuar (në proces kronologjik) dhe, bazuar në rrethana, gjykata duhet të sqarojë përfundimin (konkluzionin) që e ka sjell ajo. Përveç kësaj, gjykata duhet të demonstroj saktësinë faktike me referenca në dëshmitë që ajo i ka pranuar gjatë gjykimit. Gjatë tërë kohës gjykata duhet të shmang arsyetimin jo të plotë dhe të pabazuar. Për shembull, duhet të shmangen deklaratat si më poshtë: “nga ajo që u tha më lartë rezulton se..., pastaj bazuar në

deklaratat e dëshmitarëve....., pa sqaruar, analizuar dhe dëshmuar saktësinë e deklaratave....” e kështu me radhë).

- Përshkrimet e dëshmive duhet të jenë të arsyetuara dhe të strukturuar në mënyrë që të tregojnë se gjykata i konsideron ato bindëse, bashkë me arsyet për një përfundim të tillë. Për shembull, kur gjykata të konstatojë se pretendimi i një pale nuk është i pranueshëm, ajo duhet të arsyetojë vendimin duke cituar dëshmi konkrete, duke paraqitur referenca për kundërthëniet në mes të dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera materiale të cilat kanë çuar gjykatën deri te një përfundim i caktuar. Në këtë mënyrë, gjykata po ashtu bën një vlerësim të dëshmive të pranuar. Gjykata po ashtu, në mënyrë të veçantë do të vlerësojë besueshmërinë e dëshmive kundërthënëse, arsyet për mosaprovimin e kërkesave individuale të palëve dhe arsyet me të cilat është udhëhequr gjykata në përcaktimin e pikave të ligjit e veçanërisht, në përcaktimin se a ekziston detyrimi ligjor.
- Gjykata nuk do të krijojë besimin thjeshtë duke përshkruar arsyetimin e saj për pranimin e dëshmive ose argumenteve pa sqaruar se pse dëshmitë ose argumentet kundërthënëse nuk kanë qenë bindëse. Arsyetimi i vendimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë paanshmërinë e gjykatës kur ajo sjell përfundimet e veta. Një prej standardeve të procesit racional ligjor përfshinë respektimin e parimit të barazisë që aplikohet për të dy palët në një kontest. Rrjedhimisht, ky standard është i lidhur ngushtë me paanshmërinë dhe objektivitetin e gjykatës, dhe duhet të pasqyrohet jo vetëm në procedurat gjyqësore por edhe në arsyetimin e vendimit përfundimtar të gjykatës.
- Aktgjykimi i shkruar duhet të citoj dhe interpretojë normat ligjore të aplikuara në zgjidhjen e kundërthënies që janë ngritur në një rast të caktuar. Kur e bën këtë, gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, e pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Në këtë aspekt, aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtat subjektive të parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i aktgjykimit lidhur me aplikimin e ndonjë norme të veçantë duhet të shërbejë si argument i fuqishëm dhe bindës se vendimi i gjykatës është i drejtë sepse do të jetë e qartë se ai është i bazuar në ligj.
- Vendimi i gjykatës në çdo rast duhet të jetë logjik, me formë të duhur dhe me përmbajtje të qartë. Argumentet dhe pjesët e arsyetimit duhet të jenë të bazuara dhe të kenë lidhje logjike dhe në të njëjtën kohë të respektojnë rregullat dhe ligjet. Ato duhet të krijojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, e cila përjashton çdo mospërputhje ose kundërthënie të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që të mbështesin dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.
- Kështu, pjesët e arsyetimit dhe identifikimit të rregullës në një aktgjykim janë plotësisht në përputhje me metodologjinë IRAC. Prandaj, pjesët e analizës dhe identifikimit të rregullës në një aktgjykim të shkruar, e me këtë edhe aplikimi i rregullës, përfshihen në një pjesë të përbashkët të vendimit e jo në proces të ndarë analitik, siç bëhet në fazat e metodës IRAC.

#### 5.1.4 Aktgjykimi i pjesshëm

Aktgjykim i pjesshëm quhet ai aktgjykim me të cilin gjykata vendos vetëm për një pjesë të kërkesëpadisë, apo për njërën nga disa kërkesat që janë objekt gjykimi. Gjykata e jep këtë aktgjykim kur pjesa e objektit të gjykimit, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit të mjaftueshëm, njëra ose disa sosh, janë pjekur për vendim definitiv dhe merit, gjykata mundet, në pikëpamje të kërkesave të përgatitura, përkatësisht të pjesës së kërkesës së përgatitur, ta përfundojë shqyrtimin dhe të jep aktgjykim të pjesshëm.<sup>77</sup>

Gjykata mundet të jep aktgjykim të pjesshëm edhe kur objekt i gjykimit është edhe kundërpadia, por që për vendim është përgatitur vetëm kërkesa e padisë apo e kundërpadisë.

Nuk do të lejohet aktgjykimi i pjesshëm në qoftë së në padi apo kundërpadi janë përfshirë me tepër kërkesa vendosja e të cilave nuk mund të bëhet ndaras për shkak të natyrës së raportit kontestues për themelësinë e kërkesave të tilla.

Gjykata e jep ex officio këtë aktgjykim në qoftë se një gjë të tillë e çmon si të arsyeshme. Gjykata duhet të marrë parasysh me rastin e vendosjes së pjesshme të kërkesëpadisë madhësinë e kërkesës e cila është përgatitë për vendosje<sup>78</sup> por edhe qëllimet tjera procedurale realizimin e të cilave e mundëson aktgjykimi i pjesshëm.<sup>79</sup>

Aktgjykimi i pjesshëm është aktgjykim i pavarur nga aktgjykimi definitiv për pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikëpamje të mjeteve të goditjes ashtu edhe sa i përket përmbartimit të aktgjykimit.

#### 5.1.5 Aktgjykimi në bazë të pohimit

Aktgjykimi në bazë të pohimit është vendimi merit të cilin e jep gjykata në bazë të deklaratës së shprehur të palës së paditur. Me pohimin e kërkesëpadisë, si veprim procedural i njëanshëm i palës së paditur, bëhet i panevojshëm zhvillimi i mëtutjeshëm i procesit kontestimor.

LPK përcakton se në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo në tërësi, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

Përcaktimi ligjor se i padituri mund të pohojë kërkesëpadinë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nënkupton se i padituri mund ta pohojë kërkesëpadinë jashtë seancës gjyqësore por edhe në seancë gjyqësore, (shembull mund ta pohojë kërkesëpadinë me përgjigje në padi apo edhe me parashtresë gjatë zhvillimit të shqyrtimit përgatitor dhe atij kryesor e gjithashtu edhe me pohim të drejtpërdrejtë në seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor).

Zakonisht posa të kryhet veprimi procedural me të cilin pohohet kërkesëpadija, gjykata menjëherë pa e prituri propozimin e palës paditëse e jep aktgjykimin në bazë të pohimit me të cilin e pranon kërkesëpadinë si të themeltë. Pavarësisht se gjykata në rrethana normale duhet që menjëherë posa të pohohet kërkesëpadija të jep aktgjykimin në bazë të pohimit, në qoftë se kërkesa e padisë ka të bëjë me kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht (par.3 i nenit 3 të LPK-së), pavarësisht se plotësohen kushtet që gjykata të jep aktgjykim në bazë të pohimit, të njëjtin nuk do ta jap.

---

<sup>77</sup> Në qoftë së paditësi ka paraqitur disa kërkesa kundër të paditurit, si shembull dorëzimin e sendit, kompensimin e dëmit dhe kompensimin për pasurim pa bazë, nën supozimin së është përgatitur për vendosje pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me dorëzimin e sendit por jo edhe për kompensimin e dëmit dhe pasurimit pa bazë, atëherë gjykata mund të marr aktgjykim të pjesshëm me të cilin vendos për dorëzimin e sendit tek paditësi e pastaj të vendos edhe për dy kërkesat tjera. Kjo mund të ndodh për arsyes se në këtë rast kërkesa për kompensim dëmi dhe pasurim pa bazë mund të zgjasë për shkak të procesit kompleks të të provuarit të dëmit dhe kompensimit për pasurim pa bazë, pasi që gjykata sigurisht sipas propozimeve të palëve do të nxjerr ekspertizat përkatëse dhe provat tjera materiale për të provuar faktet e çështjes dhe vlerën e kompensimit.

<sup>78</sup> Dispozita e nenit 147.3 e LPK-së.

<sup>79</sup> Qëllimet tjera të cilat duhet t'i ketë parasysh gjykata me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të pjesshëm përveç madhësisë së kërkesëpadisë është edhe qëllimi i ekonomizimit të procedurës i cili qëllim gjen zbatim në dispozitat e nenit 174 (aktgjykimi i pjesshëm) e po ashtu edhe qëllimin e efikasitetit të procedurës dhe të vendosjes brenda një afati të arsyeshëm kohor.



Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të pohimit sa herë të konstaton se kërkesa e padisë është kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në baza të pohimit as në konteste martesore.<sup>80</sup>

**Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit** - dhënia e aktgjykimit në bazë të pohimit mund të shtyhet për më vonë në qoftë së është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura nëse kërkesa e padisë është kërkesë më të cilën palët mund të disponojnë lirisht apo jo.

Shembull i një situatë praktike mund të jetë: *Subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetim të së drejtës së pronësisë lidhur me pronën NN dhe gjatë seancës përgatitore nga ana e subjektit të paditur para gjykatës jepet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë. Në qoftë se gjykata nuk ka dëshmi të mjaftueshme mbi bazën e të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesë e disponueshme për të padituritobjekti i kërkesëpadisë, mund ta shtyjë dhënien e aktgjykimit në bazë të pohimit dhe të ndërmerr verimet e duhura me të cilat do të konstatojë nëse kërkesa e padisë është e disponueshme ose jo për të paditurin. Në këtë mënyrë ex-officio mund t'i drejtohet organit kompetente në kuptim të dispozitës së nenit 7.2 të LPK-së, me kërkesë që organi përkatës t'i dorëzojë gjykatës në afat të caktuar (afat gjyqësor) certifikatën e pronës dhe informata tjera për historiatin e pronës etj. Pas marrjes së këtyre informatave gjykata do të vendos që të pranohet apo të refuzohet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë.*

**Revokimi i deklaratës mbi pohimin e kërkesëpadisë** - I padituri i cili e ka dhënë deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë ka mundësi që ta revokoi deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë. LPK me dispozitën e nenit 148.4 e ka paraparë mundësinë që i padituri ta revokojë deklaratën me të cilën e ka pohuar kërkesën e padisë por vetëm deri në momentin e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit nga ana e gjykatës.

Për kryerjen e veprimit procedural me të cilin revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur. I padituri nuk ka nevojë që gjykatës t'i paraqes kurrfarë arsytimi për revokimin e deklaratës me të cilën është pohuar kërkesa e padisë, por mjafton vetëm deklarami se e revokon deklaratën për pohimin e kërkesëpadisë por me kusht që të mos jetë dhënë aktgjykimi.

Posa të revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë gjykata duhet të vazhdojë procedurën, një gjë të tillë gjykata do ta bëjë edhe nëse konstaton se kërkesa e padisë nuk është e disponueshme për palët.

Edhe pas revokimit të deklaratës për pohimin e kërkesëpadisë i padituri ka mundësi që ta ripohojë kërkesën e padisë dhe natyrisht kjo deklaratë e ka efektin e plotë në bazë të së cilës gjykata do të jep aktgjykimin në bazë të pohimit nëse konstaton se kërkesa padisë është e disponueshme për palët.

Nëse nxjerret aktgjykimi në bazë të pohimit i njëjti duhet të përmbaj këtë emërtim “aktgjykim në bazë të pohimit”.

**Arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit**– arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit dallon prej arsytimit të aktgjykimit të zakonshëm sepse tek ky arsyetim gjykata do të kufizohet në dhënien e arsyeve sa i përket vërtetimit të gjendjes së fakteve, analizës së provave dhe aplikueshmërisë së të drejtës materiale. Esenciale është përshkrimi i kërkesëpadisë, përshkrimi i deklaratës së pohimit të kërkesëpadisë, konstatimi se kërkesa është e disponueshme për palët dhe referenca në dispozitat e LPK-së, pjesa e aktgjykimit në bazë të pohimit.

**Shkaqet e ankimit kundër aktgjykimit në bazë të pohimit- LPK**, me dispozitën e nenit 181.2 ka përcaktuar se “aktgjykimi në bazë të pohimit mund të goditet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

---

<sup>80</sup> Neni 85 par 2 i Ligjit për Familjen i Kosovës.

### 5.1.6 Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

Me dispozitat e nenit 149 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me anë të veprimeve disponibile të palëve. Për derisa me dispozitat e nenit 148 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me pohimin e kërkesëpadiës, me dispozitat e nenit 149 të LPK-së procesi gjyqësor mund të përfundojë me heqjen dorë nga kërkesa e padisë. Në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heq dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi.

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim procedural të palës paditëse i cili i nënshtrohet rregullave të LPK-së përkatësisht dispozitës nga neni 149 të LPK-së.

Për heqjen dorë nga kërkesa e padisë palës paditëse nuk i nevojitet pëlqimi i palës së paditur.

Në praktikën gjyqësore gjykatat duhet qartësojnë situatat kur kemi të bëjmë me tërheqje të padisë me deklarin e palës paditëse dhe heqje dorë nga kërkesa e padisë.

Qartësimi i këtyre situatave më së lehti bëhet duke i identifikuar dallimet në mes të tërheqjes së padisë dhe heqjes dorë nga kërkesa e padisë.

Dallimet në mes të tërheqjes së padisë dhe heqjes dorë nga kërkesëpadia janë:

- Paditësi mund të heq dorë nga kërkesëpadia pa pëlqimin e të paditurit deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa paditësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.
- Në qoftë se paditësi heq dorë nga kërkesa e padisë atëherë gjykata do të nxjerrë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, ndërsa në qoftë se paditësi e tërheq padinë gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta konsiderojë të tërhequr padinë.
- Kundër aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia në çdo rast mund të paraqitet ankesë drejtuar gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa kundër aktvendimit me të cilin konstatohet e tërhequr padia e paditësit nuk lejohet fare ankesë.
- Procesi gjyqësor i përfunduar me aktgjykim të heqjes dorë nga kërkesëpadia konsiderohet çështje e përfunduar me vendim meritore dhe nënkupton pamundësinë që paditësi për çështjen e njëjtë të paraqes përsëri padi pasi që nëse do të paraqiste përsëri padi do të konsiderohej si çështje e gjykuar, ndërsa në qoftë se procesi gjyqësor ka përfunduar me aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit i njëjti mund ta përsërisë prapë padinë e tij.

**Refuzimi i dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia** – Gjkata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme për një gjë të tillë po që se konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia sa herë që të konstaton se palët nuk mund të disponojnë lirisht me kërkesëpadinë e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia as në kontestet martesore.<sup>81</sup>

**Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia** - dhënia e aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura, nëse kërkesa e padisë është kërkesë në të cilën palët mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të LPK-së).

**Shembulli në situatën praktike:** *në qoftë se subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetimin e të drejtës së pronësisë lidhur me pronën N.N. Supozojmë se në rastin konkret paditësi nuk ka legjitimitet aktiv në këtë çështje juridike - kontestuese për shkak të mungesës së raportit juridik - civil me palën e paditur dhe nën supozimin se i njëjti e deklaroi heqjen dorë nga kërkesëpadia, gjykata mund ta shtyjë për më vonë dhënien e aktgjykimit deri sa të siguroj dëshmi të mjaftueshme në bazë të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesa e disponueshme për palët në këtë rast për paditësin. Në këtë mënyrë gjykata ex officio në kuptim të nenit 7.2 të LPK-së mund të mbledh të gjitha informacionet e nevojshme për të nxjerrë përfundimin nëse kërkesa është e disponueshme apo jo.*

**Revokimi i deklaratës mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia** – Paditësi i cili e ka dhënë deklaratën mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia gojarisht në seancë gjyqësore ose me anë të parashtrësës jashtë seancës gjyqësore, mund ta revokojë të njëjtën pa pëlqimin e palës së paditur deri në momentin e dhënies së aktgjykimit.

### 5.1.7 Aktgjyrimi për shkak të padëgjueshmërisë

Aktgjyrimi për shkak të padëgjueshmërisë është risi të cilën e ka sjell LPK-ja aktual. Aktgjyrimi për shkak të padëgjueshmërisë është në funksion të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe shtimit të masave në funksion të parimit të ekonomizimit. LPK në mënyrë specifike e ka rregulluar mundësinë e marrjes së këtij aktgjykimi me dispozitat e nenit 150.

Është me rëndësi të theksohet për praktiken gjyqësore se ky lloj i aktgjykimit mund të merret vetëm jashtë seancës gjyqësore dhe asnjëherë në seancë gjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 150.1 të LKP-së përcaktohet se: në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë me të cilin aprovon kërkesëpadinë.

Aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë do të mund ta nxjerr gjykata në qoftë se plotësohen disa kushte kumulative:

- Po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,
- Po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi,
- Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Kushtet e lartë cituara nga ana e gjykatës duhet të vlerësohen në mënyrë kumulative dhe në mënyrë që e njëjta mund të nxjerr vendim për shkak të padëgjueshmërisë dhe atë jashtë seancës dhe pa propozimin e palës paditëse. Nga kjo rrjedh se gjykata kryesisht vlerëson nëse plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Është me rëndësi të theksohet se gjykata përveç kushtit që ndërlihet me përgjigjen në padi duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadiës e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

---

<sup>81</sup>Neni 85 paragrafi 2 i Ligjit për Familjen i Kosovës

Kur analizohen me kujdes kushtet kumulative që duhet të plotësohen për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë rezulton se praktika gjyqësore do të jetë e kufizuar në shumë raste për nxjerrjen e këtij aktgjykimi pasi që në të gjitha rastet nga të cilat rrjedh se faktet do të provohen me prova të cilat nuk mund të deponohen së bashku me padinë me rastin e punimit të padisë në gjykatë, ky aktgjykim do të jetë i pamundur të nxirret. Për shembull në qoftë se një fakt do të provohet me dëgjimin e dëshmitarëve, ky aktgjykim nuk mund të nxirret, pastaj në qoftë se një fakt do të provohet me nxjerrjen e ekspertizës ky aktgjykim gjithashtu nuk mund të nxirret etj.

**Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë** - Gjykata nuk do të nxjerr aktgjykimin për shkak të mosbindjes pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejt të disponojnë lirisht.

Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

**Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë** – Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë në qoftë se ka nevojë të merr njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët. Gjithmonë kjo shtyrje duhet të ndodhë në periudhën deri sa gjykata nuk u ka dërguar palëve ftesat për seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor në qoftë se nuk cakton seancë përgatitore. Kjo për arsye se siç u theksua gjykata mund të jep këtë aktgjykim vetëm jashtë seancës.

Në çdo rast kur i padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi por që nga faktet e treguar në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, gjykata cakton seancën përgatitore dhe po që se në seancën e kësaj paditësi nuk e ndryshon padinë, jep aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë. Kjo situatë ka nevojë të sqarohet për praktikën gjyqësore pasi që në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata do të nxjerr edhe prova tjera me të cilat provohen faktet e padisë e të cilat nuk i ka pasur në disponim gjykata me rastin e vlerësimit të kushteve për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Pra në shqyrtim gjyqësor kërkesëpadija nga provat e administruara mund të del si e bazuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që t'i jepet aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë nuk lejohet ankimi. Ky përcaktim ligjor mund të krijojë hamendje në praktiken gjyqësore pasi që mund të interpretohet se është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Vlerësojmë se nuk është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë.

### 5.1.8 Aktgjykim për shkak të mungesës

Me aktgjykim për shkak të mungesës kuptojmë atë aktgjykim me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadija e përmbajtur në padinë e ngritur kundër të paditurit i cili nuk mbrohet nga ajo, nuk e kundërshton kërkesëpadinë me veprim të shkruar dhe mungon në seancën përgatitore, apo në qoftë se nuk është mbajtur kjo, nga seanca e parë për shqyrtim kryesor, e paditësi i pranishëm e propozon dhënien e tij apo gjykata sipas detyrës zyrtare e jep këtë aktgjykim. Aktgjykim për shkak të mungesës është paraparë me dispozitat e nenit 151 të LPK-së. Në qoftë se krahasohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës dhe aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë do të vërehen se ekzistojnë disa ngjashmëri por edhe disa dallime esenciale. Kështu gjykata do të nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës kur të paditurit nuk i është dërguar padija për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore apo në seancën e parë të shqyrtimit kryesor në qoftë se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, ndërsa i padituri nuk vjen deri në përfundimin e seancës, atëherë gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin e aprovon kërkesëpadinë poqë se plotësohen edhe këto kushte:

- nëse i padituri është thirrur rregullisht në seancë;
- nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesë padinë me anë të parashtrësës,
- nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi,

- nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht,<sup>82</sup>
- nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.

Kushte për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës duhet të kuptohen si prezumime procedurale dhe materiale që duhet të plotësohen përveç prezumimeve që duhet të plotësohen për çdo aktgjykim.

Është me rëndësi të theksohet se gjykata duhet tu kushtojë vëmendjen e duhur plotësimin të kushteve siç kërkohen e veçanërisht gjykata duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadiës e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në këtë pikë vërehen zakonisht dobësitë e vendimeve të cilat merren për shkak të mungesës.

**Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës** - Gjykata nuk do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht. Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

**Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës** – Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës në qoftë se ka nevojë të merr njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët.

Në qoftë se gjykata nuk e pranon propozimin e palës për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi i palës nuk lejohet ankesë.

Duhet theksuar se dispozita e LPK-së, nga neni 151 lidhur me aktgjykimin për shkak të mungesës nuk janë duke gjetur zbatimin e duhur pasi që njëri ndër kushtet për dhënien e këtij aktgjykimi është që gjykata fare mos t'i ketë dërguar të paditurit aktvendim për përgjigje në padi, ndërsa LPK-ja, në ana tjetër parasheh detyrimin e gjykatës që palës së paditur t'i dërgoj aktvendimin për përgjigje në padi. LPK-ja nuk ka dispozita me të cilat e qartëson saktësisht se në cilat raste gjykata mundet fare mos t'i dërgojë palës së paditur aktvendimin për përgjigje në padi.

Vlerësojmë se aktgjykimi për shkak të mungesës më së shumti mund të gjej zbatim të kontestet me vlerë të vogël.

### 5.1.9 Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes

Me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, është paraparë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes. Me këtë dispozitë synohet efikasiteti i procesit gjyqësor civil.

Sipas kësaj dispozite gjykata do të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrajt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të nxjerrë aktgjykim (neni 143 dhe 147 i LPK-së), nëse nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e tij.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 152 ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Kusht esencial për nxjerrjen e aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së, është që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe më përgjigje në padi t'i ketë pohuar faktet e prezumuara nga ana e palës së paditur. Në këtë rast për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes duhet të

---

<sup>82</sup>Fakte e ditura botërisht sqarohen të kapitulli XIV-faktet që nuk ka nevojë të provohen.

plotësohen në mënyrë kumulative kushtet që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe gjithashtu t'i ketë pohuar faktet e çështjes të prezumuara nga paditësi.

Në çdo rast për praktikën gjyqësore duhet të jetë e qartë se aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes mund të nxirret vetëm jashtë seancës gjyqësore, çka do të thotë se për nxjerrjen e këtij aktgjykimi nuk do të caktohet as seancë përgatitore dhe as e shqyrtimit kryesor.

Në çdo rast nëse gjykata vlerëson se plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes atëherë mundet vetëm ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit por jo edhe ta refuzoj. Kjo nënkupton se nëse është dhënë përgjigje në padi, janë pohuar edhe faktet e prezumuara nga paditësi, por megjithatë pavarësisht se janë pohuar fakte nuk del themelësia e kërkesëpadisë apo nëse kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht atëherë gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes por e cakton seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor.

### 5.1.10 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore<sup>83</sup>

Dispozita e nenit 398 e LPK-së, ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, pasi që në të dy rastet gjykata pasi t'i arrijë përgjigja në padi pa shqyrtim kryesor do të nxjerr aktgjykim me të cilin do ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Me dispozitën e nenit 398 parashihet se: kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, dhe konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.

Edhe sipas kësaj dispozite rrjedh se njëri ndër kushte substanciale për dhënien e këtij aktgjykimi është dhënia e përgjigjes në padi nga ana e të paditurit. Kusht tjetër esencial është edhe vlerësimi i gjykatës përkatësisht konstatimi i gjykatës së ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor. Dhënia e përgjigjes në padi është me rëndësi edhe te ky aktgjykim pasi që gjykata nga padia dhe përgjigja në padi do të mund të konstatojë, se cilat fakte në mes të palëve janë kontestuese e cilat jo dhe në bazë të kësaj të vendos për veprimet e më tutjeshme.

Dallimet në mes të aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152) dhe aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 398 janë:

- aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes do të emërtohet “aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 vetëm “aktgjykim” por në hyrje të aktgjykimit do të shënohet data e nxjerrjes dhe konstatimi se është vendosur jashtë seancës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), domosdoshmërisht duhet të ketë pohim të fakteve të çështjes nga ana e të paditurit, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 nuk është e domosdoshme të ketë pohim të fakteve të prezumuara nga paditësi, por vlerësimi se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve duhet të jetë vlerësim i gjykatës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), arsyetimi i aktgjykimit sa i përket analizës dhe përfundimit për gjendjen e fakteve në të cilat mbështetet kërkesëpadia është fare i shkurtër, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 arsyetimi i aktgjykimit për faktet e çështjes dhe përfundimi i gjykatës lidhur me konstatimin se nuk është kontestuese gjendja faktike në mes të palëve duhet të jetë analizë e mirëfilltë, vlerësim logjik e objektiv se si gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuese gjendja e fakteve.

### 5.1.11 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore<sup>83</sup>

Dispozita e nenit 399 janë risi në LPK-në aktual, pasi që LPK-ja e vjetër nuk i ka përmbajtur këto dispozita.

Qëllimi i këtyre dispozitave është në funksion të parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit të procesit gjyqësor.

Sipas dispozitës së nenit 399.1 është përcaktuar se: kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendim meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.

Sipas dispozitës nga paragrafi 2 i nenit 399 parashihe se: kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të nenit 399, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo po që se faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Për dallim nga dispozitat e nenit 152 dhe 398 me të cilat është paraparë mundësia që gjykata të bie aktgjykim pa shqyrtim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë, me dispozitën e nenit 399 është parë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim por për refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata do të vlerësojë se kërkesëpadia është e pathemeltë në qoftë se ajo qartazi është në kundërshtim me faktet të cilat paditësi i ka theksuar në padi, në qoftë se faktet të cilat i ka prezantuar janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar paditësi për vërtetimin e fakteve, apo nëse kërkesëpadia është në kundërshtim me faktet e ditura botërisht.

Kërkesëpadia do të jetë në kundërshtim me faktet në qoftë se sipas të drejtës materiale nga faktet e treguara nuk del themelësia e kërkesëpadisë, faktet do të jenë në kundërshtim me provat në qoftë se me provat e propozuara do të vërtetohen fakte tjera nga ato të prezantuara nga paditësi e gjithashtu në qoftë se faktet e prezantuara nga paditësi do të jenë në kundërshtim me faktet e ditura botërisht<sup>83</sup> e të cilat nuk ka nevojë të provohen.

### 5.1.12 Aktgjykimi plotësues

Nëse gjykata me vendim meritore nuk ka vendosur për ndonjë kërkesë të palës, atëherë ajo mund të kërkojë që gjykata të vendos lidhur me këtë kërkesë.

LPK sa i përket kërkesës nuk bën dallim në mes të kërkesave kryesore dhe atyre aksesore. Me dispozitën e nenit 162.1 të LPK-së, është përcaktuar se: po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen në aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t'i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij. Po që se pala nuk paraqet propozimin brenda afatit do të konsiderohet se është tërhequr padia në pjesën që nuk është përfshirë në aktgjykimin e dhënë. Propozimi i vonuar për plotësimin e aktgjykimit hidhet poshtë nga ana e gjykatës ndërsa propozimi i pathemeltë refuzohet nga gjykata pa u caktuar seanca gjyqësore.

Nga të cekurat rrjedh se gjykata do ta plotësojë aktgjykimin nëse plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative:

- Nëse nuk është vendosur për të gjitha kërkesat apo për një pjesë të kërkesës,
- nëse paraqitet propozimi për plotësim nga pala dhe
- nëse propozimi për plotësim të aktgjykimit është i afatshëm.

---

<sup>83</sup>Fakte e ditura botërisht sqarohen të kapitulli XIV-faktet që nuk ka nevojë të provohen.

Vlerësojmë se gjykata nuk mundet ex officio të bëjë plotësimin e aktgjykimit pa pasur propozim nga pala.

Konsiderohet se është kërkesë për plotësim edhe ankesa e cila mbështetet vetëm në shkakun se gjykata nuk ka vendosur për tërë kërkesëpadinë, pra në këtë rast gjykata ankesën duhet ta trajtoj si kërkesë për plotësimin e aktgjykimit.

Paditësi i cili nuk e ka parashtruar kërkesën për plotësimin e aktgjykimit nuk e humb të drejtën që për pjesën e pavendosur të paraqesë padi të re.

Në qoftë së propozimi për plotësimin e aktgjykimit i referohet vetëm kërkesës për shpenzime atëherë gjykata nuk vendos me aktgjykim por me aktvendim.

Kundër aktgjykimit plotësues lejohet ankesë e veçantë.

## 5.2 Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit

Parimisht, aktgjykimi duhet dhënë menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor. Gjithashtu, menjëherë pas dhënies aktgjykimi duhet shpallur në seancë.

Sipas dispozitës së nenit 153.1 të LPK-së, gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim.

Në qoftë se gjyqtari e kalon afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për dhënin e aktgjykimit ai ka për detyrë ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij.

Mospërmbytja ndaj afatit për dhënin e aktgjykimit nuk ka kurrfarë pasojash procedurale- juridike për palët, ndërsa për gjyqtarin mos përmbytja e afatit mund të ketë pasoja administrative të natyrës disiplinore.

**Shpallja e aktgjykimit**- pas përfundimit të shqyrtimit kryesor gjykata i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit, e në qoftë se ndonjëra nga palët nuk merr pjesë në seancë atëherë gjykata duhet që ta njoftojë me shkrim.

Duhet theksuar se në praktikën gjyqësore në vendin tonë nuk respektohet detyrimi i shpalljes së aktgjykimit përveç në një numër të vogël kontestesh, pasi që në praktikën gjyqësore respektohet detyrimi i gjykatës që palës t'i dërgojë aktgjykimin me shkrim siç parasheh dispozita e nenit 155.2 e LPK-së.<sup>84</sup>

**Aktgjykimi burimor**-aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari. Nga kjo rrjedhe se gjyqtari e nënshkruan vetëm një dokument origjinal (aktgjykimin burimor). Sipas kuptimit të dispozitës së nenit 159 rrjedh se palëve të kontestit duhet tu dërgohet kopja e legalizuar e aktgjykimit, ndërsa aktgjykimi burimor duhet të ruhet së bashku me shkresat e lëndës në gjykatë. Praktika gjyqësore është e ndryshme pasi që gjykatat tona palëve u dërgojnë nga një kopje të aktgjykimit të cilat janë të nënshkruara nga

---

<sup>84</sup> Mos shpallja e aktgjykimit nga gjykata tonë është edhe pasoja e procedurës shumë formale që parasheh dispozitat e nenit 154.1 e LPK-së, me të cilën përcaktohet detyrimi i gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit kryesor t'i njoftojë palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit (mendohet për shpalljen e aktgjykimit), e rrjedhimisht në qoftë se ndonjëra nga palët nuk ka marrë pjesë në seancën për shqyrtim kryesor, gjykata më shkrim ta njoftoj të njëjtën për ditën e dhënies së aktgjykimit. Vlerësoj se kjo është një procedurë shumë formale që është në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës, prandaj ne insistojmë që të respektohet afati për hartimin me shkrim brenda 15 ditësh, ndërsa për detyrimin e shpalljes së aktgjykimit gjithsesi mendoj se është një detyrim ligjor që duhet respektuar, por rrethanat praktike sigurisht që do të ndikoj që ky detyrim që mos jetë i zbatuar. Në këtë aspekt paraqitet edhe një problematikë që lidhet më afatin e ankimit pasi që sipas dispozitës së nenit 154.2 të LPK-së, përshihet se në qoftë se palët janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit, afati për ankim kundër aktgjykimit fillon të ecë ditën e nesërme pas dozimit të aktgjykimit. Në këtë kontekst shtrohet pyetja çka nëse palët nuk janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit sidomos kur njëra palë nuk ka marrë pjesë në seancën, çka ndodh me afatin nëse njëra palë ka qenë e njoftuar rregullisht dhe nuk ka marrë pjesë.

Mendojmë se dispozitat ligjore janë të pa qarta, e për rrjedhojë ka ndikuar edhe në krijimin e praktikës që palëve t'u dërgohet aktgjykimi me shkrim pa e shpallur paraprakisht gjykata të njëjtin.



gjyqtari, ndërsa praktika tregon se në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë respektohet kuptimi i kësaj dispozite.

Momenti i komunikimit të aktgjykimit në aspektin procedural është i rëndësishëm sepse nga ky moment fillon të ec afati partitiv (afati i përmbushjes vullnetare të detyrimit)e gjithashtu fillon të ecë edhe afati për të drejtën e ankesës. Këtu bëhet fjalë për dorëzimin e aktgjykimit palëve e jo shpalljen e tij.

### 5.3 Korrigjimi i aktgjykimit

Korrigjimi i aktgjykimit i referohet vetëm mungesave që kanë të bëjnë me gabimet e bëra në shkrim ose llogari, si dhe pasaktësitë e dukshme të vendimit. Të kësaj natyre janë edhe gabimet në lidhje me formën e aktgjykimit si dhe mospajtimi midis kopjes dhe origjinalit të aktgjykimit. LPK-ja me dispozitën e nenit 165 i referohet korrigjimit të aktgjykimit.

Sipas dispozitës së nenit 165.1 përcaktohet se: gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi midis kopjes me origjinalin e aktgjykimit, e korrigjon gjykata në çdo kohë.

Gjykata për korrigjimin e gabimeve nxjerr aktvendim të posaçëm dhe një kopje e këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Në qoftë se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ka mospajtime atëherë palëve u dërgohet nga një kopje e korrigjuar e aktgjykimit, duke u treguar se më këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në këtë rast afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar fillon të ecë nga dita e pranimit të kopjes së korrigjuar nga palët.

Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendos pa dëgjimin e palëve. Kundër aktvendimit me të cilin bëhet korrigjimi i aktgjykimit lejohet ankesë e veçantë.

Gabimet përkatësisht mungesat në aktgjykim të cilat janë bazë e korrigjimit të aktgjykimit nuk guxojnë të jenë rezultat i formulimit të gabuar të vullnetit të gjykatës në kohën e dhënies së vendimit, sepse me anë të korrigjimit nuk mund të ndryshohet vullneti i gjykatës i formuar me rastin e dhënies së vendimit, pasi që gjykata është e lidhur me të nga momenti i shpalljes së aktgjykimit.

### 5.4 Forma e prerë e aktgjykimit

Marrëdhëniet e ndryshme juridike të palëve në kontest caktohen në mënyrë përfundimtare, atëherë kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

Pas marrjes së formës së prerë, vendimi fiton fuqinë e “gjësë së gjykuar” që do të thotë se pala që ka fituar gjyqin mund të vërë vendimin në përmbarrim të detyrueshëm në qoftë se ai nuk ekzekutohet vullnetarisht nga subjekti që ka humbur gjykimin (debitori).

Sipas dispozitës së nenit 166.1 të LPK-së, parashihet se ”aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo të kundërpadisë”.

Është detyrë e gjykatës që ex officio gjatë tërë procedurës të kujdeset nëse çështja objekt i shqyrtimit është gjë e gjykuar. Nëse konstatohet se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar padia hedhet poshtë si e palejueshme.<sup>85</sup>

Aktgjykimi mund të bëhet i formës së prerë:

- nëse palët kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë,
- nëse palët i kanë tërhequr ankesat e paraqitura,

---

<sup>85</sup> Neni 391 i LPK-së.

- nëse ka kaluar afati për paraqitjen e ankesës dhe
- nëse ka vendosur gjykata e shkallës së dytë duke e refuzuar ankesën dhe duke e vërtetuar vendimin e shkallës së parë.

Sipas LPK-së, kundër të gjitha aktgjykimeve lejohet e drejta e ankesës, prandaj në asnjë rast aktgjykimi nuk mund të bëhet i formës së prerë në mënyra tjera përveç mënyrave të cekura.

Aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, përveç kur nga shkak i natyrës së raportit kontestues apo, sipas urdhrit të ligjit, prodhon efekt kundër personave të tretë.

## 5.5 Aktvendimi

Aktvendimi është lloj i vendimit gjyqësor me të cilin gjykata gjatë procesit vendos për të gjitha çështjet tjera të cilat paraqitën gjatë zhvillimit të tij, pos për vet objektin e gjykimit.

Zakonisht me aktvendim gjykata vendos për çështje procedurale, sepse shumica e çështjeve gjatë gjykimit zgjidhen me zbatimin e normave procedurale. Mirëpo ka raste kur me aktvendim zgjidhen edhe çështje të natyrës materiale por të cilat nuk e kanë rëndësinë e çështjes kryesore, si p.sh. çështja e shpenzimeve të procedurës, pjesëmarrja e ndërhyrësit në gjykim etj.

Aktvendimet jepen sikurse në seancë gjyqësore ashtu edhe jashtë seancës gjyqësore. Të gjitha aktvendimet që jepen në seancë gjyqësore i shpall gjyqtari. Aktvendimi i shpallur në seancë gjyqësore u dërgohet palëve në kopje të verifikuar vetëm nëse mund të goditet me ankesë të posaçme, apo nëse në bazë të aktvendimit mund të kërkohet menjëherë përmbarimi, apo nëse një gjë të tillë e kërkon drejtimi i procesit.

Aktvendimet të cilat gjykata i jep jashtë seancave gjyqësore u komunikohen palëve duke iu dërguar kopja e vërtetuar e aktvendimit.

Gjykata është e lidhur për aktvendimet e saj, po që se ato nuk i përkasin drejtimit të procesit, apo nëse me LPK nuk është përcaktuar ndryshe.

Aktvendimi ndaj të cilit lejohet ankimi i veçantë duhet të ketë arsyetim.



**KAPITULLI VI**  
**MJETET E RREGULLTA TË**  
**GODITJES**

## 6 MJETET E RREGULLTA TË GODITJES

### 6.1 Mjetet e zakonshme të goditjes

Mjet goditjeje quajmë mjetin procedural me të cilin pala apo personi tjetër i autorizuar nga gjykata kërkon që ta prishë (anulojë) apo ndryshojë vendimin për të cilin pretendon të vërtetoj se është i pavolitshëm, i padrejtë dhe i kundërligjshëm. Mjeti i goditjes është shprehje e pakënaqësisë së palës me vendimin e dhënë në çështjen e saj dhe njëherazi kërkesë që ai të zëvendësohet me vendimin e ligjshëm dhe të drejtë.

#### Ankesa kundër aktgjykimit

Ankesa është mjet i rregullt i goditjes së aktgjykimit të shkallës së parë. Ankesa është e lejuar kundër çdo aktgjykimi të shkallës së parë pa përjashtim. E drejta e ankimit është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<sup>86</sup>

Ankesa është e lejuar kundër çdo aktgjykimi të shkallës së parë, pa përjashtim.

#### a) Efektet e ankesës

Ankesa është mjet me efekt suspensiv, sepse me paraqitjen e saj pengohet marrja e formës së prerë të aktgjykimit, në tërësi apo në pjesën e goditur.

Ankesa është mjet devolutiv, sepse me paraqitjen e saj themelohet kompetenca e gjykatës së shkallës më të lartë që të shqyrtojë vendimin e goditur. Përveç kësaj ankesa është mjet i pavarur, sepse për të vendoset pavarësisht mjeteve tjera të goditjes.

#### b) Interesi juridik për goditjen e vendimit

Sikurse për çdo veprim procedural, ashtu edhe për mjetin e goditjes është paraparë se pala mund ta përdorë vetëm në qoftë së për një gjë të tillë ka interes juridik. Për paraqitjen e mjetit të goditjes pala ka interes juridik në qoftë së shpreson se në lidhje me të gjykata kompetente do të jep vendim më të volitshëm se ai të cilin e ka goditur.

#### c) Afati për paraqitjen e ankesës

Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë është 15 ditë nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me Ligjin për Procedurën Kontestimore nuk parashihet ndonjë afat tjetër. Përjashtim bëjnë procedurat e posaçme kontestimore ku përcaktohen afate më të shkurtra.<sup>87</sup>

#### d) Përmbajtja e ankesës

---

<sup>86</sup> Neni 32 I LPK-së

<sup>87</sup> Afati për ankesë në procedurat e posaçme kontestimore është më i shkurtër së 15 ditë, kështu në procedurat e kontesteve nga marrëdhënia e punës, afati për ankesë është 7 ditë, në procedurën nga kontestet për shkak të pengimit të posedimit, afati për ankesë kundër aktgjykimit është 7 ditë, në konteste më vlerë të vogël afati për ankesë kundër aktgjykimit është 7 ditë, në kontestet-procedurën e dhënies së urdhërpagesës afati për prapësim është 7 ditë kur vendoset lidhur me kambialin dhe 3 ditor kur vendoset lidhur me çekun dhe në kontestet tregtare afati për ankesë është 7 ditë.

Ankesa duhet të përmbajë:

- aktgjykimin kundër të cilit paraqitet ankimi;
- deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në pjesën e caktuar;
- shkaqet e ankimit me arsyetim;
- nënshkrimin e paraqitësit të ankimit;

Nëse ankesa nuk i përmban elementet e paraqitura si më lartë, atëherë gjykata duhet të marrë aktvendim me të cilin e thërret ankuesin që brenda afatit prej 7 ditësh ta plotësojë ankesën. Kundër aktvendimit për plotësimin e ankesës nuk lejohet ankesë.<sup>88</sup>

Po që se ankuesi brenda afatit prej 7 ditësh nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedh poshtë ankesën.<sup>89</sup>

Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi

Me shkaqe të ankimit kundër aktgjykimit kuptojmë të gjitha shkaqet për të cilat, sipas LPK-së, pala mund ta godas atë me ankesë.

Aktgjykimi mund të goditet:

- Për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore,
- Për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike,
- Për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpapia mund të goditen për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, gjegjësisht e heqjes dorë nga kërkesëpapia, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit (neni 181.2 i LPK-së).

**Shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore**—është e përcaktuar me nenin 182 të LPK-së. Gjykata ka për detyrë që t'i zbatoj drejtë të gjitha rregullat procedurale të parapara me ligj. Veprimi procedural i cili nuk është kryer në pajtim me dispozita e procedurës kontestimore është jo i rregullt në pikëpamje procedurale. Nuk është me rëndësi a është bërë shkelja e ligjit me qëllim apo nga padijenja.

Mirëpo nuk janë të rëndësishme së njëjtë të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale. Disa nga shkeljet e procedurës kontestimore janë paraparë si shkelje për ankim e disa nuk janë paraparë si shkelje për ankim. Shkeljet të cilat janë paraparë për ankim i quajmë shkelje esenciale, ndërsa ato që nuk janë paraparë për ankim shkelje jo esenciale. As shkeljet esenciale nuk janë të rëndësishme së njëjtë. Për disa nga shkeljet esenciale vet ligji prezumon se ndikojnë ose mund të ndikojnë gjithmonë në dhënien e vendimit të gabuar. Këto quhen shkelje esenciale absolute. Për shkeljet tjera esenciale nuk vlen prezumimi i përmendur parandaj ankuesi duhet bërë të besueshme rrethanën se ekziston lidhja kauzale midis shkeljes së dispozitës procedurale dhe mundësisë së dhënies së vendimit të gabuar. Këto lloj shkeljesh quhen shkelje esenciale relative. Të dy lloj shkeljet e bëjnë të anulueshme aktgjykimin e dhënë, në procesin kontestimor në të cilin janë bërë, si dhe veprimet procedurale të përfshira me to.

**Konstatimi i gabuar i gjendjes faktike** - kur e parashtron këtë shkak, ankuesi pretendon të vërtetojë së shqyrtimi i çështjes është bërë në mënyrë të plotë, por me gabime. Fakti konstatohet gabimisht në qoftë së gjykata, nga provat e marra, është bindur së ai ekziston, edhe pse në të vërtetë ai nuk ekziston si dhe anasjelltas fakti konstatohet gabimisht në qoftë së gjykata, nga provat e marra, ka nxjerr përfundim së nuk ekziston edhe pse në të vërtetë ai ekziston.<sup>90</sup>

---

<sup>88</sup> Mënyra praktike e vendosje në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër I.

<sup>89</sup> Mënyra praktike e vendosje në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër II.

<sup>90</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë 2006, fq. 82.

*Shembull: në qoftë së gjykata nga provat që ka administruar ka vërtetuar faktin së paditësi ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të pronës kontestuese, ndërsa në të vërtet në posedim të pronës nuk ka qenë paditësi.*

*Shembull: në qoftë së gjykata nga provat që ka administruar ka vërtetuar faktin se paditësi nuk është penguar në posedimin e pronës nga i padituri, ndërsa në të vërtet ai është penguar nga i padituri.*

E meta e tillë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike zakonisht është pasoj e çmuarje së gabuar të provave të shfrytëzuara. Përveç kësaj konstatimi i gabuar i gjendjes faktike mund të jete edhe pasoj e provave të pamjaftueshme apo e zgjedhjes së gabueshme të tyre me qëllim të vërtetimit të ndonjë fakti, mandej e përpunimit të gabuar në baza të faktit ekzistuese (inicionit) se ekziston fakti tjetër, si dhe pasoj e qëndrimit të gabuara së është pohuar ndonjë fakt edhe pse në të vërtetë nuk është bërë një gjë e tillë ose qëndrimit të gabuar së një fakt është i ditur botërisht.<sup>91</sup>

**Konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike** - Deri të një situatë e tillë mund të vihet në rastet kurë gjykata e ka përfunduar gjykimin para se të jetë përgatitur plotësisht çështja juridike për vendosje përkatësisht pa u vërtetuar një fakt vendimtar apo disa sosh.

Me rëndësi është që ankuesi, në ankesën e tij të tregoj saktësisht perse mendon së gjendja faktike nuk është konstatuar plotësisht. Me këtë qëllim ai duhet ti përmend faktet për të cilat mendon së nuk janë konstatuar dhe të tregoj pse janë ato, sipas mendimit të tij, me rëndësi për dhënien e mendimit të drejtë.<sup>92</sup>

*Shembull: në qoftë së çështjen në të cilën paditësi e pretendon të drejtën e pronësisë sipas bazës së mbajtjes (mirëbesimit- me parashkrim fituese) ndërsa gjykata se vërteton fare faktin se kush është në posedim të pronës kontestuese.*

**Zbatimi i gabueshëm i të drejtës materiale** - Kjo shkelje kuptohet si moszbatim nga gjykata i një ligji të së drejtës materiale që duhej zbatuar, zbatimi i një ligji që nuk duhej zbatuar, si dhe interpretimi jo i drejtë i ligjit që bie në kundërshtim me kuptimin e tij të saktë ose me frymën e tij të përgjithshme.<sup>93</sup>

Një rast i tillë mund të vije në shprehje kur pavarësisht së gjykata zbaton me korrektësi dispozitat e procedurës kontestimore dhe vërteton drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, por zbaton gabimisht normën materiale mbi bazën e të cilës ka versuar themelësinë e kërkesëpadisë, aktgjykimi do të jete i kundërligjshëm.

*Shembull: në qoftë së gjykata e ka zbatuar ligjin material i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën kur është kërkuar mbrojtja juridike gjyqësore për një të drejtë të pretenduar subjektive.*

*Shembull: në qoftë së gjykata ka zbatuar gabimisht normat e përcaktimit të afateve të parashkrimit.*

*Shembull: në qoftë së gjykata i ka zbatuar dispozita të cilat një kantatë e bëjnë relativisht nule e është dashur të zbatoj dispozita të cilat kontratën e bëjnë absolutisht nule.*

## 6.2 Procedura sipas ankesës

Në procedurën e vënë në veprim me anë të ankesës kundër aktgjykimit vepron sikurse gjykata e shkallës së parë e cila e ka dhënë aktgjykimin e goditur, ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, kompetente për vendosjen meritorë për ankesën.

---

<sup>91</sup> Po aty, fq.82

<sup>92</sup> Po aty, fq.82, 83.

<sup>93</sup> Po aty, fq.82, 83.

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare.

Veprimet që duhet të ndërmerren gjykata në rast të paraqitjes së ankesës jashtë afatit, jo të plotë apo të palejueshme janë të përcaktuara në nenin 186.1 të LPK-së.

Në qoftë se ankesa është paraqitur me kohë, është e lejueshme dhe e plotë, atëherë gjykata e shkallë së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që në afat prej shtatë (7) ditësh të paraqesë përgjigje në ankesë. Në qoftë se pala e kundërt e shfrytëzon mundësinë që i ka dhënë ligji dhe paraqet përgjigje në ankesë atëherë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë përgjigjen ose më së voni brenda afatit prej shtatë ditësh nga dita e arritjes së përgjigjes së gjykatë.

**Dërgimi i ankesës në gjykatën e shkallës së dytë** - pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë (7) ditësh më së shumti.

### 6.3 Procedura sipas ankesës në gjykatën e shkallës së dytë

Para se të vendoset për ankesën gjykata e shkallë së dytë e përgatitë çështjen. Gjyqtari relator e përgatitë raportin me qëllim të shqyrtimit të lëndës në gjykatën e ankimit, e cila gjykon në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjyqtari relator, po qe nevoja mundet që nga gjykata e shkallës së parë të kërkojë raport për shkeljet e dispozitave të procedurës dhe mungesat tjera të përmendura në ankesë si dhe të kërkojë që me qëllim të konstatimit të shkeljeve, përkatësisht mungesave të tilla, të bëhen hetimet e duhura.

Detyrë e gjyqtarit relator pra është që të studiojë lëndën dhe në lidhje me të, të paraqesë raportin në seancë të mbyllur apo të hapur varësisht se si është caktuar.

Shqyrtimi i çështjes para gjykatës së shkallës së dytë fillon me shpjegime të thukëta të relatorit lidhur më çështjen, por pa e shprehur mendimin e tij rreth themelësisë së ankesës. Pastaj lexohet aktgjykimi, apo pjesa e tij e goditur me ankesë, e nëse është nevoja edhe procesverbali mbi shqyrtimin kryesor para gjykatës së shkallës së parë.

**Caktimi i seancës nga gjykata e shkallës së dytë** - gjykata e shkallës së dytë parimisht vendos për ankesën në seancë të mbyllur, por mund ta caktojë shqyrtimin e çështjes në rastet:

- Kur në procedurën sipas ankesës, para gjykatës së shkallës së dytë ofrohen fakte të reja dhe prova në lidhje me këto fakte. Fakte dhe provat e reja palët mund t'i paraqesin në pajtim me nenin 180 të LPK-së.
- Gjykata e shkallës së dytë duhet ta caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejtë të çështjes edhe po që se aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dy herë dhe kur ankesa është paraqit për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik, ndërsa në seancën e kolegjit vlerësohet se aktgjykimi i ankimit është bazuar në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore apo në gjendje faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë.
- Gjykata e shkallës së dytë mund ta caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejtë edhe kur vlerëson se më qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet përsëri të merren të gjitha ose disa nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë. Për këtë situatë mbete në vlerësimin e gjykatës së shkallës së dytë se kur do të hap shqyrtimin dhe kur do të vendos pa hapur



shqyrtim. Në praktikën gjyqësore ka fare pak raste kur gjykata e shkallës së dytë për këtë situatë ka hapur shqyrtim.

#### 6.4 Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë

Gjykata e ankimit ex officio do të kujdeset për shkeljet: në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësorë, në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji), në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet, në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë dhe në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore.

#### 6.5 Mënyrat e vendosjes sipas ankesës

Neni 195.1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore parasheh që Gjykata e Apelit, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj, ka diskrecion që të zgjidhë ankesën në njërin nga mënyrat si në vijim:

- ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;
- ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;
- ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore;
- ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur;
- ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

l) Hedhja poshtë e ankesës si e vonuar, jo e plotë apo e palejueshme

Sipas dispozitës së nenit 196 të LPK-së parashihet se: Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në (nenin 186).<sup>94</sup>

Gjykata e shkallës së dytë nuk do të veproj sipas dispozitës së nenit 196 të LPK-së, në situatën si në vijim: në qoftë se gjykatës së shkallës së dytë i është dërguar lënda sipas ankesës e cila është jo e plotë, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk i ka ndërmarrë paraprakisht veprimet nga 179 par 1 i LPK-së, atëherë gjykata e shkallës së dytë nuk mundet që ta hedh poshtë ankesën si jo të plotë por duhet që lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë më udhëzim që gjykata e shkallës së parë të veproj në kuptim të dispozitës së nenit 179 par 1 i LPK-së, duke e thirrur ankuesin që ta plotësoi ankesën.

b) Prishja e aktgjykimit të gjykatës themelore dhe hedhja poshtë e padisë

Gjykata e Apelit nxjerr aktvendim për prishjen e aktgjykimit të Gjykatës Themelore, dhe e hedhë poshtë padinë,<sup>95</sup> nëse janë plotësuar rrethanat sipas nenit 198 të LPK-së. , të cilat parashohin si në vijim:

- Nëse kërkesa për të cilën është vendosur bënë pjesë në kompetencën gjyqësore,
- Nëse ekziston gjyqëvarësia,

---

<sup>94</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur në formularin numër III.

<sup>95</sup>Mënyra praktike e vendosje në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër IV.

- Nëse çështja është e gjykuar, (ekzistimi i aktgjykimit të formës së prerë),
- Nëse paditësi ka heqë dorë nga kërkesëpadia (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia),
- Nëse ekziston pajtimi gjyqësor për çështjen.

Këto situata i referohen rasteve kur gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar prezumimet procedurale që kanë të bien me kompetencën dhe objektin e kontestit.

Gjykata e apelit e hedh padinë edhe në këto raste:

- Në qoftë se në procedurën e shkallës së parë ka vepruar, si paditës apo i paditur, personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse,
- Nëse palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo nëse palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor,
- Nëse përfaqësuesi ligjor, ose ai me prokurë, nuk i ka pasur autorizimet e duhura për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të veçanta, gje gjësisht nëse veprimet e caktuar të kryera në procedurë më vonë nuk i ka aprovuar vetë pala.

Këto situata i referohen rasteve kur gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me palët.

### c) Prishja e aktgjykimit të gjykatës themelore dhe kthimi i çështjes në rigjykim

Sipas nenit 197 të LPK-së, Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të bërë të çështjes, me aktvendim e prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe çështjen ia kthen për rigjykim,<sup>96</sup> në qoftë se konstaton se ekziston njëra ndër këto shkaqe të përmendura në ankesë:

- po që se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji gjykata e ka dhënë aktgjykimin në bazë të pohimit, apo aktgjykimin në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia;
- po që se ndonjëri nga palët me veprim të kundërligjshëm, e sidomos për shkak të mos thirrjes në mënyrë të rregullt, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, kurse veprimi i tillë ka pasur ndikim në dhënien e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë;
- po që se gjykata e ka dhënë aktgjykimin pa e bërë shqyrtimin kryesor të çështjes juridike;
- po që se në dhënien e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas vet ligjit duhet të përjashtohet nga gjykimi.

Për më tepër kur gjykata e shkallës së dytë e prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ia kthen të njëjtës gjykatë për rigjykim, ajo mund të urdhërojë që rishqyrtimi i çështjes të bëhet nga gjyqtari tjetër<sup>97</sup>.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar që pasi që ta pranoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë në aftë prej 30 ta caktoj seancën (përgatitore apo për shqyrtim kryesor), ti kryej gjitha veprimet procedurale dhe ti shqyrtoj të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë me vendimin e saj.

Procedura e zhvilluar në rishqyrtim përbënë tërësi unike më atë në të cilën është dhënë aktgjykimi i anuluar. Në të palët mund ti kryejnë të gjitha veprimet procedurale, duke përfshirë edhe ato disponibile, të cilat kanë pasur të drejtë ti kryejnë në procedurën e parë.<sup>98</sup>

---

<sup>96</sup>Mënyra praktike e vendosje në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 5.

<sup>97</sup>Neni 198.3 i LPK-së,

<sup>98</sup>Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë 2006, fq.89.

d) Refuzimi i ankesës dhe vërtetimi i aktgjykimit të shkallës së parë

Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykim e refuzon ankesën si të pathemeltë dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë nëse konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet nga të cilat është goditur aktgjykimi, e as shkaqet për të cilat ajo kujdeset sipas detyrës zyrtare, (neni 200 i LPK-së).<sup>99</sup>

Në rastet, kur gjykata e shkallës së dytë konstaton se ankesa është e pathemeltë, ajo njëkohësisht e vërteton vendimin (aktgjykimin ose aktvendimin) e gjykatës së shkallës së parë.<sup>100</sup>

e) Ndryshimi i aktgjykimit të gjykatës themelore

Sipas nenit 201 të LPK Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërsëdrejti, me aktgjykime ndryshon aktgjykimin,<sup>101</sup> po që se konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë:

- nëse ka konstatuar se ekziston shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore, përpos atyre të përmendura në nenin 197 të këtij ligji;
- nëse në seancën e kolegjit, me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të marra në mënyrë indirekte, ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë;
- nëse pas shqyrtimit direkt të çështjes, në bazë të provave të reja, apo në bazë të marrjes rishtas të provave të administruara nga Gjykata Themelore, ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë;
- nëse konsideron se gjendja faktike e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejte, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga Gjykata Themelore;
- nëse ka konstatuar se me aktgjykimin e shkallës së parë është tejkaluar kërkesëpadia ashtu që me të është pranuar me tepër se që është kërkuar me padi.

Sipas nenit 203 të LPK-së, Gjykata e Apelit nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës ankuese, po që se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtarë.

Në të gjitha rastet e ndryshimit të aktgjykimit të shkallës së parë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë duhet të jetë tjetër dhe i ndryshëm nga ai i pari. Me anë të aktgjykimit ndryshues të gjykatës së shkallës së dytë evitohen parregullsitë që kaun të bëjnë me vendosjen meritore e jo me procedurën,<sup>102</sup> përjashtim nga ky rregull benë rasti i tejkalimit të kërkesëpadiës ku gjykata e shkallës së dytë në të vërtetë e ndryshon aktgjykimin për shkak të gabimeve të procedurës.

f) Organizimi i një aktgjykimi të Gjykatës së Apelit

Neni 204 i LPK-së parasheh që në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, Gjykata e Apelit duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Të gjitha rregullat që vlejné për vendimin e gjykatës së shkallës së parë parimisht vlejné edhe për vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, por me disa specifika. Në hyrje të vendimit duhet të tregohet përmbajtja e ankesës në pika të shkurtra, në dispozitiv tregohet mënyra e vendosjes ndërsa në pjesën arsyetuese bëhet vlerësimi i thënieve të ankuesit dhe tregohen shkaqet për mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë.

---

<sup>99</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur në formularin numër 6.

<sup>100</sup> Iset Morina & Selim Nikçi "Komentari" Ligji për Procedurën Kontestimore, Prishtinë 2012, fq.385.

<sup>101</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 7.

<sup>102</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë 2006, fq. 90.

## **6.6 Ankesa kundër aktvendimit**

### **6.6.1 Baza për ankesë dhe efektet**

Neni 206.1 i LPK-së parasheh që kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, në qoftë se në këtë ligj nuk është përcaktuar që ankimi nuk lejohet, kurse (neni 206.2), po që se me këtë ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë.

Ankesa e paraqitur brenda afatit ligjor e pengon përmbarimin e aktvendimit, në qoftë se me këtë ligj nuk është parashikuar ndryshe, (neni 207.1).

### **6.6.2 Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë për ankesat kundër aktvendimeve**

Neni 209 i LPK-së i parasheh dispozitat në vijim për vendosjen mbi ankesat kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore.

Gjykata e Apelit mund ta zgjidhë ankesën në këto baza:

- të hedhë poshtë ankesën si të pa afatshme,
- ta hedhë poshtë si jo të lejueshme;
- të refuzon ankesën si të pa themeltë dhe të vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë;
- të aprovon ankesën dhe të ndryshon aktvendimin e goditur;
- të prish aktvendimin e goditur, e kur është nevoja ta kthej çështjen në Gjykatën Themelore.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**

## 6.7 Formularët praktikë për mjetet e rregullta të goditjes

### Formulari 1 – Aktvendim me të cilin kthehet ankesa për plotësim

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së palës paditëse, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_ mori këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. Paditësit i KTHEHET në plotësim ankesa e datës \_\_\_\_\_, që në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi ta plotësoi ankesën duke e nënshkruar.
- II. Nëse paraqitësi i ankesës brenda afatit të caktuar nuk ia kthen gjykatës ankesën e plotësuar, atëherë kjo gjykatë do të hedhë poshtë ankesën si jo të plotë.

#### A r s y e t i m

Paditësi kundër aktgjykimit të kësaj gjykate, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ka paraqitë ankesë me datën \_\_\_\_\_.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të ankesës së paditësit ka gjetur se e njëjta nuk është e nënshkruar nga paraqitësi i ankesës dhe në këtë mënyrë është në kundërshtim me nenin 178 të LPK, që rregullon se çka duhet të përmbajë ankesa.

Meqenëse ankesa nuk e përmban nënshkrimin e ankuesit, si element i domosdoshëm që duhet ta përmbajë ankesa sipas nenit 178 të LPK, gjykata duke ju referuar nenit 179 të këtij ligji vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLA JURIDIKE:**  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 2 - Aktvendim me të cilin hedhet poshtë si jo e plotë ankesa e paditësit

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së palës paditëse, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_ mori këtë:

### A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si jo e plotë ankesa e paditësit \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, e datës \_\_\_\_\_, e paraqitur kundër aktgjykimit të kësaj gjykate, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Paditësi kundër aktgjykimit të kësaj gjykate, me numër C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ka paraqitë ankesë me datën \_\_\_\_\_.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të ankesës së paditësit ka gjetur se ankesa nuk e përmban nënshkrimin e ankuesit, si element i domosdoshëm që duhet ta përmbajë ankesa sipas nenit 178 të LPK, andaj duke ju referuar nenit 179 të këtij ligji me aktvendim e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej shtatë ditësh të plotësojë ankesën e paraqitur.

Aktvendimin e kësaj gjykate për kthimin e ankesës në plotësim paditësi e ka marrë me datën \_\_\_\_\_ dhe nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës që në afat prej shtatë ditësh ta plotësojë ankesën duke e nënshkruar atë.

Meqenëse paditësi nuk e ka plotësuar ankesën e tij brenda afatit ligjor prej shtatë ditësh, gjykata duke ju referuar nenit 179 të LPK vendosi që ankesën e paditësit ta hedhë poshtë si jo e plotë.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm,

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.



### **Formulari 3 - Aktvendim me të cilin hedhet poshtë ankesa e paditësit si e pasafatshme**

Ac.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve \_\_\_\_\_, kryetar i kolegjit dhe \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, për shkak të \_\_\_\_\_, duke vendosur sipas ankesës të paditëses të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_, në seancë e kolegjit të mbajtur me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**HUDHET** ankesa e paditëses, si e PASAFATSHME

#### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e goditur në pikën I të dispozitivit është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës i datës \_\_\_\_\_, me të cilin paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe të detyrohet e paditura që ta kthejë paditësen në vendin e punës si operatore e qepjeve dhe të vazhdoj me të gjitha të drejtat dhe obligimet duke i kompensuar të njëjtës edhe pagat për dy muaj e 10 ditë.

Nën pikën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës ti bartë secila palë.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësja për shkak të:

- a. Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- b. Aplikimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që aktgjykimin i goditur të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar e paditura, me propozim që të refuzohet ankesa e paditëses si e pabazuar, ndërsa aktgjykimin i goditur të vërtetohet.

Kjo gjykatë gjen se ankesa është e pasafatshme.

Gjykata e Apelit me shikimin në fletë kthesë ka vërtetuar se paditësja ka pranuar aktgjykimin C.nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_\_. Ankesa ndaj këtij aktgjykimi është dorëzuar gjykatës me datën \_\_\_\_\_, çka shihet nga vula e pranimit të gjykatës, nga data e vendosur në ankesë si dhe nga akti përcjellës i Gjykatës Themelore në Prishtinë për Gjykatën e Apelit.

Pasi që afati për ankesë ka qenë 7 ditë nga dita e pranimit të aktgjyqimit, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit prej 7 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data \_\_\_\_\_ dhe kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data \_\_\_\_\_, prandaj me që ankesa është paraqitur me datën \_\_\_\_\_, atëherë rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 1 dite. Në bazë të cekurave dhe duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, Gjykata e Apelit, në kuptim të dispozitës së nenit 195 par.1 pika (a) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ac.nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_

**Kryetari i kolegjit – gjyqtari**

## **Formulari 4 - Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe hedhet poshtë padia e paditësit**

Ac.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët \_\_\_\_\_, kryetar i kolegjit, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_ av. \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, për shkak të \_\_\_\_\_, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_, C.nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. \_\_\_\_\_ mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_, C.nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, Hedhet poshtë padia e paditësit \_\_\_\_\_, nga \_\_\_\_\_, e paraqitur në Gjykatën Themelore në \_\_\_\_\_ me datën \_\_\_\_\_.

### **A r s y e t i m**

Shpjegimi i mënyrës së vendosjes nga gjykata e shkallës së parë

.....

Pretendimet ankimore të palëve

.....

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi e kishte statusin e shërbyesit civil dhe për të drejtën e pretenduar në kërkesëpadi nuk kishte shteruar mjetet administrative të ankimit, andaj pretendimet ankimore të paditurës ishin të argumentuara dhe të bazuara në ligj, të cilat pretendime pala paditëse nuk i ka kontestuar edhe pse përfaqësuesit të tij i është dorëzuar kopja e ankesës me datën \_\_\_\_\_.

Me nenin 127.4 të Ligjit për Procedurën Administrative është përcaktuar se “Palët e interesuara mund t’i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit”. Ndërsa me nenin 11.6 të Rregullores nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, e cila përfaqësonte ligj në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit, është përcaktuar “Asgjë në këtë rregullore nuk mund të pengojë të drejtën e një nëpunësi civil për shqyrtimin gjyqësor të vendimit përfundimtar administrativ në pajtim me ligjin në fuqi, me kusht që vendimi, i cili mund të apelohej konform këtij neni, nuk do të konsiderohet si përfundimtar para se Këshilli të lëshojë një vendim në përputhje me këtë”.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar procedurën kontestimore dhe ka dhënë aktgjykimin ankimor pa u krijuar kushtet ligjore për dhënien e mbrojtjes gjyqësore në këtë çështje kontestimore, sepse paditësi paraprakisht nuk kishte provuar se i kishte shfrytëzuar mjetet për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara për kompensimin në rastin e pensionimit të tij, tek organet kompetente, përfshirë edhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se “Me ligjin për Procedurën Kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të cilave gjykata shqyrton dhe i zgjidh kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridik, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.”

Andaj, paditësi, paraprakisht të drejtat e pretenduara nga marrëdhënia e punës për të cilat vlerëson se i janë cenuar sipas dispozitave të ligjeve të lartë cituara (LPA dhe Rregullores), do të duhej t'i shfrytëzonte të gjitha mjetet ligjore në procedurën administrative, përfshirë edhe procedurën para këshillit, Kolegji vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të procedurës kontestimore nga neni 182.1 e që ishte me ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Me sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 195.1 b) për të vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ac.nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_

Kryetari i kolegjit – gjyqtari

**Formulari 5 - Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin pranohet ankesa e paditësit, prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda kthehet në rigjykim**

Ac.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA E APELIT E KOSOVES, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve \_\_\_\_\_, kryetar i kolegjit dhe \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, kundër të paditurave \_\_\_\_\_, për shkak të \_\_\_\_\_, duke vendosur sipas ankesës të paditëses të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PRANOHET ankesa e paditësit \_\_\_\_\_ dhe ankesa e të paditurës \_\_\_\_\_ në Prishtinë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, lënda i kthehet në rigjykim Gjykatës Themelore në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, aprohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, Komuna e \_\_\_\_\_. Detyrohet e paditura e dytë \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ që paditësit, t'ia lirojë dhe dorëzojë në posedim pjesën e ngastrës kadastrale në 3/1, në sipërfaqe prej 36 m<sup>2</sup>, me matje dhe përkufizime gjeodezike dhe atë nga veriu në gjatësi prej \_\_\_\_\_ m, me rrugë në verilindje me ngastrën kadastrale nr. \_\_\_\_\_, në gjatësi prej \_\_\_\_\_ m dhe në jug në pjesën tjetër të ngastrës nr. \_\_\_\_\_, në gjatësi prej \_\_\_\_\_ dhe pjesën e ngastrës kadastrale nr. \_\_\_\_\_ në sipërfaqe prej \_\_\_\_\_, e cila matet dhe përkufizohet me sa vijon, në verilindje me rrugën në gjatësi prej \_\_\_\_\_, në juglindje me pjesën tjetër të ngastrës kadastrale \_\_\_\_\_, në gjatësi prej \_\_\_\_\_ m dhe në jug me ngastrën kadastrale nr. \_\_\_\_\_, në gjatësi prej \_\_\_\_\_ m si dhe në veri pjesën tjetër të ngastrës kadastrale nr. \_\_\_\_\_ në gjatësi prej \_\_\_\_\_ msi dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej \_\_\_\_\_ euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Refuzohet si e pabazë kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që e paditura e parë \_\_\_\_\_, t'ia liroj palujtshmërinë e cekur në al.II të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykim ka ushtruar ankesë paditësi përmes të autorizuarit të tij për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe për shkak të vendimit për shpenzimet e procedurës kontestimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovojë ankesën, aktgjykimin e shkallës së parë ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe vendosje të serishme.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë ka paraqitur edhe e paditura \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore me propozim që ankesa e të paditurës së dytë të aprovet dhe aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK-së gjeti se,

Ankesat janë të bazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për pagimin e borxhit në emër të qirasë me të dhënat si në dispozitivin e padisë.

Gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike bëri administrimin e provave, me leximin e marrëveshjes për nën qiradhënie të dt. \_\_\_\_\_,

kontratës së dt. \_\_\_\_\_, njoftimit nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, kopjes së planit të dt. \_\_\_\_\_, listën poseduese nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, kontratës mbi shitblerjen e dt. \_\_\_\_\_, dhe mendimit dhe konstatimit të ekspertit të gjeodezisë \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_ bashkë me plotësimin këtij mendimi të dt. \_\_\_\_\_. Gjykata vlerësoi edhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe gjeti se të njëjtat janë kryesisht të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në këtë gjendje të çështjes juridike-civile duke e vlerësuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë kjo gjykatë nuk mundet të pajtohet me qëndrimin juridik të saj sepse aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 2 par.1 sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike ka qenë e obliguar të vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse pasi të ketë analizuar provat në kuptim të nenit 9 të LPK të bjerë aktgjykim të drejtë dhe të bazuar në ligj e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë fare nuk është lëshuar për të vendosur për kërkesën e paditësit që ka bërë në precizimin e fundit të padisë e për të cilën ka shprehur interesin e tij në këtë çështje juridike. Kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar përmban edhe shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (n), sepse i njëjti është kundërthënës në vetvete për faktin se dispozitivi i tij është në kundërshtim me arsyetimin e tij në mes të asaj çka thuhet në arsyetimin e tij dhe procesverbalin e seancës kryesore.

Kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk mund vlerësohet si i rregullt edhe sa i përket vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike siç me të drejtë pretendojnë në ankesat e tyre paditësi dhe e paditura e dytë sepse gjykata e shkallës së parë ka dështuar që mbi bazën e provave dhe fakteve të paraqitura në shkresat e lëndës të konstatojë drejt gjendjen faktike në këtë çështje juridike.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë është e detyruar të evitojë të metat e sipër përmendura, të vendos brenda kufijve që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse duke i zhvilluar provat e proceduara dhe të nevojshme dhe të njëjtat t'i vlerësojë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ashtu që pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike të vendos përkritazi me kërkesëpadinë e paditëses dhe të merr aktgjykim të drejtë, meritator dhe bazuar në ligj.

Nga të cekurat më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195 pika c të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVES

C.nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

## **Formulari 6 -Aktgjykimi Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë**

Ac.nr.\_\_\_\_\_/\_\_\_\_

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët \_\_\_\_\_, kryetar i kolegjit, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_ av.nga \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, për shkak të \_\_\_\_\_, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.\_\_\_\_ të dt.\_\_\_\_, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.\_\_\_\_\_ mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës, gjersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.\_\_\_\_\_ të dt.\_\_\_\_\_, VËRTETOHET.

### **A r s y e t i m**

Shpjegimi i mënyrës së vendosjes nga gjykata e shkallës së parë

.....

Pretendimet ankimore të palëve

.....

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar te e paditura në bazë të kontratës të dt.\_\_\_\_, si dhe aneksit të kontratës të punës të dt.\_\_\_\_, në cilësi të punëtores menaxhere e degës për shërbime në \_\_\_\_\_. E paditura me njoftimin e shkëputjes së menjëhershme të kontratës së punës të dt.\_\_\_\_\_, të lëshuar nga drejtori i përgjithshëm i të paditurës \_\_\_\_\_, duke u bazuar në nenin 7 të kontratës së punës në përputhje me nenin 5 të doracakut të linjës së veprimit të personelit dhe nenit 11 të Rregullores së UNMIK-ut të Ligjit Themelor të Punës të cilat dispozita i referohen shkeljeve të rënda të detyrave të punës, paditëses ia ka shkëputur kontratën e punës me arsyetim se ajo si menaxhere për shërbime me individë në \_\_\_\_\_, ka përgjegjësi objektive për rastin e dt.\_\_\_\_\_ku punëtori që ka qenë nën mbikëqyrjen e saj, duke i shkelur procedurat operative në bankë në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar shumën prej \_\_\_\_\_. Ky njoftim është si pasojë për shkak të rastit kur me dt.\_\_\_\_\_, nën nëndegën e të paditurës në \_\_\_\_\_, nga ana e punëtorit \_\_\_\_\_, është përvetësuar shuma prej \_\_\_\_\_, menaxher i të cilit ishte paditësja. Kundër këtij njoftimi paditësja ka ushtruar ankesë. Por e paditura fare nuk është përgjigjur ankesës së paditëses për çfarë arsye paditësja ka parashtruar padi në gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike ka marrë qëndrim juridik se paditëses në mënyrë të kundërligjshme i është shkëputur kontrata e punës pa i zbatuar procedurat e parapara me nenin 11.5 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2001/27, të Ligjit Themelor të Punës dhe ka vendosur siç përshkruhet në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në rastin konkret nuk është zbatuar procedura disiplinore e brendshme ashtu siç është paraparë në nenin 5 të doracakut të linjës së veprimit të personelit të paditurës.

Paditëses i është lëshuar së pari njoftimi për shkëputje të menjëhershme të kontratës së punës e më vonë ka pasuar vërejtja me shkrim me dt \_\_\_\_\_, çka është në kundërshtim me doracakun e linjës së veprimit të personelit të paditurës e po ashtu edhe me Ligin Themelor të Punës.

Meqë aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, Gjykata e Apelit në kuptim të nenit \_\_\_\_\_ të LPK-së, e refuzon ankesën e të paditurës kurse aktgjykimin e atakuar e vërteton.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

Ac.nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari

## **Formulari 7 - Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin pranohet ankesa e të paditurit dhe ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë**

CA.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA E APELIT E KOSOVES, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët, \_\_\_\_\_ kryesues, anëtarët \_\_\_\_\_, (më tej kolegji), në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, e përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ avokat nga \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, e përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, për kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Pranohet ankesa e të paditurës \_\_\_\_\_, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. \_\_\_\_\_ i datës \_\_\_\_\_, ashtu që gjykohet:

Refuzohet kërkesëpadia e paditësit \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, me të cilën paditësi ka kërkuar të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të demit, të shkaktuar gjatë trazirave të dt.17 dhe 18.03.2004, t'ia paguajë paditësit shumën prej \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) Euro, me kamatë si për mjetet të deponuara në bankë në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar duke filluar prej dt. \_\_\_\_\_ deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet në shumë prej \_\_\_\_\_ Euro, si e pa bazuar.

### **A r s y e t i m**

Shpjegimi i mënyrës së vendosjes nga gjykata e shkallës së parë

.....

Pretendimet ankimore të palëve

.....

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.38/2008), më tej LPK, e ekzaminoj aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa është e themeltë.

Kolegji konstaton se gjatë zbatimit të procedurës kontestimore gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 par.2 nën par.(b), (g), (j),(k) dhe (m) të LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga shkresat në dosje rezulton se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar këtë gjendje faktike të përmbajtur në aktgjykimin ankimor. Është fakt notor se me 17 dhe 18 mars 2004, në Kosovë kanë ndodhur protesta dhe trazira (me tej trazirat) të cilat në disa raste dhe vende të caktuara kanë rezultuar me dhunë dhe me dëme materiale qoftë në objekte kulturore, prona publike por edhe në ato private.

Nuk ishte kontestuese në mes ndërgjyqësve se paditësi, si pasojë e trazirave, kishte pësuar dëm në vlerë prej \_\_\_\_\_ Euro, gjithashtu nuk ka qenë kontestues as fakti se paditësi dëmet e pësuar si pasojë e trazirave i ka paraqitur në shërbimin policor të asaj kohe, Stacioni Policor në Graçanicë, me ç' rast ishte përpiluar raporti nr. \_\_\_\_\_ i dt. \_\_\_\_\_.

Paditësi, kishte parashtruar kërkesë për kompensimin e demit, Komisionit Ndërmintor përkatës për sanimin e dëmeve të krijuara si pasojë e trazirave. Komisioni përkatës pas vlerësimit të gjendjes pjesërisht i kishte kompensuar dëmin paditësit dhe atë në kontest të riparimit të objektit dhe vendosjes



së xhamave, në shumën prej \_\_\_\_euro, si dhe pranimin e TVSH-së në shumë prej \_\_\_\_\_euro, të paguara në kufi me rastin e importimit të mallit.

Ndërsa dëmin e pretenduar nga paditësi se i ishte krijuar si pasojë e trazirave në vlerë prej \_\_\_\_\_euro, e paditura ka refuzuar t'ia kompensojë paditësit, duke e kundërshtuar legjitimacionin e saj të palës së paditur në këtë çështje kontestimore pasi që nuk kishte përgjegjësi të plotë në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë gjatë afatit kohor kur ka ndodhur ngjarja dëmtuese.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje juridike, por gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë është thirrur në vendimin e Kryeministrit të Kosovës, nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, sipas të cilit ishte formuar fondi emergjent për riparimin e objekteve fetare, kulturore, shkollore, shëndetësore dhe private të dëmtuara gjatë trazirave. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë, është thirrur në nenin \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, (“Gazeta Zyrtare e ish RSFJ-së” nr.20/78) më tej LMD, që përfaqësonte ligj të zbatueshëm në Kosovë, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, 1000/24, me të cilën është përcaktuar.

Me nenin 180 të LMD-së është përcaktuar se “Për dëmin e krijuar nga vdekja ose për lëndimin trupor për shkak të akteve të dhunës ose të terrorit, si dhe në rastin e demonstratave dhe manifestimeve publike përgjigjet Bashkësia Shoqërore Politike, organet e së cilës, sipas dispozitave në fuqi kanë qenë të detyrueshme ta parandalojnë një dëm të tillë”.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e vlerëson të padrejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, pasi që paditësi deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes nuk ka provuar se atij i është shkaktuar dëm i përkufizuar në dispozitën e lartë cituar të LMD-së, përveç dëmit material si pasojë e asgjësimit të mallrave të depozituara në depo, nga personat të pa identifikuar.

Qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj edhe nga aspekti se Kosova në kohën kur paditësi i është shkaktuar dëmi nuk ishte shtet dhe si rrjedhojë, nuk kishte kapacitete ligjore e as institucionale me përgjegjësi të plotë në lëmin e ruajtjes së rendit publik në Kosovë.

Kjo çështje, ishte rregulluar me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, (me tej Rezoluta \_\_\_\_\_) si dhe me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (me tej Korniza).

Me nenin 9 par.(d) të Rezolutës - është përcaktuar se “Përgjegjësit e pranisë ndërkombëtare të sigurisë që do të vendoset dhe do të veprojnë në Kosovës të përfshijnë: d) Garantimin e sigurisë dhe të rendit publik.....”.

Me nenin 8.2 nën par.(c) të kornizës është përcaktuar “PSSP-ja koordinon së bashku me Praninë Ndërkombëtare të Sigurimit, në c) Përforcimin e sigurisë dhe rendit publik”.

Kolegji vlerëson se pasi që e paditura nuk kishte kapacitet të plotë të përgjegjësisë për ruajtjen e rendit publik, kurse në proporcionet e saja të përkohshme të formuara mbi bazën e Kornizës, kishte formuar fond emergjent nga i cili ishte kompensuar paditësi (në shumën e pohuar), po ashtu paditësi nuk provoi se kishte pësuar dëm të përkufizuar sipas dispozitës së nenit 180 të LMD-së, së kërkesëpadia e tij është e pa bazuar dhe si e tillë duhet refuzuar në tërësi.

Me nenin 201.(d) të LPK-së, është përcaktuar “Gjykata e shkallës së dytë...e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, po që se konstaton se ekziston ndonjë nga këto shkaqe, nëse konsideron se gjendja faktike e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejtë, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë.

Kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga nenin 201 neni par.(d), i LPK-së për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

CA.nr.\_\_\_\_\_/\_\_\_\_ dt.\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kolegjit-gjyqtari



**KAPITULLI VII**  
**MJETET E JASHTËZAKONSHME TË**  
**GODITJES**

## 7 MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES

LPK i njeh tri lloje të mjeteve të jashtëzakonshme juridike për të cilat mund të vendosë Gjykata Supreme dhe ato janë; Revizioni, (neni 211), Përsëritja e Procedurës (neni 232) dhe Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë (neni 245).

### 7.1 Revizioni

Revizioni është mjet i goditjes së jashtëzakonshme me të cilin pala e godet për shkak të shkeljes së ligjit aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë të dhënë sipas ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Revizioni nuk duhet parë vetëm si garanci më tepër se kontesti midis palëve do të zgjidhet drejtë, por rëndësia e këtij mjeti qëndron edhe në faktin se ai është mjet për njëjtësimin e praktikës gjyqësore, pasi që duke marrë qëndrime në lidhje me një çështje Gjykata Supreme e Kosovës, ndihmon me vendimin e saj gjykatat më të ulëta, sepse ato zakonisht i respektojnë qëndrimet e saj.

Revizioni si mjet i jashtëzakonshëm është i kufizuar sepse mund të goditen vetëm vendimet e caktuara dhe për shkaqet e caktuara.

Procedura për paraqitjen e revizionit është rregulluar me nenin 211 të LPK-së.<sup>103</sup>

Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Përrjashtim nga ky rregull kemi në rastet kur revizioni paraqitet për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të bërë në gjykatën e shkallës së dytë, me ç'rast palët mund të paraqesin fakte dhe prova të reja nëse pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti paraqesin ma herët.

Revizioni kundër aktgjykimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë, me të cilin vërtetohet aktgjykimi në bazë të pohimit, mund të paraqitet vetëm nga shkaqet e përmendura në paragrafin 1 pika a) dhe b) dhe paragrafin 2 të nenit 214.3.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë, revizioni nuk lejohet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 1 pika a) e këtij neni, po që se ekzistimi i tyre nuk është përmendur fare në ankesë, përveç se kur është fjala për shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare vet Gjykata e Apelit dhe ajo e revizionit (neni 214.4).

Revizionin e paraqitur pas skadimit të afatit ligjor, të palejueshëm, apo atë jo të plotë, me anë të aktvendimit e hedhë poshtë gjykata e shkallës së parë, pa mbajtur seancë gjyqësore (neni 218).

Mënyrat e vendosjes sipas revizionit nga Gjykata Supreme e Kosovës;

- m) Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 221 i këtij ligji).
- n) Gjykata Supreme e refuzon revizionin si të pathemeltë, me anë të aktgjykimit, po që se konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet e cekura në revizion.
- o) Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se ekziston shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave mund të paraqitet revizioni, përpos (shkeljeve<sup>104</sup>), atëherë

---

<sup>103</sup>Gjykata e revizioni (Gjykata Supreme) objekt shqyrtimi e bën anën juridike të çështjes, e jo anë faktike të saj, është shumë më rëndësi, por edhe e vështirë që të dallohet njëra nga tjetra. Kjo vlen sidomos me rastin e zbatimit të qëndrimeve të përvojës, të standardeve juridike, por edhe me rastin e interpretimit të deklaratave të vullnetit, për shembull kur duhet përgjigjur se a ka qenë apo jo një person i ndërgjegjshëm, a ka vepruar apo jo në pajtim me adetet e mira etj., atëherë ana faktike dhe ajo juridike aq shumë komplikohen sa që është shumë e vështirë të veçohen dhe dallohen. Për dallimin e tyre mund të ndihmoj kriteri themelor që: ana faktike e çështjes ka të bëjë me themelimin mbi të cilin gjykata e zbaton normën materialo-juridike. Ajo pra ka të bëjë me gjendjen në rastin konkret, me ngjarjen jetësore e cila e përbën premisën e poshtme të silogjizmit gjyqësor. Ana juridike e çështjes hyn në lëmin e normativitetit dhe e përmban premisën e sipërme të silogjizmit gjyqësor.

ajo, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes, me aktvendim e anulon pjesërisht apo plotësisht aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të parë, apo vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë dhe ia kthen çështjen për rigjykim gjyqtarit tjetër apo të njëjtë të gjykatës së shkallës së parë, gjegjësisht kolegjit tjetër apo të njëjtë të gjykatës së shkallës së dytë, ose gjykatës tjetër kompetente.

- p) Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.
- q) Po që se gjykata e revizionit konstaton se për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, apo për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, atëherë ajo me aktvendim e aprovon revizionin dhe e anulon pjesërisht apo tërësisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, apo vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë, dhe çështjen ia dërgon për rigjykim gjyqtarëve të njëjtë apo të tjerë të gjykatës të shkallës së parë apo të dytë.
- r) Po që se konstaton se me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë është tejkaluar kërkesëpadia, gjykata e revizionit me aktgjykimin e saj e aprovon revizionin e palës dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.

## 7.2 Përsëritja e Procedurës

Propozimi për përsëritjen e procedurës është mjet i jashtëzakonshëm i goditjes, i kufizuar, josuspenziv, i dyanshëm dhe në disa raste demonstrativ. E drejta për të kërkuar përsëritjen e procedurës është e kufizuar në aspektin e vendimeve që mund të goditën më këtë mjete goditjeje, në aspektin e shkaqeve për të cilat mund të bëhet goditja e vendimeve, si dhe në aspektin e afatit brenda të cilit mund të ngritët ai.<sup>105</sup>

Me anë të propozimit për përsëritjen e procedurës mund të kërkohet përsëritja e procedurave të përfunduara më vendim të formës së prerë. Procedura mund të përfundoj me anë të aktgjykimit, me anë të aktvendimit me të cilin padia hedhet poshtë apo me anë të aktvendimit me të cilin konstatohet se ka përfund procedura me anë të veprimeve disponibile të palëve.<sup>106</sup>

**Shkaqet për përsëritjen e procedurës** - Neni 232 i LPK-së parasheh që procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës:

Në dispozita e nenit 232 parashihen shkaqet për përsëritjen e procedurës të numëruar në mënyrë taksative, por të cilat mund të klasifikohen në tri grupe:

### 7.2.1 Shkelja e dispozitave procedurale:

- s) në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore;
- t) në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi procedurale nuk e ka

---

<sup>104</sup>Në qoftë se në procedurën e shkallës së parë apo të dytë është vendosur mbi kërkesën që nuk bënë pjesë në kompetencën e gjykatave, apo që përbënë gjë të gjykuar, ose nga e cila paditësi ka hequr dorë, apo për të cilën ekziston ujdia gjyqësore, gjykata e revizionit me aktvendim e anulon aktgjykimin e goditur me anë të revizionit dhe e hedhë poshtë padinë si të palejueshme.

Po që se në procedurën e shkallës së parë apo të dytë, si palë paditëse apo e paditur ka marrë pjesë personi me pazotësi për të qenë palë ndërgjyqëse, apo nëse palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo nëse palën pa zotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, apo në qoftë se përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i palës nuk e ka pasur autorizimin e duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq ose për kryerjen e veprimeve procedurale konkrete, gjegjësisht po që se ndjekjen e çështjes në gjyq apo kryerjen e veprimeve procedurale konkrete nuk e ka aprovuar pala më vonë, atëherë gjykata e revizionit, varësisht nga natyra e shkeljeve procedurale ekzistuese, vepron sipas dispozitave të paragrafit 1 apo 2 të këtij neni.

<sup>105</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.104.

<sup>106</sup> Po aty, fq.104.

përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar me vonë nga pala;

- u) Vepra penale;
- v) në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklaratat të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar PËRMBAJTJA e pasaktë;
- w) në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është pasojë e veprës penale të gjyqtarit, të përfaqësuesit ligjor apo me prokurë të palës, kundërshtare apo të personit të tretë;
- x) Fakte të reja dhe provat e reja
- y) në qoftë se pala fiton mundësinë ta përdorë vendimin e formës së prerë të gjykatës, i cili më parë, është dhënë në procedurën e zhvilluar midis palëve të njëjta për të njëjtën kërkesëpadi;
- z) në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është bazuar në një vendim tjetër gjyqësor, ose në vendimin e ndonjë organi tjetër, kurse ky vendim është ndryshuar, prishur apo anuluar në mënyrë të prerë;
- aa) në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme.

## 7.2.2 Afati për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës

Sipas dispozitës së nenit 234 par 1 të LPK-së, propozimi për përsëritje mund të paraqitet brenda afati prej 30 ditësh, dhe atë:

- në rastin nga neni 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë;
- në rastin nga neni 232, pika b) e këtij ligji në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka vepruar personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar personit të tillë;
- në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor të saj, e po që se përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, nga dita kur pala ka marrë dijeni për këtë shkak;
- në rastin nga neni 232, pika c) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për aktgjykimin penal të formës së prerë;
- në rastin nga neni 232, pika d) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për vendimin penal të formës së prerë, e nëse procedura penale nuk mund të zhvillohet, atëherë nga dita kur ka marrë dijeni për pezullimin e procedurës penale, apo për rrethanat për shkak të të cilave nuk mund të iniciohet procedura penale;
- në rastet nga neni 232, pika e) dhe f) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur ta përdorë vendimin e formës së prerë që është shkak për përsëritjes së procedurës;
- në rastin nga neni 232, pika g) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur t'i parashtrijë në gjykatë faktet e reja, gjegjësisht mjetet provuese të reja.

LPK përmban dispozita të ndryshme që e rregullojnë zgjidhjen e kërkesave për mjete të jashtëzakonshme juridike në Gjykatën Supreme. Shih nenet 211 – 231 të LPK-së (që ndërlidhen me kërkesat për revizion), 232-244 (që ndërlidhen me kërkesat për përsëritjen e procedurës), 245-251 (që ndërlidhen me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë).

### 7.3 Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

E gjithë veprimtari e gjykatës në procedurën kontestimore nuk është asgjë tjetër veçse zbatim i pandërprerë i ligjit procedurale dhe material. Përkundrejt të gjitha garancive për rregullsinë e punës së gjykatës, nuk përjashtohet mundësia që gjykata ta cenoj ligjin, dhe kështu vendimi që duhet të jete ligj për palët është i kundërligjshëm.<sup>107</sup>

Me vendimin e formës së prerë por të kundërligjshëm cenohet jo vetëm interesi i palëve por edhe ai publik, sepse kundërligjshmëria e vendimit gjyqësor është shenje e funksionimit jo të rregullt të gjyqësisë si shërbim publik. Nga kjo arsye ligjdhënësi e ka paraparë kërkesën për mbrojtje të lidhshmërisë si mjete te goditjes së jashtëzakonshëm të vendimeve të formës së prerë, me qëllim që puna e organeve gjyqësor etyd akordohet me ligjin.<sup>108</sup>

**Kompetenca për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë** - sipas nenit 246 të LPK-së, kompetent për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është prokurori i shtetit. Megjithatë iniciativën për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë mund ta marrë edhe nga palët, të cilët në pamundësi të ushtrimit të këtij mjete i propozojnë prokurorit që ta bëjë një gjë të tillë.

Në praktikën gjyqësore rëndom kështu edhe ndodh që kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtron prokurori pasi që të jete marrë iniciativa nga palët.

#### 7.3.1 Shkaqet e goditjes për goditjen e vendimit më kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

- a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale , po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
- b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Prokurori publik nuk mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike

Vendimet të cilat mund të goditën me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë - kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të ushtrohet ndaj:

- c) vendimit të marrë në shkallë të parë, kundër të cilit nuk është bërë ankim prej ditës kur ky vendim nuk ka mundur më të kundërshtohet me ankim;
- d) vendimit të marrë në shkallë të dytë, kundër të cilit nuk është deklaruar revizioni prej ditës kur ky vendim i është dërguar asaj pale së cilës i është dërguar më së voni

**Afati për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë** - Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori i shtetit mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh. Afati për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë llogaritet:

<sup>107</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë 2006, fq.102.

<sup>108</sup> Po aty, fq.102.



- f) Kundër vendimit, të nxjerrë në shkallë të dytë, kundër të cilit palët kanë deklaruar revizion, prokurori publik mund të ngrejë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur i është dërguar revizioni i asaj pale, revizioni i së cilës i është dërguar me herët.
- g) Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk lejohet kundër vendimit që me rastin e revizionit ose të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka marrë gjykata me kompetencë për të vendosur për këto mjete juridik (neni 245 LPK).

**Procedura sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë** - për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vendos gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjykimi apo aktvendimi i goditur ekzaminohet vetëm në pjesën e goditur më kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe gjykata i merr parasysht vetëm shkaqet e treguar në këtë mjete të goditjes. Për seancën në të cilën shqyrtohet dhe vendoset për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë gjykata e lajmëron prokurorin e shtetit që e ka paraqitur atë. Autorizimet e gjykatës supreme me rastin e vendosjes për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë janë të njëjta me ato që i ka kur vendos për revizionin. Në qoftë së kundër të njëjti vendimi janë paraqitur si revizion ashtu edhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykata kompetentet do të vendos për mjetet juridike me një vendim.<sup>109</sup>

---

<sup>109</sup> Neni 249 i LPK-së.

# KAPITULLI VIII

## **PADIA**

## **8 PADIA**

### **8.1 Padia**

Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e padisë, e cila është veprim procedural i palës me të cilin kërkohen mbrojtja gjyqësore më anë të vendimit të gjykatës.

Procedimi civil vihet në lëvizje me parashtrimin e padisë si akt hyrës (fillestar) procedural, në të cilin theksohet një kërkesë e caktuar pa marrë parasysh se si kuptohet ai termin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë.<sup>110</sup>

#### **8.1.1 Padia pavarësisht nga lloji i saj duhet të përmbajë**

- a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;
- b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- d) vlerën e kontestit;
- e) bazën juridike dhe
- f) të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji).<sup>111</sup>

#### **8.1.2 Kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesat aksesore**

Ky element i padisë nënkupton kërkesën e palës paditëse drejtuar gjykatës për nxjerrjen e një vendimi me përmbajtje të caktuar. Paditësi në kërkesëpadi duhet të pasqyroj përmbajtjen e dispozitivit të vendimit të dëshiruar. Gjykata gjatë vendosjes së një çështjeje juridike është e lidhur tekstualisht më përmbajtjen e kërkesëpadiisë përkatësisht vendimit të dëshiruar nga pala. Ky element i padisë vlen për të gjitha llojet e padive. Caktimi i kërkesëpadiisë është kusht i domosdoshëm sepse mbi bazën e saj do të dihet se cili do të jete prestimi apo detyrimi që duhet ta përmbush pala e paditur.

#### **8.1.3 Faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën**

Kusht tjetër i domosdoshëm i padisë është edhe detyrimi që paditësi në padi të paraqes faktet mbi të cilat e bazon kërkesëpadiinë e tij. Sipas kësaj paditësi duhet të paraqes të gjitha faktet shkurtimisht dhe një nga një në mënyrë që nga faktet e paraqitura të del edhe pasoja e caktuar juridike.

#### **8.1.4 Provat me të cilat vërtetohen faktet e padisë**

Paditësi duhet të paraqesë në padi provat me të cilat në mënyrë të qartë dhe konkrete ofrohen për secilin fakt të paraqitur në padi. Duhet të qartësohet për praktikën gjyqësore se nëse paditësi i ka propozuar provat (kur ato janë materiale) duhet t'i bashkëngjiten padisë dhe ky detyrim është kusht për rregullsinë e padisë,<sup>112</sup> ndërsa në rastin kur paditësi nuk ka propozuar provat, atëherë detyrimi për t'i paraqitur provat nuk është kusht i domosdoshëm. Në këtë kuptim nuk mund t'i kthehet padia në rregullim.

---

<sup>110</sup> Enver Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009, fq.17.

<sup>111</sup> Neni 99 paragrafi 2

<sup>112</sup> Neni 99.2 dhe 102 I LPK-së.

### 8.1.5 Vlera e kontestit

Vlera e objektit të kontestit është element i padisë i përcaktuar me ligj por nuk është kusht i domosdoshëm i padisë. Sipas kësaj edhe në rastet kur pala nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit gjykata nuk do ta hedh poshtë padinë dhe as nuk do t'ia kthejë paditësit padinë në përmirësim.

Në raste të tilla kur paditësi nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit, kur e caktuar të ultë ose si shumë të lartë, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur më se voni në seancën përgatitore e nëse nuk është mbajtur seanca përgatitore para së të filloj shqyrtimi kryesor do të caktoj në përshtatshme vlerën e objektit të kontesti duke i marrë parasysh rrethanat objektive (sidomos lartasin e kërkesës).

Në raste të tilla gjykata duhet të vendos me aktvendim ndaj të cilit nuk lejohet ankesë e veçantë.

### 8.1.6 Baza juridike

Kualifikimi juridik i fakteve, në të cilat paditësi e mbështetë kërkesëpadinë, e përbën bazën juridike të kërkesëpadisë. Edhe pse me dispozitën e nenit 253 par 1 pika (e) e LPK-së, është përcaktuar edhe baza juridike si element i padisë, ky element i padisë ka cilësinë e elementit fakultativ ngase gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë e gjithashtu gjykata do veprojë edhe sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadisë.

### 8.1.7 Taksa gjyqësore për padi

Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjisë vërtetimin për taksën gjyqësore të paguar.<sup>113</sup>

Si do të veprojë gjykata kur paditësi nuk i ka bashkëngjitur padisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar?

Në raste të tilla gjykata nëse nuk ekzistojnë arsye për lirimin nga detyrimi i taksës gjyqësore, me anë të vërejtjes e thërret paditësin që ta paguaj taksën gjyqësore në afat të caktuar.<sup>114</sup>

Nëse paditësi nuk vepron sipas vërejtjes së gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore, gjykata më anë të vërejtjes së fundit do ta thërras paditësin që brenda afatit të caktuar shtesë ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi duke i përcaktuar edhe detyrimin për taksën shtese.<sup>115</sup>

Nëse paditësi nuk vepron as pas vërejtjes së fundit (vërejtja e dytë) për pagesën e taksës gjyqësore për padi atëherë gjykata do të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 253.par 5 të LPK-së, me ç'rast me aktvendim do ta konsiderojë të tërhequr padinë.<sup>116</sup>

## 8.2 Llojet e padive

Ekzistojnë kritere të ndryshme për klasifikimin e padive por kriteri më i pranuar është kriteri varësisht nga tipi dhe përmbajtja e mbrojtjes juridike që kërkohet me to. Sipas këtij kriteri kemi tri lloje të padive: padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi.

Padi detyrimi – me këtë lloj padie paditësi kërkon nga gjykata që me aktgjykim të urdhërojë të paditurin që në dobi të paditësit të përmbushë një prestim.

Padi vërtetimi - me këtë lloj padie paditësi nga gjykata kërkon që me aktgjykim të konstatohet se ekziston apo nuk ekziston marrëdhënia juridike civile e caktuar, e drejta subjektive e përmbajtjes së caktuar, apo a është një dokument autentik ose nuk është.<sup>117</sup>

---

<sup>113</sup> Neni 253.4

<sup>114</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 1.

<sup>115</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 2.

<sup>116</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 3.

<sup>117</sup> LPK- me dispozita e nenit 254 i LPK-së

Padi ndryshimi - me këtë lloj padie paditësi kërkon që me anë të vendimit gjyqësor të themelohet një raport juridik, ndryshimin e përmbajtjes së raportit ekzistues apo anulimin e tij.

### 8.2.1 Kundërpadia

Kundërpadia është padi e të paditurit kundër paditësit e parashtruar në procesin të cilin i dyti e ka vënë në veprim kundër të parit. Me kundërpadi i padituri (në procesin e iniciuar sipas padisë paditësit) në të njëjtin gjykatë dhe në të njëjtin gjykim e parashtron kërkesëpadinë e tij të veçantë. Me kundërpadi themelohet edhe një raport proceduralo-juridik, me role të kundërta të palëve. Kundërpadia është paraparë si një e drejtë e të paditurit i cili mund ta shfrytëzojë deri në një fazë të caktuar të procesit dhe assesi si detyrim i të paditurit.<sup>118</sup> I padituri kërkesën e njëjtë që e parashtron me kundërpadi mund ta parashtrojë me padi, prandaj nuk është detyrim i të paditurit paraqitja e kundërpadisë.

### 8.2.2 Llojet dhe shembujt e kundërpadive

#### a. Kundërpadia konekse

Kundërpadinë konekse i padituri mund ta paraqesë në qoftë se në mes të kërkesës së përfshirë me kundërpadi dhe asaj të përfshirë me padi nuk ka dallim në pikëpamje të bazës juridike dhe asaj faktike.

Shembull i kundërpadisë konekse: *Në qoftë se në mes të subjektit X dhe Y ekziston marrëdhënia kontraktuese e shitblerjes së sendit. Në qoftë se subjekti X-paditësi me padi kërkon dorëzimin e sendit, subjekti Y me kundërpadi mund të kërkojë pagesën e çmimit kontraktuese.*

Nga shembulli i paraqitur kuptohet se kundërpadia duhet të ketë bazë juridike dhe faktike të njëjtë me padinë.

#### b. Kundërpadia kompensuese

Këtë kundërpadi i padituri mund ta paraqes në qoftë se kërkesa e tij mund të kompensohet me kërkesën e paditësit. Kjo kundërpadi do të ishte e lejueshme nëse kërkesat e kundërpadisë do të mund të kompensoheshin me kërkesat e padisë në procesin kryesor. Nëse këto kërkesa mund të kompensohen varet nga norma e të drejtës materiale. Këtë dispozitë e gjejmë në nenin 317 të LMD-së.<sup>119</sup>

Kompensimi është një ndër mënyrat e shuarjes së detyrimeve duke bërë llogaritjen e kërkesave reciproke. Kompensimi ndodh gjithmonë kur debitori bëhet kreditor i kreditorit të vet dhe në mes këtyre dy personave ekzistojnë kërkesa të ndërsjella të njëkohshme dhe ato mund të shuhen pa u përmbushur asnjëra prej tyre, pra kompensohen.

Shembulli i kundërpadisë kompensuese: *Në qoftë se subjekti X dhe subjekti Y për shkak të raporteve të tyre kontraktuese dhe për shkak të detyrimeve të ndërsjella të pa përmbushura kanë parashtruar para gjykatës padi dhe kundërpadi, në atë mënyrë që subjekti X me padi kërkon nga subjekti Y shumën prej 1000€, në emër të borxhit për verën që ia kishte shitur subjektit Y, ndërsa subjekti Y si kultivues i rrushit me kundërpadi kërkon që të detyrohet subjekti X që t'ia paguajë shumën prej 900€ për rrushin që ia kishte shitur subjektit X. Në këtë rast kërkesat reciproke mund të kompensohen deri në vlerën e së cilës kërkesë.*

---

<sup>118</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.220.

<sup>119</sup> Debitori mund ta kompensojë kërkesën që ka ndaj kreditorit me atë që kërkon ky prej tinë qoftë se të dy kërkesat kanë si objekt të hollat ose sendet tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj se të së njëjtës cilësi dhe në qoftë se të dyja kanë arritur për pagesë.

c. Kundërpadia prejudiciale

I padituri kundërpadinë prejudiciale mund ta paraqes kur të paditurit i takon e drejta që të kërkoj konstatimin se nuk ekziston raporti juridik apo të drejtat subjektive që janë bërë kontestuese gjatë gjykimit, e nga ekzistimi apo mos ekzistimi i tyre varet pjesërisht apo plotësisht vendimi për kërkesëpadinë.

*Shembulli i kundërpadisë prejudiciale: në qoftë së subjekti X me padi kërkon dorëzimin e sendit kundër subjekti Y- i paditur, atëherë i padituri-subjekti Y me kundërpadi mund të kërkojë nga gjykata që me aktgjykim të konstatojë se sendi, kthimin e të cilit paditësi e kërkon në bazë të pronësisë, është i tij e jo i paditësit.*

### 8.3 Fazat dhe kushtet për lejimin e kundërpadisë

Procesi në lidhje me padinë nuk duhet të ketë përfunduar. I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi derisa nuk ka përfunduar seanca përgatitore, gjegjësisht seanca e parë për shqyrtim kryesor, kur nuk është mbajtur seanca përgatitore, ndërsa pas mbajtjes së seancës përgatitore apo të shqyrtimit kryesor, mund të lejohet vetëm me pëlqimin e paditësit.

Palët në proces sipas kundërpadisë duhet të jenë identike me palët në procesin kryesor. Në procesin sipas kundërpadisë vetëm ndërrohen rolet e palëve ashtu që pala e paditur e merr rolin e palës paditëse kurse palë paditëse rolin e palës së paditur.

Kundërpadia është e palejueshme nëse për të nuk është kompetente e njëjta gjykatë para së cilës zhvillohet procesi kryesor sipas padisë së parë. Lidhur me kundërpadinë duhet që gjykata të jetë kompetente si në pikëpamje lëndore ashtu edhe në pikëpamje tokësore.

Gjykata mund të vendos ndarjen e procedimit sipas kundërpadisë kur e kërkojnë shkaqet ekonomike sa i përket kundërpadisë konekse.

Pavarësisht se ligji e lejon ndarjen e procedurës sipas kundërpadisë konekse është e arsyeshme që ndarja të ndodh si përjashtim pasi që gjykata në parim duhet gjithmonë të zhvillojë një proces të vetëm lidhur me padinë dhe kundërpadinë.

#### 8.3.1 Ndryshimi i padisë

Ndryshimi i padisë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor civil është çështje shumë e rëndësishme procedurale dhe si e tillë haset shpesh në praktikë.

#### 8.3.2 Çka përbën ndryshimi i padisë?

a) Ndryshimin e njëjtësisë së kërkesëpadisë

Ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadisë ekziston atëherë kur ndryshohet baza e padisë përkatësisht gjendja faktike ose faktet në të cilat bazohet kërkesa e palës paditëse.

Shembuj të ndryshimit të njëjtësisë së kërkesëpadisë:

1. Në qoftë se subjekti X me padi ka kërkuar përmbushjen e prestimit duke u bazuar në kontratën e shitjes, e më vonë kërkon përmbushjen e prestimit për shkak të kontratës së huas.

2. Në qoftë se subjekti X me padi ka kërkuar kthimin e sendit të luajshëm nga baza e pronësisë e më vonë kërkon kompensimin e vlerës së sendit për shkak të humbjes së sendit.

b) Zmadhimi i kërkesëpadsisë

Zmadhimi i kërkesëpadsisë e nënkupton zgjerimin e kërkesëpadsisë në kuptimin kuantitativ dhe kualitativ.

Shembuj të ndryshëm për zmadhimin e kërkesëpadsisë:

- Zmadhimi i kërkesëpadsisë në kuptimin kuantitativ - në qoftë se subjekti X me padi fillimisht ka kërkuar shumën prej 5000 Euro në emër të kompensimit të dëmit, ndërsa me ndryshimin e padsisë kërkon shumën e 8000 Euro.
- Zmadhimi i kërkesëpadsisë në kuptimin kualitativ - në qoftë se subjekti X me padi fillimisht ka kërkuar dorëzimin e sendit i cili ka cilësitë e produktit të klasës III, ndërsa me ndryshim të padsisë kërkon dorëzimin e sendit i cili ka cilësitë e produktit të klasës I.

c) Parashtrimi edhe i një kërkesë krahas kërkesës ekzistuese

Kur paditësi gjatë procedurës krahas kërkesës ekzistuese parashtron edhe kërkesa të tjera.

*Shembull për këtë rast të ndryshimit të padsisë.*

- Kemi situatën kur subjekti X krahas kërkesës për kthimin e sendit paraqet edhe kërkesën për shpërblimin e dëmit për shkak të dëmtimit të tij.
- Në qoftë se subjekti X me padi ka kërkuar kompensimin e dëmit për dëmin e pësuar në pronën e tij (lokal afarist) me veprime të paligjshme të të paditurit si uzurpues i pronës ndërsa me ndryshimin e padsisë krahas kësaj kërkesë kërkon edhe kompensimin për shkak të pasurimit të pabazë të të paditurit.

d) Ndryshimi i padsisë në kuptimin subjektiv

Deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes juridike paditësi mund ta ndryshojë padinë e vet duke e paditur personin tjetër në vend të të paditurit të parë. Kjo ndodh për arsye se zhvillimi i procesit kontestimor mund të sjell në pyetje saktësinë e legjitimitetit pasiv të palës së paditur më parë.

Kushti i parë dhe kryesor që të lejohet ndryshimi i padsisë në kuptimin subjektiv është që të pajtohet pala që do të hyjë në proces përkatësisht në gjykim në vend të të paditurit, ndërsa nëse i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore nevojitet edhe pëlqimi i tij.

Personi i cili hyn në gjykim në vend të palës së paditur duhet ta pranojë atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të.

Pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padsisë është i nevojshëm në raste kur ndryshimi bëhet pas përfundimit të seancës përgatitore ose më së voni në fillim të seancës për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur fare.

Në raste të tilla pëlqimi i të paditurit justifikohet me faktin se i padituri mund të ketë interes juridik që çështjen e filluar ta përfundojë me vendim meritore dhe paditësi mos të ketë mundësi që të iniciojë prapë procesin e njëjtë kundër tij.

Praktikisht mund të ndodh që i padituri jep pëlqimin për ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv, por ka të drejtë t'i kërkojë shpenzimet e procedurës të krijuara deri në momentin kur gjykata vendos për ndryshimin e padisë. Në këtë rast gjykata duhet me aktvendim të veçantë ndaj të cilit lejohet ankesë e veçantë t'i njoh të paditurit shpenzimet e procedurës.

### 8.3.3 Fazat në të cilat mund të bëhet ndryshimi i padisë

a) Ndryshimi padisë deri në seancën përgatitore - seancën e shqyrtimit kryesor

Paditësi mund ta ndryshojë pa pëlqimin e të paditurit padinë deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor në qoftë se nuk është caktuar fare seanca përgatitore.

b) Ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo fillimit të seancës për shqyrtim kryesor

Paditësi mund ta ndryshojë padinë pas përfundimit të seancës përgatitore ose fillimit të seancës për shqyrtim kryesor por vetëm me pëlqimin e palës së paditur.

Në raste të tilla gjykata do ta lejojë ndryshimin e padisë vetëm po që se konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit.

Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë po që se ai fillon të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin.

Nëse paditësi e ndryshon padinë duke kërkuar nga e njëjta bazë faktike sendin tjetër apo një shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtojë atë nëse ndryshimi është pasojë e rrethanave të krijuara pas ngritjes së padisë.

Përshkrimi i një situatë praktike: rast tipik është kur pala paditëse në vend të sendit borxh kërkon një send tjetër ose kërkon shpërblimin e dëmit, për shkak të humbjes ose shkatërrimit të sendit i cili ka qenë objekt i kërkesëpadisë dhe i cili është shkatërruar apo është humbur pas ngritjes së padisë.

Nëse padia është ndryshuar në seancën në të cilën nuk ka qenë prezent pala e paditur atëherë gjykata duhet ta shtyjë seancën dhe t'ia dërgojë palës së paditur një kopje të procesverbalit të seancës.

Përshkrim praktik i një situatë të tillë të ndryshimit të padisë: *në qoftë se subjekti X në cilësinë e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën nuk është i pranishëm i padituri e ndryshon padinë, atëherë gjykata duhet ta shtyjë seancën dhe një kopje të procesverbalit t'ia dërgoi të paditurit subjektivit-Y, me qëllim që të paditurit t'i jepet kohë që të deklarohet në ndryshimin e padisë. Në rastet e tilla gjykata nuk ka nevojë të merr ndonjë vendim me të cilin e detyron të paditurin që të deklarohet rreth ndryshimit të padisë, por mjafton që të njëjtit t'i dërgohet një kopje e procesverbalit të seancës në të cilën është bërë ndryshimi. Ligji për Procedurën Kontestimore nuk ka paraparë ndonjë afat të caktuar se brenda cilës kohë duhet i padituri të deklarohet në ndryshimin e padisë, mirëpo konsiderojmë se gjykata duhet të marrë në konsideratë dispozitën e nenit 402 paragrafi 2 të LPK-së, sipas të cilës rezulton se palët për seancën e radhës njoftohen të paktën 7 ditë më herët. Pra në këtë rast i padituri mund të deklarohet për ndryshimin e padisë para seancës së radhës apo drejtpërdrejtë në seancën e radhës. Gjykata vetëm në seancën e radhës vendos lidhur me ndryshimin e padisë.*

c) Lejimi i ndryshimit të padisë pa pëlqimin e të paditurit

Në situatë të caktuara gjykata do ta lejojë ndryshimin e padisë edhe nëse pala e paditur nuk e ka dhënë pëlqimin, me kusht që në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte:

- Që pala paditëse pa fajin e saj nuk ka pasur mundësi ta ndryshojë padinë më parë, dhe



- Që i padituri ka mundësi të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar pa e shtyrë seancën kryesore.

Në praktikën gjyqësore ka shumë raste kur gjykata lejon ndryshimin e padisë pa e marrë pëlqimin e të paditurit.<sup>120</sup>

Në të gjitha rastet e ndryshimit të padisë si në kuptimin objektiv dhe subjektiv, gjykata vendos me aktvendim me të cilin e lejon ose refuzon ndryshimin e padisë. Varësisht nga faza e procedurës në të cilën bëhet ndryshimi i padisë gjykata mund të vendosë në seancë dhe jashtë seancës gjyqësore. Kundër një aktvendimi të tillë nuk lejohet ankesë e veçantë.

## 8.4 Tërheqja e padisë

Tërheqja e padisë është veprim procedural i palës paditëse, me të cilin veprim përfundon procesi gjyqësor civil sipas veprimit vullnetar të palës paditëse. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.<sup>121</sup>

### 8.4.1 Fazat dhe kushte për tërheqjen e padisë

- a. Tërheqja e padisë deri në momentin e dhënies së përgjigjes në padi nga pala e paditur

Në rast se paditësi e tërheq padinë para se pala e paditur të paraqet në gjykatë përgjigje në padi, atëherë nuk është e nevojshme që nga pala e paditur të kërkohet pëlqimi për tërheqjen e padisë.

Në raste të tilla gjykata nuk e njofton fare palën e paditur me vendimin me të cilin konstatohet se është tërhequr padia.<sup>122</sup>

- b. Tërheqja e padisë deri në përfundim të shqyrtimit kryesor

Paditësi mund ta tërheq padinë edhe pas dorëzimit të përgjigjes në padi, në gjykatë dhe atë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë.

I padituri duhet të njoftohet se paditësi e ka tërhequr padinë, në mënyrë që i padituri të deklarojë lidhur me tërheqjen e padisë. Pas njoftimit për tërheqjen e padisë, i padituri mund ta jep pëlqimin shprehimisht për tërheqjen e padisë, por edhe në qoftë se i njëjti brenda 7 ditësh nuk deklarojë për tërheqjen e padisë konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Në raste të tilla aktvendimi me të cilin konstatohet se është tërhequr padia i dërgohet paditësit dhe të paditurit.

Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet e tërhequr padia nuk lejohet ankesë.<sup>123</sup>

---

<sup>120</sup>Në praktikën gjyqësore paraqiten shumë raste të ndryshme kur dihet natyra e kërkesës por nuk dihet lartësia e kërkesës. Për shembull, dihet se ekziston dëmi por nuk dihet lartësia e dëmit, dihet se ekziston dëmi por nuk dihen kategoritë e dëmit, etj. Këto raste ndodhin për faktin se p.sh, lartësia e kërkesës dhe kategoritë e dëmit varen nga ekspertizat profesionale të cilat si provë direkte mund të nxirren vetëm në gjykatë me kusht që të kenë cilësinë e provës së vlefshme. Pra në raste të tilla i padituri detyrohet ta bëjë ndryshimin padisë gjatës shqyrtimit gjyqësor dhe më qëllim që të mos vijë deri të një proces tjetër gjyqësor, gjykata e lejon ndryshimin pavarësisht së i padituri nuk e ka dhen pëlqimin.

<sup>121</sup> Neni 261.1 i LPK-së

<sup>122</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 4.

<sup>123</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 5.

## 8.5 Gjqvarësia (litispendenca)

Gjqvarësia krijohet në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia, ndërsa për kërkesat e parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjqvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtare për kërkesën e tillë.<sup>124</sup>

Si raste të gjqvarësisë së krijuar gjatë zhvillimit të procedurës mund të përmenden ndryshimi i padisë dhe paraqitja e kundërpadisë.

Gjatë kohës së ekzistimit të gjqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare por edhe mund të njoftohet nga palët ose ndonjë pjesëmarrës tjetër, nëse është në zhvillim e sipër gjykim tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.

Në rast se konstatohet se ekziston gjqvarësia për të njëjtën çështje dhe midis palëve të njëjta, atëherë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë.<sup>125</sup>

Kundër aktvendimit me të cilën hedhet poshtë padia për shkak të gjqvarësisë lejohet ankesë e veçantë.

Hedhja poshtë e padisë për shkak të gjqvarësisë, në qoftë së kontesti tjetër në mes të palëve të njëjta nuk përfundon me vendim meritator apo me pajtim gjyqësor, nuk do të konsiderohet si çështje e gjykuar.

---

<sup>124</sup> Neni 262 i LPK-së

<sup>125</sup> Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër 6.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**

## 8.6 Formularët praktikë lidhur me padinë

### Formulari 1 - Formular i vërejtjes (së parë) për pagesën e taksës gjyqësore

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.

Datë;

Prishtinë

#### VËREJTJE PËR PAGESËN E TAKSËS GJYQËSORE

Ftohet paditësi/t\_\_\_\_\_i/te padituri/t\_\_\_\_\_, nga\_\_\_\_\_, që sipas lëndës C.nr.\_\_\_\_\_, e iniciuar me padinë e datës \_\_\_\_\_, që në afat prej 15 ditësh, nga marrja e kësaj vërejtje ta paguaj taksën gjyqësore për parashtrësë\_\_\_\_\_ në shumë prej \_\_\_\_\_ Euro, ndërsa kopjen e fletëpagesës t'ia dorëzojë gjykatës.

Nëse pagesa e taksës nuk bëhet në afatin e lartcekur, do të paguhet taksa shtesë në shumë prej 10 Euro, si dhe do të ndërmerren veprimet tjera të parapara me nenin 6.5 dhe 6.6 të Udhëzimit Administrativ, nr. 2008/02, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, si dhe nenit 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Referenti/ja

## Formulari 2 - Formular i vërejtjes (së dytë) për pagesën e taksës gjyqësore

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

C. nr.

Me dt. \_\_\_\_\_

Prishtinë

### VËREJTJA E FUNDIT PËR PAGESËN E TAKSËS GJYQËSORE

Ftohet/n \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, si paditës, në çështjen juridike kontestimore, për \_\_\_\_\_ i/e cili nuk e ka bërë me kohë pagesën e taksës gjyqësore sipas vërejtjes së kësaj Gjykate, të dt. \_\_\_\_\_, në shumë prej \_\_\_\_\_ Euro, ashtu që tani duhet të paguani përveç asaj takse edhe taksën shtesë në lartësi prej 10,00 Euro, të paraparë në Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Kopjen e fletëpagesës mbi taksën dhe taksën shtesë t'ia dërgoni kësaj Gjykate në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes të kësaj vërejtje.

Nëse pagesa e taksës në lartësi prej \_\_\_\_\_ Euro dhe pagesa shtesë në lartësi prej 10 Euro, nuk paguhen brenda afatit prej 7 ditësh, Gjykata konform nenit 6.5 të Udhëzimit Administrativ 2008/02 do t'a hedh poshtë padinë, parashtrësën për të cilën nuk janë paguar taksat si dhe pasojat tjera të parapara me nenin 6.6 e 6.7 të Udhëzimit të sipërpërmendur.

Referenti/ja

### **Formulari 3 - Aktvendim me të cilin është konsideruar e tërhequr padia e paditësit për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ Euro, jashtë seance, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET SE ËSHTË TERHEQUR padia me numër C.nr. \_\_\_\_\_ e paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

#### **A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_, nga Podujeva rr. "Skënderbeu" nr. \_\_\_\_\_, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit Ndërmarrja Regjionale " \_\_\_\_\_" sha.a, Prishtinë, për anulim të aktvendimit.

Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, në ekzaminim paraprak të padisë, ka gjetur se padia e paditësit nuk e përmban vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Gjykata me anë të vërejtjes gjyqësore të datës 25.10.2013, të cilën paditësi e ka pranuar me datë 30.11.2013, e ka ftuar paditësin të paguajë taksën gjyqësore në shumë prej 15 € e paraparë me udhëzimin Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore dhe atë brenda afatit 15 ditësh nga dita e marrjes së vërejtjes gjyqësore.

Paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes së parë dhe gjykata ja ka dërguar edhe vërejtjen e dytë të datës 21.11.2013, të cilën paditësi e ka pranuar me datës 30.11.2013, në të cilën është dhënë afati shtesë prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, mirëpo edhe pas kësaj vërejtje paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Meqenëse paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksave gjyqësore, gjykata duke u bazuar në nenin 253.5 të LPK-së dhe nenit 6.6. dhe 6.5 të Udhëzimit Administrativ 2008/2 për unifikimin e taksave gjyqësore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

#### **UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit.

#### **Formulari 4 - Aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ Euro, jashtë seance, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr. \_\_\_\_\_, e paditëses \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_.

#### **A r s y e t i m**

Paditësja \_\_\_\_\_, nga Prishtina, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ \_\_\_\_\_ ” Prishtinë, për kompensim.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datë 12.06.2013, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore, një kopje të së cilës ja ka bashkëngjitur parashtrësës dhe se e tërheq padinë.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURDIKE:**  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.



## Formulari 5 -Aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me pagimin e borxhit, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ € jashtë seancës gjyqësore, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër C.nr. \_\_\_\_\_ e paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen juridike \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e dt. \_\_\_\_\_ ka bërë tërheqjen e padisë, me arsyetim se i padituri e ka përmbushur borxhin sipas marrëveshjes në shumën prej 10,600.00€ Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qenë se i padituri ka paraqitur përgjigje në padi, gjykata një kopje të parashtrësës për tërheqjen e padisë ja ka dërguar të paditurit me qëllim të deklarimit.

I padituri nuk është deklaruar brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit dhe mbi këtë bazë e duke ju referuar dispozitës së nenit 261 par 2 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

KESHILLË JURIDIKE:  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa

**Formulari 6 – Aktvendim me të cilin është hedhur poshtë padia e paditësit për shkak të gjyqvarësisë (litispendencës)**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, vlera e kontestit \_\_\_\_\_ Euro, jashtë seance, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET POSHTË padia me numër C.nr. \_\_\_\_\_, e paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispendencës).

**A r s y e t i m**

Paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. \_\_\_\_\_, me bazë juridike anulim kontrate, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, nga Prishtina, Rr.” Mitrovica” nr.1.

Gjykata ka gjetur së paditësi \_\_\_\_\_, nga Prishtina, Rr.” Mitrovica” nr.1, për çështjen e njëjtë pranë kësaj gjykate kishte ushtruar edhe një padi tjetër kundër të paditurit \_\_\_\_\_, nga Prishtina, Rr.” Mitrovica” nr.1, e cila udhëhiqet sipas shenjës C.nr.422/07. Gjithashtu gjykata ka gjetur së lënda me shenjen C.nr.422/07 është në shqyrtim e sipër.

Gjykata pasi analizojë të dy lëndët C.nr.1937/09 dhe C.nr.422/07, gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, mirëpo meqenëse lënda C.nr. 422/07, është proceduar më herët dhe e njëjta gjendet në procedurë e sipër, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispencës.

Nga të cekurat më lartë gjykata duke u bazuar në nenin 391 pika c, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.



**KAPITULLI IX**

**BASHKËNDËRGJYQËSIA DHE**

**PJESËMARRJA E PERSONAVE TË**

**TRETË NË PROCEDURËN**

**KONTESTIMORE**

## 9 BASHKËNDËRGJYQËSIA DHE PJESËMARRJA E PERSONAVE TË TRETË NË PROCEDURËN KONTESTIMORE

### 9.1 Kuptimi dhe llojet e bashkëndërgjyqësisë (litis consortium)

Bashkëndërgjyqësia është institut juridik i cili mundëson që në të njëjtin proces kontestimor, në cilësinë palës paditëse apo të paditur, të marrin pjesë më shumë persona.

Në parim ekzistojnë dy lloje të bashkëndërgjyqësisë:

- aktive, dhe
- pasive,

**Bashkëndërgjyqësia aktive** ekziston në rastet kur në anën e paditësit ka më shumë palë, kurse **bashkëndërgjyqësia pasive** ekziston në rastet kur në anën e të paditurve ekzistojnë më shumë palë.<sup>126</sup>

Kuptimi i bashkëndërgjyqësisë është në realizimin e parimit të ekonomizimit, sepse përmes këtij instituti, mundësohet që ndaj kërkesave të shumë palëve në procedurë të zhvillohet një procedurë dhe të merret një vendim.

### 9.2 Bashkëndërgjyqësia

Bashkëndërgjyqësia është e paraparë me nenin 264 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Kështu, padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve në rast se:

- në pikëpamje të objektit të kontestit janë në bashkësi juridike apo nëse të drejtat e tyre, përkatësisht detyrimet, burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike (bashkëndërgjyqësia materiale);
- objekt kontesti janë kërkesat, përkatësisht detyrimet e të njëjtit lloj që mbështeten në bazën faktike dhe juridike esencialisht të njëjtë dhe po që se ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e të njëjtës gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur (bashkëndërgjyqësia formale);
- një gjë e këtillë parashikohet me ndonjë ligj tjetër<sup>127</sup>.

#### 9.2.1 Bashkëndërgjyqësia e thjeshtë

Ekziston në rastet kur secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm të bashkëndërgjyqësive të tjerë. Në këtë rast kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësinë e thjeshtë.<sup>128</sup>

#### 9.2.2 Bashkëndërgjyqësia e domosdoshme

Në qoftë se sipas ligjit ose për shkak të natyrës së raportit juridik kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve, atëherë ata të gjithë konsiderohen si një palë ndërgjyqëse e vetme, kështu që në rastin kur ndonjëri nga bashkëndërgjyqësit nuk e kryen ndonjë

---

<sup>126</sup> Shih "Praktikum za parnicu", Vukasin Ristic, Milosin Ristic, Beograd, 2000, faqe 105 e tutje.

<sup>127</sup> Shih nenin 264.1 të LPK-së.

<sup>128</sup> Shih nenin 268 të LPK-së.

veprim procedural, efekti i veprimeve procedurale të kryera nga bashkëndërgjyqësi tjetër shtrihet edhe në ata që nuk i kanë kryer veprimet e tilla. Në këtë rast kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësinë unike të domosdoshme.<sup>129</sup>

Në rast se bashkëndërgjyqësit kryejnë veprime procedurale që dallohen në mes tyre, atëherë gjykata e merr në konsiderim atë veprim procedural që është më i favorshëm për të gjithë ata.

Po që se afatet për kryerjen e veprimit procedural të caktuar skadojnë në kohë të ndryshme për bashkëndërgjyqësit në bashkëndërgjyqësi unike, atëherë veprimin e tillë procedural mund ta kryejë secili bashkëndërgjyqës deri sa të mos skadojë afati i fundit i përcaktuar për kryerjen e tij. Sipas kësaj del se për situatat e tilla veprimi i caktuar procedural, afati për kryerjen e të cilit skadon në kohë të ndryshme për bashkëndërgjyqësit në bashkëndërgjyqësi unike, mund të kryhet deri në skadimin e afatit të fundit për kryerjen e atij veprimi, nga ana e ndonjërit prej bashkëndërgjyqësve. Kjo për faktin se bashkëndërgjyqësit në bashkëndërgjyqësi unike veprojnë si një palë e vetme.<sup>130</sup>

Secili nga bashkëndërgjyqësit ka të drejtë që të bëjë propozime lidhur me drejtimin e procesit gjyqësor.

### 9.2.3 Bashkëndërgjyqësia eventuale

Paditësi me padinë e tij mund t'i përfshijë dy ose më tepër të paditur edhe në mënyrë që të kërkojë që kërkesëpadia e tij të aprovohet ndaj të paditurit të dytë, po që se refuzohet si e pabazuar ndaj të paditurit të parë. Në këtë rast kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësinë me të paditurin eventual.<sup>131</sup>

Qëllimi i bashkëndërgjyqësisë eventuale është që paditësi të sigurohet nga inicimi i procesit të ri kontestimor në rast të dështimit ndaj të paditurit të parë, apo që të sigurohet nga paraqitja e parashtrimit të kërkesës ndaj të paditurit të parë, etj.

### 9.2.4 Deri në cilën fazë dhe kur mund të iniciohet bashkëndërgjyqësia?

Deri në përfundimin e seancës përgatitore, përkatësisht seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, paditësit mund t'i bashkohet, nën kushtet e paragrafit 1 të nenit 264 të LPK-së, edhe një paditës tjetër apo të zgjerohet padia edhe për një të paditur tjetër, duke u marrë pëlqimi i këtij. Këto janë rastet të cilat në pikëpamje të objektit të kontestit janë në bashkësi juridike apo nëse të drejtat e tyre, përkatësisht detyrimet, burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike (e ashtuquajtura bashkëndërgjyqësia materiale); rastet kur objekt kontesti janë kërkesat, përkatësisht detyrimet e të njëjtit lloj që mbështeten në bazën faktike dhe juridike esencialisht të njëjtë dhe po që se ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e të njëjtës gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur (e ashtuquajtura bashkëndërgjyqësia formale); apo rastet kur një gjë e tillë parashihet me ndonjë ligj tjetër të veçantë.<sup>132</sup>

Në këtë rast personi që i bashkohet paditësit, përkatësisht personi në të cilin zgjerohet padia duhet ta pranojë procedurën në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur ai hyn në të.

---

<sup>129</sup> Shih nenin 269.1 të LPK-së.

<sup>130</sup> Shih nenin 270 të LPK-së.

<sup>131</sup> Shih nenin 265 të LPK-së.

<sup>132</sup> Shih nenin 264.1 të LPK-së.

### 9.3 Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin kontestimor

#### 9.3.1 Ndërhyrësi i thjeshtë

Përveç palëve, në procedurë kontestimore mund të marrin pjesë edhe personat e tretë, të cilët si subjekte në vete kanë interes juridik për përfundimin e procedurës.

Pala merr pjesë në kontest në mënyrë që ta realizojë ndonjë të drejtë të saj. Edhe personi i tretë merr pjesë në procedurë kontestimore që ta realizojë ndonjë interes të tij. Ky interes i personit të tretë është i karakterit të dyfishtë, respektivisht në shumicën e rasteve interesi është personal (i posaçëm) i palës së tretë (ndërhyrësit), por shpeshherë personat e tretë paraqiten edhe në formë të interesit të përgjithshëm apo publik, siç mund të jetë rasti i avokatit publik komunal apo atij shtetëror.

Në rast se personi i tretë (person fizik apo juridik), ka interes juridik që njëra nga palët në procedurë të fitojë, atëherë ai mund t'i bashkëngjitet asaj pale. Deklarimin mbi kyçjen në procedurë, ndërhyrësi mund ta jap përgjatë tërë procedurës (nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në përfundim të plotfuqishëm të procesit), qoftë edhe në procedurën pranë gjykatës së instancës më të lartë përmes mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Deklarata mund të jepet:

- a) në formën me shkrim, apo
- b) verbalisht në procesverbal para gjykatës së çështjes.

Parashtesa e ndërhyrësit i dërgohet të dy palëve ndërgjyqëse, e kur deklarata e ndërhyrësit është dhënë në seancë gjyqësore, atëherë pjesa përkatëse e procesverbalit i dërgohet vetëm palës e cila nuk ka qenë e pranishme në seancë.<sup>133</sup> Në këtë rast kemi të bëjmë me ndërhyrësin e thjeshtë.

Për ekzistimin e institutit të ndërhyrësit të thjesht, kusht është që personi i tretë të ketë interes juridik që pala të cilës ky i bashkëngjitet, ta fitojë çështjen kontestimore. Një rast i tillë do të ekzistonte në situatën kur kompania e sigurimit i bashkëngjitet të paditurit, përkatësisht të siguruarit të tij, në kontestin për kompensimin e dëmit, me qëllim që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Ndërhyrësi nuk mund të obligohet për pagimin e shpenzimeve procedurale nëse pala të cilës i bashkohet ai e humb kontestin. Por atij i takojnë shpenzimet nëse palës të cilës i bashkohet ai e fiton kontestin.

Secila nga dy palët ndërgjyqëse mund t'ia kontestojë ndërhyrësit të drejtën e ndërhyrjes dhe të refuzojë propozimin e tij. Derisa aktvendimi me të cilin është refuzuar pjesëmarrja e ndërhyrësit të ketë marrë formën e prerë, ndërhyrësi mund të marrë pjesë në procedurë dhe veprimet e tij procedurale nuk mund të përjashtohen.<sup>134</sup>

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin aprovet pjesëmarrja e ndërhyrësit nuk lejohet ankesa e posaçme.

#### 9.3.2 Ndërhyrësi kryesor

Personi që tërësisht apo pjesërisht e kërkon sendin apo të drejtën lidhur me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis dy palëve ndërgjyqëse, mundet që në gjykatën e çështjes t'i padis ata me padinë e

---

<sup>133</sup> Shih nenin 271 të LPK-së si dhe formularin praktik nr.1.

<sup>134</sup> Shih formularin praktik nr.5.

tij deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë. Në këtë rast kemi të bëjmë me institutin e ndërhyrësit kryesor.<sup>135</sup>

Ndërhyrja kryesore kuptohet si rast kur në çështjen e caktuar për gjykim e cila është në zhvillim e sipër ndërmjet dy palëve ndërgjyqëse, personi tjetër me padinë e tij, paditë që të dy këto palë ndërgjyqëse lidhur me çështjen e cila mund të ketë si objekt sendin apo të drejtën.

Një rast i tillë do të ishte kur Komuna si njësi e vetëqeverisjes lokale, i paditë paditësin si dhe të paditurin, duke pretenduar se ngastra kadastrale e cila është objekt kontesti në mes të palëve në procedurë, është e saj, e jo e paditësit i cili e kërkon atë me padi, apo e të paditurit në emrin e të cilës evidentohet ajo ngastër.

Pra del se instituti i ndërhyrësit kryesor dallon nga instituti i bashkëndërgjyqësisë, sepse personi i tretë i cili ndërhyr në një çështje të caktuar (ndërhyrësi kryesor) nuk i bashkohet asnjërës palë, pra as palës paditëse e as palës së paditur, mirëpo ngrit padinë kundër të dyja palëve, duke shprehur pretendimin e tij ndaj sendit apo të drejtës për të cilën është duke u zhvilluar procedura kontestimore. Ndërhyrësi kryesor, në këtë rast padinë e tij duhet ta paraqes në gjykatën në të cilën është duke u zhvilluar procesi kontestimor dhe momenti i fundit për ta paraqitur padinë e tij është deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë.<sup>136</sup>

Në rastet kur gjykata vendos që ta ndalë procedurën e cila ka të bëjë me padinë e parë, aktgjykimi me të cilin aprovohet kërkesëpadia e ndërhyrësit kryesor, e ka rëndësinë paraprake (prejudiciale) për gjykimin sipas padisë së parë. Kjo nënkupton se vendimi i gjykatës lidhur me çështjen e ndërgjyqësve të mëhershëm do të varet nga vendimi apo zgjidhja e gjykatës mbi padinë apo kërkesëpadinë e ndërhyrësit kryesor si çështje paraprake. Në këtë rast po që se gjykata do ta aprovonte kërkesëpadinë e ndërhyrësit kryesor, atëherë me të njëjtin aktgjykim kërkesëpadia e paditësit (fillestar) ndaj të paditurit do të refuzohej si e pabazuar.

Në rast se kërkesëpadia e ndërhyrësit kryesor refuzohet, gjykata mundet që me të njëjtin apo me aktgjykim tjetër të vendos mbi bazueshmërinë e kërkesëpadisë sipas padisë së paditësit fillestar. Si rast i ndërhyrësit kryesor në procedurë mund të përmendet shembulli kur bashkëshorti i shkurorëzuar për sendin për të cilin pretendon se është pasuri e veçantë e tij, paditë bashkëshortin tjetër si dhe palën tjetër në kontestin në të cilin është duke u zhvilluar ndërmjet këtyre dy të fundit mbi të drejtën e pronësisë në atë send.

Me dispozitat e LPK-së gjithashtu është e paraparë se debitori kryesor dhe dorëzani mund të paditen bashkërisht, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës mbi dorëzanimin.

### 9.3.3 Personat të cilët mund të ndërhyjnë në procesin kontestimor

Me dispozitat e LPK-së, është e paraparë se kushdo mund të ndërhyjë në një procedurë kontestimore që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes juridik për të mbështetur njërin apo tjetrën palë ndërgjyqëse, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë.<sup>137</sup>

### 9.3.4 Emërimi i paraardhësit juridik

Personi që është i paditur si posedues i një sendi apo si shfrytëzues i një të drejte pasurore dhe që pretendon se sendin e posedon, respektivisht se të drejtën e shfrytëzon në emër të personit të tretë, mundet që më së voni në seancën përgatitore, e po që se kjo seancë nuk është mbajtur, atëherë në seancën e shqyrtimit kryesor, nëpërmjet gjykatës ta thërras atë person të tretë (paraardhës juridik) që në vend të tij të hyj si palë e paditur në gjykim.<sup>138</sup> Këtë institut mund ta shfrytëzojë i padituri si mbajtës i

---

<sup>135</sup> Shih nenin 266.1 të LPK-së si dhe formularin praktik nr.2.

<sup>136</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 496.

<sup>137</sup> Shih nenin 271.1 të LPK-së.

<sup>138</sup> Shih nenin 275 të LPK-së



një sendi apo shfrytëzues i ndonjë të drejte, kur ai thekson se sendin e mban, respektivisht të drejtën e realizon në emër të personit tretë.<sup>139</sup>

Pëlqimi i paditësit që në vend të palës së paditur nga ai të hyjë në gjykim paraardhësi juridik, nevojitet vetëm në qoftë se paditësi kundër të paditurit parashton edhe kërkesat që nuk varen nga ajo se a e mban në posedim ose jo sendin në emër të paraardhësit, respektivisht a e ushtron ose jo të drejtën e caktuar në emër të paraardhësit juridik. Në qoftë se paraardhësi juridik që është thirrur rregullisht nuk vjen në seancë gjyqësore apo nuk pranon që të hyjë në procesin kontestimor në vend të palës së paditur, atëherë ky i fundit nuk mund të kundërshtojë pjesëmarrjen në shqyrtimin e çështjes së ngritur me padi kundër tij.

### 9.3.5 Njoftimi i personit të tretë për procesin gjyqësor

Secila palë mund të thërras në gjykimin e çështjen një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen, ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.<sup>140</sup>

Personi i tretë thirret me kërkesë të shkruar që mund të paraqitet deri në përfundimin e gjykimit me vendimin e formës së prerë. Në shkresën e tillë, e cila personit të tretë i dërgohet nëpërmjet gjykatës së çështjes, tregohet shkaku i thirrjes dhe gjendja në të cilën ndodhet procesi kontestimor.<sup>141</sup>

Kjo do të thotë se ky njoftim nuk mund të ndikoj në zhvillimin e procesit gjyqësor, ndërsa që mund të ndikojë në çështjet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesave në lëminë e marrëdhënieve të detyrimeve.

---

<sup>139</sup> Shih formularin praktik nr.3.

<sup>140</sup> Shih nenin 276 të LPK-së.

<sup>141</sup> Shih formularin praktik nr.4

# **FORMULARËT PRAKTIKË**

#### 9.4 Formularët praktikë për bashkëndërgjyqësinë dhe personat e tretë

##### Formulari 1 - Parashtrësë e ndërhyrësit - ndërhyrësi i thjeshtë

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykatës Themelore në Prishtinë

Paditës: \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Zahir Pajaziti" nr. -----

I paditur: \_\_\_\_\_, nga Prishtina rr. "Adem Jashari" nr. ----

Ndërhyrës: Byroja \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Hoxhë Kadri Prishtina" nr. \_\_\_\_

Objekti i kontestit: Kompensimi i dëmit

Vlera e kontestit: 2.500 euro

##### Parashtrësë e ndërhyrësit

Paditësi pranë kësaj gjykate ka iniciuar padinë kundër të paditurit për shkak të kompensimit të dëmit.

Ndërhyrësi Byroja \_\_\_\_\_ nga Prishtina, e ka pranuar një parashtrësë nga i padituri, përmes të cilës ky i fundit e ka informuar atë në lidhje me këtë proces kontestimor. Nga kjo parashtrësë, por edhe nga vetë padia, shihet se ndërmjet palëve ndërgjyqëse është duke u zhvilluar kontesti në lidhje me kompensimin e dëmit dhe se ekziston mundësia që ndërhyrësi Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, të përgjigjet për kompensimin e dëmit si debitor regresiv.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, ndërhyrësi gjen se ka interes juridik që këtë çështje kontestimore ta fitojë i padituri, andaj në kuptim të nenit 271 të LPK-së, paraqet këtë:

##### D E K L A R A T Ë

Mbi ndërhyrjen në këtë proces kontestimor në favor të të paditurit, njëherit duke i propozuar gjykatës që këtë parashtrësë t'ia dorëzoj palëve ndërgjyqëse, ta aprovoj ndërhyrjen e ndërhyrësit në këtë procedurë, të cilit në të ardhmen edhe to t'ia dorëzojë ftesat për seancë si dhe shkresat e tjera.

Prishtinë, më \_\_\_\_\_

Ndërhyrësi,  
Byroja \_\_\_\_\_

## Formulari 2 - Padi e personit të tretë kundër të dy palëve – ndërhyrësi kryesor

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykatës Themelore në Prizren

Paditës: \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “nëna Terezë ” nr. \_\_\_\_\_

Të paditur: \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Adem Jashari” nr. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. “Zahir Pajaziti” nr. \_\_\_\_\_

Objekti i kontestit: Vërtetimi i të drejtës së pronësisë

Vlera e kontestit: 50.000 euro

P A D I  
-E ndërhyrësit kryesor-

Pranë kësaj gjykate është në zhvillim e sipër kontesti ndërmjet të paditurve \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë.

Ndër të tjera objekt kontesti është edhe banesa e cila gjendet në adresën Llamella 7, kati i tretë, banesa nr.----. Banesa në fjalë evidentohet në emër të të paditurit të parë \_\_\_\_\_.

Provë: Certifikata e pronësisë me nr.17, e datës 15.05.2014.

Në lidhje me faktin se banesa e cila është objekt i kontestit, evidentohet ende në emër të paditurit të parë \_\_\_\_\_, paditësi ka kuptuar për të gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore ndërmjet këtu të paditurve, e cila zhvillohet pranë kësaj gjykate.

Por pronar i vërtetë i banesës kontestuese është këtu paditësi \_\_\_\_\_, edhe pse në bazë të dokumentacionit, banesa në fjalë del të jetë e këtu të paditurit \_\_\_\_\_. Në fakt paditësi i ka kaluar mbi 15 vite të jetës së tij me punë jashtë Kosovës, përkatësisht në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nga parat e fituara atje e ka blerë banesën e cila është objekt i këtij kontesti.

Provë: Dëgjimi i dëshmitarëve \_\_\_\_\_, si dhe faturat e fletëpagesat mbi shumën e të hollave të dërguara.

I padituri i parë \_\_\_\_\_, i cili është i biri i paditësit \_\_\_\_\_, duke e shfrytëzuar mospraninë e paditësit, banesën dhe tërë dokumentacionin tjetër përkatës në fjalë e ka transferuar në emrin e tij.

Provë: jo kontestuese, dëgjimi i palëve, dokumentacioni i lartcekur.

Me qenë se paditësi e ka blerë banesën kontestuese me mjetet e tij vetanake të fituara gjatë punës jashtë Kosovës, nga ku del se ai është pronar i vetëm dhe ekskluziv i të njëjtës, bazuar në nenin 266 të LPK-së, paditësi parashtron këtë padi kundër dy të paditurve dhe propozon që gjykata pas shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të merr këtë:

A K T G J Y K I M

Vërtetohet se paditësi \_\_\_\_\_ nga Prizreni, në bazë të kontributit dhe shitblerjes është pronar i vetëm i banesës e cila gjendet në adresën Llamella 7, kati 3, banesa nr.---, e cila evidentohet sipas certifikatës pronësore me nr.17, e datës 15.05.2014, gjë që të paditurit janë të detyruar ta pranojnë, ndërsa që i padituri \_\_\_\_\_ të lejojë paditësin që të njëjtën banesë ta regjistrojë pranë organeve komunale kompetente në emrin e tij, gjë që nëse nuk e lejon, ky aktgjykim do të shërbej si bazë për regjistrim të saj.

Detyrohen të paditurit që paditësit të ia paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale,të gjitha këto brenda afatit 15 ditorë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Prizren, me \_\_\_\_\_

Paditësi

\_\_\_\_\_

### Formulari 3 - Parashtrësë e të paditurit për emërimin e paraardhësit juridik

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykatës Themelore në Pejë

Paditës: \_\_\_\_\_ nga Peja rr. "Zahir Pajaziti" nr. \_\_\_\_

I paditur: \_\_\_\_\_, nga Peja rr. "Adem Jashari" nr. \_\_\_\_

Objekti i kontestit: Kompensimi i dëmit

Vlera e kontestit: 1.500 euro

#### Parashtrësë e të paditurit

Përmes të cilës e fton paraardhësin juridik që të përfshihet në procedurë në vend të tij.

Nga ana e kësaj gjykate i padituri ka pranuar padinë dhe ftesën për seancë.

Paditësi në padi ka theksuar se kopeja e deleve pronë e të paditurit, i ka shkaktuar atij dëmin në lartësi prej 1.500 euro.

I padituri përmes kësaj parashtrëse deklaron se delet nuk janë pronësi të tij, por të \_\_\_\_\_ nga Peja, rr. "Haxhi Zeka" nr. \_\_\_\_, ndërsa që i padituri vetëm se i ka ruajtur ato nën shumën e caktuar të të hollave.

Meqenëse këtu i padituri, kopenë e deleve përmes të cilave i është shkaktuar dëmi paditësit, e ka mbajtur në emër të pronarit të lartcekur, e jo në emër të vetin, në kuptim të nenit 275 të LPK-së, përmes kësaj gjykate i padituri e fton \_\_\_\_\_ nga Peja, rr. "Haxhi Zeka" nr. \_\_\_\_, që në vend të tij të përfshihet si palë e paditur në këtë procedurë kontestimore.

I padituri i propozon gjykatës që këtë parashtrësë t'ia dorëzojë paditësit si dhe paraardhësit juridik, me ç'rast këtij të fundit propozon që ti dorëzohet edhe padia si dhe që i njëjti të ftohet që të deklarohe në lidhje me pretendimet e padisë.

Pejë  
Datë: \_\_\_\_\_

I padituri  
\_\_\_\_\_

#### Formulari 4 - Parashtrësë mbi njoftimin e personit të tretë mbi procesin gjyqësor

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_

Paditës: \_\_\_\_\_ nga Gjilani, rr. "Zahir Pajaziti" nr. \_\_\_\_

I paditur: \_\_\_\_\_, nga Gjilani, rr. "Adem Jashari" nr. \_\_\_\_

Personi i tretë: Ministria e \_\_\_\_\_ së Republikës së Kosovës

Objekti i kontestit: Kompensimi i dëmit

Vlera e kontestit: 5.500 Euro

##### Parashtrësë e të paditurit

-Përmes të cilës e informon personin e tretë për procesin gjyqësor-

Paditësi në këtë procedurë ka kërkuar nga i padituri kompensimin e dëmit për shkak të aksidentit të komunikacionit në shumën prej 5.500 euro.

I padituri për këtë aksident është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënimin me gjobë nga ana e Gjykatës Themelore në Gjilan - Divizioni për Kundërvajtje. Por i padituri konsideron se nuk është fajtor për këtë aksident, e i cili aksident është shkaktuar si pasojë e dëmtimeve të mëdha të rrugës, për mirëmbajtjen e të cilës kompetente është Ministria e lartpërmendur e Republikës së Kosovës.

Në rast se i padituri detyrohet që të paguajë dëmin e lartcekur, ai ka për qëllim që të parashtrojë padi regresive kundër Ministrisë së lartpërmendur, e cila ka për obligim mirëmbajtjen e rrugëve, andaj që të evitohet kjo, në kuptim të nenit 276 të LPK-së:

##### Informon

Ministrinë e \_\_\_\_\_ të Republikës së Kosovës mbi këtë çështje kontestimore, për shkak të përfshirjes eventuale në këtë çështje kontestimore në cilësi të ndërhyrësit të thjeshtë në këtë rast, e në anën e të paditurit, e duke u bazuar në nenin 271 të LPK-së.

I padituri gjykatës i propozon që këtë parashtrësë t'ia dorëzojë paditësit si dhe personit të tretë të ftuar - ndërhyrësit, të cilit duhet ti dërgohet edhe një kopje e padisë.

Gjilan,  
Datë, \_\_\_\_\_

I padituri

\_\_\_\_\_

## Formulari 5 - Aktvendim mbi refuzimin e ndërhyrësit të thjeshtë

C.nr. \_\_\_\_\_

Gjykata Themelore në Prizren me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Prizreni, rr. "Halim Spahiu" nr.4, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prizreni, rr. "Dukagjini" nr.15, për shkak të anulimit të kontratës mbi ndërrimin e banesës, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Refuzohet si i pa bazuar propozimi i Ndërmarrjes Publike \_\_\_\_\_ me seli në Prizren, që në këtë procedurë kontestimore të përfshihet si ndërhyrës në favor të të paditurit.

### A r s y e t i m

Ndërmarrja Publike \_\_\_\_\_ me seli në Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozimin që të ndërhyjë në këtë procedurë, respektivisht të kyçet në të njëjtën në cilësi të ndërhyrësit e në favor të të paditurit.

Duke vepruar sipas këtij propozimi, e duke marrë parasysh sipas detyrës zyrtare edhe faktin se në kuptim të nenit 271 të LPK-së se a ka interes juridik ndërhyrësi që të përfshihet në procedurë, gjykata ka gjetur se ndërhyrësi i lartcekur në këtë çështje kontestimore nuk ka interes juridik, andaj propozimin e tij e refuzoi.

Në fakt në këtë çështje kontestimore paditësi ka kërkuar anulimin e kontratës mbi shitblerjen e banesës, kundër të paditurit, duke theksuar se e njëjta kontratë është lidhur në lajthim nga ana e paditësit.

Përmes përgjigjes me shkrim në padi i padituri e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se kontrata në fjalë është lidhur pranë shërbimit kompetent, i cili shërbim merret me të tilla punë, andaj për shkak të kësaj arsyeje edhe e ka ftuar ndërmarrjen publike të lartpërmendur që të përfshihet në këtë procedurë si ndërhyrës në anën e tij.

Gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore, është jo kontestues fakti se palët ndërgjyqëse pranë shërbimit kompetent kanë lidhur kontratën mbi ndërrimin e banesës dhe se të njëjtën kontratë e kanë përmbush me vendosjen e palëve në banesa. Në bazë të kësaj gjendje juridike, sipas gjykatës nuk ekziston interesi juridik për ndërhyrësin që i padituri të ketë sukses në këtë procedurë kontestimore, apo në përgjithësi në përfundimin e këtij kontesti, andaj duke u bazuar në nenin 272.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_  
C.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit.





**KAPITULLI X**  
**NDËRPRERJA E GJYKIMIT DHE**  
**PUSHIMI I GJYKIMIT**

## 10 NDËRPRERJA DHE PUSHIMI I GJYKIMIT

### 10.1 Ndërprerja dhe pushimi

Me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), përkatësisht nenin 277 të tij, janë paraparë shkaqet për shkak të të cilave ndërpritet një proces gjyqësor.<sup>142</sup>

### 10.2 Çka nënkupton ndërprerja e gjyqimit (procedurës)?

Ndërprerja e gjyqimit nënkupton ndaljen e përkohshme të aktivitetit procedural në një çështje për shkak të rrethanave të cilat e pengojnë vazhdimin e shqyrtimit dhe vazhdimin e zgjidhjes së kësaj çështje.<sup>143</sup> Këto rrethana nuk janë të karakterit taksativ, ndërsa kanë të përbashkët se ndodhin pa dëshirën dhe vullnetin e palëve apo dhe të gjykatës.

### 10.3 Kur ndërpritet gjyqimi (procedura)

Procesi gjyqësor ndërpritet në këto raste:

- a) Për shkak të vdekjes së palës ndërgjyqëse, apo kur pala ndërgjyqëse e humb zotësinë procedurale-kontestimore;<sup>144</sup>
- b) Kur përfaqësuesi ligjor i palës vdes ose kur shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, ndërsa pala nuk ka caktuar përfaqësues me prokurë për gjykim;
- c) Kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës së tij;
- d) Kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në konteste në të cilat i padituri është debitor falimentues;<sup>145</sup>
- e) Kur për shkak të luftës apo për shkaqe të tjera pushon puna në gjykatë;
- f) Kur ndërprerja e gjyqimit parashihet me ndonjë ligj tjetër,<sup>146</sup> etj.

Rastet më të shpeshta të ndërprerjes së gjyqimit ndodhin pikërisht për shkak të pikës (a) të nenit 277 të lartcekur, respektivisht për shkak të vdekjes së palës.

Me rastin e vdekjes së ndonjëres palë, procedura kontestimore ndërpritet, mirëpo fillon procedura jokontestimore, përkatësisht procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore e cila duhet të vihet në veprim sipas detyrës zyrtare nga gjykata, në momentin që kjo e fundit të informohet se një person ka vdekur, apo se me vendim gjyqësor është shpallur i vdekur.<sup>147</sup> Vetëm pasi të përfundojë procedura e trashëgimisë dhe të shpallën trashëgimtarët e mundshëm, do të arrihen kushtet për vazhdimin e procedurës kontestimore, respektivisht në këtë rast do të sigurohej legjitimiteti real i palës/ve në procedurë.

Praktika gjyqësore ka dëshmuar se me rastin e vdekjes së njëres palë, procesi kontestimor ka vazhduar edhe para se të zhvillohej procedura e trashëgimisë, respektivisht duke u bazuar në aktvdekjen e palës së ndjerë, e cila (aktvdekja) është një dokument zyrtar të cilin e lëshojnë organet komunale kompetente dhe e cila për një person lëshohet vetëm njëherë, apo edhe në rastet kur edhe pa nxjerrjen e aktvdekjes, është bërë propozimi për vazhdimin e procedurës, me ç'rast e njëjta ka vazhduar duke pasur për palë trashëgimtarët e deklaruar të trashëgimlënësit, respektivisht të palës e cila ka vdekur.

---

<sup>142</sup> Shih nenin 277 të LPK-së, si dhe nenin 18 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së nr.04/L-118.

<sup>143</sup> Shih "Praktikum za parnicu", Vukasin Ristic, Milosin Ristic, Beograd, 2000, faqe 121 e tutje.

<sup>144</sup> Shih formularët praktik nr.1 dhe 2.

<sup>145</sup> Shih formularin praktik nr.3.

<sup>146</sup> Shih formularin praktik nr.4.

<sup>147</sup> Shih nenin 127 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Vlen të përmendet se si rast tipik kur mund të vjen në shprehje ndërprerja e procesit gjyqësor për shkak se një gjë e tillë është e paraparë në ndonjë ligj të veçantë,<sup>148</sup> ndër të tjera, parashihet me nenin 80 të Ligjit mbi Zgjidhjen e Konfliktit të Ligjeve (LZKL) - Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.43/82 dhe me përmirësimin në nr.72/82. Sipas kësaj dispozite del se gjyqvarësia e krijuar në ndonjë gjykatë të ndonjë vendi tjetër, ka ndikim direkt edhe në procesin kontestimor i cili zhvillohet para gjykatës së vendit tonë. Por në këtë rast duhet që gjykimi në gjykatën e huaj, të jetë iniciuar para se i njëjti të iniciohet në gjykatat tona; që të kemi të bëjmë me konteste për të cilat nuk është e paraparë kompetenca ekskluzive e gjykatave të Republikës së Kosovës, si dhe që të ekzistojë reciprociteti në mes të Republikës së Kosovës si dhe shtetit pranë të cilit zhvillohet procesi gjyqësor. Në këto raste pra gjykimi duhet të ndërpritet.<sup>149</sup>

#### 10.4 Rastet e tjera të ndërprerjes së gjykimit (procedurës)

Përveç rasteve të cekura më lartë, gjykata e ndërpret gjykimin e dhe në këto raste:

- Po që se gjykata ka vendosur që vet të mos e zgjidh çështjen paraprake (neni 13 i këtij ligji);<sup>150</sup>
- Po që se pala ndodhet në zonën e cila për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme (vërshimi, tërmeti) është shkëputur nga gjykata.<sup>151</sup>

Gjykata mund të caktojë ndërprerjen e gjykimit në qoftë se vendimi mbi kërkesëpadinë varet nga fakti nëse është kryer delikti ekonomik apo vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, se kush kryerësi dhe nëse ai është i përgjegjshëm, sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose eksperti kanë dhënë deklaratë të rreme, apo se dokumenti i përdorur si mjet provues është i rremë.

#### 10.5 Pasojat e ndërprerjes së gjykimit (procedurës)

Si rezultat i ndërprerjes së gjykimit, afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale, po ashtu ndërpritin.<sup>152</sup> Përderisa nuk përmendet se për cilat afate saktësisht bëhet fjalë, nënkuptohet se fjala është për të gjitha llojet e afateve, duke përfshirë këtu afatet ligjore dhe ato gjyqësore.

Gjatë kohës sa zgjatë ndërprerja e gjykimit, gjykata nuk mund të kryej kurrfarë veprimesh procedurale, por nëse ndërprerja është shkaktuar pas përfundimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, gjykata mund të jep vendimin meritore në bazë të materialit procedural nga shqyrtimi i bërë deri në kohën e ndërprerjes.<sup>153</sup> Kësisoj p.sh. gjykata mundet që ta hartoj me shkrim aktgjykimin për të cilin ka përfunduar shqyrtimi kryesor edhe në rast se pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, por para se të jetë hartuar me shkrim aktgjykimi, ka vdekur ndonjëra nga palët ndërgjyqëse.

Veprimet procedurale të kryera nga njëra palë gjatë kohës sa zgjatë ndërprerja e gjykimit, nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare. Efekti i tyre fillon vetëm pasi të vazhdojë procesi gjyqësor i ndërprerë.<sup>154</sup>

#### 10.6 Kur fillon procesi i ndërprerë gjyqësor ?

Procedura e cila është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 par. 1 pikat a - d të LPK-së, respektivisht rastet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humb zotësinë procedurale; kur përfaqësuesi ligjor i palës vdes ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, e pala nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë

---

<sup>148</sup> Shih nenin 277 pika (f).

<sup>149</sup> Shih nenin 80 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të Ligjeve (LZKL).

<sup>150</sup> Shih formularin praktik nr.5.

<sup>151</sup> Shih nenin 278 të LPK-së.

<sup>152</sup> Shih nenin 279.1 të LPK-së

<sup>153</sup> Shih nenin 279.2 të LPK-së

<sup>154</sup> Shih nenin 279 të LPK-së.

në gjykim; kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës së tij; apo kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues, do të vazhdohet kur trashëgimtari apo kujdestari i pasurisë trashëgimore përfaqësuesi i ri ligjor, administratori falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën, apo kur i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Procedura e cila është ndërprerë nga shkak i përmendur në neni 277 par. 1 pik. (e) të LPK-së, respektivisht kur për shkak të luftës ose për shkaqe të tjera pushon puna në gjykatë, do të vazhdoj pasi që gjykata e falimentimit ta anuloj moratoriumin.<sup>155</sup>

Nëse gjykata e ka ndërpre gjykimin nga shkaqet e përmendura nga neni 277 par. 1 pik. a dhe paragrafi 2 të LPK-së, gjykimi do të vazhdoj pasi të përfundoj procedura në formë të prerë tek gjykata apo organi tjetër kompetent, apo kur gjykata e çështjes konstaton se nuk ekzistojnë më arsyet për të pritur përfundimin e saj.<sup>156</sup>

Në të gjitha rastet e tjera gjykimi i ndërprerë do të vazhdoj pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes.<sup>157</sup>

### 10.7 Afatet

Afatet të cilat për shkak të ndërprerjes së gjykimit kanë pushuar të rrjedhin, për palën e interesuar fillojnë të rrjedhin rishtazi, nga dita kur gjykata ia dërgon atij aktvendimin mbi vazhdimin e gjykimit.<sup>158</sup>

### 10.8 Ankesa kundër aktvendimit për ndërprerjen e gjykimit (procedurës)

Ankesa kundër aktvendimit me të cilin konstatohet apo ndërpritet procedura, nuk e pengon përmbartimin e aktvendimit.

Në qoftë se gjykata gjatë seancës gjyqësore e refuzon propozimin për ndërprerjen e gjykimit dhe vendos që gjykimi menjëherë të vazhdoj së zhvilluari, kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa e posaçme.<sup>159</sup>

#### 10.8.1 Pushimi i gjykimit

Pushimi i gjykimit shkaktohet kur pala vdes, apo kur mbaron së ekzistuari, në rastet kur objekt kontesti janë të drejtat që nuk mund të kalojnë në trashëgimtarët e palës, përkatësisht në pasardhësin juridik të saj. Në këto raste aktvendimi për pushimin e gjykimit i dërgohet palës kundërshtare, trashëgimtareve, përkatësisht pasardhësit juridik të palës pasi të jenë caktuar ata.

Trashëgimtareve të palës së vdekur, sipas propozimit të palës kundërshtare apo sipas detyrës zyrtare, gjykata ua cakton përfaqësuesin e përkohshëm, të cilit ia dërgon aktvendimin mbi pushimin e gjykimit, nëse konstaton se procedura trashëgimore mund të zgjasë një kohë të gjatë.

Aktvendimi mbi pushimin e gjykimit i dhënë nga shkak i mbarimit të personit juridik, i dërgohet palës kundërshtare dhe pasardhësit juridik të personit juridik, po qe se ky i fundit ekziston.

Deri sa aktvendimi mbi pushimin e gjykimit të bëhet i formës së prerë, lidhur me afatet për kryerjen e veprimeve juridike, me të drejtat e palëve dhe veprimet e gjykatës në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat mbi ndërprerjen e gjykimit.<sup>160</sup>

---

<sup>155</sup> Shih nenin 280.2 të LPK-së

<sup>156</sup> Shih nenin 280.3 të LPK-së

<sup>157</sup> Shih nenin 280 të LPK-së, si dhe nenin 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së nr.04/L-118.

<sup>158</sup> Shih nenin 280.5 të LPK-së

<sup>159</sup> Shih nenin 281 të LPK-së.

### **10.8.2 Dallimi në mes të ndërprerjes së gjykimit (procedurës) dhe pushimit të gjykimit (procedurës)**

Instituti i pushimit të gjykimit në fakt përbën njërën prej formave përmes të cilave mund të përfundoj procedura kontestimore.

Dallimi në mes të kësaj forme dhe formave të tjera të përfundimit të procedurës kontestimore konsiston në ngjarjen apo rrethanat të cilat e shkaktojnë këtë përfundim, e të cilat paraqiten të jenë ngjarje apo rrethana jashtë procedurale.

Me rastin e trajtimit të institutit të ndërprerjes së gjykimit, gjithashtu është thënë se vdekja e personit fizik apo mbarimi i ekzistimit të personit juridik, paraqesin rrethana apo shkaqe të cilat shkaktojnë ndërprerjen e gjykimit, mirëpo kjo në asnjë mënyrë nuk guxon të ngatërrohet me institutin e pushimit të gjykimit, sepse tek instituti i pushimit të gjykimit objekt kontesti janë të drejtat që nuk mund të kalojnë apo të bartën në trashëgimtarët e palës, përkatësisht në pasardhësin juridik të saj, ndërsa tek instituti i ndërprerjes së gjykimit objekt kontesti janë të drejtat të cilat mund të kalojnë dhe të bartën në trashëgimtarët apo pasardhësit e palëve, prandaj edhe gjykimi i ndërprerë vazhdon me këta të fundit.<sup>161</sup>

Të drejtat e tilla të cilat nuk mund të bartën tek personat e tjerë apo tek trashëgimtarët e tyre janë ato të drejtat të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me personin e caktuar, apo janë produkti drejtpërdrejt i mendjes dhe shpirtit të tij, siç janë p.sh. të drejtat nga pronësia intelektuale.<sup>162</sup>

---

<sup>160</sup> Shih nenin 282 të LPK-së.

<sup>161</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 512 e tutje.

<sup>162</sup> Shih formularin praktik nr.6.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**



## 10.9 Formularët praktikë për ndërprerjen dhe pushimin e gjykimit

### Formulari 1 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së paditësit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësve \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, dhe \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurit Komuna e Prizrenit, e përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën dhe kthimit të paluajtshmërisë në posedim, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit \_\_\_\_\_ ish nga Prizreni.

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

#### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, dhe \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit Komuna e Prizrenit, e përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën dhe kthimit të paluajtshmërisë në posedim.

Gjatë seancës përgatitore të mbajtur me datën 30.03.2012, i autorizuari i paditësve \_\_\_\_\_, av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, e ka informuar gjykatën me faktin e vdekjes së paditësit \_\_\_\_\_ ish nga Prizreni, për çka edhe ia ka dorëzuar gjykatës një certifikatë vdekjeje me nr. rendor 491, të datës 30.03.2012, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 2 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së të paditurit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Bill Klinton" nr.\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Muhaxhirët" nr.\_\_\_\_, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 1.523 euro, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes së të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Muhaxhirët" nr.\_\_\_\_.

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Bill Klinton" nr.\_\_\_\_, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Muhaxhirët" nr.\_\_\_\_, për shkak të borxhit.

Përmes parashtrësës së datës 08.11.2011, të parashtruar nga ana e të birit të të paditurit, \_\_\_\_\_, gjykata ka konstatuar se i padituri \_\_\_\_\_, ka ndërruar jetë më 17.03.2010, fakt ky i provuar në bazë të certifikatës së vdekjes me nr. rendor 202, të datës 04.11.2011, të lëshuar nga Komuna e Prishtinës.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika ( a ) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

### Formulari 3 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të likuidimit të të paditurës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësve \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Peja, tani me qëndrim në Stamboll – Republika e Turqisë, të cilët i përfaqëson e autorizuar e tyre paditësja e parë \_\_\_\_\_ nga Peja rr. “Nëna Terezë” nr. \_\_\_\_, kundër të paditurve \_\_\_\_\_, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë dhe dorëzimit të patundshmërisë, me datën \_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të likuidimit të të paditurës së dytë N.Sh. \_\_\_\_\_ nga Peja.

#### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Peja, tani me qëndrim në Stamboll – Republika e Turqisë, të cilët i përfaqëson e autorizuar e tyre paditësja e parë \_\_\_\_\_ nga Peja rr. “Nëna Terezë” nr. \_\_\_\_, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurve \_\_\_\_\_, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë dhe dorëzimit të patundshmërisë.

Duke qenë se në këtë procedurë si palë e paditur është paraqitur \_\_\_\_\_ nga Prizreni, me datën 12.10.2011, kjo gjykatë zyrtarisht i është drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me kërkesën që të njoftohet nga kjo e fundit në lidhje me statusin e këtu të paditurës së lartcekur dhe procedurat eventuale ligjore të cilat janë zhvilluar në lidhje me të.

Me datën 17.10.2011, nga ana e AKP-së, gjykata e ka pranuar njoftimin me nr. 005-0051-11, përmes të cilit është njoftuar se N.Sh. \_\_\_\_\_ nga Peja, me vendim të Bordit të AKP-së të datës 04.07.2006, gjendet në proces të likuidimit dhe se sipas nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-34 mbi AKP-në, në këtë çështje juridike kontestimore duhet të pezullohet (ndërpritet) procedura.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 9.3 të Ligjit mbi AKP-në, në lidhje me nenin 277 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## **Formulari 4 -Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të përfshirjes së autoritetit publik në cilësinë e palës së paditur**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, nga Prizreni rr."Dositejeva"nr. \_\_, tani me banim të përkohshëm në Novi Beograd - Republika e Serbisë rr."Lubinke Bobiq" nr. \_\_, kundër të paditurave Komuna e Prizrenit, dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës - Qeveria e Kosovës, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 180.000 euro, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

NDËRPRITET (Pezullohet)procedura në këtë çështje juridike, konform nenit 68.1 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, dhe nenit 25 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-221.Ndërprerja e procedurës zgjatë 18 muaj dhe fillon të rrjedh nga dita e njoftimit (dorëzimit të listës së lëndëve të pezulluara të kësaj natyre), Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës.

Nëse Ministria e Drejtësisë e njofton gjykatën me shkrim se do të marrë përfaqësimin e Qeverisë ose të një autoriteti publik, atëherë periodha e pezullimit ndërpritet nga data e këtij njoftimi dhe gjykata vazhdon me zgjidhjen e rastit.

### **A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurave Komuna e Prizrenit dhe IPVQ- Qeveria e Kosovës, për shkak të kompensimit të dëmit.

Sipas nenit 68 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe nenit 25 të ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin Financave Publike dhe Përgjegjësit, gjykata duhet të ndërpresë procedurën dhe menjëherë të lajmërojë Ministrinë e Drejtësisë, të cilës do t'ia siguroj listën e lëndëve në të cilat është ndërprerë procedura, nëse procedura udhëhiqet kundër Qeverisë ose një autoriteti publik, ku së paku njëri nga pretendimet ndërlidhet me dëmtime pronësore që kanë rezultuar nga lufta, kryengritja civile ose trazirat civile dhe ku padia është dorëzuar me apo para 1 janarit 2005. Në rastin konkret padia është e drejtuar kundër Komunës së Prizrenit, institucion ky i cili sipas ligjit të lartcekur konsiderohet autoritet publik.

Kjo procedurë e ndërprerë zgjat 18 muaj dhe fillon të rrjedh nga dita e dorëzimit të listës së lëndëve në të cilat është ndërprerë procedura. Por, nëse Ministria e Drejtësisë e njofton gjykatën me shkrim se do të marr përfaqësimin e Qeverisë ose të një autoriteti publik, atëherë periodha e pezullimit ndërpritet nga data e këtij njoftimi dhe gjykata vazhdon me zgjidhjen e rastit.

Nga shkaqet e paraqitura, gjykata vendosi si në shqiptim të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (f) të LPK-së, lidhur me nenin 68.1 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 25 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_/ \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimit është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 5 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditëses \_\_\_\_\_ nga Mitrovica rr. “Fehmi Ibrahim” nr. \_\_\_1, të cilën përmes Agjencionit për Ndihmë Juridike e përfaqëson e autorizuar e saj av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Mitrovica rr. “Zahir Pajaziti” – Kafeteria “ \_\_\_\_\_”, për shkak të besimit të fëmijëve, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

Udhëzohet pala paditëse që përmes Organit të Kujdestarisë – Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë, të inicioj procedurën e heqjes së të drejtës prindërore ndaj të paditurës, në procedurën gjyqësore jashtë kontestimore.

### A r s y e t i m

Paditësja pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës, për shkak të besimit të fëmijëve të mitur.

Me shikim në shkresat e lëndës, përgjatë zhvillimit të procedurës, gjykata ka konstatuar se kjo procedurë nuk mund të zhvillohet më tutje sipas rregullave të procedurës kontestimore, përkatësisht se në këtë çështje juridike, si çështje paraprake paraqitet të jetë çështja e heqjes së të drejtës prindërore ndaj të paditurës, e cila procedurë paraqitet të jetë e veçantë dhe e cila duhet të iniciohet nga organi i veçantë, në këtë rast Organi i Kujdestarisë - Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë, dhe atë në procedurën tjetër gjyqësore jashtëkontestimore.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, e konform nenit 13 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në lidhje me nenin 108 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 6 - Aktvendim mbi pushimin e procedurës për shkak të vdekjes së të paditurit

CE.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_ në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, rr. “Hoxhë Kadri Prishtina” nr.\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. “Zahir Pajaziti” nr.\_\_\_\_, për shkak të vërtetimit të së drejtës së autorit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike PUSHON për shkak të vdekjes së të paditurit \_\_\_\_\_, ish nga Prishtina.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Prishtina, rr. “Hoxhë Kadri Prishtina” nr.\_\_\_\_, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. “Zahir Pajaziti” nr.\_\_\_\_, për shkak të vërtetimit të së drejtës së autorit.

Përmes parashtrësës së datës 08.11.2011, të parashtruar nga ana e të birit të të paditurit, \_\_\_\_\_, gjykata ka konstatuar se i padituri \_\_\_\_\_, ka ndërruar jetë më 17.12.2013, fakt ky i provuar në bazë të certifikatës së vdekjes me nr. rendor \_\_\_\_\_, të datës 04.11.2011, të lëshuar nga Komuna e Prishtinës.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 282.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE  
CE.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.



**KAPITULLI XI**  
**DHËNIA E NDIHMËS JURIDIKE**



## 11 DHËNIA E NDIHMËS JURIDIKE

### 11.1 Ndihma juridike

Dhënia e ndihmës juridike qëndron në kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e një gjykate në procesin kontestimor i cili zhvillohet në gjykatën tjetër, e njohur si gjykata e çështjes.

#### 11.1.1 Dhënia e ndihmës juridike gjykatës së vendit

Dispozita e nenit 283.1 të LPK ka paraparë si detyrim çështjen e dhënies së ndihmës juridike reciproke ndërmjet gjykatave.

Kjo në praktikë ndodh kur gjatë zhvillimit të një procedure gjyqësore për shembull në Gjykatën Themelore në Prishtinë paraqitet nevoja që të bëhet nxjerrja e provës relevante për çështjen që mund të jetë këqyrja direkte e sendit të paluajtshëm që gjendet në territorin Gjykatës Themelore në Ferizaj. Në këtë rast ndihma juridike është rrugë e domosdoshme për marrjen e këtyre provave.

Realizimi i ndihmës juridike në këtë rast bëhet në atë mënyrë që Gjykata Themelore e Prishtinës, si gjykatë e çështjes, duke e marrë për bazë edhe parimin e ekonomizimit të procedurës, i lutet - i drejtohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, në territorin e së cilës gjendet prova në këtë rast sendi i paluajtshëm, dhe kërkon nga ajo ndihmë juridike për marrjen e provës me këqyrjen direkt të sendit të paluajtshëm.

Gjykata e lutur në këtë rast, Gjykata e Ferizajt është e detyruar që ta kryej veprimin e kërkuar nga gjykata në Prishtinë dhe procesverbalin e përpiluar rreth marrjes së provës t'ia dërgojë gjykatës në Prishtinë.

Në praktikë ndodh që ndihma juridike të mos realizohet për shkak se gjykata apo organi tjetër nga i cili kërkohet ndihma të mos jetë kompetent për këtë.<sup>163</sup>

Karakterit detyrues i dhënies së ndihmës juridike shprehet në faktin se edhe në rastin kur gjykata e lutur nuk është kompetente për kryerjen e veprimit që është objekt i ndihmës juridike, nuk ia kthen mbrapa lutjen gjykatës e cila ka kërkuar ndihmë juridike, por ajo vetë ia dërgon lutjen gjykatës kompetente, apo ndonjë organi tjetër shtetërorë që është kompetent për këtë çështje.

Duhet të kihet parasysh se gjykata e lutur për ndihmë mund të ja kthejë lutjen gjykatës e cila ka kërkuar ndihmë juridike, vetëm në ato raste kur ajo (gjykata e lutur) nuk ka njohuri se cila gjykatë është kompetente apo cili organ tjetër shtetëror është kompetent për dhënien e ndihmës juridike të kërkuar.

#### 11.1.2 Dhënia e ndihmës juridike gjykatës së huaj

Gjykatat tona janë të detyruara që t'u japin ndihmë juridike edhe gjykatave të huaja, nëse një gjë e tillë është paraparë me kontratë ndërkombëtare si dhe kur ekziston reciprociteti (neni 284.1 LPK).

Burim kryesor formal për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare janë marrëveshjet e ndryshme ndërshtetërore, ato bilaterale apo multilaterale. Këto marrëveshje ndërkombëtare në aspektin e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare kanë përparësi në zbatim në raport me legjislacionin e vendit.

---

<sup>163</sup>Në praktikë ndodh që ndihma juridike të mos realizohet për shkak se gjykata apo organi tjetër nga i cili kërkohet ndihma të mos jetë kompetent për këtë. Shembull në qoftë së Gjykata Themelore në Pejë, kërkon ndihmë juridike nga Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, për këqyrjen direkte të sendit i cili ndodhet në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në këtë rast ndihma juridike nuk do të realizohet nga ky departament për shkak të mos kompetencës së këtij departamenti. Shembull tjetër mund të jetë Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme kërkon ndihmë nga Gjykata Themelore e Prizrenit, për këqyrjen direkte të sendit i cili ndodhet në territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj. Në këtë rast ndihma nuk mund të jepet sepse Gjykata Themelore në Prizren nuk ka jurisdikcion në territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e marrëveshjeve bilaterale apo multilaterale me shtetet tjera, megjithatë në Kosovë vlejnë edhe më tutje marrëveshjet ndërkombëtare të cilat i ka lidhur ish RSFJ. Nëse shtetet tjera do të zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me ndihmën juridike ndërkombëtare me Kosovën, kjo varet nga qasja e tyre lidhur me këtë çështje.<sup>164</sup>

Objekt i dhënies së ndihmës juridike mund të jetë komunikimi i shkresave të ndryshme apo kryerja e ndonjë veprimi procedural, e që në të shumtën e rasteve ka të bëjë me marrjen e provës.

Ligji për Gjykatat ka paraparë Gjykatën Themelore si gjykatë me kompetencë lëndore për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.<sup>165</sup>

## 11.2 Procedura lidhur me dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare

Realizimi i ndihmës juridike ndërkombëtare bëhet përmes Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës.

Përveç kësaj, në rastet kur gjykatat e vendit në ndonjë rast të ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare vijnë në hamendje apo dyshojnë se ka reciprocitet me shtetin që duhet ofruar ndihmë, atëherë ky organ duhet që gjykatën ta njoftojë se a ka reciprocitet apo jo.

Procedura për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet civile nuk është rregulluar ende me ligj të veçantë por me Udhëzim Administrativ.<sup>166</sup> Ky udhëzim përshkruan procedurat për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare në lëndët civile dhe siguron orientim në lidhje me ndihmën juridike ndërkombëtare të cilat i adresohen shtetit tjetër nga Republika e Kosovës dhe ndihmës juridike ndërkombëtare të cilat pranohen nga shtetet e huaja në Republikën e Kosovës.<sup>167</sup>

Në rast se gjykata e huaj kërkon nga gjykata e vendit tonë që të kryejë një veprim të caktuar, i cili përbën objekt të ndihmës juridike, në mënyrën e caktuar, atëherë ky veprim i tillë edhe pse mund të mos parashihet me ligjin tonë, gjykata e vendit tonë mund ta kryejë këtë veprim, mirëpo me kusht që ky veprim të mos jetë në kundërshtim me rendin juridik të vendit tonë.

Pesë hapat të cilët i ndërmerr Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në trajtimin e lutjeve nga shtetet e huaja janë:

- Pranimi i lutjes.
- Shqyrtimi i lutjes (shqyrtimi i lutjes nënkupton konfirmimin e ekzistimit të reciprocitetit, konfirmoj se, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj, lutja e huaj a është dërguar në rrugë diplomatike dhe shkresat që i janë bashkangjitur janë hartuar në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë ose nëse është bashkëlidhur përkthimi i tyre i legalizuar në gjykatë).<sup>168</sup>
- Vendimi për ta dërguar lutjen në gjykatën përkatëse ose institucion tjetër kompetent;
- Pranimi i përgjigjes nga gjykata apo institucioni tjetër kompetent (në rastet kur përgjigja është e mangët, me një koordinim formal në mes të gjykatës dhe institucionit tjetër kompetent për të shikuar nëse përgjigja mund të ndryshohet për të plotësuar parimet e Udhëzimit Administrativ, Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe ligjeve të tjera përkatëse).
- Përcjellja e përgjigjes te autoriteti kërkues

### 11.2.1 Veprimi në rastet kur lutja e shtetit të huaj për ndihmë juridike bie në kundërshtim me rendin juridik të vendit tonë

---

<sup>164</sup>Në Republikën e Kosovës ende është në zbatim Ligji për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera në marrëdhëniet e caktuara. Ky ligj është botuar në "Gazetën Zyrtare të RSFJ-së" nr.43/82 dhe me përmirësime në nr.72/82.

<sup>165</sup>Shih nenin 11 të Ligjit për Gjykatat

<sup>166</sup>Udhëzimi Administrativ për procedurat e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale dhe civile, nr.01-1265, i vitit 2009.

<sup>167</sup>Po aty, neni 1.

<sup>168</sup>Neni 286 LPK

Gjykata e vendit tonë mund të jep ndihmë juridike në mënyrën e kërkuar nga gjykata e huaj dhe me ligjin e huaj (lex fori i gjykatës që kërkon ndihmë juridike), por vetëm nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me rendin juridik të vendit tonë. Kështu p.sh. nëse gjykata e huaj ka kërkuar që të merret në pyetje pala me betimin se e ka thënë të vërtetën (edhe pse LPK nuk e parasheh këtë), nuk ka pengesë që gjykata jonë të veprojë kështu.

Gjykata e vendit tonë nuk do të veprojë sipas lutjes së gjykatës së huaj nëse me këtë do të rrezikohet sovraniteti dhe siguria e vendit tonë. P.sh. lutja e gjykatës së huaj me të cilën kërkohet që të merret në pyetje dëshmitari lidhur me faktet që përbëjnë sekret profesional, zyrtar apo ushtarak. Kur ekzekutimi i kërkesës do ta paragjykonte sovranitetin, sigurinë, rendin publik apo interesat tjera esenciale të Kosovës.

Në rast se gjykatës së lutur i kërkohet që të ndërmerr ndonjërin nga veprimet e lartshënuara, atëherë gjykata e lutur do t'ia dërgoj kryesisht lutjen Gjykatës Supreme e cila do të merr vendim definitiv për këtë çështje.

### **11.2.2 Lutjet nga gjykata e vendit drejtuar gjykatave të huaja**

Në rast se nuk e kemi të përcaktuar me kontratë ndërkombëtare formën dhe mënyrën e veprimit, atëherë gjykata jonë i drejtohet gjykatës së huaj, në rrugë diplomatike duke i parashtruar lutje dhe shkresa tjera që i bashkëngjiten, në gjuhën e shtetit të lutur, ose t'ia bashkëngjis përkthimin e tyre të legalizuar në atë gjuhë.

Edhe këtu, kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare nga gjykata jonë parimisht i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, si organ kompetent për trajtimin e lutjeve që burojnë nga Kosova. Edhe në këtë rast ky organ i ndërmerr 5 hapat të cilët u trajtuan në rastet kur lutja dërgohet nga shteti i huaj.

Pra parimisht komunikimi bëhet në rrugë diplomatike, mirëpo ekzistojnë edhe përjashtime dhe sipas nenit 2 (2) të Udhëzimit Administrativ nr.01-1265, i vitit 2009, mund të kërkohet ndihmë juridike ndërkombëtare kur kjo autorizohet nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare dhe përjashtimi tjetër ka të bëjë me çështjet civile dhe komerciale të cilat duhet të trajtohen brenda territorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## KAPITULLI XII

# **MOSRESPEKTIMI I GJYKATËS**

## 12 MOSRESPEKTIMI I GJYKATËS

### 12.1 Mosrespektimi i gjykatës

Mosrespektimi i gjykatës mund të vije në shprehje nga ndonjë veprim i palës, përfaqësuesit ligjor, përfaqësuesit me prokurë apo ndërhyrësit, përmes të cilit cenohet autoriteti dhe dinjiteti i gjykatës.

Dispozita e nenit 9 të LPK ka paraparë si detyrim të palëve ndërgjyqëse, ndërhyrësve dhe përfaqësuesve të tyre që t'i shfrytëzojnë me ndërgjegje të drejtat që u janë njohur me këtë ligj. Ndërsa sipas nenit 10.2 të LPK veprimet e palëve në procedurë duhet të jenë konform zakoneve të mira, ato duhet të shfrytëzohen me mirëbesim, ndërgjegje dhe të mos shpërdorohen.

Pra palët në proces gjyqësor dhe pjesëmarrësit e tjerë duhet që të rezervohen jo vetëm nga çfarëdo veprimi që paraqet keqpërdorim të të drejtave, por edhe të evitojnë çfarëdo shprehje e cila do të përbënte fyerje për gjykatën dhe palët e tjera në procedurë.

### 12.2 Roli i gjyqtarit në rastet kur palët dhe pjesëmarrësit në procedurë keqpërdorin të drejtat procedurale

Keqpërdorim të të drejtave procedurale kemi atëherë kur pala, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi me prokurë apo ndërhyrësit e shfrytëzon një të drejtë apo autorizim procedural jo për qëllimin për të cilin ajo e drejtë i është dhënë, mirëpo me qëllim që palës tjetër t'i shkaktoj ndonjë dëm, apo të shkaktoj ndonjë zvarritje të procesit gjyqësor.

Gjyqtari i çështjes, nga momenti i fillimit të procedurës e deri në mbarim të saj, duhet të kujdeset lidhur me shfrytëzimin e të drejtave procedurale nga palët dhe pjesëmarrësit në procedurë dhe në rast se konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurë (në cilëndo fazë të saj) palët dhe pjesëmarrësit e tjerë, në ndonjë formë, kanë keqpërdorë ndonjë të drejtë që i është njohur me këtë ligj, atëherë do ti dënojë me gjobë deri në 500€<sup>169</sup>

Disa shembuj kur palët mund të dënohen për shkak të mos respektimit të gjykatës;

*Është e drejtë e secilës palë të deklarohet për pretendimet e veta lidhur me çështjen, por ndalohen deklaratimet që dalin jashtë natyrës së çështjes e që mund të jenë deklarime lidhur me personalitetin e palës tjetër, të kaluarën e saj, deklarime lidhur me moralin, edukimin, etj.*

*Është e drejtë e palës të përfaqësohet nga avokati, por nuk mund të kërkoj shtyrjen e seancës më shumë se një herë për qëllimin e angazhimit të avokatit.*

*Është e drejtë e palës të kërkoj shtyrjen e seancës për një shkak të pranueshëm por nuk mund ta përsëris propozimin për shtyrje të seancës për shkakun e njëjtë.*

---

<sup>169</sup>Masat të cilat mund ti ndërmer gjyqtari në rast të mos respektimit të gjykatës kanë të bëjnë më nevojën që palët në procesin kontestimor t'i shfrytëzojnë të drejtat e tyre konform parimeve dhe dispozitave ligjore duke u rezervuar nga çfarëdo veprimi i cili mund të cilësohet si keqpërdorim i të drejtave në procedurë por edhe të evitojnë çfarëdo deklarimi i cili mund të vlerësohet si fyerje ndaj gjykatës. Keqpërdorimi i të drejtave procedurale është në çdo rast kur palët e shfrytëzojnë një të drejtë apo autorizim procedural jo për qëllimin për të cilin parashihet e drejta por me qëllim të zvarritjes së procedurës, fyerjes së gjykatës apo edhe shkaktimin e ndonjë dëmi palës tjetre.

*Është e drejtë e palës të kërkoj përjashtimin e gjyqtarit kur ka pretendim për arsyet e përjashtimit por nuk mund të kërkohet përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve dhe kryetarëve të të gjitha gjykatave sepse kjo kërkesë mund të ketë për qëllim zvarritjen e procedurës.*

*Është e drejtë e palës të ketë vërejtje në ekspertizë dhe në ekspert por nuk mund të kërkoj përjashtimin e të gjithë ekspertëve dhe të gjitha instituteve që merren me ekspertiza.*

*Pala mund të kërkoj përjashtimin e gjyqtarit por jo sipas pretendimit se gjyqtari është i korruptuar pas asnjë fakt për këtë pretendim.*

Për disa pretendime të palëve që mund të kualifikohen si përpjekje për keqpërdorim të të drejtave procedurale, nevoja për të shqiptuar një dënim më të holla konsumohet më tërheqjen e vërejtjes apo me refuzimin e propozimit.

Në rastet kur përmes keqpërdorimit të të drejtës procedurale ndonjërit nga pjesëmarrësit në procedurë i është shkaktuar dëm i natyrës juridiko civile (dëm që ndikon në zvogëlimin e pasurisë së dikujt ose në pengim e rritjes së tij) atëherë pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kompensim dëmi dhe në rastet e tilla gjyqtari i çështjes ka mundësi që në të njëjtin proces gjyqësor të vendos edhe lidhur me kërkesën për kompensim dëmi.

### **12.3 Rastet e keqpërdorimit të drejtave procedurale**

Rasti i parë: i referohet situatës kur kreditori edhe pse i është paguar borxhi nga debitori ngre padi kundër tij duke menduar se debitori nuk do të mund ta bind gjykatën se e ka paguar borxhin, për shkak se nuk ka kurrfarë provash për një gjë të tillë.

Rasti i dytë: ka të bëjë me situatën kur pala në procedurë pa pasur ndonjë arsye kërkon rekuizimin e gjyqtarit me qëllim të zvarritjes së gjykimit.

Rasti i tretë: kur lidhur me vërtetimin e një fakti gjykata ka dëgjuar disa dëshmitarë ndërsa pala prapëseprapë propozon që të dëgjohet dëshmitari tjetër për të cilin e din se nuk ka kurrfarë dijenie në lidhje me atë fakt.

#### **12.3.1 Roli i gjyqtarit në rastet kur palët dhe pjesëmarrësit në procedurë e fyejnë gjykatën dhe pjesëmarrësit në procedurë përmes parashtresës apo në seancë gjyqësore**

Gjyqtari i çështjes mund ta gjobitë me dënim në të holla prej 100-500 € palën ose pjesëmarrësit e tjerë në procedurë të cilët në formën e shkruar e fyejnë gjykatën. Qëllimi i një dënimi të tillë është që të ruhet autoriteti i gjykatës dhe palët si dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë të rezervohen dhe të evitohen çfarëdo shprehje përmes të cilave do të cenohej autoriteti dhe dinjiteti i gjykatës.

Në rastet kur pjesëmarrësi në procedurë apo personi që është i pranishëm në vendin ku mbahet seanca për shqyrtimin e çështjes e fyen gjykatën apo pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, e pengojnë punën apo nuk i respektojnë urdhrat e gjyqtarit për mbajtjen e rendit dhe qetësisë. Gjyqtari i çështjes fillimisht do ta qortojë palën përgjegjëse. Qortimi bëhet në formë të vërejtjes që shënohet në procesverbal dhe në qoftë se përkundër kësaj personi i qortuar i përsërit veprimet e tilla, atëherë gjyqtari këtë person do ta largojë nga vendi ku mbahet seanca gjyqësore ose do ta dënoj me gjobë deri në shumën prej 500€ Gjyqtari mundet që këtë person edhe ta largojë nga seanca gjyqësore e edhe ta dënojë me gjobë.

Gjyqtari mundet që përfaqësuesit me prokurë të palës t'ia ndalojë përfaqësimin e metutjeshëm të palës në çështjen e caktuar në qoftë se ai përsërit në vazhdimësi sjellje të tilla me të cilat e fyen gjykatën dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë.

Në rastet kur pala dhe përfaqësuesi me prokurë i saj largohen nga vendi ku mbahet seanca, seanca gjyqësore do të mbahet pa praninë e tyre.

Pjesë nga procesverbali kur gjykata në seancë gjyqësore pjesëmarrësve ua tërheq vërejtjen, i largon nga seanca gjyqësore apo u shqipton dënimin me gjobë

Gjykata i tërheq vërejtjen të autorizuarit të të paditurit avokatit \_\_\_\_\_ meqë i njëjti pa lejen e gjykatës ndërhyrë në fjalën e gjyqtarit të çështjes.

Pavarësisht se i është tërhequr vërejtja të autorizuarit të të paditurit që të mos ndërhyjë pa lejen e gjykatës i njëjti përsëri ndërhyrë në fjalën e gjyqtarit prandaj gjykata merr këtë:

Aktvendim

Të autorizuarit të të paditurit av. \_\_\_\_\_, për shkak pengimit të punës së gjykatës dhe mos respektimit të urdhrimit të gjyqtarit për mbajtjen e rendit, i shqipton dënimin me gjobë prej 250€

Për këtë gjykata do të nxjerr vendim të veçantë.

Për kundër faktit se të autorizuarit të të paditurit av. \_\_\_\_\_ i është shqiptuar dënimi me gjobë i njëjti, serish, pa lejen e gjyqtarit të çështjes, ndërhyrë në fjalën e tij, dhe pas kësaj gjykata merr:

Aktvendim

I autorizuari i të paditurit av. \_\_\_\_\_ largohet nga salla ku mbahet seanca gjyqësore.

### 12.3.2 Roli i gjyqtarit në rastet kur dëshmitari dhe eksperti nuk e respektojnë gjykatën

Dhënia e dëshmimeve është detyrë qytetare dhe njëkohësisht edhe ligjore. Ligji e obligon secilin person që thirret si dëshmitar se ka për detyrë që ti përgjigjet thirrjes dhe të dëshmojë, përveç nëse ekziston ndonjë arsye ose rrethanë që do ta lironte nga kjo detyrë.<sup>170</sup> Ndërsa eksperti i caktuar nga gjykata për kryerjen e ekspertizës, ka për detyrë që ti përgjigjet thirrjes së gjykatës dhe të parashtrijë konstatimin dhe mendimin e tij lidhur me çështjen e thirrur.<sup>171</sup>

### 12.3.3 Rasti kur dëshmitari nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës apo pa leje dhe ndonjë arsye largohet nga vendi ku duhet të dëgjohet

Në rastin kur dëshmitari nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës për të dëshmuar si dhe në rastin kur i përgjigjet thirrjes por pa leje dhe ndonjë arsye largohet nga gjykata, gjyqtari i çështjes do të urdhëroj që dëshmitari të sjellet me detyrim, ti paguajë shpenzimet e procedurës nga sjellja me detyrim si dhe do ta dënoj me gjobë deri në 500€

### 12.3.4 Rasti kur dëshmitari refuzon të dëshmojë apo të përgjigjet në pyetjen konkrete

Në praktikë mund të ndodh që një person i ftuar nga gjykata për të dëshmuar në një rast pa arsye refuzon për të dëshmuar apo të përgjigjet në pyetje konkrete që i bëhen në seancë. Në raste të tilla gjyqtari duhet ta vlerësojë se dëshmitari a ka arsye ligjore për të mos dëshmuar dhe përgjigjur në pyetje konkrete (neni 342 dhe 343) dhe nëse konstatohet se shkaqet e refuzimit janë të pa arsyeshme<sup>172</sup> atëherë mundet që dëshmitarin ta dënoj me gjobë deri në 500€

---

<sup>170</sup>Shih nenin 342.1 të LPK.

<sup>171</sup>Shih nenin 359 të LPK.

<sup>172</sup>Ma gjerësisht shih kapitullin XIV – Mjetet provuese veç e veç.

Nëse përkundër kësaj dëshmitari prapë refuzon të dëshmojë, përveç gjobës, dëshmitarin mund ta dënojë me burg. Burgimi zgjat deri sa dëshmitari mos të pranojë të dëshmojë, apo gjersa dëshmia e tij të bëhet e pa nevojshme, por jo me tepër se tridhjetë (30) ditë.

Nëse pala kërkon, gjyqtari do të vendos që dëshmitari të ngarkohet edhe me shpenzimet të cilat i ka shkaktuar ai me mosardhjen e vet dhe refuzimin e pa arsyeshëm për të dëshmuar. Shpenzime të tilla mund të jenë: shpenzimet të cilat i ka pasur pala për shtyrje të seancës shpenzimet për sjelljen me detyrim të dëshmitarit etj.

Gjyqtari mundet që ta revokoj aktvendimin me të cilin është dënuar me gjobë dëshmitari, ose me burg dhe kur i janë ngarkuar shpenzimet, në situatën kur: ai më vonë e arsyeton mungesën e vet, mund ta liroj pjesërisht apo krejtësisht nga detyrimi i pagimit të shpenzimeve si dhe në rastet kur dëshmitari gjatë vuajtjes së dënimit me burg pranon të dëshmojë.

### **12.3.5 Rasti kur eksperti nuk e dorëzon brenda afatit konstatimin dhe mendimin e vet, apo pa arsye nuk vjen në seancë dhe refuzon ekspertimin**

Kur eksperti pa ndonjë shkak të arsyeshëm brenda afatit të caktuar nga gjyqtari nuk e dorëzon konstatimin dhe mendimin e vet, apo pa arsye nuk vjen në seancë edhe pse është thirrur rregullisht si dhe në rastin kur pa arsye refuzon ekspertizën, në raste të tilla, gjyqtari i çështjes mundet që ekspertin ta dënoj me gjobë deri në 1000€

Për dallim nga dëshmitari ndaj ekspertit mund të shqiptohet vetëm dënimi me të holla, pasi që eksperti është i zëvendësueshëm ngase zakonisht ekzistojnë më shumë persona që kanë dijeni për vlerësim profesional të fakteve që ekzistojnë në momentin e ekspertimit. Eksperti nuk mund të sillet me detyrim në gjykatë e as të burgoset nëse i shkelë detyrat e caktuara nga gjykata në bazë të ligjit.





KAPITULLI XIII  
**SIGURIMI I KËRKESËPADISË**



## 13 SIGURIMI I KËRKESËPADISË

### 13.1 Kuptimi dhe përmbajtja

Instituti i sigurimit të kërkesëpadisë është i paraparë me kreun XXI, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), përkatësisht nenet 296-318.

Për dallim prej LPK-së së vjetër në të cilin nuk ka qenë e rregulluar procedura për sigurimin e kërkesëpadisë, por se e njëjta procedurë ka qenë e rregulluar me Ligjin për Procedurën Përmbartimore (LPP) të vjetër, LPK i ri parasheh në vet kapitullin e lartpërmendur institutin e sigurimit të kërkesëpadisë si dhe procedurën për caktimin e masave për sigurimin e kërkesëpadisë.

Me LPK-në nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë natyra juridike e masave përmes të cilave sigurohet kërkesëpadia, sepse në fakt të gjitha masat e sigurimit të cilat mund t'i caktojë gjykata janë të natyrës së përkohshme, por që (paradoksalisht) do të vlejné dhe mund të vlejné deri në përfundim e tërësishëm të procedurës gjyqësore (përfshirë këtu edhe procedurën përmbartimore).

Sidoqoftë, në bazë të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, mund të themi se në parim dhe duke marrë për bazë kriterin e mënyrës së caktimit, kemi dy lloj masash për sigurimin e kërkesëpadisë: masat e përkohshme të sigurisë dhe masat e sigurisë.

Dihet se për lejimin e përmbartimit, ligji kërkon ekzistimin e të ashtuquajturit “dokument përmbartues”. Kësisoj në bazë të nenit 22 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, parashihet qartë se çka nënkuptohet me dokumentin përmbartues dhe cilat akte konsiderohen dokumente përmbartuese.<sup>173</sup> Por që të mos ndodh që kreditori, apo paditësi (në procedurë kontestimore), të vihet në pozitë të papërshtatshme dhe të rrezikshme për realizimin e kërkesëpadisë së tij, si dhe që kërkesëpadia e paditësit të ketë mundësi të bëhet e pa përmbartueshme, në fazën kur vendimi gjyqësor përkatës të bëhet i formës së prerë, LPK në kreun XXI të tij, ka paraparë një mori rregullash, qëllimi i të cilës është që të sigurojnë realizimin e kërkesëpadisë në të ardhmen, realizmi i të cilave rrezikohet, apo mund të rrezikohet nga ana e të paditurit apo edhe e kundërshtarit të sigurimit. Kjo edhe për faktin se realizimi faktik i të drejtave subjektive private (civile), zakonisht merr kohë bukur të gjatë, sepse për realizimin e një të drejte subjektive, duhet që së pari të zhvillohet procedura e njohjes (kognicionit) në të cilën konstatohet kjo e drejtë dhe më pastaj të zhvillohet procedura e realizimit faktik të së drejtës subjektive private, e në të cilën procedurë kërkesa e kreditorit (apo paditësit) realizohet dhunshëm.

Pra shihet se deri te realizimi faktik i të drejtës subjektive private kalon një kohë bukur e gjatë, andaj edhe për këtë arsye paraqitet nevoja e ekzistimit të masave përkatëse përmes të cilave do të sigurohet kërkesëpadia e paditësit, përkatësisht propozuesit të sigurimit.

LPK përdor termet propozues i sigurimit dhe kundërshtari i propozimit të sigurimit, e që në fakt në procedurën kontestimore janë ekuivalente të termeve paditës dhe i paditur. Po ashtu, parashihet se përmes masave të përkohshme si masa me të cilat sigurohet kërkesëpadia, nuk mund të themelohet e drejta e pengut, përpos një rasti të paraparë me nenin 299 par.1 pika (d) të LPK-së.

Sigurimi i kërkesave të kreditorëve realizohet në procedura të veçanta, të cilat procedura në parim janë procedura sumare (të shpejta). Në këto procedura vendoset përkohësisht për ndërmarrjen e një apo disa masave me karakter të përkohshëm por që mund të zgjasin deri në realizimin faktik të kërkesave të kreditorit apo propozuesit të sigurimit.

Me nenin 296 të LPK-së, është paraparë momenti kohor se kur mund të paraqitet kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë. Sipas këtij neni del se ky propozim mund të bëhet para se të jetë ngritur padia për fillimin e procedurës kontestimore, por edhe gjatë procedurës së tillë. Në bazë të po këtij neni përcaktohet edhe gjykata e cila është kompetente për caktimin e masave të sigurisë, e që del të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë dhe të kërkesëpadisë, përkatësisht gjykata e cila vepron sipas padisë. Përfundimisht sipas këtij neni rregullohet edhe mënyra dhe forma e vendosjes lidhur me

---

<sup>173</sup>Shih nenin 22 të LPP-së.

propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë. Kësisoj përkritazi me lejimin e sigurimit të kërkesëpadisë, apo refuzimin propozimit, gjykata vendos me aktvendim.<sup>174</sup> Këtë aktvendim mund ta merr edhe gjykata më e lartë, por vetëm në rastet kur propozimi për sigurimin e kërkesëpadisë është paraqitur pasi që lënda sipas ankesës, ka kaluar për shqyrtim në atë gjykatë.<sup>175</sup>

Vlen të ceket se dhe në rastet kur kemi të bëjmë me aktgjykim të formës së prerë, kompetente për të vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës siguroese, është gjykata e cila do të ishte kompetente për vendosje për kërkesëpadinë në shkallë të parë, apo gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë. Megjithatë kjo ka të bëjë vetëm me rastet kur ende nuk ka filluar procedura e përmbarimit ngase pasi që të fillojë procedura e përmbarimit, kompetente për të vendosur lidhur me masën përkatëse për sigurimin e kërkesëpadisë, është gjykata përmbarimore.

Nga ajo që u tha më lartë, konkludohet se me dispozitat e LPK-së, parashihet se sigurimi i kërkesëpadisë mund të bëhet:

- para se të jetë ngritur padia;
- gjatë procedurës e cila është në vijim e sipër, por edhe
- pas përfundimit të procedurës kontestimore, derisa nuk është filluar procedura përmbarimore.

### 13.2 Kushtet për caktimin e masave të sigurimit

Caktimi i masave të sigurimit është përcaktuar me neni 297.1 të LPK-së.

Këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Në lidhje me kushtin e parë mendohet se propozuesi i sigurimit, duhet ta dëshmojë atë përmes ndonjë vendimi të mëhershëm të gjykatës apo të ndonjë organi administrativ, testamenti, kontrate, ndonjë dokumenti përmbarimor, respektivisht ndonjë titulli tjetër juridik. Ndërsa sa i përket kushtit të dytë, nënkuptohet se ky kusht plotësohet në rastet kur ekziston rreziku që pala kundërshtare do të mund të bënte tjetërsimin e pasurës së vet, ta fsheh atë, ta vë në ngarkim qoftë me peng apo nën hipotekë etj.

Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është e paraparë se gjykata mund të caktojë masën e sigurimit vetëm në kushtet kur propozuesi i sigurimit brenda afatit të caktuar nga gjykata paguan shumën e caktuar të garancionit në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe përmbarimin e asaj mase.<sup>176</sup>

Në këto raste garancioni paguhet në para të gatshme, por gjykata në pajtim me dispozitat e LPP-së mund të lejojë që dhënia e garancionit të bëhet në formë të:

- a) letrave me vlerë;
- b) sendeve të çmueshme, apo edhe
- c) garancitë bankare,

Në garancionin e deponuar në këtë mënyrë pala kundërshtare e fiton të drejtën e pengut ligjor.<sup>177</sup>

Sidoqoftë me dispozita ligjore është e paraparë se me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta lirojë atë nga detyrimi i dhënies së garancisë, po që se në bazë të provave përkatëse të cilat ai i'a ofron gjykatës konstatohet se ai nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë.

Po që se propozuesi nuk e paguan garancionin në masën dhe afatin e caktuar nga gjykata, kjo e fundit do ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së propozuar të sigurimit.<sup>178</sup> Ngjashëm do të vepohet

---

<sup>174</sup>Shih formularët praktik nr.1 – 9.

<sup>175</sup>Shih nenin 296 të LPK-së.

<sup>176</sup>Shih nenin 297 të LPK-së, si dhe formularin praktik nr.1.

<sup>177</sup>Shih nenin 14 të LPP.

<sup>178</sup>Shih nenin 297.3 të LPK-së, si dhe formularin praktik nr.2

edhe në rastet kur gjykata fillimisht e ka caktuar masën e përkohshme, e pastaj duke vepruar sipas kundërshtimit të të paditurit – kundërshtarit të masës së propozuar ndaj aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e cakton seancën dëgjimore për caktimin e tani masës së sigurisë, po që se paditësi – propozuesi i masës së sigurisë, sipas urdhrit të gjykatës, nuk e deponon shumën e garancionit përkatës për tani masën e sigurisë.<sup>179</sup>

Bashkësitë e pushtetit lokal, respektivisht të gjithë personat juridik të së drejtës publike janë të përjashtuara nga detyrimi i pagesës së garancionit. Një gjë e tillë është e paraparë edhe me dispozitat e LPP-së së ri.<sup>180</sup>

Shuma e të hollave e paguar në emër të garancisë sipas nenit 297 të LPK-së, i kthehet personit që e ka paguar brenda afatit 7 ditor nga dita në të cilën shuhet masa e sigurimit. Nëse në ndërkohë propozuesi i sigurimit parashtron padi ndaj të paditurit edhe për kompensimin e dëmit, gjykata kompetente për gjykimin sipas padisë do të vendos për lënien në fuqi të masës përkatëse të sigurimit.<sup>181</sup>

### 13.3 Llojet e masave të sigurimit

Me dispozitat ligjore të LPK-së është e paraparë se mund të bëhet sigurimi i:

- Kërkesës në të holla;
- Sigurimi i kërkesës i drejtuar kah sendi i caktuar apo nga një pjesë e tij, si dhe
- Sigurimi i të drejtave të tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave.

Masat për sigurimin e kërkesës në të holla janë të përcaktuara në nenin 299.1 të LPK-së.

Për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij, mund të caktohen këto masa sigurimi:

- ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsoj, fsheh, ngarkoj apo disponoj me pasurin kah e cila është drejtuar kërkesa, me ç'rast ky ndalim do të evidentohet në regjistrin publik përkatës;<sup>182</sup>
- ruajtja e pasurisë të cilës i përket ndalimi nga pika a e këtij paragrafi dhe atë duke e depozituar në gjykatë nëse kjo është e mundshme, apo duke ju dorëzuar në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë;
- ndalimi i kundërshtarit të sigurimit të kryej veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë kah e cila është drejtuar kërkesa, apo urdhri i kundërshtarit të sigurimit që t'i kryej veprimet e caktuara të nevojshme për tu ruajtur pasuria apo për tu ruajtur gjendja ekzistuese e rrethanave.<sup>183</sup>
- Autorizimi i propozuesit të sigurimit që t'i kryej aktivitete e caktuara.

Vlen të ceket se masat e drejtuara ka sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij e të cilat zakonisht gjenden tek pala kundërshtare, nuk guxojnë ta përfshijnë në tërësi kërkesën që sigurohet me anë të tyre.<sup>184</sup> Kjo nënkupton se me rastin e caktimit të ndonjëres nga këto lloj masash, gjykata nuk mund të vendos që këto masa ta sigurojnë në tërësi kërkesën e propozuesit të sigurimit në aspektin e vlerës të asaj kërkesë. E në rastet kur kërkesa e propozuesit të sigurimit ka një vlerë të caktuar, atëherë masa e sigurimit e cila është drejtuar ka sendi i caktuar apo ka një pjesë e tij, nuk guxon të përfshijë në tërësi atë vlerë të kërkesës.<sup>185</sup>

---

<sup>179</sup>Shih formularin praktik nr.3.

<sup>180</sup>Shih nenin 297.4 të LPK-së, dhe nenin 14.2 të LPP të ri.

<sup>181</sup>Shih nenin 298 të LPK-së.

<sup>182</sup>Shih formularin praktik nr.4.

<sup>183</sup>Shih formularin praktik nr.6

<sup>184</sup>Shih nenin 300.3 të LPK-së.

<sup>185</sup>Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 552.

Përfundimisht, për sigurimin e të drejtave të tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave mund të caktohen masat siguruese si në vijim:

- a) ndalim i kundërshtarit të sigurimit që t'i kryej aktivitetet e caktuara, apo urdhri që t'i kryej aktivitetet, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese apo pengimit të dëmtimit të palës kundërshtare,
- b) autorizim i propozimit të sigurimit që t'i ndërmerr aktivitetet e caktuara,
- c) lënia e pasurisë së caktuar të kundërshtarit të sigurimit për ruajtje dhe përkujdesje personit të tretë,
- d) masat tjera të cilat i cakton gjykata si të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadsisë së propozuesit të sigurimit.<sup>186</sup>

Pra rasti i caktimit të ndonjëres nga ky grup i masave për sigurimin e kërkesëpadsisë, ka të bëjë në situatat kur objekt i sigurimit nuk janë as kërkesat në të holla, e as kërkesat e tjera të drejtuara nga sendi apo pasuria e kundërshtarit të sigurimit, por janë të drejtat e tjera, apo kur kërkohet ruajtja e gjendjes ekzistuese të rrethanave. Ajo që i dallon këto lloje të masave nga dy grupet e tjera të lartpërmendura, është se derisa dy llojet e para janë të numëruara në mënyrë taksative, lloji i tretë i masave për sigurimin e kërkesëpadsisë nuk është i përmbyllur në mënyrë taksative në nenin 301 të LPK-së, kështu që në këtë rast ekziston hapësirë për gjykatën që të caktoj edhe masa të tjera, nëse kjo e fundit e shih të nevojshme dhe të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadsisë së propozuesit të masës përkatëse të sigurimit.<sup>187</sup>

Po ashtu duhet të ceket se gjykata mundet që kur ka nevojë për një gjë të tillë, t'i caktoj dy apo më tepër masa të sigurimit.<sup>188</sup>

### 13.4 Pasojat e mosrespektimit të masave me të cilat sigurohet kërkesëpadsia

Kundërshtari i sigurimit i cili vepron në kundërshtim me aktvendimin për ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit me pasurinë, përgjigjet sipas rregullave të së drejtës civile.

Propozuesi i sigurimit ka të drejtë që sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore, t'i kompensohet dëmi që i është shkaktuar me mosrespektimin e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit.

Duke pasur parasysh natyrën e masave të sigurimit del se ato përgjithësisht detyrojnë kundërshtarin e sigurimit në ndërmarrjen e një veprimi të caktuar, apo në moskryerjen e një veprimi të caktuar në lidhje me sendin e caktuar.

Në rast të shkaktimit të dëmit për shkak të mos respektimit të masës së sigurimit, propozuesi i sigurimit ka të drejtë që në bazë të rregullave të parapara me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), të kërkojë kompensimin e dëmit të thjeshtë, si dhe kompensimin e fitimit të humbur. Në fakt kundërshtari i sigurimit fillimisht do të obligohet që ta rivendos gjendjen e mëparshme e cila ka ekzistuar para se të shkaktohet dëmi, e në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, atëherë për pjesën tjetër të dëmit mund të kërkohet një kompensim në të holla.

Kompensimi i tërësishëm në të holla do të vije në shprehje edhe në rastet kur nuk është e mundshme që të kthehet gjendja e mëparshme, apo kur gjykata konsideron se rikthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i domosdoshëm.<sup>189</sup>

Me dispozitat ligjore të LPK-së, është garantuar e drejta e kompensimit të dëmit edhe për kundërshtarin e masës së sigurimit për dëmin i cili i është shkaktuar atij si rezultat i zbatimit të masës së sigurimit e cila ka qenë e vendosur pa bazë, apo e cila ka qenë e pajustificuar. Edhe në këtë rast parashihet se

---

<sup>186</sup> Shih formularët praktik nr.4 dhe 7.

<sup>187</sup> Shih nenin 301 pika (d) të LPK-së.

<sup>188</sup> Shih nenin 303 të LPK-së

<sup>189</sup> Shih nenin 185 e tutje të LMD-së.

lidhur me kompensimin e dëmit do të aplikohen rregullat e përgjithshme të së drejtës pasurore, përkatësisht rregullat dhe dispozitat ligjore të parapara me LMD.

### **13.5 Mënyra e paraqitjes dhe përmbajtja e propozimit për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë**

Propozimi për caktimin e masës së sigurisë mund të paraqitet:

- a. në formë të shkruar, apo edhe
- b. në formë gojore në rast se procesi gjyqësor është në zhvillim e sipër.<sup>190</sup>

Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit, propozuesi i sigurimit duhet ta cek në të:

- a) kërkesën për sigurimin e të cilës bën propozim;
- b) masën e sigurimit që e propozon;
- c) mjetet dhe
- d) objektin e masës së sigurimit.

Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, e të cilat mjete, sipas mundësive propozuesi duhet t'ia bashkëngjisë propozimit për caktimin e masës së sigurisë.

#### **13.5.1 Njoftimi i kundërshtarit të propozimit në lidhje me masën e propozuar**

Përveç rasteve të përcaktuara me LPK, masa përkatëse e sigurimit nuk mund të caktohet po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësi që të deklarohet për propozimin për caktimin e saj.<sup>191</sup>

Propozimin për caktimin e masës së sigurisë, gjykata bashkë me shkresat që i janë bashkëngjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftimin se mund të paraqes përgjigjeje të shkruar brenda afatit 7 ditor.<sup>192</sup>

Mosdhënia e mundësisë që kundërshtari i sigurimit të deklarohet për propozimin për caktimin e masës së sigurimit mund të ndodh vetëm përjashtimisht për rastet të cilat vet ligji parasheh një mundësi të tillë. Rasti tillë mund të jetë për shembull kur propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar, duke paraqitur për këtë vendimin apo titullin juridik përkatës, si dhe duke prezantuar urgjencën e çështjes, e cila kërkohet lidhur me atë rast dhe se me veprimin ndryshe do të humbte qëllimi i sigurimit të kërkesëpadisë. Pra fjala është për të ashtuquajturën “masa e përkohshme e sigurimit”, e paraparë me nenin 306 të LPK. Por edhe në këto raste kundërshtarit të sigurimit nuk i humbet e drejta që ta kontestojë apo kundërshtojë masën (e përkohshme të sigurimit) të caktuar, sipas procedurës së paraparë për kundërshtimin e masës së përkohshme të sigurisë.

#### **13.5.2 Masat e përkohshme të sigurimit**

Në fakt, LPK nuk bën ndonjë dallim esencial në mes të masave të sigurimit dhe masave të përkohshme, por me dispozitat e nenit 306 të LPK-së parashihen vetëm rrethanat e caktuara të cilat mund ta determinojnë një të ashtuquajtur “masë të përkohshme” të sigurimit. Sipas këtij kuptimi, “masën e përkohshme” të sigurimit, e karakterizojnë tri elemente thelbësore:

---

<sup>190</sup> Shih nenin 304 të LPK-së.

<sup>191</sup> Shih nenin 305.1 të LPK-së.

<sup>192</sup> Shih nenin 305.2 të LPK-së.



- procedura e shpejtë
- rreziku i cili paraqitet dhe
- shkaqet mbi të cilat ajo vendoset<sup>193</sup>

Këto elemente bëjnë që kjo masë të dallohet nga masat e tjera siguroese.

- a. Procedura e shpejtë për vendosje lidhur me këtë masë nënkupton që gjykata mund të caktoj masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit.
- b. Rreziku për vendosjen lidhur me këtë masë nënkupton atë se në rast se nuk caktohet masa përkohshme e sigurimit, atëherë do të humbte qëllimi i saj.
- c. Ndërsa shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat vendoset masa e përkohshme e sigurimit nënkupton se ato duhet të jenë të besueshme dhe të bazuara.
- d. Përgjithësisht lidhur me masat e përkohshme të sigurimit mund të thuhet se ato mund të caktohen kur parashtruesi jep prova të besueshme se në rast se masa e përkohshme e sigurimit nuk caktohet, ai do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme.
- e. Pasi të merret vendimi nga ana e gjykatës për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe pasi që për të njëjtin vendim të njoftohet kundërshtari i sigurimit, atëherë ky i fundit mundet që brenda afatit 3 ditor në përgjigjen e tij, t'i kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit. Në qoftë se kundërshtari i sigurimit në këtë rast arsyeton kundërshtimet e tij, atëherë gjykata do të jetë e detyruar që brenda 3 ditëve të ardhshme, lidhur me këtë çështje të caktoj seancë. Në rast se pas mbajtjes së kësaj seance, gjykata gjen se kundërshtimet e kundërshtarit të sigurimit (të paditurit) janë të bazuara, atëherë ajo mundet që me aktvendim të veçantë të anulojë aktvendimin e mëhershëm për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ose që të njëjtin ta zëvendësoj me një aktvendim tjetër mbi caktimin e masës së sigurimit e në pajtim me nenin 307 të këtij ligji. Kundër këtij aktvendimi të ri për caktimin e masës së sigurimit, tani lejohet ankesa.
- f. Nga kjo del se edhe pse me rastin e caktimit të masës së përkohshme të sigurimit, kundërshtarit të sigurimit nuk i jepet mundësia që ai të deklarohej për të njëjtën, apo ta kundërshtoj atë, ai ka të drejtë që brenda afatit 3 ditor të shpreh qëndrimet e tij në lidhje me masën e caktuar përmes një përgjigjeje me shkrim.<sup>194</sup>

### 13.5.3 Përmbajtja e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit

Në aktvendimin mbi caktimin e masës së sigurimit, gjykata përcakton llojin e masës së sigurimit, mjetet me të cilat ajo do të realizohet dhunshëm dhe objektin e masës së sigurimit, duke i aplikuar përkatësisht rregullat e procedurës përbarimore.<sup>195</sup> Lloji i masës së sigurimit varet nga lloji i kërkesave për të cilat kërkohet siguri.

Gjykata sipas detyrës zyrtare ia dërgon një aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit gjykatës përbaruese kompetente me qëllim të ekzekutimit të tij të dhunshëm si dhe regjistrimit publik me qëllim të regjistrimit në të.

LPK-ja ka përcaktuar në mënyrë të veçantë masat e sigurimit për kërkesat me të holla, për ato të drejtuara ka sendi apo një pjesë e caktuar e sendit, si dhe llojet e masave të sigurimit për kërkesat lidhur me të drejtat e tjera.

Aktvendimi mbi caktimin e masës së sigurimit, po ashtu duhet të përcaktojë edhe mjetet me të cilat realizohet dhunshëm kërkesa e caktuar dhe objekti i masës së sigurimit.

---

<sup>193</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 540 e tutje.

<sup>194</sup> Shih nenin 306 të LPK-së, si dhe formularin praktik nr. 5 dhe 7.

<sup>195</sup> Shih formularët praktik nr. 4, 7 dhe 9.

Kur është fjala për mjetet me të cilat do të realizohet dhunshëm kërkesa e caktuar lidhur me objektin e masës së sigurimit, aplikohen përshtatshmërisht rregullat e procedurës përmbarimore të cilat parashohin edhe aplikimin e mjeteve dhe masave të dhunshme në rastet kur personat e obliguar sipas vendimeve të gjykatës refuzojnë të kryejnë veprimet e parapara me ato vendime. Po që se me qëllim të realizimit të urdhëresës apo ndalimit të caktuar duhet ndryshuar mjetet apo objektet e sigurimit, propozuesi i sigurimit mund të propozojë ndryshimin e tillë në të njëjtën procedurë dhe në bazë të urdhëresës apo ndalimit ekzistues.

Mjetet e dhunshme të parapara, do të mund të nënkuptoheshin si veprime të caktuara përmes “dhunës”, “forcës”, si dhe “gjobave”.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa e sigurimit, ka efekt të aktvendimit mbi përmbarimin nga Ligji për Procedurën Përmbarimore. Aktvendimi duhet ta ketë edhe pjesën e vet arsyetuese.<sup>196</sup>

Efektet e aktvendimit për caktimin e masës përkatëse për sigurim, nuk përfshijnë vetëm palët e përfshira në procedurë, por edhe palët e treta, të cilët mund të kenë ndërlidhje me palët e procesit apo të çështjes, me kusht që palët ndërgjyqëse apo edhe palët e treta, të jenë të njoftuara me përmbytjen e aktvendimit të tillë.

#### **13.5.4 Mundësia e caktimit të masës së sigurimit para se të jetë ngritur padia**

Me dispozitat ligjore të LPK-së, është e parapare mundësia që masa e sigurimit të caktohet edhe para se të jetë ngritur padia.<sup>197</sup> Një situatë e tillë mund të ndodhë sidomos në rastet kur kemi rrezik objektiv dhe serioz për pamundësinë e realizimit të kërkesëpadisë së paditësit. Por në këtë rast, duhet që me vendimin me të cilin caktohet masa e sigurimit, të caktohet edhe afati jo më i shkurtër se 30 ditë, brenda të cilit afat, propozuesi i sigurimit duhet të ngritë padinë. Në këto raste propozuesi i masës së sigurisë duhet që gjykatës t’ia paraqet provën nga e cila shihet se ka vepruar në pajtim me të lartcekurat.<sup>198</sup>

Megjithatë, LPK nuk e parasheh mundësinë e caktimit të masës së përkohshme të sigurisë, para se të jetë ngritur padia. Sipas dispozitave të neneve 296, 304 dhe 308 të LPK-së, parashihet mundësia e caktimit vetëm të masës së sigurisë, e jo edhe të masës së përkohshme të sigurimit. Kjo ngase në rast të ekzistimit të ndonjë propozimi për caktimin e masës së sigurisë para se të jetë ngritur padia, para se të vendos për të, gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore të palëve, në të cilën ata do t’i shprehin qëndrimet e tyre. E meqenëse në rastet e propozimit eventual për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, para se të jetë ngritur padia, gjykata do të duhej të vendos fare pa u dëgjuar palët dhe pa pasur asnjë provë – shpresë të lëndës, del se me LPK, në mënyrë të drejtë është rregulluar kjo çështje.

#### **13.5.5 Kohëzgjatja e masës së sigurimit**

Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës, mbetet në fuqi derisa gjykata të mos merr ndonjë vendim tjetër mbi masën e sigurimit. Në këtë rast kemi të bëjmë me vendim tjetër të gjykatës mbi masën e sigurisë, i cili e shfuqizon dhe rrjedhimisht e zëvendëson vendimin e mëparshëm mbi masën e sigurisë.

Edhe në rast të mos aprovimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet që me aktgjykimin përmes të cilit e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, të vendos që ta lejë në fuqi masën e caktuar të sigurimit, deri sa aktgjykimi i shkallës së parë të mos bëhet i formës së prerë.<sup>199</sup> Kjo për faktin se edhe përkundër aktgjykimit të dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, palëve u është garantuar e drejta e ankesës, brenda afatit ligjor 15 ditor nga dita e pranimit të tij, andaj rrjedhimisht kjo ndikon që aktgjykimi të mos e merr formën e prerë brenda këtij afati.

---

<sup>196</sup>Shih nenin 307.4 të LPK-së, si dhe formularët praktik nr.4, 7 dhe 9.

<sup>197</sup>Shih nenin 296, 304 dhe 308 të LPK-së.

<sup>198</sup>Shih nenin 308.2 të LPK-së

<sup>199</sup>Shih nenin 309 të LPK-së, si dhe formularin praktik nr.9.

Masa e caktuar e sigurimit mbetet në fuqi më së shumti deri në skadimin e afatit prej 30 ditëve pas krijimit të kushteve për përmbarim të dhunshëm.

### **13.5.6 Mjetet juridike kundër aktvendimit për caktimin e masës së sigurimit dhe aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit**

Kundër aktvendimit të shkallës së parë mbi caktimin e masës së sigurimit mund të paraqitet ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të tij. Gjithsesi ankesa duhet t'i dërgohet edhe kundërshtarit të sigurimit, i cili brenda afatit pre tri ditësh nga dorëzimi, ka të drejtë që të paraqes përgjigjen në ankesë. Mbi ankesën vendos gjykata e shkallës së dytë, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita në të cilën gjykatës së shkallës së dytë i arrin përgjigja në ankesë, apo skadimit të afatit për paraqitjen e saj. Po ashtu duhet të ceket se ankesa me këtë rast nuk e shtynë përmbarimin e aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë.<sup>200</sup>

Kundër aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurimit nuk është e lejuar ankesa.<sup>201</sup> Vlen të ceket se dispozita e nenit 310.5 të LPK-së, lë vend për interpretim të ndryshëm, ngase nëse ankesa në këtë rast nuk do të lejohej në asnjë mënyrë, mund të vij deri te cenimi i parimit të dëgjimit të palës dhe cenimi i parimit të kontradiktoritetit, ndërsa që gjithashtu mund të shkelet edhe neni 206.2 i LPK-së, i cili parasheh se po që se me ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedura në gjykatën e shkallës së parë.<sup>202</sup>

### **13.5.7 Autorizimet e gjykatës në lidhje me sendet e siguruar**

Gjykata ka tagër që me propozimin e kundërshtarit të propozuesit në rastet kur janë caktuar masat e përcaktuara me nenin 299 paragrafi 1 pika a dhe b, të vendos që të shiten sendet e luajtshme që prishen shpejt apo nëse ekziston rreziku nga rënia e dukshme e çmimit të sendeve të këtilla e . Shitja e sendeve të këtilla bëhet sipas rregullave për ekzekutimin e sendeve të luajtshme.<sup>203</sup> Në bazë të dispozitave të LPP, parashihet që shitja e sendeve të luajtshme të bëhet përmes ankandit publik.

Po ashtu në rastet kur është caktuar masa e sigurimit “ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që të kryejë veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë kah e cila është drejtuar kërkesa apo urdhri i kundërshtarit të sigurimit që t'i kryej veprimet e caktuara të nevojshme për tu ruajtur pasuria apo për tu ruajtur gjendja ekzistuese e rrethanave”, gjykata mundet që me propozimin e palës propozuese të masës, apo kundërshtarit të tij, të vendos që propozuesit të masës së sigurisë, t'i kalojë e drejta e realizimit të kërkesës, po që se ekziston rreziku i mos realizimit të saj, për shkak të vonimit në realizimin e saj, apo rreziku i humbjes së të drejtës së regresit ndaj personit të tretë.

### **13.5.8 Autorizimet e palëve ndërgjyqëse në lidhje me masat e propozuara**

Propozuesi i sigurimit në propozimin e tij për caktimin e masës së sigurimit, ose me vonë, mundet të deklarojë se pajtohet që në vend se të caktohet masa e sigurimit, ai do të ishte i kënaqur me dhënien e pengut nga ana e kundërshtarit të tij. Në fakt dhënia e pengut në vend të masës së sigurimit mund të caktohet edhe me propozimin e kundërshtarit të sigurimit po që se me këtë pajtohet propozuesi i sigurimit.<sup>204</sup> Kjo situatë në një farë mënyrë paraqet një situatë negociuese apo disponibile ku vetë palët mund të propozojnë dhe të pajtohen me zëvendësimin e masës së sigurimit dhe me krijimin e pengut. Duhet cekur se themelimi i të drejtës së pengut i paraparë kësisoj, nuk paraqet ndonjëherë prej llojeve të masave siguroese të parapara me nenet 299, 300 dhe 301 të LPK-së dhe se kjo nuk duhet të ngatërrohet me masën e sigurimit lidhur me parashënimin e të drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm të

---

<sup>200</sup> Shih nenin 310 të LPK-së.

<sup>201</sup> Shih formularët praktik nr.5, 6 dhe 8.

<sup>202</sup> Shih nenin 206 të LPK-së.

<sup>203</sup> Shih nenin 311 të LPK-së.

<sup>204</sup> Shih nenin 312 të LPK-së.

kundërshtarit të sigurimit, apo mbi të drejtën e regjistruar në sendin e paluajtshtëm, siç parashihet me nenin 299 par.1 pika (d).

### 13.5.9 Autorizimet e gjykatës në lidhje me procedurën dhe aktvendimin e nxjerrë

Kërkesa e nenit 313.1 ka të bëjë me pagesën e shpenzimeve nga ana e propozuesit të sigurimit. Andaj në rast se propozuesi i sigurimit nuk paraqet prova lidhur me pagesën e shpenzimeve paraprakisht, të shkaktuara gjatë procedurës sigurose, atëherë gjykata e përfundon procedurën dhe i anulon pra veprimet e kryera që lidhen me këtë procedurë. Për këtë çështje gjykata duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata mundet që me propozim të kundërshtarit të sigurimit, ta përfundoj procedurën e filluar dhe t'i anuloj veprimet e kryera, po që se rrethanat për shkak të të cilave është caktuar masa përkatëse e sigurimit, kanë ndryshuar esencialisht më vonë duke e bërë të panevojshme atë masë.<sup>205</sup> Gjykata sipas propozimit të kundërshtarit të sigurimit e përfundon procedurën dhe i anulon veprimet e kryera edhe po që se:

- Kundërshtari i sigurimit e deponon në gjykatë shumën e detyruar të kërkesës që sigurohet me kamata dhe shpenzime;
- Kundërshtari i sigurimit e bën të besueshëm pretendimin se kërkesa në momentin e dhënies së aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit është realizuar apo se ka qenë mjaftueshëm e siguruar;
- Me vendim të formës së prerë është vërtetuar se kërkesa nuk është krijuar, apo se e njëjta është shuar;

### 13.5.10 Shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës për sigurimin e kërkesëpadisë

Shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës për caktimin e masës së sigurimit i bartë paraprakisht propozuesi i sigurimit. Në rast se propozimi për caktimin e masës së sigurimit paraqitet gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore apo të ndonjë procedure tjetër gjyqësore, gjykata kompetente për vendosje mbi kërkesëpadinë, apo mbi kërkesën tjetër, do të vendosë se kush i bartë shpenzimet e caktimit dhe të zbatimit të masës së sigurisë.

### 13.5.11 Pasojat e mosrespektimit të masës për sigurimin e kërkesëpadisë

Propozuesi i sigurimit ka të drejtë që sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore, të kërkojë që t'i kompensohet dëmi që i është shkaktuar për shkak të mosrespektimit të aktvendimit mbi masën sigurose të caktuar.<sup>206</sup> Pra, pasojat e mosrespektimit të masës me të cilën është siguruar kërkesëpadia, janë të natyrës civile, e jo penale.

Bazuar në natyrën e masave përmes të cilave sigurohet kërkesëpadia, del se në përgjithësi ato e detyrojnë kundërshtarin e masës në ndërmarrjen e ndonjë veprimi të caktuar, pra në veprim, apo në moskryerjen e ndonjë veprimi të caktuar, që d.m.th. edhe në mosveprim. Edhe pse në këtë rast fjala është për një dëm paksa më specifik, për shkak se ky dëm është shkaktuar si pasojë e mosrespektimit të masës përkatëse, prapë se prapë edhe në këtë rast do të vlejnjë rregullat e përgjithshme të së drejtës pasurore, përkatësisht ato të së drejtës civile. Në fakt për këto raste zbatohen rregullat apo dispozitat ligjore civile të cilat rregullojnë institutin e dëmit, i cili institut rregullohet me dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). E sipas këtyre dispozitave parashihet se në rast të shkaktimit të dëmit, propozuesi i sigurimit ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë, e gjithashtu edhe për kompensimin e fitimit të humbur.

---

<sup>205</sup> Shin nenin 313 të LPK-së.

<sup>206</sup> Shih nenin 315 të LPK-së.

Normalisht që së pari kundërshtari i sigurimit do të detyrohet që të rivendos gjendjen e mëparshme që ka ekzistuar para se të shkaktohet dëmi, e në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, atëherë për pjesën tjetër të dëmit mund të kërkohet të jepet shuma e caktuar e kompensimit në të holla.

Kompensimi në të holla ndodh edhe në rastet kur gjykata konstaton se nuk ka mundësi që të kthehet gjendja e mëparshme, apo kur gjykata konstaton se rikthimi i kësaj gjendje nuk është i domosdoshëm. Vlen të ceket se shuma e dëmit të thjesht që kërkohet, caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, me përjashtim të rasteve kur ligji parasheh diçka tjetër.

Në anën tjetër edhe kundërshtari i sigurimit ka të drejtë që sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore, të kërkojë nga propozuesi i sigurimit që t'i kompensoj dëmin e shkaktuar nga masa e caktuar e sigurimit të kërkesëpadisë, e për të cilën masë është vërtetuar se ka qenë e pa bazë apo të cilën masë nuk e ka justifikuar propozuesi i sigurimit.<sup>207</sup> Pra derisa më sipër bëhej fjalë për të drejtën e kompensimit të dëmit propozuesit të sigurimit për shkak të mos respektimit të masës nga ana e kundërshtarit të sigurimit, tani fjala është për dëmin i cili i është shkaktuar kundërshtarit të sigurimit përmes zbatimit të masës përkatëse për sigurimin e kërkesëpadisë, e cila ka qenë e masë e pa bazë dhe e pajustificuar. Edhe në këtë rast zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës civile, përkatësisht rregullat dhe dispozitat e LMD-së.

### 13.6 Kush i ekzekuton masat e sigurimit?

Masat e sigurimit të kërkesëpadisë i zbaton gjykata që do të ishte kompetente për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.<sup>208</sup>

Në këtë rast duhet të qartësohet se nuk është fjala për ndonjë gjykatë të veçantë, por për llojin e veçantë të procedurës, respektivisht atë të procedurës përbarimore.

Pra zbatimi i masës së sigurimit bëhet nga gjykata themelore, respektivisht gjykatësi i procedurës përbarimore pranë kësaj gjykate.

---

<sup>207</sup> Shih nenin 316 të LPK-së.

<sup>208</sup> Shih nenin 318 të LPK-së

# **FORMULARËT PRAKTIKË**

### 13.7 Formularët praktikë lidhur me kërkesëpadinë

#### **Formulari 1 - Aktvendim mbi detyrimin e paditësit për deponimin e garancionit për masën e propozuar të sigurisë**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësve \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, që të dy nga Prizreni, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ etj., që të gjithë nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, si dhe të paditurit \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, duke vendosur në lidhje me kundërshtimin e të autorizuarve të të paditurve për caktimin e masës së përkohshme, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

I. DETYROHEN paditësit \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ që në emër të garancionit për masën e propozuar të sigurisë, brenda afatit prej 3 ditësh, në mënyrë solidare t'i deponojnë pranë arkës së kësaj gjykate, përkatësisht në xhironlogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për depozita civile, shumën në lartësi prej 5000 (pesë mijë) euro.

II. Në rast se paditësit brenda afatit të lartcekur, nuk e deponojnë shumën e lartcekur, gjykata do ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së sigurisë, si dhe do ta shfuqizoj aktvendimin e kësaj gjykate C.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, me të cilin është caktuar masa e përkohshme në këtë çështje kontestimore.

#### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, që të dy nga Prizreni, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë kundër të paditurve \_\_\_\_\_ etj., që të gjithë nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, si dhe të paditurit \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, mes tjerash me propozim për caktimin e masës së përkohshme.

Me aktvendimin C.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, kjo gjykatë e ka caktuar masën e përkohshme dhe e ka ndaluar çfarëdo forme të tjetërsimit apo shfrytëzimit të ngastrave kadastrale kontestuese, më saktësisht sikurse në këtë aktvendim. Kundër këtij aktvendimi, i autorizuari i të paditurve av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, ka parashtruar ankesë, e cila nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, është konsideruar si kundërshtim, me ç'rast për vendosje në lidhje me kundërshtimin, lënda i është kthyer kësaj gjykate.

Duke vepruar sipas kundërshtimit të të autorizuarit të të paditurve kundër aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme C.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, kjo gjykatë ka caktuar seancë shqyrtuese, në të cilën kanë prezantuar, të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, paditësit, si dhe të paditurit \_\_\_\_\_ si dhe \_\_\_\_\_.

Në këtë seancë, i autorizuari i paditësve av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni ka deklaruar se konsideron se masa e përkohshme e aprovuar nga kjo gjykatë është ligjërishit e qëndrueshme, për shkak se paditësit tanimë kanë paguar mbi gjysmën e çmimit kontraktues për ngastrat kadastrale kontestuese. Sipas tij ekziston rreziku potencial që të paditurit t'i tjetërsojnë këto ngastra andaj paraqitet nevoja që tani gjykata të caktoj masën siguroese për sigurimin e këtyre ngastrave. I njëjti gjithashtu ka shprehur gatishmërinë për depozitimin e deponimit përkatës në emër të garancisë për masën e sigurisë në shumën dhe kohën të cilën do t'i obligonte gjykata.

Në këtë seancë i autorizuari i të paditurve, av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni ka deklaruar se mbetet në tërësi sikurse në pretendimet e deritanishme, në përgjigjen në padi, në ankesën kundër aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme, si dhe pranë theksimeve të cekura në përgjigjen e të paditurit \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_. Gjykatës i ka propozuar që pas shqyrtimit të të gjitha provave shkresore, ta shfuqizojë aktvendimin për caktimin e masës së përkohshme C.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_ dhe që njëkohësisht të bjerë vendim me të cilin do ta refuzojë caktimin e tani masës së sigurisë.

I padituri prezent \_\_\_\_\_ personalisht në këtë seancë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve të të autorizuarit të të paditurve të tjerë av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, duke e kundërshtuar propozimin e paditësve për caktimin e masës së sigurisë.

Në bazë të nenit 297.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “po qëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata për dëmin që mund t’i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit”.

Mbi bazën e të lartcekurave e duke marrë parasysh faktin se edhe vetë i autorizuari i paditësve në seancën e mbajtur para kësaj gjykate lidhur me procedurën e kundërshtimit të aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme, ka deklaruar se është i pajtimit që në emër të garancisë për caktimin e masës së sigurisë, të deponojnë shumën e caktuar në kohën e caktuar nga gjykata, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 297.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm C.nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



## Formulari 2 - Aktvendim mbi refuzimin e masës së sigurisë për shkak të mos pagesës së garancionit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prishtinës, tani me vendqëndrim në Kragujevac - Republika e Serbisë rr. "Nikolla Pashiq" nr. \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prishtinës dhe \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prishtinës, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, për shkak të anulimit të kontratës mbi shitblerjen, duke vendosur në lidhje me propozimin e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, me datën 28.12.2013, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET propozimi i paditësit \_\_\_\_\_, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, përmes të cilit ka kërkuar që t'i ndalohej të paditurve \_\_\_\_\_ që edhe më tutje të disponojnë me parcelat kadastrale kontestuese nr.1175-1, 1175-2 dhe 1177-2, deri në përfundimin e plotfuqishëm të këtij kontesti, nën kërcënim të pasojave ligjore".

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prishtinës, tani me vendqëndrim në Kragujevac - Republika e Serbisë rr. "Nikolla Pashiq" nr. \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prishtinës dhe \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Prishtinës, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, për shkak të anulimit të kontratës mbi shitblerjen, mes tjerash, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse, kjo gjykatë, me datën 15.12.2011, e ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën seancë me aktvendim është obliguar paditësi që brenda afatit 5 ditor, në emër të garancionit për masën e përkohshme të sigurisë të cilën mund ta caktojë gjykata, t'i deponoj në llogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shumën në lartësi prej 2000 eurove, me vërejtjen se në rast se paditësi brenda këtij afati nuk e paguan garancionin në shumën e lartcekur, respektivisht nuk ia prezanton gjykatës faturën mbi deponimin e këtyre mjeteve në llogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata do ta refuzojë propozimin për caktimin e kësaj mase.

Nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi ka kaluar afati kohor brenda të cilit paditësi ka qenë i obliguar të veprojë, ndërsa që në shkresat e kësaj lënde nuk ekzistojnë provat që i njëjti të ketë vepruar konform këtij vendimi, respektivisht nuk ekzistojnë prova se ai e ka deponuar garancionin e caktuar në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 297.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari;

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

### **Formulari 3 -Aktvendim mbi refuzimin e caktimit të masës së sigurisë, si dhe anulimin e aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, për shkak të mos pagesës së garancionit**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_ me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson e autorizuar e tij av. \_\_\_\_\_ nga Suhareka, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ Komuna e Suharekës, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të anulimit të kontratës mbi shitblerjen, duke vendosur në lidhje me propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurisë, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET propozimi i paditësit \_\_\_\_\_, për caktimin e masës së sigurisë, përmes të cilit ka kërkuar që t'i ndalohet të paditurës \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Suharekës që ta shes, ndërroj apo bartë në emër të dikujt tjetër banesën e cila gjendet në Suharekë rr. "Brigada 155" banesa IV – 18".

II. Anullohet aktvendimi i kësaj gjykate për caktimin e masës së përkohshme C.nr. \_\_\_\_\_, i datës \_\_\_\_\_.

III. Procedura në këtë çështje juridiko-kontestimore do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

#### **A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Suhareka rr. " \_\_\_\_\_", banesa \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson e autorizuar av. \_\_\_\_\_ nga Suhareka, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Suharekës, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të anulimit të kontratës mbi shitblerjen, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, është caktuar masa e përkohshme e sigurisë dhe i është ndaluar të paditurës që banesën kontestuese ta shes, ndërrojë apo bartë në emër të dikujt tjetër, më gjerësisht sikurse në këtë aktvendim.

Kundër këtij aktvendimi, i autorizuari i të paditurës av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, brenda afatit ligjor, ka parashtruar kundërshtim.

Duke vepruar sipas kundërshtimit të të autorizuarit të së paditurës, gjykata me datën 24.07.2014, ka caktuar seancën përgatitore për dëgjimin e palëve ndërgjyqëse. Në këtë seancë e autorizuar e paditësit av. \_\_\_\_\_ nga Suhareka, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kundërshtimin e të autorizuarit të të paditurës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, duke i propozuar gjykatës që në tërësi ta aprovojë kërkesën për caktimin e tani masës së sigurisë. Po ashtu në këtë seancë i autorizuari i të paditurës av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kundërshtimit të bërë me shkrim dhe se i propozon gjykatës që propozimin për caktimin e tani masës së sigurisë, ta refuzoj si të pabazuar.

Në këtë seancë, e autorizuar e paditësit av. \_\_\_\_\_ nga Suhareka, konform nenit 297 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me aktvendim është obliguar që brenda afatit 3 ditor, në emër të garancionit për masën e përkohshme të sigurisë të cilën do të mund ta caktojë gjykata, t'i deponoj në llogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shumën në lartësi prej 4000 eurove, me vërejtjen se në rast se brenda këtij afati nuk paguhet garancioni në shumën e lartcekur, respektivisht në rast se

nuk i prezantohet gjykatës fatura mbi deponimin e këtyre mjeteve në llogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata do ta refuzojë propozimin për caktimin e kësaj mase.

Nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi ka kaluar afati kohor brenda të cilit paditësi, përkatësisht e autorizuar e tij, ka qenë e obliguar të veprojë, ndërsa që në shkresat e kësaj lënde nuk ekzistojnë provat që të jetë vepruar konform këtij vendimi, respektivisht nuk ekzistojnë prova se ai, përkatësisht e autorizuar e tij ta ketë deponuar shumën e garancionit të kërkuar në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 297.3 dhe 306 par.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 4 - Aktvendim mbi caktimin e masës së sigurisë

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, me bashkëpunëtorin profesional \_\_\_\_\_, në çështjen juridike të paditësve \_\_\_\_\_, nga Prizreni, rr."Xhevat Berisha", nr.\_\_\_\_dhe \_\_\_\_\_, nga Prizreni, rr."Xhevat Berisha", nr.\_\_\_\_, të cilët me autorizim i përfaqëson av. \_\_\_\_\_, nga Prizreni, kundër të paditurve \_\_\_\_\_, të gjithë nga fshati \_\_\_\_\_, Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. \_\_\_\_\_, nga Prizreni, \_\_\_\_\_, nga fshati \_\_\_\_\_, Komuna e Prizrenit dhe \_\_\_\_\_, nga fshati \_\_\_\_\_ Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm i tij av. \_\_\_\_\_, nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 5.000 euro, duke vendosur sipas propozimit të palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

I. CAKTOHET MASA E SIGURIMIT dhe i URDHËROHET të paditurve \_\_\_\_\_, të gjithë nga fshati \_\_\_\_\_, Komuna e Prizrenit, që të mos ndërtojnë asgjë në ngastrat kontestuese, të mos i shesin dhe në atë drejtim të mos e kontraktjnë dhe vërtetojnë kontratën për shitblerjen e patundshmërive tek Noteri kompetent në Prizren dhe më gjerë për njësit kadastrale nr. P-71813068-05186-1, vendi i quajtur Kamenica, klasë kullosë e klasës së 2, sipërfaqe 2448m<sup>2</sup> kulturë kullosë, numri i lëndës 6511/12, Zona kadastrale Prizren dhe P-71813068-05187-0, vendi i quajtur Kamenica, kulturë minierë, sipërfaqe 4762m<sup>2</sup>, numri i lëndës 6509/12, Zona Kadastrale Prizren, të tëra këto deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate.

II. DETYROHEN Zyra Kadastrale në Komunën e Prizrenit dhe Noterët e Regjionit të Prizrenit, që ndalimin nga paragrafi I të dispozitivit të këtij aktvendimi, ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_, nga Prizreni, rr."Xhevat Berisha", nr.\_\_\_\_dhe \_\_\_\_\_, nga Prizreni, rr."Xhevat Berisha", nr.203, të cilët me autorizim i përfaqëson av. \_\_\_\_\_, nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre, pranë Gjykatës Themelore në Prizren, kanë parashtruar padi kundër të paditurve \_\_\_\_\_, të gjithë nga fshati Gërnqar, Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në paluajtshmëri në bazë të kontratës interne për shitblerje, vlera e kontestit 5.000 euro, mes tjerash me propozim për caktimin e masës së përkohshme, duke theksuar se janë plotësuar kushtet për caktimin e të njëjtës.

Gjykata me Aktvendimin C.nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, e ka aprovuar propozimin e palës paditëse dhe e ka caktuar masën e përkohshme. Kundër të njëjtit aktvendim me datën 12.07.2013 ka ushtruar ankesë i autorizuari i të paditurve av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, me arsye të paraqitura më afër si në ankesë.

Gjykata e Apelit me shkresën AC.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, shkresat e lëndës ia ka kthyer Gjykatës Themelore në Prizren me ç'rast ankesën e ushtruar nga i autorizuari i të paditurve e ka konsideruar si kundërshtim dhe se për këtë kundërshtim duhet të vendos Gjykata e cila ka vendosur për masën e përkohshme.

Lidhur me këtë ankesë (kundërshtim) gjykata ka caktuar seancën përgatitore e cila është mbajtur me datën 10.12.2013.

Në këtë seancë, i autorizuari i paditësve av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, ka deklaruar se konsideron se masa e propozuar dhe e aprovuar nga kjo gjykatë ligjrisht është e qëndrueshme nga se si arsye kryesore e cila e konfirmon këtë është se paditësit e kanë paguar mbi gjysmën e më tepër të çmimit kontraktues në bazë të kontratave interne të bashkangjitura bashkë me padinë si provë për administrim

për këtë çështje kontestimore. Po ashtu ekziston rreziku pretendues i të paditurve që t'i mohojnë veprimet e kontraktuara në bazë të kontratave interne për shitblerje si dhe pagimin e çmimit kontraktues me qëllim që këto dy paluajtshmëri t'i shesin – ta kontraktojnë kontratën tek noteri përkatës i Komunës së Prizrenit dhe në atë drejtim kjo paluajtshmëri të huajësohet dhe pronarët faktik të eliminohen nga mbajtja e mëtejme faktike dhe pronësimi ligjor në paluajtshmërinë kontestuese. Po ashtu ka theksuar se mbi bazën e të lartcekurave konsiderojmë se masa është e domosdoshme si dhe pajtohemi që gjykata po ashtu ta merr masën e sigurisë për këtë çështje të këtyre patundshmërive kontestuese dhe në atë drejtim pajtohemi të deponojmë depozitën përkatës në shumën dhe kohën të cilën na obligon gjykatësi. Për fund thekson se në posedim të këtyre ngastrave kadastrale kontestuese paditësit janë në posedim që pothuajse 10 vite.

I autorizuari i të paditurve në shqyrtimin përgatitor njëherit përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit \_\_\_\_\_ av. \_\_\_\_\_, nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në pretendimet e deritanishme si në përgjigje në padi po ashtu mbetet në të gjitha pretendimet e cekura në ankesë ndaj aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme për mos tjetërsimin e patundshmërive kontestuese dhe në fund mbetemi në tërësi pran të gjitha pretendimeve që janë cekur në parashtresën e të paditurit \_\_\_\_\_ të datës 21.11.2013. Ka propozuar që gjykata mbas shqyrtimit të të gjitha këtyre provave ta shfuqizojë aktvendimin për caktimin e masës së përkohshme C.nr. \_\_\_\_\_, të dt. \_\_\_\_\_ dhe njëkohësisht të bie vendim me të cilin do ta refuzojë caktimin e masës së sigurisë.

I padituri \_\_\_\_\_ në seancën përgatitore personalisht ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve të lartcekura të dhëna nga i autorizuari i të paditurve tjerë av. \_\_\_\_\_, nga Prizreni. Përndryshe e kundërshton propozimin e këtu paditësve për caktimin e tani masës së sigurisë.

Gjykata me Aktvendimin C.nr. \_\_\_\_\_ të dt. \_\_\_\_\_, e ka obliguar palën paditëse që në emër të garancionit për masën e propozuar të sigurisë, brenda afatit prej 3 ditësh, në mënyrë solidare t'i deponojë pranë arkës së kësaj gjykate, përkatësisht në xhirollogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për depozita civile, shumën në lartësi prej 5.000 euro. Paditësit brenda afatit të përcaktuar e kanë bërë pagesën e shumës së caktuar nga gjykata dhe i'a kanë dorëzuar gjykatës urdhërpagesën.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin për masën e sigurisë si dhe deklarimet e palëve ndërgjyqëse lidhur me caktimin e tani masës së sigurimit në seancën përgatitore të mbajtur me datës 10.12.2013 dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, është i bazuar.

Me nenin 297 të LPK-së, është paraparë se “Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, “Propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit”.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i paditësve për caktimin e masës së sigurimit është i bazuar nga fakti se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës nga palët, i paraparë me nenin 297.1 pika b), ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar pala paditëse do të pësojë dëm të riparueshëm. Duke u nisur nga propozimi i palës paditëse me të cilin kanë kërkuar që të t'i ndalohet të paditurve që të mos ndërtojnë asgjë në ngastrat kontestuese, të mos i shesin dhe në atë drejtim të mos e kontraktojnë dhe vërtetojnë kontratën për shitblerjen e patundshmërive tek Noteri kompetent në Prizren dhe më gjerë për njësit kadastrale nr. P-71813068-05186-1, vendi i quajtur Kamenica, klasë kullosë e klasës së 2, sipërfaqe 2448m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë,

numri i lëndës 6511/12, Zona Kadastrale Prizren dhe P-71813068-05187-0, vendi i quajtur Kamenica, kulturë minierë, sipërfaqe 4762m<sup>2</sup>, numri i lëndës 6509/12, Zona kadastrale Prizren, të tëra këto deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore pranë Gjykatës Themelore në Prizren, rrjedh fakti se nga ky propozim dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se ka rrezik se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtare do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e aprovoi propozimin e palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) e LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 297, nenin 306 par.3 lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese  
në afat prej 7 dite pas ditës së pranimi të njëjtit,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

- Të përkthehet në gjuhën boshnjake;
- T'iu ekspedohet palëve, përkatësisht të autorizuarve
- Drejtorisë së Gjeodezisë dhe të Kadastrës;
- Noterëve të regjionit

## Formulari 5 - Aktvendim mbi refuzimin e masës së përkohshme të sigurimit

C. nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_ me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësve \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ që të dy nga Peja rr. "Saraqët", kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Peja, DPH "\_\_\_\_\_" rr. "Saraqët", për shkak të pengim posedimit, vlera e kontestit 100 Euro, duke vendosur sipas propozimit të paditësve për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me datën \_\_\_\_\_ mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET propozimi i paditësve \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ që të dy nga Peja rr."Saraqët", për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, përmes të cilit kanë kërkuar që të "urdhërohet i padituri \_\_\_\_\_ nga Peja, që ta bënë kthimin në gjendje të mëparshme të pjesës së patundshmërisë, lokalit afarist e cila gjendet në Pejë në rr."Saraqëve" e evidentuar si parcelë kadastrale me nr. të njësisë P-71813068-01972-0, sipas çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.18-2741- ZK Pejë, duke u bazuar në kontratën mbi dhënien me qira të lokalit afarist, të largohet nga paluajtshmëria dhe të lirojë hapësirat e uzurpuara të paluajtshmërisë së paditësve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe përgjegjësisë penale të paditurit", si tërësisht i pabazuar.

### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ që të dy nga Peja rr. "Saraqët", pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Peja, DPH "\_\_\_\_\_" rr.Saraqëve, për shkak të pengim posedimit, mes tjerash, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Duke vendosur sipas këtij propozimi gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor në lidhje me propozimin e palëve paditëse për caktimin e masës së përkohshme, e cila seancë është mbajtur me datën 13.02.2013. Në këtë seancë kanë prezantuar paditësit si dhe i padituri. Gjatë kësaj seance, paditësit kanë deklaruar se mbeten pranë theksimeve të dhëna pranë padisë duke precizuar kërkesëpadinë si në vijim: "aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësve \_\_\_\_\_ që të dy nga Peja, vërtetohet se i padituri \_\_\_\_\_ nga Peja i ka penguar paditësit në posedimin e lirë dhe të fundit faktik të objektit familjar në Pejë rr."Saraqëve" e evidentuar si parcelë kadastrale me nr. të njësisë P-71813068-01972-0 sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.18-2741- ZK Pejë , në mënyrë që pas skadimit të kontratës mbi qiranë e lokalit afarist me rastin e shpërnguljes nga lokali me datën 02.01.2013 e ka hekur njehsorin elektrik nga lokali i cili evidentohet në emër të paditësve dhe e ka bartur në tendën ku e ka vazhduar veprimtarinë e vet afariste si dhe ka ndërprerë furnizim me ujë të lokaleve dhe detyrohet i padituri \_\_\_\_\_ që menjëherë ta kthejë njehsorin e rrymës, të kyç ujësjellësin në mënyrë që të bëhet furnizimi i rregullt i lokaleve me ujë, ta heqë tendën e cila është pengesë e lokalit dhe tani e tutje të mos i pengojë paditësit në çfarëdo mënyre të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi në kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm", me ç' rast ka propozuar që gjykata të merr së pari aktvendim lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme, e pastaj ta caktojë shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike.

I padituri e ka kundërshtuar në tërësi propozimin e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Pas analizimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palëve paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, është i pa bazuar.

Me nenin 297 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), është e paraparë se "Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, apo në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e

pasurisë së vetë, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Me nenin 300 të LPK-së, është e paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë të tij, mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se mes tjerash, “propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe propozohen mjete provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Duke vendosur sipas propozimit të palëve paditëse, të datës 22.01.2013, gjykata të njëjtin propozim e ka refuzuar, ngase duke marrë parasysh formulimin e kërkesës në lidhje me caktimin e masës së përkohshme (aludohet në masën e sigurisë), del se i njëjti propozim është identik me formulimin të cilin e përmban kërkesëpadia. Gjykata vlerëson se me aprovimin eventual të propozimit për caktimin e masës së përkohshme të propozuar, do të zgjidhej edhe çështja kryesore e kësaj padie, respektivisht kërkesëpadia, andaj për këtë shkak, masa e propozuar është refuzuar si e pabazuar, ngase me masë të përkohshme nuk mund të zgjidhet çështja kryesore, por me të vetëm sigurohet kërkesëpadia.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzojë propozimin e paditësve për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, duke gjetur se në rastin konkret i njëjti nuk është formuluar në mënyrën e duhur.

Nga se u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 387.1 pika (1), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.



## **Formulari 6 - Aktvendim mbi refuzimin e masës së përkohshme të sigurisë e cila ka të bëjë me ruajtjen e pasurisë apo ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me bashkëpunëtorin profesional \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjakova, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Gjakova, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ të gjithë nga fshati Demjan komuna e Gjakovës, me objekt të padisë pengim posedimi, duke vendosur sipas propozimit të paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET si i pabazuar propozimi i paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjakova, për caktimin e masës përkohshme të sigurimit, me të cilin ka kërkuar që “të urdhërohen të paditurit, që menjëherë të ndërprejnë prerjen e druve në pronën e paditësit, si dhe të mos ndërmarrin asnjë veprim tjetër të pengim posedimit dhe të lejojnë që paditësi të posedojë, shfrytëzojë dhe disponoj paluajtshmërinë – ngastrën kadastrale nr.\_\_\_\_, në sipërfaqe prej 8532m<sup>2</sup> sipas fletëposedimit nr.310, Zona Kadastrale Demjan, në mënyrë plotësisht të lirë”.

II. Procedura në këtë çështje juridike-kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Gjakova, me datë 31.10.2014, ka parashtruar padi në gjykatë, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ të gjithë nga fshati Demjan komuna e Gjakovës, me objekt të padisë pengim posedimi, me propozim që gjykata të caktojë masën e përkohshme të sigurisë, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin për masën e përkohshme të sigurimit dhe pas analizimit të provës materiale e cila gjendet në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme, është i pa bazuar.

Me nenin 297 të LPK-së, në mënyrë decitive ceket se “Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, “propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartpërmendura, erdhi në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës është i pabazuar. Kjo për arsye se duke u nisur nga propozimi i palës paditëse me të cilin ka kërkuar që “të urdhërohen të paditurit, që menjëherë të ndërprejnë prerjen e druve në pronën e paditësit, si dhe të mos ndërmarrin asnjë veprim tjetër të pengim posedimit dhe të lejojnë që paditësi të posedojë, shfrytëzojë dhe disponoj paluajtshmërinë – ngastrën kadastrale nr.436, në sipërfaqe prej 8532m<sup>2</sup> sipas fletëposedimit nr.310, Zona Kadastrale Demjan, në mënyrë plotësisht të lirë”, del se ky propozim është identik me petitumin e kërkesëpadisë (çështjen kryesore), për çka edhe gjykata vlerëson se caktimi i masës së përkohshme të

sigurimit të kërkuar në këtë fazë të procedurës do të thoshte edhe përfundimin e çështjes kryesore, e cila në këtë rast nuk do të kishte më objekt lëndor. Me dispozitat ligjore të LPK-së, është paraparë se me masë të përkohshme të sigurisë nuk mund të zgjidhet çështja kryesore, por me të vetëm sigurohet kërkesëpadia.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzoi propozimin e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, pasi vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) e LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 387.1 pika (l), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**  
kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 310.5 të LPK-së,  
nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 7 - Aktvendim mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurimit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga Prizreni, lagja Arbana, rr. "Çesk Zadeja", nr. \_\_\_\_\_, të cilën me autorizim e përfaqëson av. \_\_\_\_\_, nga Prishtina, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga Prizreni, lagja Arbana, rruga "Çesk Zadeja", nr. \_\_\_\_\_, dhe \_\_\_\_\_ Sh.A, me seli në Prishtinë rr. "Migjeni", nr. \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson drejtori i përgjithshëm \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të marrëveshjes hipotekare, vlera e kontestit 3.500 euro, duke vendosur sipas propozimit të palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar propozimi i paditëses \_\_\_\_\_ nga Prizreni, CAKTOHET MASA E PËRKOHSHME E SIGURIMIT dhe i NDALOHET kundërshtarit të sigurimit \_\_\_\_\_ Sh.A-Prishtinë, që të realizojë të drejtën e kreditorit hipotekar që të shes paluajtshmërinë e regjistruar si ngastër kadastrale P-71813023-00422-3, parcela e cila gjendet në vendin e quajtur Vishe Sela-Od Druma/Vishe, në sipërfaqe prej 416 m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, arë e klasit 3, Zona Kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, krejt kjo e regjistruar në Çertifikatën – 18-16399 të datës 17.01.2014.

DETYROHEN Zyra Kadastrale në Komunën e Prizrenit dhe Shërbimi Noterial në Prizren, që ndalimin nga paragrafi I të këtij dispozitivi ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

### A r s y e t i m

Paditësja \_\_\_\_\_ nga Prizreni, lagja Arbana, rr. "Çesk Zadeja", nr. \_\_\_\_\_, të cilën me autorizim e përfaqëson av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, pranë Gjykatës Themelore në Prizren, ka parashtruar padi kundër të paditurve \_\_\_\_\_ nga Prizreni, lagja Arbana, rruga "Çesk Zadeja", nr. \_\_\_\_\_, dhe \_\_\_\_\_ Sh.A, me seli në Prishtinë rr. "Migjeni", nr. \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson drejtori i përgjithshëm \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të marrëveshjes hipotekare, mes tjerash me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet propozimi i saj, të caktohet masa e përkohshme e sigurimit me të cilën i ndalohet kundërshtarit të sigurimit \_\_\_\_\_ Sh.A-Prishtinë, që të realizojë të drejtën e kreditorit hipotekar që të shes paluajtshmërinë e regjistruar si ngastër kadastrale P-71813023-00422-3, parcela e cila gjendet në vendin e quajtur Vishe Sela-Od Druma/Vishe, në sipërfaqe prej 416m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, arë e klasit 3-të, Zona Kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, krejt kjo e regjistruar në Çertifikatë – 18-16399 të datës 17.01.2014, duke theksuar se janë plotësuar kushtet për caktimin e të njëjtës, pasi që pa caktimin e masës së përkohshme të sigurimit do të rrezikohet dhe vështirësohet qenësisht realizimi i kërkesëpadisë së propozueses së sigurimit, përkatësisht paditëses.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin e paditëses për masën e përkohshme të sigurimit dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, është i bazuar.

Me nenin 306.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se "Me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit". Ndërsa me nenin 306.2 të LPK-së, është paraparë se "Vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë. Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej tre (3) ditësh në përgjigjen e tij mund t'i

kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e pas kësaj gjykata duhet të caktojë seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbajë pjesën arsyetuese”. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se “për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit”, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, “Propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, për momentin është i bazuar nga fakti se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës nga palët, i paraparë me nenin 297.1 pika b), përkatësisht ka konstatuar ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar pala paditëse do të mund të pësojë ndonjë dëm të pariparueshëm. Duke u nisur nga propozimi i palës paditëse me të cilin ka kërkuar që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit Banka Ekonomike Sh.A-Prishtinë, që të realizojë të drejtën e kreditorit hipotekar që të shes paluajtshmërinë e regjistruar si ngastër kadastrale P-71813023-00422-3, parcela e cila gjendet në vendin e quajtur Vishe Sela-Od Druma/Vishe, në sipërfaqe prej 416m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, arë e klasit 3-të, Zona Kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, krejt kjo e regjistruar në Çertifikatë – 18-16399 të datës 17.01.2014, rrjedh fakti se nga ky propozim dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se ka rrezik se pa caktimin e masës së këtillë, pala kundërshtarë do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me ndryshimin e gjendjes faktike, tjetërsimin e pronës, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses të sigurimit, përkatësisht paditëses.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e aprovoi propozimin e palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, pasi vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 e LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Nga sa u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 306 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi, kundër propozuesi  
i masës së përkohshme të sigurimit – i padituri,  
ka të drejtën e deklaramit të kundërshtimit brenda afatit 3 (tre) ditor.  
Kundërshtimi i deklaruar nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi  
dhe i njëjti i dorëzohet kësaj gjykate.

## **Formulari 8 - Aktvendim mbi anulimin e masës së përkohshme të sigurimit me propozimin e palës paditëse – propozuese**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me bashkëpunëtorin profesional \_\_\_\_\_, në çështjen juridike të paditëses - nga Ferizaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. \_\_\_\_\_ nga Peja, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Ferizaj rr. "Vëllezërit Dëshiri", nr. \_\_\_\_\_, me objekt të padisë pengimi në posedim, duke vendosur sipas parashtrësës së palës paditëse për e tërheqjen e propozimit për caktimin e masës së përkohshme, me datë \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

ANULOHET masa e përkohshme e sigurimit e caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. \_\_\_\_\_, e datës \_\_\_\_\_.

### **A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, është caktuar masa e përkohshme e sigurimit dhe është urdhëruar kundërshtari i sigurimit- nga Ferizaj, që t'i ndërpret të gjitha punimet, që ka filluar në paluajtshmërinë e paditëses e regjistruar si ngastër kadastrale nr.1527/1 ZK Ferizaj, deri në përfundimin e kësaj çështje kontestimore.

Kundër të njëjtit aktvendim me datën 08.12.2014 ka ushtruar përgjigje (kundërshtim) kundërpropozuesi - i padituri \_\_\_\_\_ nga Ferizaj, me arsye të paraqitura më afër si në këtë kundërshtim.

Lidhur me këtë përgjigje (kundërshtim) gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datën 15.12.2014, me ç'rast palët kanë dhënë deklaratimet e tyre duke propozuar që të bëhet këqyrja në vend përmes ekspertit përkatës të xheodezisë.

Mirëpo në ndërkohë, përkatësisht menjëherë të nesërmen pala paditëse, gjegjësisht i autorizuari av. \_\_\_\_\_ nga Ferizaj ka parashtruar parashtrësë me të cilën ka deklaruar se ka komunikuar me palën paditëse nga e cila ka kuptuar se i padituri i ka ndërprerë punimet dhe se tani nuk është duke bërë asnjë veprim tjetër për ndryshimin e gjendjes faktike, prandaj ka kërkuar që seanca e datës 18.12.2014 të mos mbahet, pasi që tërhiqet nga propozimi për caktimin e masës së sigurimit.

Duke qenë se pala paditëse e ka tërhequr propozimin për caktimin e masës së sigurimit, bazuar me nenin 306 paragrafi 3, si dhe nenin 313.2 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_/ \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Bazuar në nenin 310.5 të LPK-së,  
kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 9 - Aktgjykim refuzues me të cilin është vendosur që masa e sigurimit të mbetet në fuqi deri në plotfuqishmëri të kontestit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_ në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjilani rr.“Salajdin Braha” nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Gjilani, kundër të paditurve \_\_\_\_\_, e vajzërisë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ që të dy nga Gjilani, tani në adresë të panjohur jashtë Kosove, e të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Gjilani, si dhe të paditurit \_\_\_\_\_ nga Gjilani, lagja “Arbanë” rr. “Jeta e re” nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Gjilani, për shkak të anulimit të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmerisë dhe vërtetimit të së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 3.200 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjilani rr.“Salajdin Braha” nr.\_\_\_\_, me anë të së cilës ka kërkuar që “të aprovohet kërkesëpadia e paditësit kështu që kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerisë nk.1077/7 f.p. Nr.10223 ZK Gjilan, në sipërfaqe të tërësishme prej 365 m<sup>2</sup>, e legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Gjilan Leg.nr.2502/2006, të datës 24.05.2006 dhe atë në mes të paditurve \_\_\_\_\_, e lindur \_\_\_\_\_, si dhe \_\_\_\_\_, që të dy shitës në njërin anë, si dhe të paditurit \_\_\_\_\_, si blerës në anën tjetër, të anulohet në tërësi si e kundërligjshme dhe të vërtetohet se paditësi është bashkëpronar i pjesës ideale në ½ të paluajtshmerisë – shtëpisë familjare në Gjilan, e cila evidentohet si ngastra kadastrale nr.1077/7 f.p.nr.10223 ZK Gjilan, në sipërfaqe të tërësishme prej 365 m<sup>2</sup>, andaj të detyrohen të paditurit që ta pranojnë këtë fakt me detyrim që në afatin prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë ligjore, të lejojnë regjistrimin e kësaj paluajtshmerie në favor të paditësit pranë Agjencionit Kadastral të Kosovës - Drejtorisë për Kadastër në Gjilan, si dhe që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajnë paditësit shumën në lartësi prej 5.980,12 euro, nën kërcënim të përmbarimit, si tërësisht e pa bazuar.

II. DETYROHET paditësi që në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia paguajë të paditurit \_\_\_\_\_ shumën në lartësi prej 2000 euro, brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. MASA E PËRKOHSHME E SIGURISË, e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.\_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

\_\_\_\_\_

Gjendja faktike e vërtetuar

\_\_\_\_\_

Baza ligjore

\_\_\_\_\_

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

\_\_\_\_\_

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Sa i përket masës së përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.1448/04, të datës 25.01.2005, gjykata vendosi që të njëjtën ta lë në fuqi deri në përfundim të plotfuqishëm të këtij

kontesti, në mënyrë që mos të vije deri te shkaktimi i ndonjë dëmi të pariparueshëm për palët ndërgjyqëse.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

**KAPITULLI XIV**  
**MJETET PROVUESE DHE MARRJA**  
**E PROVAVE**



## 14 MJETET PROVUESE DHE MARRJA E PROVAVE

### 14.1 Veprimet

Veprimet kryesore të cilat i kryen gjykata kanë për qëllim zbulimin e së vërtetës rreth çështjes në kontest, dhe çdo gjykim për zbulimin e kësaj të vërtete nuk është gjë tjetër veç se një proces njohje.

Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve kryesore me të cilat bëhet propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe çmuarja e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështeten kërkesat e palëve.

### 14.2 Barra e të provuarit

Secila palë ndërgjyqësore ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.<sup>209</sup> Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen fakte e tilla.<sup>210</sup>

Nga këto dispozita rrjedh se barra e të provuarit është detyrë ekskluzive e palëve në procedurë, ndërsa në raport me gjykatën barra e të provuarit vjen në shprehje vetëm përjashtimisht kur ngarkohet me detyrën që saktësisht ta vërtetojë gjendjen faktike po qe nevoja edhe duke marrë prova të cilat nuk i kanë propozuar palët.

Detyra e gjykatës sa i përket barrës së të provuarit i referohet vetëm situatave kur nga rezultati i shqyrtimit del përfundimi se palët kanë për qëllim të disponojnë me kërkesa me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht.

Sipas dispozitës së nenit 7.2 të LPK-së, “Gjykata është e autorizuar t’i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t’i marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”, ndërsa me dispozitën e nenit 320 parashihet se “Gjykata është e autorizuar që t’i marrë edhe provat që nuk i kanë propozuar palët, po që se konstaton se ato tentojnë të disponojnë me kërkesat me të cilat nuk kanë të drejtë të disponojnë (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji)”.

Nga këto dispozita ligjore rezulton se vetëm përjashtimisht gjykata ka të drejtë dhe detyrim që të ofrojë fakte ose të marrë prova, që nuk i kanë paraqitur palët, nëse kemi të bëjmë me veprimet që i referohen kërkesave me të cilat palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

**Përshkrimi praktik i një situate të tillë:** Nëse subjekti X ka paraqitur padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë pranë gjykatës kompetente, kundër të paditurit subjektit Y, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i padituri e pohon kërkesën e padisë së paraqitur nga paditësi, mirëpo nga rezultati i shqyrtimit gjykata vlerëson se mund të bëhet fjalë për kërkesën me të cilën i padituri nuk mund të disponojë lirisht pasi që prona kontestuese nuk figuron si pronësi e të paditurit. Në këtë rast gjykata ka detyrim që të ketë rol aktiv të hetimit, me qëllim që të konstatojë nëse kërkesa e padisë është kërkesë e disponueshme për palët ndërgjyqësore. Për të konstatuar këtë rrethanë gjykata zyrtarisht mund të marrë edhe prova si p.sh: kërkimi i certifikatës së pronësisë nga organi kompetent, këqyrja në vend apo dëgjimi i dëshmitarëve etj.

Duhet theksuar faktin së sipas LPK veprimet kryesore të cilat i kryen gjykata sipas propozimit të palëve në procesin e të provuarit kanë për qëllim që të zbulohet e vërteta përkatësisht që të arrihet të e vërteta e provuar. Pra nuk kërkohet të arrihet te e vërteta absolute por te e vërteta e provuar. Në këtë kontekst

---

<sup>209</sup>Neni 319 par 1, i LPK-së.

<sup>210</sup>Neni 7 par 1, i LPK-së.

duhet theksuar se i tërë aktiviteti i gjykatës duhet të jetë i fokusuar në drejtim të arritjes së të vërtetës së provuar, por me që barra e të provuarit sipas LPK-së, bie mbi palët atëherë gjykata mund të arrijë te e vërteta e provuar në qoftë se palët e kontestit i paraqesin faktet dhe provat e duhura për çështjen që është objekt shqyrtimi dhe vendosje.

Me rëndësi themelore në këtë proces, është që gjyqtarët të gjitha veprimet që i ndërmarrin në një çështje shqyrtimi t'i ndërmarrin sipas kompetencës që kanë për çështjen, në pajtim me ligjin dhe me paanësi.

Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve kryesor me të cilat bëhet propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe çmuarja e mjeteve provuese më qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështeten kërkesat e palëve.<sup>211</sup> Me anë të të provuarit gjykata sipas propozimeve të palëve e grumbullon materialin faktik i cili e përbën premisën e vogël të silogjizmit gjyqësor. Duke zbatuar normën juridike të konstatuar gjatë procesit gjykata e jep vendimin i cili është rezultat i raportit të dy premisave të përmendura (gjendja faktike e konstatuar dhe norma juridike).<sup>212</sup>

Pala paditëse duhet të parashtrojë faktet, në të cilat mbështeten kërkesat e saj, mendohet në rrethanat e rëndësishme në të cilat pala paditëse mbështetet si bazë për kërkesë. Pra të gjitha faktet e rëndësishme për çështjen objekt i të provuarit së bashku me të gjitha provat për secilin fakt që duhet të provohet pasi që në këtë mënyrë kur kualifikohen faktet e çështjes gjykata do nxjerr përfundimin së më aplikimin e normës materialo juridike ekziston e drejtat e pretenduara për palën paditëse apo kërkesa duhet të refuzohet.

Në procesin e të provuarit për çdo çështje i rëndësishëm përveç hetimit të çështjes është edhe shqyrtimi. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se gjykata do të marrë parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga ana e palës. Informatat e tjera, që do të kenë mundësi të arrijnë te gjykata, nuk mund të merren parasysh, edhe nëse ato informata i përgjigjen të vërtetës dhe në rast konkrete do të kishin ndikim në vendimmarrje.<sup>213</sup>

Pavarësisht detyrimit të palëve për paraqitjen dhe shtjellimin e fakteve dhe provave të çështjes, është detyrë e gjykatë që të vendos se cilat fakte do ti konsideroj të provuara e cilat jo. Të ky përfundim arrihet përmes çmuarjes së lirë të provave nga ana e gjykatës. Çmuarja e lirë është vendimtare për mënyrën e vendosjes së një çështjeje. Çmuarjen e lirë gjykata e bën duke vlerësuar me ndërgjegje dhe më kujdes çdo provë veç e veç dhe të gjitha bashkërisht si dhe në bazë të rezultatit të tërë procedurës. Supozohet se gjykata me anë të mjeteve provuese dhe vlerësimit të tyre në mënyrë e caktuar është në gjendje të konstatojë gjendjen faktike relevante e cila përputhet me realitetin objektiv.

Në sistemin tonë të vlerësimit të provave nuk parashihen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese.

Zbatimi i normave juridike, qofshin ato materiale apo procedurale, mund të bëhet në mënyrë të drejtë vetëm në qoftë se konstatohet saktësisht dhe plotësisht gjendja faktike në të cilën palët i bazojnë kërkesat e tyre.

Me anë të provuarit palët mundohen ta bindin gjykatën në saktësinë e fakteve në të cilat e mbështetin ndonjë kërkesë materialo-juridike apo proceduralo-juridike, kurse gjykata e verifikon saktësinë e tyre.

### 14.2.1 Faktet që nuk kanë nevojë të provohen

Edhe pse në disa raste e përbëjnë thelbin e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, disa fakte nuk ka nevojë të provohen:

---

<sup>211</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.232.

<sup>212</sup> Kualifikimi juridik i fakteve, në të cilat paditësi e mbështetet kërkesëpadinë, e përmban bazën juridike të kërkesëpadisë.

<sup>213</sup> Çfarëdo informate që mund ta ketë gjykata për çështje sa do e rëndësishme që të jetë, nëse nuk është paraqitur dhe shtjelluar nga palët, gjykata nuk mund ta marrë parasysh me rastin e vendosjes.

- Faktet e ditura botërisht- janë faktet ekzistencën e të cilave e njih një rreth shumë i gjerë njerëzish, p.sh: luftërat, tërmetet, zjarret masive etj.<sup>214</sup>
- Faktet e vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm- fakte të tilla konsiderohen ato të cilat gjykata i ka vërtetuar në ndonjë procedurë të mëhershme gjyqësore e cila ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, të cilat për nga karakteri përfaqësojnë çështje të gjykuar.
- Faktet e pohuara- pohimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij.
- Faktet e prezumuara me ligj- objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji e prezumon. Prezumimi ligjor i fakteve përfaqëson rregullin sipas të cilit gjykata është e detyruar që ta merr si ekzistues një fakt (fakt i prezumuar) nëse vërtetohet së ekziston një fakt tjetër i përcaktuar nga ligji. Shembull: prezumohet se baba i fëmijës është personi i cili është në martesë me nënën e fëmijës 300 ditë para lindjes së fëmijës.<sup>215</sup>

#### 14.2.2 Marrja e provave

Marrja e provave është veprim procedural i gjykatës me anën e të cilit ajo merr dijeni për bazat e të provuarit nga mjetet provuese. Gjykata ka për detyrë të caktojë mënyrën, kohën dhe vendin e marrjes së provave.

Është rregull që provat të merren në seancë për shqyrtim kryesor, mirëpo në interes të ekonomizimit të procesit, të efikasitetit në vendosje, ligji bën përjashtim nga ky rregull duke përcaktuar mundësinë që gjykata të vendos që prova e caktuar të merret para ndonjë gjykatë tjetër (gjykata e porositur).

Kur gjykata vendos që një provë të merret përpara gjykatës së porositur, në letër porosinë për marrjen e provës përshkruhet gjendja e çështjes sipas të dhënave nga shkresat e lëndës dhe posaçërisht do të theksohet se cilat rrethana duhet të kihen posaçërisht parasysh me rastin e marrjes së provës.<sup>216</sup>

Disa nga rastet kur gjykatës së porositur i besohet nxjerrja e provës janë: dëgjimi i dëshmitarëve, sjellja e të cilëve në gjykatë është e pamundur apo e vështirësuar, për shkak të sëmundjes së dëshmitarit, këqyrja në vend kur sendi i cili duhet të këqyret gjendet në territorin e gjykatës së porositur etj.

Për marrjen e provës nga gjykata e porositur vendoset me aktvendimi kundër të cilit nuk lejohet ankesë e veçantë.

#### *Shembull praktik i letër porosisë për marrjen e provës*

Gjykata që parashtron kërkesën  
Gjykata të cilës i drejtohet kërkesa  
Numri identifikues – emri i rastit  
Emrat dhe adresat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre  
Padiësi -përfaqësuesi  
I padituri- përfaqësuesi  
Palët tjera – përfaqësuesi i tyre  
Natyra e procedurës – ( baza e kontestit)  
Përshkrim i shkurtër i kërkesëpadsisë  
Përshkrim i shkurtër i kundërshtimeve  
Informacione tjera të domosdoshme që ndërlidhen me çështjen  
Prova e cila duhet të merret  
Qëllimi i provës ose aktit që duhet kërkuar  
Identiteti dhe të dhënat tjera për personin i cili duhet të pyetet në qoftëse marrja e provës i referohet dëgjimit të dëshmitarit.

<sup>214</sup>Me gjerësisht shih në këtë kapitull mjetet provuese veç e veç

<sup>215</sup>Ligji i Familjes i Kosovës, neni 99 par 1

<sup>216</sup>Me gjerësisht shi kapitullin XI dhënia e ndihmës juridike.

Pyetjet që i parashtrihen personit i cili merret në pyetje ose deklarata lidhur me lëndën për të cilin do të merret në pyetje.  
Dokumenti ose prona që duhet të këqyret, në qoftëse marrja e provës nuk i referohet dëgjimit të ndonjë dëshmitari.  
Çfarëdo detyre që dëshmia të merret nën kushte te caktuara dhe çfarëdo mënyrë tjetër specifike që zbatohet.  
Metoda dhe procedura që duhet ndjekur me rastin e marrjes së provës, (p.sh.me gojë ose me shkrim, tekstualisht, transkripte ose përmbledhje, marrje në pyetje etj.).  
Kërkesa për njoftim lidhur me kohën dhe vendin për ekzekutimin e kërkesës dhe identitetet dhe adresa e personit që njoftohet.  
Specifikimi i privilegjit ose detyrës për të refuzuar që të dëshmoj, sipas ligjit të gjykatës e cila parashtron kërkesën.  
Njoftimi për shpenzimet që mund të rimbursohen për shkak të marrjes së provës.  
Emërtimi i gjykatës, numri i rastit, data e kërkesës dhe nënshkrimi i gjyqtarëve

### 14.3 Sigurimi i provës (paraprova)

Si rregull provat merren gjatë zhvillimit të procedurës, mirëpo në praktikë shpeshherë paraqiten situata të cilat kërkojnë që provat të merren sa më shpejtë, për shkak se marrja e tyre më vonë do të jetë e vështirësuar ose krejtësisht e pamundur.

Procedura për sigurimin e provës zbatohet gjithnjë sipas propozimit të palëve. Pala kërkesën për sigurimin e provës duhet ta paraqesë në gjykatën që është duke u shqyrtuar çështja dhe, në rast se padia nuk është ngritur ende, në gjykatën e vendit ku e ka vendbanimin personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret. Në rastet urgjente pala mundet që kërkesën ta paraqesë në gjykatën e vendit ku e ka banimin personi që duhet të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret përkundër faktit që padia është ngritur.

Kërkesa për sigurimin e provës – kërkesa duhet të përmbajë këto të dhënat:

- provën që duhet të merret;
- rrethanat dhe faktet për vërtetimin e të cilave shërben ajo
- arsyet që justifikojnë marrjen e saj para kohe dhe
- emrin dhe mbiemrin e palës kundërshtare

Veprimet e gjykatës në procedurën e sigurimit të provës – posa të dërgohet kërkesa për marrjen e provës, gjykata duhet që një kopje të kërkesës t'ia dorëzojë palës kundërshtare përveç në rastet kurë pala kundërshtare nuk dihet ose kur marrja e provës nuk lejon shtyrje.

Gjykata për marrjen e provës vendos me aktvendim i cili duhet të përmbaj provën që do të merret, mënyrën e marrjes së provës dhe faktet apo rrethanat që duhet të provohen me të. Kundër aktvendimit me të cilin pranohet propozimi për sigurimin e provës si dhe kundër aktvendimit me të cilin vendoset që marrja e provës të filloj para se aktvendimi ti dërgohet palës kundërshtare nuk lejohet ankimi i veçantë<sup>217</sup>. Nga kjo rrjedh se gjykata duhet ta njoftojë palën kundërshtare para se të filloj marrjen e provës me aktvendimin me të cilin është pranuar dhe caktuar seanca për marrjen e provës. Në qoftë se palës kundërshtare nuk i është dërguar kopja e kërkesës për sigurimin e provës atëherë ajo i dërgohet së bashku me aktvendimin me të cilin pranohet kërkesa për sigurimin e provës.

Palës kundërshtare e cila është e panjohur ose të cilës nuk i dihet vendbanimi gjykata mund t'ia emëroj përfaqësuesin e përkohshëm me qëllim që të marr pjesë në seancën e caktuar për marrjen e provës, por për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në këtë rast nuk ka nevojë që të bëhet shpallje publike.<sup>218</sup>

---

<sup>217</sup> Neni 383 par 4, i LPK-së.

<sup>218</sup> Neni 383 par 2, i LPK-së.

Pasojat e mosparaqitjes së palës që ka kërkuar sigurimin e provës në seancë- në qoftë se pala që ka kërkuar sigurimin e provës nuk paraqitet në seancën e caktuar për marrjen e provës, atëherë gjykata do ta refuzoj propozimin, përveç kur marrjen e saj e kërkon pala kundërshtare ose kur gjykata e çmon se kjo është në dobi të procesit gjyqësor.<sup>219</sup>

Procesverbali mbi marrjen e provës, në rastin kur marrja e provës është bërë para ngritjes së padisë ruhet në gjykatën ku është përpiluar procesverbali, ndërsa në rastin kur sigurimin e provës nuk e ka bërë gjykata e çështjes atëherë procesverbali i dërgohet gjykatës në të cilën në zhvillim e sipër është procedura.<sup>220</sup>

## 14.4 Mjetet provuese veç e veç

### 14.4.1 Këqyrja në vend

Këqyrja në vend është një nga llojet e mjeteve provuese që shërbejnë për ta vënë gjykatën në mundësi që të marr dijëni vet për gjendjen dhe cilësitë e personave dhe sendeve. Dijenia e fituar në këtë mënyrë gjykatës i shërben për verifikimin e vërtetësisë së thënieve që janë objekt i të provuarit.

Gjykata cakton marrjen e kësaj prove në rastet kur e çmon të nevojshme për vërtetimin e ndonjë fakti, apo për sqarimin e ndonjë rrethane, (neni 326 .1, LPK-së).

Ne qoftë së për nxjerrjen e provës me këqyrjen në vend nevojitet njohuri profesionale të cilën gjykata nuk e ka, gjykata mundet që këqyrjen ta realizoj me pjesëmarrjen dhe ndihmën e ekspertit të lëmisë përkatëse, (p.sh. me ndihmën e gjeodetit, ndërtimitarit, arkitekti, agronomit etj.).

Në çdo rast kur bëhet këqyrja në vend hartohet procesverbali nga ana e gjykatës.

Shembull praktik i procesverbalit të këqyrjes në vend

GJYKATA THEMELORE _____ Departamenti i Përgjithshëm	
Procesverbali i këqyrjes në vend	
Gjyqtari _____	Paditësi _____
Sekretarja juridike _____	I padituri _____
Çështja kontestuese _____	
Filloi në ora _____	
Gjyqtari i çështjes konstaton se në këqyrje në vend janë të pranishëm:	
Për paditësin: _____	
Për të paditurin: _____	
Nga personat tjerë të ftuar prezanton eksperti i gjeodezisë _____	
Konstatohet se ka kushte për këqyrjen në vend	
Gjykata me ndihmën e ekspertit konstaton se prona kontestuese identifikohet si ngastër kadastrale numër _____, zona kadastrale _____.	
Ngastra kontestuese kufizohet në pjesën veriore me ngastrën numër _____, në pjesën _____	

<sup>219</sup> Neni 384 par 1, i LPK-së

<sup>220</sup> Neni 385 par 1 dhe 2, i LPK-së

perëndimore me ngastrën numër \_\_\_\_\_, në pjesën jugore me ngastrën \_\_\_\_\_, dhe në pjesën lindore me ngastrën \_\_\_\_\_.

Gjykata konstaton se në pronën kontestuese është i ndërtuar objekti i banimit i tipit P+1K, i përfunduar, në të cilin jeton familja e paditësit. Gabariti i objektit është 100m<sup>2</sup> baza, ndërsa sipërfaqja tjetër e pronës është e gjelbëruar.

Paditësi nuk ka vërejtje në konstatimet e gjykatës.

I padituri nuk ka vërejtje në konstatimet e gjykatës.

Pas kësaj gjykata merr:

#### A K T V E N D I M

Detyrohet eksperti që në afat prej 7 ditësh gjykatës t'ia paraqes raportin me shkrim - ekspertizën me të dhëna për identifikimin e pronës kontestuese, përshkrimin faktik, kufizimin dhe historiatin.

Këqyrja në vend përfundoi, ndërsa seanca e shqyrtimit kryesor do të caktohet pasi që gjykata ta pranoj raportin - ekspertizën.

Përfundoi në ora \_\_\_\_\_

Paditësi

I padituri

Vertetojnë

Procesmbajtësja

Gjyqtari

#### 14.4.2 Shkresat

Dokumentet ose provat shkresore që parashikohen si një nga llojet e mjeteve provuese janë mjete me anë të të cilave nëpërmjet shenjave shprehen mendime që përmbajnë të dhëna për faktet, të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e një kontesti.<sup>221</sup>

##### a) Llojet e shkresave

- Dokumenti publik - konsiderohet ai dokument shkresor i cili sipas nenit 329.1 të LPK-së, është hartuar nga organi shtetëror, në formën e caktuar, brenda kufijve të kompetencës së vet si dhe shkresa të cilën e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike.
- Dokumenti jopublik (privat) - është çdo shkresë tjetër e cila nuk mund të përfshihet me definicionin e dokumenti publik siç parasheh dispozita e nenit 329.1 e LPK-së.
- Dokumentet e vendit dhe të huaja- kjo ndarje bëhet duke marrë parasysh vendin në të cilin është lëshuar dokumenti apo në të cilin ndodhet subjekti që e ka lëshuar atë.
- Dokumente origjinal dhe kopje e origjinalit.

##### b) Fuqia provuese e shkresave-dokumenteve

Sipas nenit 329.1 të LPK-së, parashihet së gjykata ka detyrë që ta marr si të saktë atë që është vërtetuar apo përcaktuar me anë të dokumenti publik.

---

<sup>221</sup> Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.254.

Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat me dispozitat e veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike. Ky vlerësim i referohet shkresave jopublike pasi që dokumenti jopublik, pavarësisht nga forma në të cilin është përpiluar, i nënshkruar nga personi që e ka lëshuar, përbën një provë të plotë për faktin së deklarimet që përmban janë të atij që e ka nënshkruar.

Të njëjtën fuqi provuese sikurse dokumentet publike të vendit, e kanë edhe dokumente publike të shteteve tjera në qoftë së plotësohen këto kushte:

- me kontratë ndërkombëtare nëse nuk është përcaktuar ndryshe,
- që dokumenti i huaj të jete i legalizuar sipas ligjit,
- të ekzistojë reciprociteti për njohjen e dokumenteve publike në mes të shtetit të Kosovës dhe shteti të huaj, organi i të cilit e ka lëshuar dokumentin, dhe
- që dokumenti i huaj të jetë lëshuar nga organi kompetent i shtetit përkatës me përmbajtjen dhe formën e paraparë me dispozitat ligjore të atij shteti.

c) Paraqitja dhe kërkimi i dokumenteve publike

Në qoftë se pala në padi, përgjigje në padi, në parashtresë apo verbalisht gjatë seancës gjyqësore thirret në dokument publik si mjet për provimin e fakteve, ka për detyrë që gjykatës t'ia dorëzojë atë dokument.

Nëse dokumenti është në gjuhën e huaj i njëjti duhet të paraqitet në gjykatë bashkë me përkthimin e tyre të legalizuar nga ana e përkthyesit gjyqësor të përhershëm.

Gjykata sipas propozimit të palës do ta marrë sipas detyrës zyrtare dokumentin po që se dokumenti ndodhet tek organi shtetëror, ose personi juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kurse pala vetë nuk është në gjendje ta dorëzojë apo tregojë atë.-

Kur dokumenti ka rëndësi për të provuar pretendimet e një pale, por ndodhet në dorën e palës kundërshtare, gjykata me kërkesën e palës së interesuar, kur e gjen me vend kërkimin, me aktvendim urdhëron paraqitjen e këtij dokumenti.

Në tri raste ligji (neni 334) e detyron palën që ta dorëzojë dokumentin gjithsesi:

- Në qoftë se pala vet e ka përmend dokumentin me qëllim të provimit të ndonjë pretendimi të saj,
- Në qoftë se është fjala për dokumentin, të cilin ajo sipas ligjit është e detyruar ta dorëzojë apo ta tregojë, (për shembull: dokumenti i cili i është besuar për ruajtje ose që është në bashkëpronësinë e të dy palëve), dhe
- Në qoftë se dokumenti, për shkak të përmbajtjes së tij konsiderohet si i përbashkët për të dy palët, (për shembull: kontrata, testamenti etj.).

Pala mund të refuzojë paraqitjen e dokumentit të kërkuar vetëm për arsyet e përcaktuara me dispozitën e nenit 342 dhe 343 të LPK-së.

Dokumentin të cilin njëra palë dëshiron ta përdor për provimin e ndonjë pretendimi, mund të ndodhet në duart e personit të tretë që nuk është palë në gjykim. Sipas propozimit të palës gjykata mund të urdhëroj personin e tretë me vendim që ta dorëzojë apo tregojë dokumentin e tillë.

Personi i tretë mund të refuzojë paraqitjen e dokumentit të kërkuar vetëm për arsyet e përcaktuara me dispozitën e nenit 342 dhe 343 të LPK-së.

Kur personi i tretë konteston detyrimin e dorëzimit të dokumentit që ndodhet tek ai, gjykata vendos se a është ai i detyruar ta dorëzojë atë ose jo.<sup>222</sup> Në situatën kur personi i tretë mohon se dokumenti ndodhet te ai, gjykata mundet që për vërtetimin e këtij fakti të marrë prova.

Aktivendimi i formës së prerë për detyrimin e personit të tretë që ta dorëzojë dokumentin mund të përmbrohet nëpërmjet gjykatës kompetente sipas rregullave të procedurës përmbroese.<sup>223</sup>

#### 14.4.3 Dëshmitarët

Dëshmitarët janë persona të cilët i japin gjykatës deklaratat në lidhje me perceptimin e fakteve në të kaluarën. Dëshmitari me deklaratën e tij të cilën e jep në këtë cilësi duhet të kufizohet vetëm në perceptimin e tij shqisor, duke mos e dhënë mendimin e tij për faktin e perceptuar.

##### a) Zotësia për të qenë dëshmitarë

Si dëshmitar mund të pyeten vetëm personat që kanë aftësi të japin informata mbi faktet që duhet të provohen.

LPK nuk ka përcaktuar taksativisht kritere formale lidhur me mundësi që një person të dëgjohet si dëshmitar dhe mbi këtë bazë si dëshmitar mund të dëgjohet:

- çdo person pavarësisht nga mosha, (të miturit, të rriturit dhe të moshuarit),
- pavarësisht nga gjendja shpirtërore e tij,
- pavarësisht nga aftësia e kufizuar që ka, dhe
- pavarësisht nga mënyra se si ka ardhur deri të informata për faktet kontestuese.

LPK përcakton së të miturit nën moshën katërmëdhjetë vjeç mund të pyeten vetëm kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.

##### b) Personat që nuk mund të dëgjohen si dëshmitar

Nuk mund të dëgjohet si dëshmitarë:

- personi i cili me thëniet e tij do ta cenonte detyrën e ruajtjes së sekretit zyrtar apo ushtarak, derisa organi kompetent të mos e lirojë nga kjo detyrë.
- Personi që për shkak të metave fizike ose psikike është absolutisht i paaftë për të qenë dëshmitar.
- personat relativisht të paaftë siç janë: të verbrit, por vetëm për fakte që perceptohen me anë të shikimit, të shurdhrit, por vetëm për faktet që perceptohen me anë të dëgjimit

##### c) Detyra e dhënies së dëshmisë

Detyra e dëshmisë nënkupton detyrën e paraqitjes sipas thirrjes në gjykatë, atë të dhënies së deklaratës si dhe detyrën e thënies së të vërtetës, (neni 339.1, i LPK-së). Detyrën e dhënies së dëshmisë e kanë jo vetëm shtetasit e një shteti ku zhvillohet gjykimi por edhe tëhuajt që ndodhen në atë shtet. Personat që gëzojnë të drejtën e eksterritorialitetit (imuniteti diplomatik) dhe ata që ndodhen jashtë shtetit, mund të dëgjohen si dëshmitar sipas rregullave për dhënien e ndihmës ndërkombëtare.

---

<sup>222</sup> Neni 338 par 1 i LPK-së.

<sup>223</sup> Neni 338 par 3 i LPK-së.



d) Refuzimi i dhënies së dëshmisë

Personat e ftuar për të dëshmuar në kontest, e të cilët gjatë kryerjes së funksionit të vetë, thirrjes ose veprimtarisë kanë marrë dijeni për disa fakte ose të dhëna, kanë të drejtë që të refuzojnë të dëshmojnë.

Arsyet për të cilat personi mund të refuzojë të dëshmojë:

- mbi atë që pala ndërgjyqëse ia ka besuar si përfaqësuesit të vetë me prokurë;
- mbi atë që pala ose personi tjetër ia ka treguar dëshmitarit si rrëfyesit të vetë;
- mbi faktet që i ka marrë në dijeni dëshmitari si avokat, si mjek ose në ushtrimin e ndonjë profesioni apo veprimtarie tjetër, po që se ekziston detyrimi që të ruhet si sekret ajo që merr në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit apo të veprimtarisë së vet.

Gjykata do të ja tërheqë vërejtjen dëshmitarit se mund të refuzoj dhënien e dëshmisë në çdo rast kur i ka të njohura shkaqet për refuzim.

e) E drejta e dëshmitarit për mos dhënien e përgjigjes në pyetjen konkrete

Dëshmitari mund të mos jap përgjigje në pyetje konkrete në qoftë së për një gjë të tillë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe të rëndësishme (neni 343).

Rrethana të cilat i parasheh ligji për refuzimin e dhënies së përgjigjes në pyetjen konkrete:

- në qoftë se me përgjigjen në këto pyetje, do t'ia ekspozonte përgjegjësinë penale vetës, apo të afërmit e tij të gjinisë së gjakut në vijë vertikale deri në cilëndo shkallë, e në vijë horizontale deri në shkallën të tretë përfundimisht, bashkëshortin e vet, ose të afërmit e gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë përfundimisht, edhe po që se ka pushuar martesë, personin me të cilin jeton në bashkësi jashtëmartesore, apo kujdestarin e vet, ose personin nën kujdestarinë e tij, adoptuesin apo të adoptuarin e vet.<sup>224</sup>

Gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare për ekzistimin e këtyre rrethanave për shkak të cilave dëshmitari mund të refuzoj përgjigjen në pyetje të caktuara, por është e obliguar që të ja tërheq vërejtjen dëshmitarit se e ka këtë të drejtë (neni 343.2, i LPK-së).

Gjykata këtë vërejtje do ta bëj në fillim pasi ti marrë të dhënat personale nga dëshmitari, kur edhe mëson për afrinë e tij me palët, ose drejtpërdrejtë pasi ti parashtrohet pyetja konkrete.

f) Kur nuk mund të refuzoj dëshmitari të jep dëshminë e tij

Kategoria e caktuar e dëshmitarëve nuk mund ta refuzojë dhënien e përgjigjeve në pyetjet konkrete me arsyetim së mund ti shkaktohet ndonjë dëm pasuror, (neni 344 i LPK-së).

Të tillë janë:

- Personat që thirrën të dëshmojnë lidhur me veprimet juridike të themeluara në praninë e tyre si dëshmitarë të thirrur,
- Personat që thirrën të dëshmojnë lidhur me veprimet, të cilat në pikëpamje të raportit kontestuese i kanë kryer si paraardhës juridik apo si përfaqësues të njëjës nga palët ndërgjyqëse.

---

<sup>224</sup> Neni 343 par 1 i LPK-së.

- Personat që thirren të dëshmojnë për faktet, të cilat kanë të bëjnë me raportet pasurore të kushtëzuara në lidhje familjare apo martesore si dhe për faktet që kanë të bëjnë me lindjen, vdekjen apo me lidhjen e martesës, dhe
- Kur me dispozita të posaçme ka për detyrë të jep deklaratë apo të bëjë njoftime.

g) Thirrja e dëshmitarit

Thirrja e dëshmitarit bëhet me anë të letërthirrjes në të cilën tregohet:

- emri dhe mbiemri i dëshmitarit,
- profesioni i dëshmitarit,
- vendi dhe koha e ardhjes,
- lënda lidhur me të cilën thirret, dhe
- theksimi se thirret në cilësinë e dëshmitarit.

h) Pyetja e dëshmitarit

Ky veprim procedural zakonisht kryhet në seancë gjyqësore, por kur dëshmitari për shkak të sëmundjes ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të paraqitet para gjykatës, gjykata mund të vendos që pyetja e tij të bëhet në banesën e dëshmitarit apo në lokale tjera, (si për shembull në spital, qendra të rehabilitimit etj.)

Dëshmitarët dëgjohen veç e veç dhe pa praninë e dëshmitarëve që do të dëgjohen më vonë.<sup>225</sup>

Dëshmitari nga gjyqtari i çështjes njoftohet para se të merret dëshmia e tij me detyrën që të flasë të vërtetën dhe se asgjë nuk guxon ta lë në heshtje, pastaj do të paralajmërohet për pasojat e dhënies së deklaratës së rreme.

Pas kësaj dëshmitari pyetet për emrin, mbiemrin, emrin e babait, vendlindjen, moshën dhe për raportin e tij me palët ndërgjyqëse.<sup>226</sup>

Pas pyetjeve të përgjithshme, dëshmitarit i bëjnë pyetje pala që e ka propozuar thirrjen e tij, e pas kësaj pala kundërshtarë.<sup>227</sup>

Gjykata në çdo moment mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit, por do të kufizohet vetëm në pyetjet që kanë të bëjnë më çështje që gjykata i heton kryesisht sipas dispozitës së nenit 3.3 të LPK-së dhe rasteve që kanë të bëjnë me detyrën e gjykatës që gjatë procesit gjyqësor të kujdesët për interesin ma të mirë të të miturve.

Dëshmitari gjithmonë pyetet si i ka marrë në dijeni gjërat për të cilat dëshmon.<sup>228</sup>

i) Ballafaqimi i dëshmitarëve

Ballafaqimi i dëshmitarëve nuk është i detyrueshëm por vjen në shprehje në rastet kur në mes të deklarimeve të dëshmitarëve ka mospërputhje që krijon vështirësi për vërtetimin e fakteve që janë me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Në këto raste ballafaqimi mund të bëhet kryesisht nga gjykata apo më kërkesën e palëve. Dëshmitarët që ballafaqohen do të pyetën për secilën rrethanë që nuk kanë dhënë deklaratë të njëjtë.

---

<sup>225</sup> Shih nenin 347.1 të LPK-së

<sup>226</sup> Shih nenin 347.2 të LPK-së

<sup>227</sup> Shih nenin 348.1 të LPK-së

<sup>228</sup> Shih nenin 348.3 të LPK-së

Ballafaqimi i dëshmitarëve në çdo rast ndodh pas dëgjimit të dëshmitarëve veç e veç, dhe nëse gjykata vendos që të ballafaqohen dëshmitarët atëherë duhet që të merr aktvendim ndaj të cilit nuk lejohet ankesë e veçantë.<sup>229</sup>

j) Revokimi i vendimit për dëgjimin e dëshmitarit

Pala e cila e ka propozuar dëgjimin e dëshmitarit mund të kërkojë nga gjykata që ai të mos pyete fare. Kërkesa për mos dëgjimin e dëshmitarit do të merret parasysh në rast se pala tjetër është dakord dhe nëse gjykata e vlerëson se pyetja e tij nuk do të jetë e nevojshme për sqarimin e rrethanave.

Në këto raste pavarësisht se pala kundërshtare mund të pajtohet me kërkesën e palës tjetër për mos pyetjen e dëshmitarit, gjykata mund të vendos që të dëgjohet dëshmitari, ndërsa nëse pala kundërshtare nuk pajtohet që dëshmitari të mos dëgjohet atëherë gjykata duhet që ta dëgjojë dëshmitarin.

k) Heqja dorë nga dëgjimi i dëshmitarit

Në qoftë se gjatë gjykimit të çështjet me provat e marra dhe me dëshmitarët e dëgjuar konstatohet së janë sqaruar fakte dhe pretendimet e palëve, gjykata kryesisht apo me kërkesën e palëve mund të marrë vendim për mos pyetjen e dëshmitarëve tjerë.

Në praktikën gjyqësore duhet të bëhet dallimi në mes situatave kur pala e cila e ka propozuar dëshmitarin kërkon që ai të mos dëgjohet dhe situatave kur nga dëgjimi i disa dëshmitarëve bëhet e panevojshme dëgjimi i dëshmitarëve tjerë për shkak të sqarimit të rrethanave.

Në situatën kur pala kërkon që të mos pyete dëshmitari i propozuar më tepër kemi të bëjmë me vlerësimet subjektive për procesin e të provuarit nga pala e cila e ka propozuar dëshmitari, ndërsa në situatën e heqjes dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve kemi të bëjmë me vlerësimin gjithëpërfshirës të palëve dhe gjykatës se janë sqaruar fakte dhe pretendimet e palëve.

l) Kompensimi i shpenzimeve të dëshmitarit

Dëshmitari ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ushqimit, fjetjes dhe fitimit të humbur.<sup>230</sup>

Gjykata do të vendos me aktvendim për shpenzimet e dëshmitarit duke caktuar shumën e të hollave që do të paguhet nga paradhënia e deponuar në gjykatë apo duke e detyruar palën që në afat prej 7 ditësh dëshmitarit t'i paguajë shpenzimet, nëse dëshmitari i ka kërkuara menjëherë pasi është pyetur nga gjykata.

Dëshmitari do të kompensohet edhe në rastet kur i është përgjigjur thirrjes së gjykatës por nuk është dëgjuar pa fajin e tij, (për shembull: për shkak të shtyrjes së seancës, kërkesës që mos të dëgjohet nga pala e cila e ka propozuar, nëse gjykata e pranon një kërkesë të tillë dhe në rastet e heqjes dorë nga dëgjimi i dëshmitarit).

Dëshmitarit nuk do t'i paguhet shpenzimet nëse është vonuar për seancë dhe ka ndikuar në shtyrjen e seancës si dhe në rastet kur është paraqitur në gjykatë, por ka refuzuar të dëshmojë pa ndonjë arsytet të justifikueshme.

---

<sup>229</sup> Ballafaqimi i dëshmitarëve bëhet më kërkesën e palëve apo nga vet gjykata për arsyet e paraqitur më lartë në shpjegim, mirëpo për tu ballafaquar dëshmitarët ata duhet të kenë në radhë të parë burimin e njëjtë të informatave për rrethanat për të cilat dëgjohej e gjithashtu të kenë deklarime të kundërt për fakte e njëjta.

<sup>230</sup> Neni 355.1. Siç është theksuar dëshmitari ka të drejtë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ushqimit, fjetjes dhe fitimit të humbur, por gjykata duhet ti pranojë shpenzimet e arsyeshme për ushqim, për udhëtim, fjetje dhe fitim të humbur. Shpenzimet e ushqimit pranohen sipas një menyje të zakonshme, shpenzimet e udhëtimit sipas tarifës së transportit publik, shpenzimet e fjetjes sipas çmimit mesatar të fjetjes nëpër hotele, ndërsa për fitimin e humbur aq sa është fitimi i humbur.

#### 14.4.4 Ekspertët

Gjykatat gjatë shqyrtimit dhe zgjidhjes së kontesteve civile ndeshen shpeshherë me probleme të ndryshme për zgjidhjen e të cilave kërkohen njohuri të posaçme apo përvojë e caktuar në fushën e shkencës, teknikës, letërsisë, artit etj.

Kur gjykata nuk ka njohuri apo përvojë të tillë, për zgjidhjen e problemeve konkrete ajo i shfrytëzon ekspertët.

##### a) Caktimi i ekspertëve ex-officio

Gjykata ex-officio mund të caktojë nxjerrjen e provës me ekspertizë për provimin e ndonjë fakti i cili është kontestues midis palëve dhe është relevant për vendosjen e çështjes e cila është objekt i kontestit. Mundësia që i është dhënë gjykatës që ex-officio ta bëjë nxjerrjen e provës me ekspertizë ka të bëjë vetëm me rastet e zbatimit të nenit 3.3 të LPK-së<sup>231</sup> dhe në çështjet familjare lidhur me mbrojtjen e interesit më të mirë të të miturve.<sup>232</sup>

##### b) Caktimi i ekspertëve me propozimin e palëve

Gjykata me propozimin e palëve mund të caktojë nxjerrjen e provës me ekspertizë për provimin e ndonjë fakti i cili është kontestues midis palëve dhe është i rëndësishëm për vendosjen e çështjes e cila është objekt i kontestit.

Kur pala e propozon ekspertizën ka për detyrë që në propozim të theksojë në mënyrë të saktë se cilat fakte duhet të vërtetohen me ekspertizë. Në këtë kuptim pala ka për detyrë të propozojë objektin, vëllimin dhe personin që do ta punoj ekspertizën.

Pas çdo propozimi për nxjerrjen e provës me ekspertizë palës kundërshtare duhet t'i jepet mundësia e deklarimit lidhur me ekspertizën e propozuar.

Vendimin për caktimin e ekspertizës dhe ekspertit gjykata do ta marrë pasi që të deklarohet pala kundërshtare përkatësisht pasi t'i është dhënë mundësia që të deklarohet dhe atë për objektin, vëllimin dhe ekspertin.

Gjykata zakonisht e cakton një ekspert por në raste të ndërlikuara mund të caktohen më tepër ekspert. Tek rastet e ekspertimeve me të ndërlikuara ekspertimi mund t'i besohet edhe ndonjë institucioni profesional (p.sh. Spitali, laboratorët, fakultete etj.), ndërsa nëse ekzistojnë institucione të posaçme për llojin e caktuar të ekspertimit (për shembull: për ekspertimin e dorëshkrimit, shenjave të gishtërinjve, të hollave të falsifikuara etj.) atëherë ekspertimi i tillë u besohet në rënd të parë këtyre institucioneve.<sup>233</sup>

Eksperti ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes së gjykatës dhe të jep mendimin e tij profesional.

Gjykata do ta lirojë ekspertin me kërkesën e tij, nga detyra e dhënies së mendimit të tij profesional, për të njëjtat shkaqe për të cilat dëshmitari mund të refuzojë dhënien e dëshmisë si dhe për shkaqet për të cilat dëshmitari mund të refuzojë që të përgjigjet në pyetjet konkrete.

---

<sup>231</sup>Në rast se ka pretendim nga ndonjë palë që të disponoj me ndonjë kërkesë më të cilin nuk mund të disponoj, e për të vërtetuar nëse është kërkesë e disponueshme ose jo për palën nevojitet vërtetimi i ndonjë fakti i cili mund të provohet me ekspertizë në raste të tilla gjykata mundet ex officio të kërkojë nxjerrjen e provës me anë të ekspertizës.

Shembull: Nëse X subjekti e ka paditur Y subjektin për vërtetimin e pronësisë për pronë e paluajtshme, ndërsa i padituri më përgjigje në padi e ka pohuar kërkesëpadinë, në këtë rast nëse gjykata nuk është e bindur së kërkesa është e disponueshme për palët mund të angazhojë ekspertin e përkatës (të gjeodezisë) për të verifikuar cila është prona dhe kush është pronari, pastaj të vendos.

<sup>232</sup> Gjykata e ka mundësinë që të nxjerr provë me anë të ekspertizës ex officio edhe në çështjet familjare ku janë të përfshirë të miturit sepse gjykata është e detyruar që në çdo rast kur janë të përfshirë në procedura gjyqësore fëmijët ti zhvilloj dhe udhëheq procedurat duke u mbështetur në parimin e interesit më të mirë për të miturin.

Konventa për të Drejta e Fëmijës, e Kombeve të Bashkuara, 1989, neni 3. Parashihet "Të gjitha masat që ndërmerren për fëmijët, qofshin ato të marra nga institucionet publike apo nga ato private të përkujdesjes sociale, nga gjyqet, nga autoritetet e administratës apo nga organet legjislativë, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë synim mbizotëruar....."

<sup>233</sup> Shih nenin 358 të LPK-së

Gjykata mund ta largoj ekspertin nga detyrimi i ekspertimit edhe atëherë kur eksperti jep shkaqe të arsyeshme për përjashtim, (mund të jenë: sëmundja, ngarkesa në vendin e tij të punës, largimi për një periudhë nga vendi apo vendbanimi i përhershëm, kur pohon se nuk posedon aftësi profesionale të profilit specifik etj.).

### c) Përjashtimi i ekspertit

Përjashtimi i një personi nga pjesëmarrja në gjykim si ekspert mund të kërkohet po për ato shkaqe për të cilat kërkohet edhe përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi konkret, mirëpo derisa gjyqtari nuk mund ta ushtrojë detyrën e gjyqtarit nëse është dëgjuar si dëshmitar, si ekspert mund të caktohet edhe personi i cili më parë është dëgjuar si dëshmitar në të njëjtin kontest.

Kur palët kanë kundërshtime, nuk mund të marrë pjesë si ekspert në zgjidhjen e çështjes personi që është palë, bashkëshort, gjini ose krushqi e afërt me njërin nga palët, ai që ka interes në zgjidhjen e çështjes, ose është bashkëshort, gjini ose krushqi e afërt me një person që ka interes në zgjidhjen e çështjes etj.

Pala e cila e bën kërkesën për përjashtimin e ekspertit duhet ta arsyetojë kërkesën, ndërsa shkakun e përjashtimit duhet ta bëjë të besueshëm.

Kërkesën për përjashtimin e ekspertit pala duhet ta bëjë posa të marrë dijeni për shkakun e përjashtimit, por më së voni para fillimit të marrjes së provës me ekspertizë. Ligji ka paraparë mundësinë që palët të kërkojnë përjashtimin e ekspertit edhe pasi që ai ta ketë kryer ekspertimin por me kusht që shkakun e përjashtimit të ekspertit ta ketë kuptuar pasi që është punuar ekspertiza.

Mbi kërkesën e përjashtimit të ekspertit vendos gjyqtari i çështjes. Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet apo refuzohet kërkesa për përjashtimin e ekspertit nuk lejohet ankesë e veçantë.

### d) Ekspertimi

Marrjen e provës me anë të ekspertizës gjykata e cakton me aktvendim<sup>234</sup> në të cilin duhet të përcaktojë.<sup>235</sup>

- emrin, mbiemrin dhe profesionin e ekspertit,
- objektin e kontestit,
- vëllimin dhe lëndën e ekspertimit,
- afatin për paraqitjen me shkrim të konstatimit dhe mendimit.

Eksperti duhet të thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.<sup>236</sup>

Gjykata pasi që ta pranojë konstatimin dhe mendimin e ekspertit, të njëjtin do t'ua dërgoj palëve së paku 8 ditë para mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor.

Gjykata seancën për shqyrtim kryesor mund ta mbajë edhe nëse nuk vjen eksperti i thirrur në të, por në qoftë se njëra apo të dy palët propozojnë që të dëgjohet eksperti dhe nëse gjykata e vlerëson së është e domosdoshme sqarimi dhe plotësimi i konstatimit dhe mendimit të ekspertit, ajo në pajtim me nenin 438 do ta shtyjë seancën, do ta caktoj seancën e re dhe do ta thërras ekspertin që të prezantohet në seancën e ardhshme.

---

<sup>234</sup> Formulari numër I.

<sup>235</sup> Shih nenin 361 të LPK-së

<sup>236</sup> Shih nenin 362.1 të LPK-së

#### 14.4.5 Dëgjimi i palëve

Palët si mjet provues janë burim kryesor dhe i sigurt i dijenisë lidhur me faktet relevante të çështjes juridike. Dëgjimi i palëve i mundëson gjykatës që të shërbehet me dijen e palëve për vërtetimin e fakteve të rëndësishme në të njëjtën mënyrë ashtu siç shfrytëzohet dija e personave të tjerë të cilët dëgjoen si dëshmitarë.

Me dispozitat e LPK-së, dëgjimi palëve si mjet provues është barazuar me mjete tjera provuese, prandaj mund të përdoret në funksion të të provuarit në çdo kohë dhe për vërtetimin e cilitdo fakt.

Marrja e kësaj prove caktohet me propozimin e njëres nga palët apo me propozimin e të dy palëve.

Letërthirja për tu dëgjuar në seancë palës duhet t'i dorëzohet personalisht, mirëpo nëse pala është e pranishme në seancën kur është caktuar nxjerrja e kësaj prove, gjykata do t'i tërheq vërejtjen palës që të paraqitet në seancën e radhës për tu pyetur në këtë cilësi dhe këtë vërejtje do ta shënojë në procesverbal.

Nëse pala në kontest përfaqësohet nga përfaqësuesi ligjor, thirrja për tu dëgjuar në këtë cilësi i dërgohet nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.

Gjykata mund të vendos që ta dëgjojë vetëm njëren palë me rastin e marrjes së provës me dëgjimin e palëve, mirëpo si rregull gjykata do t'i dëgjoj të dyja palët, por mund të vendos që ta dëgjojë vetëm njëren nga palët, për këto arsye:

- në qoftë se njëra palë refuzon të pyete në këtë cilësi, dhe
- nëse njëra palë nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës.

Në rastin kur pala është person fizik dhe nuk e ka zotësinë procedurale, në cilësi të palës do të dëgjoet përfaqësuesi i saj ligjor, por gjykata mund të vendos që krahas përfaqësuesit ligjor të dëgjoet vet pala në qoftë se është i mundur dëgjimi i saj. Gjykata do ta dëgjojë krahas përfaqësuesit ligjor edhe palën në qoftë se pala është në gjendje që t'i theksojë faktet të cilat janë me rëndësi për vendosjen e çështjes.

Kur është në pyetje personi juridik si palë në procedurë, në vend të tij dëgjoet personi i cili me ligj apo me aktin e përgjithshëm të personit juridik është caktuar për përfaqësim. Në rast se në njëren anë marrin pjesë disa persona, qoftë si paditës apo të paditur (bashkëndërgjyqësit aktiv apo pasiv), gjykata varësisht nga natyra e këtij raporti do të vendos për dëgjimin e tyre në cilësinë e palës.

Nëse ekziston bashkëndërgjyqësia formale, gjykata si rregull do të dëgjojë të gjithë bashkëndërgjyqësit në cilësinë e palës, sepse secili nga ata i përgjigjet palës kundërshtare me kërkesë të veçantë. Ndërsa nëse ekziston bashkëndërgjyqësia materiale (unike) gjykata do të vendos nëse do të dëgjojë të gjithë bashkëndërgjyqësit apo vetëm disa prej tyre.

Me rastin e marrjes së kësaj prove përshtatshmërisht aplikohen dispozitat me të cilat është paraparë marrja e provës me anë të dëshmitarëve, po që se për dëgjimin e palëve nuk është parashikuar shprehimisht dhe posaçërisht diç tjetër, mirëpo kundër palëve nuk mund të përdoren masa shtrënguese, nëse të njëjtët nuk i përgjigjen thirrjes së gjykatës për tu pyetur e as të detyrohen për të dhënë deklaratë.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**



## 14.5 Formularët praktikë lidhur me mjetet provuese dhe marrjen e provave

### Formulari 1 - Aktvendimi për caktimin e ekspertit-ekspertizës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson \_\_\_\_\_, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, të cilën e përfaqëson me autorizim \_\_\_\_\_, për kompensim dëmi, jashtë seance, me datë \_\_\_\_\_, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. CAKTOHET si ekspert gjyqësor financiar ecc. dipl., \_\_\_\_\_, i autorizuar, nga \_\_\_\_\_.
- II. Eksperti duhet ta llogarisë lartësinë e rentës së paditësit për kohën e kaluar kontestuese nga dt. \_\_\_ e deri me dt. \_\_\_\_, si fitim i humbur, si dhe lartësinë e rentës mujore që do t'i takonte paditësit në të ardhmen e nga dt. \_\_\_\_ e tutje.
- III. Lartësia e shpenzimeve për ekspertizë caktohet në shumën prej \_\_\_\_\_ € të cilën shumë paditësi është i detyruar ta deponojë në xhironlogarinë e ekspertit në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së ekspertizës së hartuar nga eksperti.
- IV. Eksperti konstatimin dhe mendimin e tij në formë të shkruar duhet t'ia dorëzojë kësaj gjykate në afat më së largu pas 7 ditësh, nga marrja e këtij aktvendimi, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.

#### A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit në seancën përgatitore të datës \_\_\_\_\_ i ka propozuar gjykatës që në këtë çështje të bëhet nxjerrja e provës me ekspertizë dhe të caktohet eksperti financiar me qëllim të llogaritjes së rentës për paditësin.

Gjykata në këtë seancë, duke u bazuar në nenet 356 dhe 361 të LPK-së, ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të paditësit pasi që ka vlerësuar se për vendosjen meritore të çështjes konkrete juridike është i domosdoshëm mendimi profesional i ekspertit të përmendur.

Nga sa u tha më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gjyqtari

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

KAPITULLI XV  
**PËRGATITJA E SHQYRTIMIT  
KRYESOR**

## 15 PËRGATITJA E SHQYRTIMIT KRYESOR

Shqyrtimi kryesor paraqet fazën kryesore dhe më të rëndësishme në procedurën kontestimore. Në këtë fazë të procedurës bëhet finalizimi i veprimeve procedurale të palëve, gjykatës dhe përfundon procedura në gjykatën e shkallës së parë me sjelljen e vendimit lidhur me çështjen e iniciuar me padi.

Që shqyrtimi kryesor të përfundojë me sukses, pa zvarritje dhe sa më me pak shpenzime është e nevojshme që ai të përgatitet mirë.

### 15.1 Faza përgatitore e shqyrtimit kryesor

Zhvillimi i kësaj fazë është i detyrueshëm për gjykatën e cila fillon që nga momenti i ngritjes së padisë dhe zgjat deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor.

Përgatitja e shqyrtimit kryesor kalon nëpër katër faza:

- b. Ekzaminimi paraprak i padisë;
- c. Dërgimi i padisë palës së paditur për përgjigje në padi
- d. Mbajtja e seancës përgatitore dhe
- e. Caktimi i seancës për shqyrtim kryesor të çështjes

Me qëllim që çështja e cila është shtruar para gjykatës të përgatitet sa më mirë për t'u zgjidhur shpejt e drejt, gjyqtari i çështjes që nga momenti i marrjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor mund të merr aktvendime dhe të vendos për:<sup>237</sup>

- a) dhënien e përgjigjes në padi nga pala e paditur;
- b) sigurimin e provës;
- c) tërheqjen e padisë;
- d) ndryshimin e padisë;
- e) ndërprerjen e procedurës;
- f) pjesëmarrjen e ndërhyrësit;
- g) hyrjen e paraardhësit juridik në procesin gjyqësor;
- h) veçimin apo bashkimin e dy proceseve gjyqësore;
- i) caktimin apo zgjatjen e afateve gjyqësore;
- j) caktimin apo shtytjen e seancave;
- k) rivendosjen në gjendjen e mëparshme;
- l) masat e përkohshme të sigurimit;
- m) sigurimin e shpenzimeve procedurale;
- n) lirimin e palës nga pagimi i shpenzimeve procedurale;
- o) deponimin e paradhënies për shpenzimet e veprimeve procedurale;
- p) caktimin e ekspertit;
- q) emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm;
- r) dërgimin e shkresave gjyqësore;
- s) masat për përmirësimin dhe plotësimin e parashtresave;
- t) rregullsinë e përfaqësimit dhe të prokurës;
- u) mos kompetencën e gjykatës;
- v) bashkimin e padive;
- x) pushimin e gjykimit kur hedhet poshtë padia apo kur tërhiqet ajo, si dhe të gjitha çështjeve tjera që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit.<sup>238</sup>

Kundër aktvendimeve të dhëna gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit nuk lejohet ankimi.

---

<sup>237</sup> LPK me dispozita e nenit 387 ka përcaktuar formën e vendosjes me aktvendim për një numër veprimesh të cila i ndërmerr gjykata me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për tu zgjidhur shpejt e drejtë nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes.

<sup>238</sup> Neni 387 par 1, I LPK-së.

Në këtë fazë të procedurës i është dhënë mundësia gjyqtarit të çështjes që të merr aktgjykim në bazë të pohimit, aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, aktgjykim për mos bindje, aktgjykim për shkak të mungesës si dhe të miratojë ujdinë gjyqësore të palëve.<sup>239</sup>

### 15.1.1 Faza e shqyrtimi paraprak të padisë

Shqyrtimi paraprak i padisë është fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të cilën e bën gjyqtari i çështjes. Këtë aktivitet procedural gjyqtari e kryen pasi ta paraqes padinë paditësi. Gjyqtari shqyrtimin paraprak të padisë e bën duke e verifikuar se a janë plotësuar prezumimet procedurale në mënyrë që të mund të procedohet sipas padisë. Këtë verifikim gjyqtari e bën në bazë të dhënave që i përmban padia dhe në bazë të fakteve që i din vet gjykata.

Në bazë të materialit që e ka në disponim, gjyqtari i çështjes mund të konstatoj se ekzistojnë pengesa procedurale të cilat mund të evitohen.

Si pengesa procedurale të cilat mund të evitohen, në ligj përmenden:

- padia është e pakuptueshme apo jo e plotë;
- ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre;
- mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj,

Kur gjyqtari konstaton se ekzistojnë pengesa të tilla, për ti evituar këto mungesa merr aktvendim për masat të cilat duhet të ndërmerren e të cilat janë përcaktuara me neni 79 dhe 102 të LPK.

### 15.1.2 Hedhja poshtë e padisë si e palejueshme

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjyqtari i çështjes me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se ndonjëherë nga rrethanat e përcaktuara në nenin 391 të LPK-së.<sup>240</sup>

### 15.1.3 Shpallja jokompetente e gjykatës

Ekzistimi i kompetencës territoriale dhe i asaj lëndore për zgjidhjen e çështjes konkrete paraqet prezumim procedural, për të cilën gjyqtari i çështjes sipas detyrës zyrtare duhet të kujdeset gjatë gjithë procedurës. Në këtë fazë të procedurës, pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjyqtari i çështjes merr aktvendim me të cilin gjykatën e shpall jokompetente dhe lëndën ia dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për shqyrtimin e çështjes së ngritur me padi,<sup>241</sup> nëse konstaton:<sup>242</sup>

- 1) se nuk është e kompetencës territoriale për gjykimin e çështjes;
- 2) se nuk është e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes.

---

<sup>239</sup> Neni 388. Lidhur me këto aktgjykime shih kapitullin V.

<sup>240</sup> Gjykata do ta hedh padinë sepse të gjitha çështjet që janë trajtuar në neni 391 të LPK-së, i referohen disa prej prezumimeve nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor. Kështu çështja në pikën 1 dhe 2 i referohen prezumimeve që kanë të bëjnë me kompetencën e gjykatës, çështja në pikën 3,4 dhe 5 i referohet prezumimeve që kanë të bëjnë me objektin e kontestit, ndërsa çështja në pikën 6 dhe 7 i referohet prezumimeve që kanë të bëjnë me padinë.

Duhet theksuar së disa në këto prezumime gjykata mund ti vlerësoj para së të caktoj seancën përgatitore apo atë të shqyrtimit kryesor kur nuk e cakton seancën përgatitore, siç është rast me kompetencën e gjykatës, afatin e padisë, interesin juridik, ndërsa disa prezumimi gjykata i vlerëson edhe në seancë sepse atëherë mund të marrë dijeni për ekzistimin e një fakti të caktuar shembull se çështja është e gjykuar apo se kemi litispëndencë.

<sup>241</sup> Shih kapitullin I të doracakut që e trajton kompetencën lëndore dhe territoriale.

<sup>242</sup> Shih nenin 392 të LPK-së

#### 15.1.4 Shtyrja e vendosjes për disa çështje

Nëse gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të padisë gjyqtari i çështjes nga materiali që e posedon (nëse thënie e padisë dhe ajo që gjykatës i është njohur nuk janë të mjaftueshme për vlerësimin e çështjes së caktuar juridike) mund të mbetet pa qëndrim të qartë lidhur me ndonjë çështje procedurale, atëherë i është lënë mundësia që të shtyjë marrjen e aktvendimeve për çështje të tilla (neni 389-392 LPK) deri në paraqitjen e përgjigjes në padi, gjatë seancës përgatitore ose në seancën e shqyrtimit kryesor nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur.

#### 15.1.5 Përgjigja në padi

Kur pas shqyrtimit paraprak të padisë gjyqtari i çështjes vlerëson se padia është e rregullt dhe e plotë, atëherë me aktvendim padinë së bashku me shkresat e lëndës do t'ia dërgoj të paditurit për përgjigje në padi brenda 15 ditësh nga dita kur padia është paraqitur në gjykatë.<sup>243</sup> I padituri, pasi t'ia dorëzohet padia, me shkresat e bashkëngjitura eventualisht, ka për detyrë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi.

#### 15.1.6 Udhëzimet e gjykatës për të paditurin me rastin e dërgimit të padisë për përgjigje

Në vazhdim janë paraqitur udhëzimet e gjykatës në aktvendim për dorëzimin e padisë në përgjigje, për përmbajtjen që duhet të ketë përgjigja në padi si dhe për pasojat procedurale për mos respektim të afatit për përgjigje në padi.

- I padituri është i detyruar që në përgjigje në padi t'ia paraqet prapësimet procedurale dhe të deklaroj se e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Në qoftë se i padituri e konteston kërkesëpadinë e paditësit, përgjigja në padi duhet t'ia përmbaj faktet mbi të cilat i padituri i bazon thënie e tij dhe provat me të cilat pranohen faktet e paraqitura. Përgjigja duhet t'ia përmbaj të gjitha elementet e parapara me dispozita nga neni 99, i LPK-së.
- Në qoftë se, përgjigja në padi është e pakuptueshme apo e jo e plotë, me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veproi në pajtim me dispozitat e nenit 102, të LPK-së.
- Paralajmërohet i padituri se, në qoftë se brenda afatit të caktuar nuk e paraqet përgjigjen në padi, atëherë gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë-mosbindjes, po që se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 al.1 pikat (a), (b), (c) e LPK-së.
- Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provojë cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t'ia paraqes autorizimin në rregull.

#### 15.1.7 Kthimi i përgjigjes në padi në korrigjim dhe plotësim

Nëse përgjigja në padi nuk i përmban elementet e detyrueshme sipas udhëzimeve të dhëna nga gjykata në aktvendim për përgjigje në padi e të parapara në nenin 396 të LPK, si dhe të dhënat nga neni 99, atëherë gjyqtari i çështjes në pajtim me nenin 102 të LPK përgjigjen në padi në korrigjim dhe plotësim. Me këtë rast i padituri udhëzohet se çka duhet të korrigjojë apo plotësojë në përgjigje në padi, duke ja caktuar afatin 3 ditor brenda të cilit duhet ta kthehet përgjigja e korrigjuar.<sup>244</sup>

#### 15.1.8 Pasojat e mos korrigjimit dhe plotësimit të përgjigjes në padi

Ligji i Procedurës Kontestimore nuk përmban dispozitë konkrete lidhur me situatën kur i padituri e kthen përgjigjen në padi të paplotësuar dhe të pakorrigjuar. Mirëpo, për kundër kësaj, në raste të tilla

---

<sup>243</sup> Formulari numër I.

<sup>244</sup> Formulari numër II.

duhet të gjejnë zbatim dispozitat e nenit 102 të LPK, në atë mënyrë që përgjigja në padi do të konsiderohet e tërhequr nëse gjykatës nuk i kthehet brenda afatit prej 3 ditësh, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa u plotësuar, përgjigja në padi do të hidhet poshtë.

Në këto raste nuk merret aktvendim i veçantë por do të konsiderohet se përgjigja në padi nuk është paraqitur në kohë, gjë që do të ketë për pasojë dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë së palës sipas nenit 150 të LPK, nëse plotësohen kushtet e parapara për dhënien e tij.

### **15.1.9 Vendimet të cilat mund të jepen pas përgjigjes në padi**

Kur gjyqtari i çështjes pasi t'i arrijë përgjigja në padi, vlerëson se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë<sup>245</sup>.

Ndërsa në rastin kur nga përgjigja në padi konstatohet se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës ngase qartazi shihet se është në kundërshtim me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo faktet që botërisht janë të ditura, atëherë do të jepet vendim meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.<sup>246</sup>

## **15.2 Seanca përgatitore**

### **15.2.1 Shqyrtime të përgjithshme**

Me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e paraparë se procedura e shkallës së parë, si rregull nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj, përbëhet prej dy seancave gjyqësore:

- a) Seancës përgatitore, dhe
- b) Seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.<sup>247</sup>

Kështu tani mbajtja e seancës përgatitore, në parim, paraqitet të jetë e detyrueshme, përveç rasteve në të cilat gjykata pasi që t'i ketë arritur përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese, apo kur nga shkak i pa ndërlíkueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë që të mbahet seanca përgatitore.<sup>248</sup>

Ndarja e procesit gjyqësor në dy seancat e lartpërmendura, kryesisht ka të bëjë me aspektin ekonomik, dhe është në funksion të realizimit edhe të parimit të ekonomizimit të procedurës. Gjithsesi, në këtë fazë të procedurës, gjykata është aktive në kuptim të kontrollimit paraprak të rregullsisë së padisë si dhe përgatitjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.

### **15.2.2 Veprimet dhe autorizimet e gjykatës**

Në seancën përgatitore, pasi që të arrijë padia, gjykata ka për detyrë që të kontrollojë lejueshmërisë e padisë, si dhe faktin se janë përmbushur prezumimet procedurale për vazhdimin e mëturjeshëm të procedurës. Marrë në tërësi, në seancën përgatitore gjykata duhet të tentojë që të sqarojë:

---

<sup>245</sup> Shih nenin 398 të LPK-së

<sup>246</sup> Shih për këtë kapitullin V të doracaktit në të cilin trajtohen llojet e aktgjykimeve.

<sup>247</sup> Shih nenin 12 të LPK-së, si dhe nenin 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LPK-së, me nr. 04/L-118.

<sup>248</sup> Shih nenin 401 të LPK-së.

- a. pretendimet e palëve dhe kundërshtimet si dhe faktet e ngritura nga palët si bazë për kërkesën;
- b. se deri në çfarë mase pajtohen palët lidhur me faktet e pretenduara;
- c. se cilat janë propozimet e palëve, cilat janë provat dhe cilat fakte përmes atyre provave mëtohen të vërtetohen, dhe
- d. a ka kushte për ndërmjetësim ose zgjidhje tjetër konsensuale përmes mënyrave të tjera alternative të zgjidhjes së kontestit në fjalë,<sup>249</sup> etj.

Andaj rëndësia dhe arsyeshmëria e seancës përgatitore paraqitet të jetë në faktin se përmes kësaj seance, tentohet që të krijohen të gjitha kushtet që seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes të mbahet pa ndërprerje si dhe që gjykimi i çështjes të përfundojë në mënyrë sa më efikase.<sup>250</sup>

Ndryshe sa i përket drejtimit të procedurës, gjykata në seancën përgatitore i ka të gjitha autorizimet që i takojnë edhe në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes, siç janë autorizimi për hapjen e seancës përgatitore, për përjashtimin e publikut, për mbajtjen e rendit në seancë, për shqiptimin e dënimit me të holla për prishësit e rendit përgjatë seancës, autorizimi për marrjen e provave për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjeve procedurale, apo vendimet e tjera për drejtimin e procedurës.

### 15.2.3 Format e mbajtjes së seancës përgatitore

Sipas disa teoricienëve, seanca përgatitore mund të zhvillohet në forma të ndryshme, si p.sh., në formë të takimit në gjykatë, sqarimeve përmes telefonit, sqarimeve me shkrim, apo gojarisht, në ndonjë mënyrë tjetër. Sidoqoftë, është gjykata ajo e cila do të përcaktojë se në cilën formë do të realizohet kjo seancë, ndërsa që praktika gjyqësore e sistemit tonë juridik ka dëshmuar se seanca përgatitore zhvillohet në formë të takimit në gjykatë, me ç' rast edhe zgjidhen një mori çështjesh të caktuara të cilat duhet të trajtohen në këtë seancë.<sup>251</sup>

### 15.2.4 Caktimi dhe mbajtja e seancës përgatitore

Gjykata e cakton seancën përgatitore, pasi që të arrijë përgjigja në padi e të paditurit. E nëse i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, gjykata do ta konvokojë seancën përgatitore pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e përgjigjes me shkrim në padi.

Si rregull, seanca përgatitore duhet të mbahet më së voni brenda afatit 30 ditor nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja me shkrim e të paditurit.<sup>252</sup>

Në letërthirrjen për në seancën përgatitore, gjykata duhet t'i njoftoj palët për pasojat e mosardhjes në seancë, si dhe për detyrën e tyre që më së voni deri në përfundim të kësaj seance, ata duhet t'i parashtrojnë gjykatës:

- a) të gjitha faktet në të cilat i mbështesin kërkesat e tyre;
- b) t'i propozojnë të gjitha provat që dëshirojnë të merren gjatë procedurës,
- c) por që edhe në këtë seancë t'i sjellin të gjitha shkresat dhe sendet që dëshirojnë t'i përdorin si mjete provuese.<sup>253</sup>

---

<sup>249</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 44.

<sup>250</sup> Shih formularët praktik nr.1-14.

<sup>251</sup> Shih formularët praktik nr.4-11.

<sup>252</sup> Shih nenin 400 të LPK-së.

<sup>253</sup> Shih nenin 402 të LPK-së.

Andaj del se seanca përgatitore është faza e fundit deri kur palët mund:

- a) t'i theksojnë faktet e reja dhe t'i propozojnë provat e reja;
- b) ta ndryshojnë kërkesëpadinë;
- c) të ushtrojnë kundërpadi, apo
- d) që paditësi i ri të bashkëngjitet në kontest ose që padia të zgjerohet edhe në të paditur të tjerë.

Gjithashtu edhe gjykata, më së largu deri në përfundimin e seancës përgatitore, mund të vendos që:

- a. t'i bashkojë disa konteste për procedim të përbashkët, apo
- b. që të bëjë ndarjen për shqyrtim të veçantë të ndonjë kërkesë të një padie unike.<sup>254</sup>

Letërthirrja për në seancë përgatitore, palëve duhet tu dërgohet së paku 7 ditë para ditës në të cilën mbahet ajo.

Seanca përgatitore fillon me shtjellimin e padisë nga ana e paditësit, e pastaj edhe me shtjellimin e përgjigjes në padi të parashtruar nga ana e të paditurit. Në rast se i padituri nuk ka paraqitur përgjigje me shkrim në padi, atëherë ai në këtë seancë e parashtron përgjigjen e tij ndaj padisë së paditësit.

Në qoftë se gjykata nuk e miraton prapësimin e palës me të cilin pretendohet se ekziston ndonjëra nga pengesat për procedimin e çështjes, atëherë ajo vendimin mbi prapësimin do ta jep bashkë me vendimin mbi çështjen kryesore, me përjashtim të prapësimit të kompetencës territoriale,<sup>255</sup> ku për këtë të fundit edhe seanca duhet të ndërpritet menjëherë.

Varësisht nga rezultati i shqyrtimit në seancën përgatitore, gjykata do të vendos se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Kësisoj propozimet të cilat nuk i konsideron esenciale për dhënien e vendimit meritor, përmes aktvendimit kundër të cilit nuk lejohet ankimi i veçantë, gjykata i refuzon, njëherësh duke i treguar edhe shkaqet e refuzimit.

Duhet cekur se gjatë procedimit të mëtejshëm të çështjes, gjykata nuk është e lidhur me vendimet e dhëna në bazë të dispozitave të këtij neni, për çka ajo kurdoherë që e çmon të arsyeshme, mundet që në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, ta pranoj propozimin konkret të ndonjëres nga palët, e të cilin propozim më parë e kishte refuzuar në seancën përgatitore, apo që ta abrogojë aktvendimin për marrjen e provës, nxjerrjen e të cilës e ka caktuar në seancën përgatitore.<sup>256</sup>

Nëse gjykata me propozimin e palës, vendos që të merret prova me anë të ekspertimit, atëherë ajo e cakton edhe afatin brenda të cilit eksperti me shkrim duhet ta paraqesë konstatimin dhe mendimin e vet. Kjo arsyetohet me shkakun e ekonomizimit të procedurës, e që e ka për synim që edhe ky mjet provues të jetë i përgatitur dhe i gatshëm për seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Me rastin e caktimit të këtij afati, gjykata çdo herë do të ketë parasysh faktin se konstatimi dhe mendimi i shkruar duhet që tu dërgohet palëve se paku 7 ditë para se të mbahet seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes.<sup>257</sup>

Nëse në të njëjtën gjykatë janë në zhvillim e sipër dy apo më tepër gjykime ndërmjet personave të njëjtë, apo në të cilat i njëjti person është kundërshtari i paditësve apo i të paditurve të ndryshëm, në seancën përgatitore, apo deri në fillimin e seancës për shqyrtimin kryesor në rastet kur seanca përgatitore nuk është mbajtur, gjykata mund t'i bashkojë të gjitha ato me aktvendim me qëllim të shqyrtimit të përbashkët, nëse me një gjë të tillë do të zvogëloheshin shpenzimet dhe do të përshpejtohej shqyrtimi i çështjeve. Në këtë rast për të gjitha gjykimet e bashkuara jepet një aktgjykim i përbashkët. Për të vepruar kësisoj, nevojitet pëlqimi i palëve.<sup>258</sup>

<sup>254</sup> Shih nenet 258, 256.1, 264.2 dhe 408 të LPK-së.

<sup>255</sup> Shih nenin 404.3 të LPK-së.

<sup>256</sup> Shih nenin 406 të LPK-së.

<sup>257</sup> Shih nenin 407 të LPK-së.

<sup>258</sup> Shih nenin 408.1 të LPK-së.



Po ashtu, në seancën përgatitore gjykata mund të vendosë që të shqyrtohet në mënyrë të veçantë ndonjë kërkesë e një padie unike dhe pas shqyrtimit të tillë të jep vendime të posaçme mbi kërkesat e padisë. Edhe në këtë rast nevojitet pëlqimi i palëve.<sup>259</sup>

### 15.2.5 Çka ndodh nëse njëra nga palët nuk paraqitet në seancën përgatitore?

Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur në mënyrë të rregullt, padia e tij do të konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet. Në këtë mënyrë del se mungesa e paditësit ka për pasojë dhe tërheq në vete prezumimin për tërheqjen e padisë.<sup>260</sup>

Në anën tjetër, nëse në seancën përgatitore nuk vjen i padituri i cili është ftuar në mënyrë të rregullt, seanca vazhdon të mbahet me palën paditëse të pranishme në seancë, me kusht që kjo palë të propozoj mbajtjen e seancës në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, e i cili mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.<sup>261</sup>

### 15.2.6 Caktimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes

Në fakt, caktimi apo konvokimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, paraqet fazën e fundit të seancës përgatitore. Në këtë rast gjykata me aktvendim e cakton seancën:

- ditën dhe orën e mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes;
- çështjet që do të shqyrtohen dhe bisedohen në seancën kryesore;
- provat që do të merren në seancën kryesore, si dhe
- personat që do të thirren në seancën kryesore<sup>262</sup>

Në këtë rast, palët prezentë në seancën përgatitore njoftohen drejtpërdrejtë me përmbajtjen e këtij aktvendimi dhe atyre nuk do tu dërgohet as aktvendimi e as letërthirrja për seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes. Rrjedhimisht i bie se ndaj këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë. Në po këtë seancë, gjykata do t'i njoftojë palët e pranishme edhe për pasojat procedurale të mos ardhjes në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.<sup>263</sup>

Për seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, me letërthirrje do të ftohen palët të cilat nuk kanë qenë të pranishme në seancën përgatitore, dëshmitarët si dhe ekspertët të cilët duhet të paraqiten sipas vendimit të gjykatës për marrjen e provave përkatëse përmes tyre. Edhe në këtë rast gjykata, përmes letërthirrjes për në seancën kryesore, duhet t'i paralajmërojë palët për pasojat e mos ardhjes në seancë.

Palës e cila nuk ka qenë e pranishme në seancën e shqyrtimit përgatitor, bashkë me letërthirrjen për seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes, duhet t'i dërgohet edhe kopja e verifikuar e procesverbalit nga seanca përgatitore.

Në parim, seanca kryesore do të mbahet më së voni brenda afatit prej 30 ditëve nga dita kur është mbyllur - përfunduar seanca përgatitore. Në këtë mënyrë brenda këtij afati, i cili paraqitet të jetë i mjaftueshëm, gjykata por edhe palët do të mund të përgatiten për seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes.<sup>264</sup> Megjithatë, praktika gjyqësore ka dëshmuar se për arsye të caktuara është e mundur që seanca e shqyrtimit kryesor të mbahet edhe pas afatit prej 30 ditëve. Ky do të ishte rasti kur vetë palët i propozojnë gjykatës që seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes të caktohet pas afatit prej 30 ditëve,

---

<sup>259</sup> Shih nenin 408 të LPK-së.

<sup>260</sup> Shih nenin 409.1 të LPK-së si dhe formularët praktik nr.7 dhe 9.

<sup>261</sup> Shih nenin 409.2 të LPK-së.

<sup>262</sup> Shih nenin 420.1 të LPK-së.

<sup>263</sup> Shih nenin 421 të LPK-së.

<sup>264</sup> Shih nenin 420.2 të LPK-së.

kur gjyqtari gjendet në pushim vjetor, mjekësor apo pritët që i njëjti të mungon për arsye të caktuara, etj.

Gjykata mund të vendos që seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas mbajtjes së seancës përgatitore.<sup>265</sup> Përkitazi me këtë zgjidhje ligjore, vlen të ceket se është në vlerësimin e gjykatës se a do të mbahet seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes menjëherë pas asaj përgatitore dhe për këtë çështje nuk parashihet ndonjë kusht i posaçëm. Zakonisht gjykata do të mund të vendoste që seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas mbajtjes së seancës përgatitore, nëse nga shqyrtimi i seancës përgatitore del se:

- a) ndonjëra nga palët nuk ka legjitimacion aktiv apo pasiv në atë çështje kontestimore;
- b) ekziston parashkrimi i kërkesës, me kusht që pala të jetë thirrur në të;
- c) faktet vendimtare për vendosjen e çështjes janë jo kontestuese në mes të palëve, etj.<sup>266</sup>

Në funksion të asaj që u cek me lartë, gjykata duhet që çdo herë të shikojë mundësinë e mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, menjëherë pas mbajtjes së seancës përgatitore, sepse në këtë mënyrë procedura bëhet sa më efikase, ndërsa që në të njëjtën kohë edhe respektohet edhe parimi i ekonomizimit të procedurës.

Nëse gjykata vlerëson se shqyrtimi kryesor në një çështje kontestimore do të zgjatë më shumë se një ditë, atëherë seanca do të caktohet – konvokohet për aq ditë me radhë sa është e nevojshme që shqyrtimi të bëhet në vazhdimësi. Edhe kjo është në funksion të jetësimit të parimit të ekonomizimit në procedurës.

### 15.3 Ndërmjetësimi dhe Pajtimi Gjyqësor

#### 15.3.1 Ndërmjetësimi në procedurën gjyqësore

Ndërmjetësimi përfaqëson një mënyrë alternative të zgjidhjes së kontesteve. Në shumicën e vendeve të Evropës kjo mënyrë e zgjidhjes së kontesteve aplikohet me sukses si në çështjet civile, e poashtu edhe në çështjet penale, administrative e të tjera.<sup>267</sup>

Ndërmjetësimi në të drejtën tonë ka filluar të zbatohet me miratimin e Ligjit për Ndërmjetësim, nr.03/L-057, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 18.09.2008, ndërsa i dekretuar nga Presidenti i Republikës më 03.10.2008.<sup>268</sup>

Përmes ndërmjetësimit tentohet që kontestet e ndryshme të zgjidhen jashtë gjykatës dhe me ndërmjetësimin e personit të tretë (ndërmjetësuesit), i cili duhet të jetë i aftësuar profesionalisht për kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit për zgjidhjen e kontesteve.

Në Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK), ndërmjetësimi dhe procedura e ndërmjetësimit është e paraparë me nenin 411 të tij.<sup>269</sup> Në bazë të këtij neni del se po që se gjykata e gjen të nevojshme, atëherë ajo më së voni në seancën përgatitore, duke marrë parasysh natyrën e kontestit dhe rrethanat e tjera, mund t'iu propozojë palëve ndërgjyqëse që kontestin ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit të rregulluar me Ligjin mbi Ndërmjetësimin. Përrjashtimisht gjykata këtë propozim mund t'ua bëjë palëve edhe në seancën për shqyrtimin kryesor në qoftë se seanca kryesore nuk është mbajtur.

Megjithatë duke pasur parasysh faktin se qëllimi i ndërmjetësimit është kursimi i kohës dhe i shpenzimeve, si për palët ashtu edhe për gjykatën, duhet bërë përpjekje që propozimi i këtillë për zgjidhjen e kontestit në procedurën e ndërmjetësimit të bëhet në fazën e procedurës (përgatitore) kur

---

<sup>265</sup> Shih nenin 420.3 të LPK-së.

<sup>266</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 723.

<sup>267</sup> Shih komentarin e LPK-së, Iset Morina & Selim Nikçi, Prishtinë, 2012, faqe 709.

<sup>268</sup> Shih Ligjin për Ndërmjetësim Nr.03/L-057.

<sup>269</sup> Shih nenin 411 të LPK-së.

ende nuk janë bërë shpenzime të konsiderueshme për palët (p.sh. të evitohet faza pasi që është kryer ekspertiza e cila ka koston e vet). Sidoqoftë, meqenëse edhe përmes procedurës së ndërmjetësimit, kontesti në mes të palëve mund të zgjidhet në mënyrë të përhershme, gjykata përjashtimisht do të duhej tua lejojë mundësinë palëve që përmes procedurës së ndërmjetësimit, të tentojnë ta zgjidhin kontestin që kanë në mes vete. Në fund të fundit, kjo do të ishte edhe në funksion të jetësimit të gjithmbarshëm të parimit të disponibilitetit të palëve, përmes të cilit parim palët disponojnë me kërkesat e tyre përgjatë tërë procedurës kontestimore dhe jo vetëm.

Zgjidhjen e kontestit me anë të ndërmjetësimit mund ta propozojnë edhe vetë palët me marrëveshjen e tyre, e krejt kjo bazuar në parimin e disponibilitetit, i cili është një nga parimet bazë të procedurës kontestimore. Propozimin e këtillë palët mund ta bëjnë deri në përfundimin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, sepse është në dispozicionin e tyre që të vendosin që në cilën fazë të procedurës dhe në cilën mënyrë palët dëshirojnë ta përfundojnë kontestin.<sup>270</sup>

### 15.3.2 Pajtimi gjyqësor

Kontesti ndërmjet dy palëve mund të përfundojë edhe me pajtim gjyqësor mbi objektin e kontestit, përkatësisht mbi tërë kërkesëpadinë apo vetëm mbi një pjesë të saj.

Pajtimi gjyqësor mund të lidhet gjatë tërë procedurës.<sup>271</sup> Kjo do të thotë se pajtimi gjyqësor mund të lidhet si para gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe gjatë procedurës e cila zhvillohet sipas mjeteve juridike, pra deri në përfundimin e procedurës me vendim të plotfuqishëm. Sidoqoftë pajtimi gjyqësor mund të lidhet edhe në gjykatën e shkallës së dytë, në rastet kur kjo gjykatë e hap shqyrtimin e drejtpërdrejtë të çështjes.<sup>272</sup>

Pajtimi gjyqësor i ka efektet e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe ka fuqinë e titullit përmbarues. Me arritjen e pajtimit gjyqësor kontesti përfundon, kështu që kontesti i ri ndërmjet palëve të njëjta dhe me objekt të njëjtë nuk mund të iniciohet. Gjykata për këtë çështje kujdeset sipas detyrës zyrtare gjatë gjithë procedurës.

Lidhur me çështjen e vendosur me aktgjykim të plotfuqishëm, në bazë të nenit 391 të LPK-së, parashihet se nuk mund të zhvillohet procedurë gjyqësore, mirëpo palët kanë të drejtë që të lidhin pajtim gjyqësor edhe pasi që aktgjykimi për të njëjtën çështje të ketë marrë formën e prerë. Kjo për arsye se palët kanë të drejtë që raportet e tyre t'i rregullojnë në mënyrën tjetër nga ajo që është vendosur me aktgjykim.

Roli i gjykatës në arritjen e marrëveshjes në mes të palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e kontestit është mjaftë aktiv, me ç'rast parashihet se gjykata gjatë gjithë procedurës duhet të bëjë përpjekje për zgjidhjen e kontestit përmes pajtimit gjyqësor, kur e lejon natyra e çështjes. Në funksion të kësaj del se gjykata gjatë gjithë procedurës do t'u sugjerojë palëve për mundësinë e lidhjes së pajtimit gjyqësor dhe do t'i ndihmojë ato në arritjen e pajtimit.

Megjithatë gjykata gjithmonë duhet ta ruajë paanshmërinë gjatë angazhimit për zgjidhjen e kontestit me pajtim gjyqësor. Kështu gjykata në asnjë mënyrë nuk guxon që për arritjen e pajtimit, ndaj palëve të ushtrorë ndikim apo presion, që ndonjëherë prej palëve ta detyrojë në lidhjen e pajtimit, i cili do të ishte në kundërshtim me interesin e asaj pale.

Pajtimin gjyqësor të arritur në mes të palëve për çështjen konkrete, gjykata e miraton me aktvendim. Sidoqoftë, duhet të ceket se palët nuk mund ta zgjedhin kontestin e tyre me anë të pajtimit gjyqësor kur kërkesëpadia ka të bëjë me të drejtat me të cilat ato palë nuk mund të disponojnë lirisht, respektivisht në rastet kur disponimet e palëve janë në kundërshtim me:

- a) rendin juridik;
- b) dispozitat ligjore, dhe

---

<sup>270</sup> Shih nenin 411 të LPK-së, si dhe shtojcat 1 - 5.

<sup>271</sup> Shih nenin 412 të LPK-së, si dhe formularin praktik nr.6.

<sup>272</sup> Shih nenin 415.3 të LPK-së.

c) rregullat e moralit publik <sup>273</sup>.

Në rastet kur gjykata nuk e miraton pajtimin gjyqësor, atëherë procedura në lidhje me atë çështje kontestimore ndalet derisa të mos bëhet i formës së prerë vendimi (i posaçëm) mbi refuzimin e pajtimit gjyqësor të propozuar. Kundër këtij aktvendimi të gjykatës, lejohet ankesa e posaçme.

Marrëveshja e palëve mbi pajtimin gjyqësor, përfshihet në procesverbalin gjyqësor. Pajtimi gjyqësor quhet i përfunduar në momentin kur palët pasi që e lexojnë procesverbalin mbi pajtimin, e nënshkruajnë procesverbalin gjyqësor. Palëve gjithnjë u jepet kopja e verifikuar e procesverbalit, në të cilin është përfshirë pajtimi gjyqësor.

Me futjen e pajtimit gjyqësor në procesverbalin gjyqësor dhe me nënshkrimin e tij nga ana e palëve ndërgjyqëse, pajtimi i merr të gjitha karakteristikat e një kontrate detyrimore dypalëshe. Shih për këtë, në teorinë juridike, e përkrahur edhe nga disa praktika gjyqësore të shteteve në regjion, ka mendime se gjykata nuk ka nevojë që të merr aktvendim për lejimin apo aprovimin e pajtimit të tillë. Sipas këtyre teoricienëve, gjykata duhet të marrë aktvendim vetëm në rastet kur nuk e lejon lidhjen e pajtimit gjyqësor, e jo edhe në rastet kur e lejon apo aprovon atë. Sidoqoftë, me dispozitat e LPK-së, në mënyrë decisive parashihet se gjykata me anë të aktvendimit e miraton pajtimin gjyqësor.<sup>274</sup>

Pajtimi gjyqësor duhet të përmbajë marrëveshjen për të gjitha kërkesat kryesore si dhe për ato aksesore, përfshirë këtu edhe marrëveshjen për shpenzimet procedurale. Në qoftë se palët nuk mund të merren vesh rreth shpenzimeve, ato mund të kërkojnë që vendimin për shpenzimet ta jep gjykata. Në këtë rast, gjykata është e detyruar që vendimin për shpenzimet ta merr menjëherë dhe që të njëjtin ta përfshijë në procesverbal. E në rast se palët nuk merren vesh për shpenzimet e procedurës dhe nuk propozojnë që për këtë çështje të vendos gjykata, atëherë secila palë do t'i bartë shpenzimet e veta procedurale, sepse gjykata nuk mund të vendos jashtë autorizimeve të saja ligjore.

Gjatë gjithë procesit gjyqësor, gjykata ka për obligim që të kujdeset ex officio, nëse procesi është duke u zhvilluar lidhur me kërkesëpadinë për të cilën më parë është arritur pajtimi gjyqësor. Po që se gjykata konstaton se për të njëjtin kërkesëpadi, më herët është arritur pajtimi gjyqësor, atëherë ajo e hedh poshtë padinë e parashtruar pranë saj.<sup>275</sup> Kjo ngase pajtimi gjyqësor i prodhon të gjitha efektet juridike sikurse edhe aktgjykimi i plotfuqishëm, prandaj pa marrë parasysh faktin se pajtimi gjyqësor, ndër të tjera, i ka elementet e kontratës detyrimore dypalëshe, palët e njëjta nuk mundin që për objektin e njëjtë, përmes pajtimit të ri, t'i eliminojnë efektet e plotfuqishmërisë së pajtimit të mëparshëm.

Edhe pse ka efekt juridiko - procedural të njëjtë sikurse aktgjykimi i plotfuqishëm dhe paraqet titull përmbarues, pajtimi gjyqësor megjithatë nuk konsiderohet si vendim gjyqësor, por si marrëveshje – kontratë e palëve ndërgjyqëse e lidhur në gjykatë dhe e përfshirë në procesverbal. Andaj ngjashëm sikurse kontrata, pajtimi gjyqësor mund të goditet vetëm me anë të padisë, e jo edhe përmes ankesës.

Pajtimi gjyqësor anulohet në rastet kur ai është arritur nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit apo dhunës. Pajtimi gjyqësor anulohet edhe po që se në arritjen e tij ka marrë pjesë pala me pazotësi procedurale, apo nëse palën e tillë nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor apo nëse palën e ka përfaqësuar personi i pa autorizuar, ose personi që nuk ka pasur autorizimin e nevojshëm për kryerjen e veprimeve procedurale të veçanta, përveç rasteve kur veprimet e tilla janë aprovuar më vonë nga vet pala. Në bazë të të lartcekurave del se si shkaqe për goditjen e pajtimit gjyqësor, paraqiten të jenë ato për të cilat sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), mund të goditen kontratat.

Padia për anulimin e pajtimit gjyqësor mund të ngrihet:

- brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e marrjes së dijenisë për shkakun e anulimit (afati subjektiv);

---

<sup>273</sup> Shih nenin 414.2 të LPK-së si dhe formularët praktik nr.7 dhe 8.

<sup>274</sup> Shih nenin 414.1 të LPK-së.

<sup>275</sup> Shih nenin 417 të LPK-së.

- më së voni brenda afatit prej 1 viti, nga dita e përfundimit të pajtimit gjyqësor (afati objektiv),<sup>276</sup>

Personi që e ka ndërmend që të ngrisë padi, mundet që përmes gjykatës së shkallës së parë në territorin e së cilës pala kundërshtare e ka vendbanimin, të përpiqet që të bëjë pajtim gjyqësor. Pra në këtë rast fjala është për mundësinë dhe procedurën e lidhjes së pajtimit gjyqësor para se të ngrihet padia. Propozimi i tillë duhet të përmbajë në vete edhe ofertën me projektin e pajtimit i cili propozohet. Në këtë rast, gjykata të cilës i është paraqitur propozimi i tillë, do ta thërras palën kundërshtare dhe do ta njoftojë atë me propozimin për pajtim gjyqësor. Pajtimi i lidhur në këtë mënyrë gjithashtu quhet pajtim gjyqësor dhe i njëjti i ka në vete të gjitha veçoritë dhe efektet juridike të pajtimit gjyqësor të arritur pas ngritjes së padisë.<sup>277</sup>

Shpenzimet e kësaj procedure i bartë paraqitësi i propozimit.<sup>278</sup>

### 15.3.3 Konvokimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes

Shqyrtimi kryesor është faza qendrore e procedurës kontestimore. Atë e bëjnë veprimet procedurale të gjykatës dhe të palëve, të kryera në një apo më tepër seanca, me qëllim të shoshitjes dhe shqyrtimit të fakteve nga të cilat varet themelësia e kërkesëpadisë.

Gjyqtari i çështjes seancën për shqyrtim kryesor të çështjes e konvokon me aktvendim, të cilin e jep në fund të seancës përgatitore, përkatësisht para përfundimit të saj.

Model i aktvendimit për konvokim të seancës për shqyrtim kryesor

Seanca për shqyrtim kryesor të çështjes ...

Koha e mbajtjes së seancës

Dita dhe ora: [ ... ]

Përshkrimi i objektit të shqyrtimit kryesor

Çështjet të cilat konsiderohen relevante për vendosjen e çështjes kontestuese,

Provat të cilat do të nxirren në seancën e shqyrtimit kryesor

Personat të cilët duhet të thirren në seancën e shqyrtimit kryesor

Gjyqtari në seancë përgatitore, varësisht nga rezultati i shqyrtimit, do të nxjerrë përfundim se për çfarë do të bisedohet gjatë shqyrtimit kryesor dhe cilat prova do të nxirren në seancën për shqyrtim kryesor.

Krejt ajo çka përmban aktvendimi mbi konvokimin e seancës kryesore palët që kanë qenë të pranishme në seancë përgatitore janë njoftuara nga diktimi me zënë në procesverbal të seancës përgatitore apo me leximin e tij para se ta nënshkruajnë.

Palëve të tilla nuk ka nevojë që t'u dërgohet aktvendimi për konvokimin e seancës kryesore e as thirrje për seancë.

Për seancë kryesore thirren palët të cilat nuk kanë marrë pjesë në seancën përgatitore, si dhe ekspertët dhe dëshmitarët të cilët duhet të paraqiten në gjykatë sipas aktvendimit për marrjen e provës e të cilët janë paraparë në aktvendimin për konvokimin e seancës kryesore.

<sup>276</sup> Shih nenin 418 të LPK-së.

<sup>277</sup> Shih nenin 419 të LPK-së.

<sup>278</sup> Shih nenin 419.3 të LPK-së.

Palët të cilat nuk kanë qenë të pranishme në seancë përgatitore si dhe personat e tjerë, të cilët është paraparë që të thirren për seancë kryesore, gjykata në letërthirrje do ti paralajmërojë për pasojat e mos ardhjes në seancë.

Palëve të cilat nuk kanë qenë prezent në seancën përgatitore, bashkë me letërthirrje për seancë kryesore u dërgohet edhe kopja e procesverbalit e verifikuar nga seanca përgatitore në të cilin është përfshirë aktvendimi për konvokim të seancës kryesore.

Si rregull seanca kryesore duhet të mbahet më së voni brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore, mirëpo është paraparë mundësia që gjyqtari i çështjes, varësisht nga vlerësimi i tij, seancën kryesore ta mbajë në vazhdim të seancës përgatitore.

Disa nga rastet kur gjyqtari i çështjes mund të vendos që seancën kryesore ta mbaj menjëherë në vazhdim të seancës përgatitore;

- nëse nga rezultati i seancës përgatitore vërtetohet se njëra nga palët nuk ka legjitimacionin aktiv apo pasiv në kontest.
- nëse vërtetohet se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës dhe ka kundërshtim lidhur me të dhe
- nëse konstatohet se faktet vendimtare për vendosjen e çështjes janë jo kontestuese në mes të palëve etj.

## 15.4 Zhvillimi i shqyrtimit kryesor

### 15.4.1 Hapja e seancës për shqyrtim kryesor

Gjyqtari i çështjes e hap seancën dhe e shpall objektin e shqyrtimit, i cili mund të jetë p.sh. kompensimi i dëmit, përmbushja e kontratës, anulimi i kontratës etj., e pas kësaj konstaton se a kanë ardhur të gjithë personat e thirrur.

Pas hapjes së seancës kryesore gjyqtari i çështjes konstaton se a janë plotësuar kushtet për mbajtjen e saj, dhe atë duhet që të verifikohet se:

- a janë prezentë të gjithë personat e ftuar për shqyrtim kryesorë (palët, përfaqësuesit e tyre ligjorë, përfaqësuesit me prokurë, ndërhyrësit, ekspertët etj.)
- nëse ndonjëri nga personat e ftuar nuk është i pranishëm në shqyrtim kryesor duhet të konstatohen shkaqet e mosparaqitje, (një verifikim i tillë bëhet në bazë të informatave nga fletë dorëzimet, nga përfaqësuesit ligjor dhe personat e tjerë)
- të verifikoj rregullsinë e thirrjeve për ata të cilët nuk janë prezantuar në seancë.

Në rastet kur paditësi nuk vjen në seancë kryesore, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, konsiderohet se e ka tërhequr padinë. Në këtë rast, nëse pala e paditur nuk propozon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit, gjyqtari i çështjes në procesverbal merr aktvendim me të cilin konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë.<sup>279</sup> Seanca kryesore mund të mbahet edhe në mungesë të paditësit, kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të tij.

---

<sup>279</sup>LPK, me dispozitën e nenit 423 par. 3 ka përcaktuar së: në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.

Nëse në seancën e shqyrtimit kryesor nuk vjen i padituri, i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes mbahet pa praninë e tij.

Paraprakisht gjyqtari, sipas prapësimit të palës dhe sipas detyrës zyrtare, konstaton se a ekzistojnë pengesa procedurale për procedimin e mëtutjeshëm të çështjes.<sup>280</sup>

Si rregull gjykata lidhur me pengesat procedurale vendos gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ose në seancë përgatitore, mirëpo në qoftë se në bazë të thënieve të palëve, provave të ofruara dhe në bazë të asaj që gjykatës i është njohur nuk mund të merr vendim në atë fazë të procedurës, gjyqtari i çështjes mund të vendos që vendimin për pengesat procedurale ta marr gjatë shqyrtimit kryesor.

Ka raste kur gjykata dhe palët për ekzistimin e pengesave procedurale mund të mësojnë pas seancës përgatitore, prandaj duhet që t'u jepet mundësia palëve që edhe pas seancës përgatitore t'i theksojnë kundërshtimet e tilla dhe gjykata e ka mundësinë që sipas detyrës zyrtare edhe në këtë fazë të procedurës të konstatohej nëse ekzistojnë pengesa të tilla.

Sa herë që gjykata, në këtë fazë të procedurës, sipas prapësimit të palëve apo sipas detyrës zyrtare, konstaton se ekzistojnë pengesa procedurale për procedim të mëtutjeshëm të çështjes atëherë vepron sipas nenit 391 të LPK.

Nëse gjyqtari në këtë fazë të procedurës e mëson se ekziston ndonjë pengesë procedurale e paraparë në nenin 391 të LPK, atëherë merr aktvendim me të cilin padinë e hedhë poshtë si të palejueshme

#### **15.4.2 Zhvillimi i shqyrtimit kryesor në rastet kur nuk është mbajtur seanca përgatitore**

Nëse më parë nuk është mbajtur seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor do të zhvillohet në mënyrën e përcaktuar si më poshtë:

- paditësi jep shpjegime të thukta rreth kërkesave të parashtruar në padi;
- i padituri në mënyrë të thuktë e paraqet përgjigjen në padi;
- po që se është propozuar marrja e provës me anë të dëgjimit të palëve, së pari pyetet paditësi e mandej i padituri;
- merren në pyetje dëshmitarët, së pari ata të propozuar nga pala paditëse e mandej ata të propozuar nga pala e paditur;
- merren provat e tjera, përfshirë edhe ekspertimin;
- pas marrjes së të gjitha provave, të dy palët, por së pari paditësi e mandej i padituri, i drejtohen gjykatës me shpjegimet përfundimtare, me të cilat i përmbledhin aspektet faktike dhe juridike të çështjes kryesore;
- gjykata mund t'i lejoj paditësit që shkurtimisht të deklarohej lidhur me fjalën përfundimtare të palës së paditur;
- po që se paditësi i është lejuar deklarimi rreth fjalës së fundit të palës së paditur, atëherë edhe kësaj i lejohej që shkurtimisht të deklarohej rreth thënieve të fundit të palës paditëse.<sup>281</sup>

Mirëpo përkundër radhës së përcaktuar për marrjen e provave, në praktikë gjyqtari i çështjes ka mundësi që me aktvendim procedural kundër të cilit nuk lejohet ankesa që të vendos që marrja e provave të kryhet sipas një radhe tjetër.

Kjo në praktikë ndodhë jo rrallë herë që gjyqtari duhet ta shmang një renditje të tillë të marrjes së provave. Kjo mund të ndodhë si në situatat e paraqitura më poshtë:

---

<sup>280</sup>Neni 424 I LPK.

<sup>281</sup>Neni 425 par 1, i LPK-së.

- Kur në shqyrtim kryesor, për shkak të mungesës të një prove (p.sh për shkak të mungesës së dëshmitarit), paraqitet nevoja që më parë të merret një provë tjetër (p.sh të lexohet ekspertiza dhe të dëgjohet eksperti), kurse dëgjimi i dëshmitarit do të bëhet në seancën tjetër të shqyrtimit kryesor.
- Këqyrja në vend shpesh herë duhet të bëhet para se të merren provat tjera dhe në disa raste duhet të përjashtohet radha e marrjes së provave ku duhet të merren më parë më shumë prova për vërtetimin e një fakti.

#### 15.4.3 Drejtimi i shqyrtimit kryesor

E përbëjnë veprimet procedurale me anë të të cilave gjykata e drejton fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e shqyrtimit kryesor.

Sipas dispozitave ligjore të LPK-së autorizimet për drejtimin e procedurës në shqyrtim kryesor në aspektin proceduralo-juridik dhe materialo-juridik në shkallë të parë i ka gjyqtari i çështjes. Përjashtim nga kjo bën rasti kur kemi të bëjmë për zgjidhjen e martesës dhe në rastet kur objekt shqyrtimi është kërkesa për ruajtje dhe kujdesin ndaj fëmijëve të mitur, në të cilat konteste procedura edhe në shkallë të parë zbatohet nga kolegji (neni 324 i LF).

Shqyrtimi i gjithanshëm i çështjes juridike dhe përfundimi i tij në një seancë gjyqësore është i mundur vetëm nëse gjyqtari i zgjedh si duhet mjetet dhe mënyrën e drejtimit të gjykimit.

Gjyqtari ka për detyrë që të kujdeset që shqyrtimi kryesor të zhvillohet në mënyrë të rregullt, pa zvarritje dhe pa shtyrje të panevojshme. Këto qëllime mund të arrihen atëherë kur gjyqtari i çështjes kujdeset që në seancën për shqyrtim kryesor të shqyrtohen vetëm çështjet të cilat janë me rëndësi për marrjen e vendimit dhe assesi mos të lejohet që palët me shpjegime dhe parashtrime të panevojshme qoftë gjatë shpjegimeve të padisë apo paraqitjes së përgjigjes në padi, gjatë dëgjimit të dëshmitarëve apo të palëve ose gjatë paraqitjes së fjalës përfundimtare, të ndikojnë në zvarritje të procesit dhe zhvillimit normal të kontestit.

Gjykata ka për detyrë që të kujdeset për mbajtjen e rendit në shqyrtim kryesor që paraqet një nga kushtet për zhvillimin normal të procedurës. Mbajtja e rendit konsiston në pengimin e sjelljeve jo korrekte, jo dinjitoze dhe të pahijshme të secilit që merr pjesë në shqyrtimin kryesor si dhe në ruajtjen e dinjitetit të gjykatës dhe pjesëmarrësve në procedurë. Në këtë fazë të procedurës gjyqtari i çështjes mund të marrë masa ndaj personave të cilët e shkelin rendin në gjykatë ose cenojnë dinjitetin e gjykatës dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë.<sup>282</sup>

#### 15.4.4 Zhvillimi i procedurës në shqyrtim kryesor

Gjatë shqyrtimit kryesor në përgjithësi veprimet procedurale të palëve dhe të gjykatës ndërmerren gojarisht (palët gojarisht i paraqesin shpjegimet themelore nga padia dhe nga përgjigja në padi, ato gojarisht i paraqesin provat për provimin e fakteve, gojarisht deklarohen lidhur me rezultatin e provave dhe gojarisht e paraqesin fjalën përfundimtare dhe njëkohësisht edhe gjyqtari i çështjes gojarisht komunikon me palët). Përjashtimisht shqyrtimi kryesor nuk zhvillohet gojarisht në rastet kur personi është i shurdhër apo i verbër dhe për shkak të këtyre kufizimeve duhet që pyetjet apo përgjigjet ti parashtrihen në formë të shkruar.

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor provat merren drejtpërdrejt para gjykatës përkatësisht para gjyqtarit të çështjes. Përjashtim nga kjo marrje e drejtpërdrejt e provave bëhet në rastin kur prova është dashur të merret nga gjykata e porositur apo kur është bërë sigurimi i provës para ngritjes së padisë.

---

<sup>282</sup> Shih kap. Për mosrespektimin e gjykatës dhe masat që ndërmerren



Në këto raste prova nuk merret drejtpërdrejtë në gjykatën, e cila do të vendos lidhur me objektin e kontestit por para kësaj gjykate do të lexohen procesverbalet për provat e marra para gjykatës tjetër.

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor palët në shpjegimet e veta duhet t'i parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat i mbështesin arsyetimet e propozimeve dhe i propozojnë të gjitha provat me të cilat mendojnë që ti vërtetojnë ato fakte si dhe të deklarohen lidhur me faktet dhe provat e palës tjetër.

Palët gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor mund të paraqesin fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm po që se e bëjnë të besueshme rrethanën se pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti paraqesin, respektivisht propozojnë në seancën përgatitore.<sup>283</sup> Nga kjo rrjedh se faktet të cilat nuk janë theksuar dhe provat të cilat nuk janë propozuar në seancë përgatitore, si rregull, nuk do të mund të theksohen, gjegjësisht të propozohen në fazën e shqyrtimit kryesor.

Përrjashtime mund të bëhen në rastet kur palët janë në gjendje të provojnë se faktet e reja të cilat i theksojnë dhe provat e reja të cilat i propozojnë në shqyrtim kryesor, pa fajin e tyre nuk kanë mundur t'i theksojnë gjegjësisht t'i propozojnë në seancë përgatitore.

Disa nga rastet e tilla mund të jenë:

- Pala mund të theksojë faktet e reja nëse kemi të bëjmë me ato fakte të cilat pala nuk i ka ditur dhe nuk ka mundur ti dijë, deri në seancën përgatitore,
- Mund të propozoj prova të reja nëse e provon se ato nuk ka mundur t'i siguroj deri në seancën përgatitore (p.sh nëse pala me kohë ka kërkuar nga organi kompetent dokumentin e caktuar apo të dhëna nga regjistri përkatës zyrtar, por të cilat i janë dhënë pas përfundimit të seancës përgatitore),

### 15.4.5 Mënyra e marrjes në pyetje të palëve në shqyrtim kryesor

Meqenëse palët janë ato të cilat kanë interes për nxjerrjen e provave, roli udhëheqës në marrjen në pyetje të palëve u jepet përfaqësuesve të tyre (përfaqësuesit me prokurë dhe përfaqësuesit ligjor) si dhe vet palëve. Nëse pala ka përfaqësues me prokurë apo përfaqësues ligjor, atë së pari e merr në pyetje përfaqësuesi i saj, e pastaj e pyet pala kundërshtare. Nga kjo rrjedh përfundimi se gjykata palën e pyet pasi që të pyetën përfaqësuesit e saj edhe pala tjetër, mirëpo gjykata ka mundësi që palën ta pyet në të gjitha fazat e marrjes në pyetjeje. Palën e cila nuk ka përfaqësues së pari e pyet gjykata e pastaj pala kundërshtare ose përfaqësuesi i saj.

### 15.4.6 Rrjedha e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve në shqyrtim kryesor

Gjyqtari i çështjes së pari ia jep fjalën palës e cila e ka propozuar dëshmitarin apo ekspertin, mandej palës kundërshtare, e më pastaj po që se ka nevojë, përsëri palës që e ka propozuar.<sup>284</sup>

### 15.4.7 Roli i gjyqtarit me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve

Palët janë ato të cilat i bëjnë pyetje njëra tjetrës si dhe dëshmitarëve dhe ekspertëve, mirëpo sipas dispozitës së nenit 432 të LPK-së gjyqtari në të gjitha fazat e marrjes në pyetje mund t'u bëj pyetje palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Përveç autorizimeve nga ky nen, në pikëpamje të marrjes në pyetje të palëve dëshmitarëve dhe ekspertëve, gjyqtari ka autorizim që personave të cilët dëgjohen në këto cilësi t'u bëj pyetje të përgjithshme, t'ua tërheq vërejtjen se kanë për detyrë ta thonë të vërtetën dhe i pyet palët të cilat nuk kanë përfaqësues me prokurë.

Gjatë drejtimit të shqyrtimit kryesor gjyqtari i çështjes ka këto autorizime ligjore;

---

<sup>283</sup> Shih nenin 428.2 të LPK-së

<sup>284</sup> Shih nenin 431.2 të LPK-së

- nuk e lejon kryerjen e veprimeve procedurale të cilat nuk janë qenësore për procesin gjyqësor
- nuk lejon të bëhen pyetje në të cilat përmbahen sugjerimet se si duhet dhënë përgjigjja në to (pyetjet sugjестive)
- nuk lejon të bëhen pyetje që janë të parëndësishme për çështjen dhe në të cilat janë dhënë përgjigjet.
- me kërkesën e palës, në procesverbal regjistrohen pyetjet të cilat nuk i ka lejuar gjyqtari.
- nuk lejon fyerjen dhe shqetësimin e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve me rastin e marrjes në pyetje.<sup>285</sup>

#### 15.4.8 Shtyrja dhe vazhdimi i seancës gjyqësore për shqyrtim kryesor

Shkaqet për shtyrjen e seancës janë të shumta. Gjyqtari mund ta shtyjë seancën e konvokuar për shqyrtim kryesor para se të fillojë ajo po që se konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për mbajtjen e saj dhe pamundësia e sigurimit të provave për marrjen e tyre në këtë seancë.

Mund të konsiderohet se nuk ekzistojnë prezumimet procedurale për mbajtjen e seancës për shqyrtim kryesor në këto situata:

- Nëse gjyqtari i çështjes është i sëmurë
- Nëse palët nuk janë ftuar me rregull
- Nëse ndonjëra nga palët për shkaqe të arsyeshme është penguar të marrë pjesë në seancë, lidhur me çka gjykata është njoftuar me kohë
- Nëse seanca gabimisht është caktuar të mbahet në ditët e ndonjërës nga festat shtetërore

Seanca për shqyrtim kryesor mund të shtyhet edhe në rast se provat marrja e të cilave është caktuar nga gjykata, nuk kanë mundur të sigurohen para fillimit të seancës.

Situata të tilla mund të vijnë në shprehje kur:

- dëshmitarët apo ekspertët nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt,
- eksperti nuk e ka dorëzuar konstatimin dhe mendimin e kërkuar, dhe
- nuk janë siguruar dokumentet shkresore të cilat gjykata i ka kërkuar nga personi i tretë apo organi shtetëror,

Gjykata ka për detyrë që më së voni 7 ditë para fillimit të seancës për shqyrtim kryesor ta verifikojë nëse ekzistojnë shkaqet për shtyrjen e seancës. Këtë gjykata mund ta bëj kur ajo ka dijeni para seancës, p.sh. kur palët apo pjesëmarrësit tjerë nuk janë ftuar me rregull për seancë ose disa prova nuk kanë mundur të sigurohen (eksperti nuk e ka dorëzuar konstatimin dhe mendimin profesional, gjykata nuk ka mundur ta sigurojë dokumentin apo të dhënat e caktuar nga organi i tretë ose nga organi përkatës shtetëror). Gjykata mundet që ta shtyjë seancën e shqyrtimit kryesor edhe në ditën në të cilën është caktuar mbajtja e saj nëse nuk ka qenë e mundur që në afat prej shtatë ditësh para fillimit të seancës të konstatohet se nuk ekzistojnë prezumime ligjore për mbajtjen e saj (p.sh. ku për shkak të dështimit të shërbimit të dorëzimit të ftesave, gjykata nuk e ka pasur të ditur 7 ditë para fillimit të seancës se ndonjëri nga palët apo nga pjesëmarrësit tjerë në procedurë nuk është ftuar me rregull etj.).

Nëse gjykata e shtynë seancën ajo ka për detyrë që menjëherë ta caktoj datën për mbajtjen e seancës së re dhe që për tjetrën t'i njoftoj të gjithë personat që kane qenë të ftuar për seancën e shtyrë.

---

<sup>285</sup> Neni 433 i LPK-së.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**

## 15.5 Formularët praktikë lidhur me shqyrtimin kryesor

### Formulari 1- Aktvendim për përgjigje në padi

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit/ve \_\_\_\_\_, kundër të paditurit/ve \_\_\_\_\_, për anulim vendimi, gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim përgatitor-kryesor, me datë \_\_\_\_\_, merr:

#### AKTVENDIM

- I. DETYROHET i padituri \_\_\_\_\_ nga Prishtina, Rr" Nëna Terezë, që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat, të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi, t'i paraqesë gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar, në 2 (dy) ekzemplar, nën kërcënim të pasojave procedurale.
- II. I padituri është i detyruar që në përgjigje në padi t'i paraqesë prapësimet procedurale dhe të deklarojë se e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Në qoftë se, i padituri e konteston kërkesëpadinë e paditësit, përgjigjja në padi duhet t'i përmbajë faktet mbi të cilat i padituri i bazon thëniet e tij dhe provat me të cilat pranohen faktet e paraqitura. Përgjigjja duhet t'i përmbajë të gjitha elementet e parapara me dispozitat nga neni 99, i LPK-së.
- III. Në qoftë se, përgjigjja në padi është e pakuptueshme apo e jo e plotë, me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 102, të LPK-së.
- IV. Paralajmërohet i padituri se në qoftë se brenda afatit të caktuar në pikën I. të këtij aktvendimi nuk e paraqet përgjigjen në padi, atëherë gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë-mosbindjes, po që se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 al.1 pika (a), (b), (c) e LPK-së.
- V. Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provojë cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t'ia paraqes autorizimin në rregull.

#### Arsyetim

Gjykatësi i çështjes, në pajtim me dispozitat e nenit 394, 395, al.1 dhe 2, 396, 397, 99, 102, 150 al.1 pika (a), (b) dhe (c), 77 al.2, 93 al.1 dhe 387 al.1 pika (a) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

UDHËZIMI JURIDIK:  
Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 2 - Aktvendim më të cilin i kthehet në plotësim paditësit padia

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_, lidhur me çështjen \_\_\_\_\_, gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim përgatitor-kryesor, me dt. \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Të paditurës \_\_\_\_\_ i KTHEHET në korrigjim dhe plotësim përgjigja në padie dt. \_\_\_\_\_, në afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në drejtim të rregullimit të përmbajtjes së përgjigjes në padi në pajtim me neni 396 të LPK-së.

### A r s y e t i m

Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, pas marrjes së përgjigjes në padi nga e paditura, ka vërejtur se e paditura ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar mirëpo nuk ka prezantuar fakte për t'i mbështetur konstatimet e saj dhe prova për t'i vërtetuar faktet eventuale.

Gjykata vlerëson se përgjigja në padi si e tille është në kundërshtim me nenin 396 të LPK-së, që e rregullon atë se çka duhet të përmbajë përgjigja në padi.

Nga këto arsye gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 102 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

UDHEZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

### Formulari 3 - Aktvendim mbi inkompetencën lëndore

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari \_\_\_\_\_, në çështjen juridike të paditësit \_\_\_\_\_ nga Prizreni, kundër të paditurës Republika e Kosovës –Ministria \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të vendimit për refuzimin e dhënies së lejes së sigurisë për nivelin sekret, pas shqyrtimit paraprak të padisë, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, shpallet INKOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore që është.

#### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Republika e Kosovës–Ministria \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të vendimit për refuzimin e dhënies së lejes së sigurisë për nivelin sekret.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështjen administrative, përkatësisht me kërkesën për anulimin e vendimit nr. \_\_\_\_\_, të datës \_\_\_\_\_, të nxjerrë nga drejtori i Agjencionit \_\_\_\_\_, i cili vendim paraqet akt administrativ përfundimtar, i nxjerrë në procedurën administrative dhe i bazuar në Ligjin për Procedurën Administrative.

Me Ligjin nr.03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, përkatësisht nenin 28 par. 4 të tij, është e paraparë se “një personi të konsideruar si rrezik i papranueshëm për sigurinë, i lëshohet vendim me shkrim i cili ia mohon lëshimin e lejes së sigurisë. Ai person mund të paraqes ankesë ndaj një vendimi të tillë brenda 15 ditësh nga dita kur ai/ajo është njoftuar për vendimin. Ankesa paraqitet dhe përpunohet në pajtim me Ligjin mbi Procedurën Administrative dhe nuk ka efekt suspenziv”.

Me nenin 14 të Ligjit për Gjykatat nr.03/L-199, është përcaktuar në mënyrë të qartë se “Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj”.

Duke qenë se bazuar në Ligjin mbi Gjykatat, për kontestet e kësaj natyre, Gjykata Themelore në Prizren, përkatësisht Departamenti i Përgjithshëm i saj, nuk ka kompetencë lëndore, kjo gjykatë gjeti se për çështjen në fjalë, e njëjta duhet të shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore dhe se kjo lëndë duhet t'i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore që është.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 17 dhe 392 pika (b), të LPK-së, në lidhje me nenin 14 të Ligjit për Gjykatat.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## **Formulari 4 - Aktvendim për shpalljen absolutisht inkompetente të gjykatës dhe hudhjen poshtë të padisë**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Peja rr. "Lulzim Rexhepi" nr. \_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ komuna e Pejës, për shkak të vërtetimit të faktit të lindjes, vlera e kontestit 50 euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Gjykata Themelore në Pejë SHPALLET absolutisht inkompetente për të vendosur në këtë çështje dhe padia e paditësit HUDHET POSHTË.

#### **A r s y e t i m**

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Peja rr. "Lulzim Rexhepi" nr. \_\_\_\_, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për shkak të vërtetimit të faktit të lindjes, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga fshati Novosellë komuna e Pejës.

Në bazë të Ligjit për Librat Amëz nr.2004/46 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrat e Gjendjes Civile nr.02/L-126, regjistrimi i faktit të lindjes pas afatit 30 ditësh, bëhet me aktvendimin e organit kompetent (komunal) mbi regjistrimin e mëvonshëm (shih edhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr.15/2009).

Meqenëse në rastin në fjalë kemi të bëjmë me vërtetimin e faktit të lindjes, për vërtetimin e të cilit nuk është kompetent organi gjyqësor, gjykata vlerësoi se kjo e fundit duhet të shpallet absolutisht inkompetente për të vendosur në lidhje me këtë çështje dhe se kjo padi duhet të hudhet poshtë.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 18.2 në lidhje me nenin 391 (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

#### **KESHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit nëpërmjet të kësaj gjykate.



## Formulari 5 -Aktvendim për shpalljen absolutisht inkompetente të gjykatës dhe hedhjen poshtë të padisë

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen juridike të paditëses \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. “Kaçaniku” p.nr., kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. “Suzi Qelebi” nr.\_\_\_\_, për shkak të zhvarrosjes së trupit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Prizren, shpallet absolutisht inkompetente për vendosje në këtë çështje juridike, andaj padia e paditëses \_\_\_\_\_ nga Prishtina, hudhet poshtë si e palejuar.

### A r s y e t i m

Paditësja \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. “Kaçaniku” p.nr., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. “Suzi Qelebi” nr.\_\_\_\_, për shkak të zhvarrosjes së trupit.

Bazuar në Ligjin mbi Varrin dhe Varrezat (gazeta zyrtare e KSAK nr.24/74), si dhe Rregulloren mbi Kushtet dhe Mënyrën e Nxjerrjes nga Varri dhe Bartjen e Personave të Vdekur (gazeta zyrtare e KSAK nr.17/77), gjykata ka konstatuar se çështja e varrosjes dhe zhvarrosjes së personave, nuk hynë në kompetencën e organeve gjyqësore.

Meqenëse në rastin në fjalë kemi të bëjmë me kërkesën e paditëses për zhvarrosjen e trupit, për të cilën çështje siç edhe u cek më lartë, nuk është kompetente gjykata por organi përkatës administrativ, gjykata vlerësoi se kjo e fundit duhet të shpallet absolutisht inkompetente për të vendosur në lidhje me këtë çështje dhe se kjo padi duhet të hudhet poshtë si e palejuar.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 18 par.2 në lidhje me nenin 391 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimi të tij, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 6 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së paditësit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësve \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prishtina të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, kundër të paditurit Komuna e Prishtina, e përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën dhe kthimit të paluajtshmërisë në posedim, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit \_\_\_\_\_ ish nga Prishtina.

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

### A r s y e t i m

Paditësit \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prishtina të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit Komuna e Prishtinës, e përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën dhe kthimit të paluajtshmërisë në posedim.

Gjatë seancës përgatitore të mbajtur me datën 30.03.2012, i autorizuari i paditësve \_\_\_\_\_, av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, e ka informuar gjykatën me faktin e vdekjes për paditësin \_\_\_\_\_ ish nga Prishtina, për çka edhe ia ka dorëzuar gjykatës një certifikatë vdekjeje me nr. rendor \_\_, të datës 30.03.2012, të lëshuar nga Komuna e Prishtinës.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas majës të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 7 - Aktvendim për detyrim të të paditurit për të dhënë përgjigje në padi

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. "Sezair Surroi" nr. \_\_\_\_\_, kundër të paditurve \_\_\_\_\_, për shkak të anulimit të kontratës së punës për shkak të pavlefshmërisë, gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtimin kryesor, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

I. DETYROHET e paditura \_\_\_\_\_, që në afat prej 15 dite nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi, t'i paraqesë gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcënim të pasojave procedurale.

II. E paditura është e detyruar që në përgjigje në padi t'i paraqesë prapësimet procedurale dhe të deklarojë se a e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Në qoftë se e paditura e konteston kërkesëpadinë e paditësit përgjigja në padi duhet t'i përmbajë faktet mbi të cilat i padituri i bazon thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e paraqitura. Përgjigja në padi duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 99 të LPK-së.

III. Në qoftë se përgjigja në padi është e pakuptueshme apo jo e plotë, me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 102 të LPK-së.

IV. Paralajmërohet e paditura se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në par. I të këtij aktvendimi, nuk e paraqet përgjigjen në padi, atëherë gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes, po që se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 par. 1 pika (a),(b),(c) e LPK-së.

V. Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provojë cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari, me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t ia paraqes autorizimin e rregullt.

### A r s y e t i m

Gjyqtari i çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 394, 395 par. 1 dhe 2, 396, 397, 99, 102, 150 par. 1 pika (a), (b), (c), 77 par. 2, 93 par. 1, dhe 387 par. 1 pika (a) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari  
\_\_\_\_\_

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## **Formulari 8 -Aktvendim me të cilin konstatohet e tërhequr padia dhe kundërpadia**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen kontestimore të paditësve-kundërpaditësve \_\_\_\_\_ të cilët i përfaqëson e autorizuar e tyre këtu paditësja \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Gjilani rr. “Zahir Pajaziti” nr.\_\_\_\_, kundër të paditurit – kundër paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjilani rr. “Ardian Zurrnaxhiu” nr.\_\_\_\_, për shkak të pengim posedimit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

I. Konstatohet se padia e paditësve – të kundërpaditurve \_\_\_\_\_, në këtë çështje kontestimore, është e TËRHEQUR.

II. Konstatohet se padia e të paditurit-kundërpaditësit \_\_\_\_\_, në këtë çështje kontestimore është e TËRHEQUR.

### **A r s y e t i m**

Paditësit - të kundërpaditurit \_\_\_\_\_ të cilët i përfaqëson e autorizuar e tyre këtu paditësja \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Gjilani rr. “Zahir Pajaziti” nr.\_\_\_\_, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit – kundërpaditësit \_\_\_\_\_ nga Gjilani rr. “Ardian Zurrnaxhiu” nr.\_\_\_\_, për shkak të pengim posedimit.

Me datën 13.05.2014, i padituri tani kundërpaditësi \_\_\_\_\_ pranë kësaj gjykate ka parashtruar kundërpadi kundër paditësve tani të \_\_\_\_\_.

Në seancën përgatitore të datës 30.05.2014, paditësit – të kundërpaditurit \_\_\_\_\_ në emrin e saj personal si dhe në emër të paditësve \_\_\_\_\_, kanë deklaruar se në këtë çështje kontestimore e tërheqin padinë. Po ashtu në këtë seancë edhe i padituri-kundërpaditësi \_\_\_\_\_ ka deklaruar se është i pajtimit me tërheqjen e padisë së paditësve - të kundërpaditurve dhe se edhe ai në këtë çështje kontestimore e tërheq kundërpadinë e tij. Edhe paditësit – të kundërpaditurit \_\_\_\_\_ janë pajtuar me tërheqjen e kundërpadisë.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 261.2, në lidhje me nenin 261.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Bazuar në nenin 261.4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**Formulari 9 - Aktvendim me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit – të kundërpaditurit, si dhe me të cilin konstatohet e tërhequr kundërpadia e të paditurit – kundërpaditësit**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen kontestimore të paditësit – të kundërpaditurit \_\_\_\_\_ nga Ferizaj rr. “Xhevat Berisha” nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Ferizaj kundër të paditurit – kundërpaditësit \_\_\_\_\_ nga Ferizaj rr. “Ismet Jashari” Kumanova” nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Ferizaj, për shkak të shpërnguljes, përkatësisht kompensimit të demit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Padia e paditësit – të kundërpaditurit \_\_\_\_\_ në këtë çështje kontestimore konsiderohet se është e TËRHEQUR.

II. Konstatohet se kundërpadia e të paditurit - kundërpaditësit \_\_\_\_\_, në këtë çështje kontestimore është e TËRHEQUR.

**A r s y e t i m**

Paditësi – i kundërpadituri \_\_\_\_\_ nga Ferizaj rr. “Xhevat Berisha” nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Ferizaj, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Ferizaj rr. “Ismet Jashari” Kumanova” nr.\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Ferizaj, për shkak të shpërnguljes.

Përmes përgjigjes me shkrim në padi, i padituri – kundërpaditësi \_\_\_\_\_ e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit – të kundërpaditësit, njëherit edhe duke parashtruar kundërpadi ndaj tij për shkak të kompensimit të demit.

Në seancën përgatitore të datës 22.05.2014, është konsideruar se padia e paditësit – të kundërpaditurit është e tërhequr, me arsyetimin se në këtë seancë nuk kishte prezantuar i autorizuari i tij, përkundër faktit se gjykata ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt. Në seancën e datës 13.06.2014, edhe i autorizuari i të paditurit – kundërpaditësit av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni ka deklaruar se e tërheq kundërpadinë e të paditurit – kundërpaditësit. I autorizuari i paditësit – të kundërpaditurit av. \_\_\_\_\_ në këtë seancë është pajtuar me tërheqjen e padisë së të paditurit – kundërpaditësit.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 409.1 dhe 261.2, në lidhje me nenin 261.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

## Formulari 10 - Aktvendim me të cilin konstatohet tërheqja e padisë së paditësit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditëses \_\_\_\_\_ nga Mamusha, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve \_\_\_\_\_, e përfaqësuar nga i autorizuari \_\_\_\_\_, për shkak të kompensimit të dëmit, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Konstatohet se padia e paditëses \_\_\_\_\_ nga Mamusha, në këtë çështje juridiko kontestimore, është e TËRHEQUR.

### A r s y e t i m

Paditësja \_\_\_\_\_ nga Mamusha, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve \_\_\_\_\_, e përfaqësuar nga i autorizuari \_\_\_\_\_, për shkak të kompensimit të dëmit.

Në seancën përgatitore të datës 23.07.2014, paditësja personalisht ka deklaruar se në këtë çështje juridike kontestimore, e tërheq padinë e saj. Në këtë seancë i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se është i pajtimit me tërheqjen e padisë së paditëses.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 261.2, në lidhje me nenin 261.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Bazuar në nenin 261.4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 11 - Aktvendim me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_, nga Gjakova rr. "Jeta e re" nr. \_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Gjakova rr. "Kadri Nesho" p.nr., për shkak të kompensimit të demit, vlera e kontestit 6000 euro, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Padia e paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjakova, në këtë çështje kontestimore, konsiderohet se është e TËRHEQUR.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_, nga Gjakova rr. "Jeta e re" nr. \_\_\_\_, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Gjakova rr. "Kadri Nesho" p.nr., për shkak të kompensimit të demit.

Me datën 16.07.2014, gjykata ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk ka prezantuar paditësi, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa që mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Në bazë të nenit 409.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se "në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit".

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 409.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 12 – Aktvendim me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_, nga Gjakova rr. “Jeta e re” nr. \_\_\_\_\_, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Gjakova rr. “Kadri Nesho” p.nr., për shkak të kompensimit të demit, vlera e kontestit 6000 euro, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Padia e paditësit \_\_\_\_\_ nga Gjakova, në këtë çështje kontestimore, konsiderohet se është e TËRHEQUR.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_, nga Gjakova rr. “Jeta e re” nr.62, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë, kundër të paditurës \_\_\_\_\_ nga Gjakova rr. “Kadri Nesho” p.nr., për shkak të kompensimit të demit.

Me datën 16.07.2014, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën nuk ka prezantuar paditësi, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa që mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

I padituri prezent nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të paditësit por i ka kërkuar gjykatës që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit.

Në bazë të nenit 423.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se “Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 423.3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, me datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.



## **Formulari 13 - Aktvendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake**

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_ në çështjen juridike kontestimore të paditësve \_\_\_\_\_ që të gjithë nga Mitrovica, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën, me datën \_\_\_\_\_, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë sipas propozimit të palëve, e pas përfundimit të procedurës trashëgimore T.nr.359/06.

### **A r s y e t i m**

Paditësit \_\_\_\_\_ që të gjithë nga Mitrovica, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën.

Me datën 15.07.2014, gjykata ka caktuar shqyrtimin përgatitor. Në këtë seancë, paditësja \_\_\_\_\_, e ka informuar gjykatën se po pranë kësaj gjykate, por në procedurën trashëgimore, është në zhvillim e sipër procedura trashëgimore T.nr.359/06 dhe atë sipas trashëgimlënësit \_\_\_\_\_, procedurë kjo e cila vazhdon që nga viti 2006.

Andaj, duke marr parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konfom nenit 13 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ngase gjeti se procedura trashëgimore T.nr.359/06, paraqitet të jetë çështje paraprake pa përfundimin e të cilës gjykata nuk mund të vazhdojë me këtë procedurë.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.

## Formulari 14 - Aktvendim mbi hedhjen poshtë të padisë për shkak të çështjes së gjykuar – res judicata

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në çështjen juridike kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_ rr. “Nasheci” përballë ish fabrikës “Perllonka”, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, kundër të paditurve \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni rr. “Sahat Kulla” nr. \_\_\_\_\_, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me datën \_\_\_\_\_ mori këtë:

### A K T V E N D I M

Padia dhe propozimi për caktimin e masës së përkohshme, të paditësit \_\_\_\_\_ nga Prizreni, në këtë çështje kontestimore hudhen poshtë si të palejuara.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ rr. “Nasheci” përballë ish fabrikës “\_\_\_\_\_”, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurve \_\_\_\_\_, që të gjithë nga Prizreni rr. “Sahat Kulla” nr. \_\_\_\_\_, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, mes tjerash me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, kjo gjykatë me datën 30.05.2013, ka caktuar seancën përgatitore në të cilën të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë theksimeve të tyre të dhëna në padi, respektivisht përgjigjes me shkrim në padi.

Në lidhje me këtë çështje, e duke u thirrur në theksimet e të autorizuarit të të paditurve të dhëna në përgjigjen me shkrim, gjykata ka bërë shikimin në shkresat e lëndës e sidomos në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.847/05, të datës 09.01.2008, aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.847/05, të datës 28.06.2007, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1041/70, i datës 20.01.1971, me ç’rast edhe është konstatuar se në këtë çështje kontestimore, kemi të bëjmë me çështjen e gjykuar - res judicata, ngase për këtë çështje dhe ndërmjet këtyre palëve tani më njëherë është vendosur nga ana e kësaj gjykate.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 391 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

### KESHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

## Formulari 15- Kërkesë Komunës për verifikimin e faktit të vdekjes

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Drejtorisë së Administratës – Sektorit të Ofiqarisë në Komunën e Pejës

z. \_\_\_\_\_ – Udhëheqës i sektorit

### KËRKESË

Në Gjykatën Themelore në Pejë, është në zhvillim e sipër procesi kontestimor C.nr.495/06, në mes të paditëses \_\_\_\_\_ nga Stambolli – Republika e Turqisë, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. \_\_\_\_\_ nga Gjakova, kundër të paditurve \_\_\_\_\_ që të dy nga Peja rr. “Adem Jashari” nr.\_\_\_\_, për shkak të pagesës së borxhit.

Meqenëse përgjatë shqyrtimit përgatitor, i padituri i parë \_\_\_\_\_, ka deklaruar se i padituri i dytë \_\_\_\_\_, ish nga Peja, ka ndërruar jetë diku në vitin 2011, për të cilin fakt nuk ia ka prezantuar gjykatës asnjë dëshmi materiale, si dhe duke pasur parasysh natyrën e lëndës, kërkohet nga ju që të bëni përpjekje maksimale dhe që brenda afatit sa më të shkurtër të mundshëm, të na informoni zyrtarisht me shkrim në lidhje me faktin e vdekjes për të paditurin \_\_\_\_\_, respektivisht me faktin se a është i njëjti i regjistruar në librin amë të të vdekurve.

Shpresojmë në bashkëpunimin tuaj.

Gjyqtari,

\_\_\_\_\_

## Formulari 16 - Kërkesë për verifikimin e faktit të marrëdhënies së punës

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Shkollës fillore “Lidhja e Prizrenit” në Prizren  
-Drejtorit të kësaj shkolle-

### K Ë R K E S Ë

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është në zhvillim e sipër procesi kontestimor C.nr.341/10, në mes të paditëses \_\_\_\_\_ nga Prizreni, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të besimit, ruajtjes dhe edukimit të fëmijëve të mitur. Përgjatë zhvillimit të procedurës, përkatësisht në seancën përgatitore, paditësja e ka zgjeruar padinë ashtu që tani kërkon nga i padituri edhe pagesën e ushqimisë-alimentacionit për fëmijët e mitur dhe për vetë paditësen. Sipas theksimeve të padisë, i padituri \_\_\_\_\_ punon si arsimtar në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Prizren.

Duke pasur parasysh natyrën urgjente të lëndës, kërkojmë nga juqë të bëni përpjekje maksimale dhe që brenda afatit sa më të shkurtër të mundshëm, të na informoni zyrtarisht se është në marrëdhënie pune këtu i padituri \_\_\_\_\_, në shkollën e lartpërmendur dhe nëse po, sa janë të ardhurat mujore të cilat i realizon ai.

Për dijeninë tuaj, seanca e radhës për këtë çështje kontestimore është caktuar me datën 09.11.2012, në orën 11:00, andaj luteni që të veproni para kësaj date.

Shpresojmë në bashkëpunimin tuaj.

Gjyqtari, \_\_\_\_\_

## Formulari 17 - Kërkesë për shikim në shkresat e lëndës të cilat gjenden pranë organit administrativ

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Agjencionit Kosovar për Prona - AKP (Ish UN HABITAT-i)

### KËRKESË

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është në zhvillim e sipër procesi kontestimor C.nr. \_\_\_\_\_, në mes të paditësit – të kundërpaditurit \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij \_\_\_\_\_, e këtë me autorizim bartës av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, kundër të paditurit – kundërpaditësit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, për shkak të dorëzimit të palutjashmërisë, përkatësisht vërtetimit të së drejtës së pronësisë.

Duke pasur parasysh natyrën e lëndës, palët ndërgjyqëse si dhe faktin se nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, kjo lëndë në ndërkohë është kthyer në rivendosje, kërkojmë nga ju që të bëni përpjekje maksimale dhe që brenda afatit sa më të shkurtër të mundshëm, të na i dërgoni për shikim të gjitha shkresat e lëndës, e cila pranë organit tuaj mbanë numrin I/04/0005/PZ, të datës 22.04.2014, në mënyrë që të veprojmë sipas vërejtjeve të dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së dytë të lartpërmendur.

Shpresojmë në bashkëpunimin tuaj.

Gjyqtari,

\_\_\_\_\_

**Formulari 18 – Model i vendimit të Gjykatës për referimin e rastit për ndërmjetësim**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Gjykata _____	VENDIM PËR REFERIMIN E RASTIT PËR NDËRMJETËSIM	Nr. i Ref. i gjykatës: Numri i ref. i ndërmjetësimit:
---	--	--

Adresa e Gjykatës:

VENDIM

Në bazë të të drejtave të palëve në këtë rast për dërgimin e rastit në ndërmjetësim në pajtim me “Ligjin për Ndërmjetësim” nr. 03/L-057, të datës 18 shtator 2008, nenin 1.2 dhe autorizimeve që i ka gjykata në bazë të Ligjit për Ndërmjetësim, neni 9.5 dhe 9.6, gjyqtari përkatës e referon këtë rast për ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim.

Nëpunësi i gjykatës urdhërohet që ta referojë këtë rast në Qendrën e Ndërmjetësimit dhe ta ruaj këtë vendim në dosjen e rastit.

Data
Nënshkrimi
Gjyqtari

**Formulari 19 – Model i Marrëveshjes për Ndërmjetësim<sup>286</sup>**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Gjykata _____	MARRËVESHJE PËR NDËRMJETËSIM	Nr. i Ref. i gjykatës: Numri i ref. i ndërmjetësimit:
---	------------------------------	--

Adresa e Gjykatës:

Kjo marrëveshje është lidhur me datën \_\_\_\_ në qytetin e \_\_\_\_, ndërmjet palëve të përmendura më poshtë, në bazë të nenit 10 të “Ligjit për Ndërmjetësim” Nr. 03/L-057, të datës 18 shtator 2008, përmes së cilës ato merren vesh që të zgjidhin kontestin e tyre përmes procedurës së ndërmjetësimit. Palët pajtohen me përzgjedhjen e ndërmjetësuesit të përmendur në këtë marrëveshje.

Pala “A” (emri/mbiemri)	Pala “B” (emri/mbiemri)
-------------------------	-------------------------

Përmes kësaj palët deklarojnë që:

- Ato e kuptojnë procedurën e ndërmjetësimit dhe pajtohen për referimin e rastit të tyre në ndërmjetësim;
- Ato e kuptojnë që procedura e ndërmjetësimit duhet të përfundojë brenda 90 ditëve nga data e kësaj marrëveshje ashtu siç parashihet në Ligjin për ndërmjetësim;
- Ato e kuptojnë dhe pajtohen që të gjitha informatat e diskutuara gjatë procedurës së ndërmjetësimit të konsiderohen konfidenciale siç është paraparë në Ligjin për ndërmjetësim;
- Ato pajtohen që të përmbahen nga ndonjë veprim tjetër juridik gjatë procedurës së ndërmjetësimit;
- Ato janë informuar dhe i pranojnë parimet e ndërmjetësimit si dhe shpenzimet e ndërmjetësimit, përfshirë tarifën e ndërmjetësuesit.

Përmes kësaj, palët pajtohen që ndërmjetësuesi i poshtëshënuar të jetë ndërmjetësues:

Emri/mbiemri telefoni i ndërmjetësuesit të caktuar:	Në rast se ndërmjetësuesi i përzgjedhur nuk mund të ndërmjetësojë rastin tonë, ne pajtohemi për këtë ndërmjetësues tjetër: Emri/mbiemri telefoni i ndërmjetësuesit tjetër:
---	---

Lënda e kontestit:

Përfaqësuesi i Palës A nëse ka: Emri/mbiemri adresa dhe numri i telefonit dhe natyra e përfaqësimit	Përfaqësuesi i palës B nëse ka: Emri/mbiemri adresa dhe numri i telefonit dhe natyra e përfaqësimit
--	--

Data:

Nënshkrimi i palëve:

Pala “A” Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit	Pala “B” Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit
---	---

**Formulari 20 -Model i Marrëveshjes për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar<sup>287</sup>**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës/ Gjykata --_____	MARRËVESHJE PËR ZGJIDHJEN E NDËRMJETËSUAR	Nr. i Ref. i gjykatës:  Numri i ref i ndërmjetësimit:
---	---	---

Adresa e gjykatës:

Kjo marrëveshje është lidhur me datën \_\_\_\_ në qytetin e \_\_\_\_\_ ndërmjet palëve të poshtëshënuara, sipas nenit 12 të “Ligjit për ndërmjetësim” Nr. 03/L-057,

Procedura e ndërmjetësimit ka filluar më (data) sipas Marrëveshjes për Ndërmjetësim të datës [ ] të nënshkruar nga palët e poshtëshënuara .

Pala “A” (Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit)	Pala “B” (Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit)
Ndërmjetësuesi	

Përmes kësaj ne pajtohemi për kushtet dhe dispozitat në vijim:

Detyrat dhe përgjegjësitë (Përdorni fletë shtesë nëse keni nevojë)

Data:		Data:
Pala “A”: nënshkrimi:		Pala “B”: nënshkrimi:



## Formulari 21 - Raport për moszgjidhjen e rastit

Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Gjykata _____	Raport i Ndërmjetësuesit Moszgjidhja	Nr. i Ref. i gjykatës: Numri i ref i ndërmjetësimit:
--	---	---

Adresa e gjykatës:

Pala "A" (Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit)	Pala "B" (Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit)
---	---

### Raporti konfidencial i ndërmjetësuesit për moszgjidhjen

Data e urdhrimit të gjykatës për ndërmjetësim:	
Datat e ndërmjetësimit:	Numri i orëve:

Në bazë të vendimit të gjykatës për referimin e rastit në ndërmjetësim në rastin e lartcekur, e kam realizuar procedurën e ndërmjetësimit me palët në kontest.

Palët nuk arritën zgjidhje. Prandaj, po e kthej dosjen e ndërmjetësimit në Qendrën e ndërmjetësimit e cila këtë dokument së bashku me dokumentet tjera të bashkëngjitura do t'ia dërgojë gjykatës përkatëse për vazhdimin e procedurave ligjore në këtë rast.

Data:
Ndërmjetësuesi (nënshkrimi):
Emri i ndërmjetësuesit:

**Formulari 22 – Model i vendimit të gjykatës për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Gjykata ---	Vendim pas ndërmjetësimit	Nr. i Ref. i gjykatës: Numri i ref. i ndërmjetësimit:
---	---------------------------	--

Adresa e gjykatës:

Pala "A" (Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit)	Pala "B" (Emri/mbiemri/adresa/nr. i telefonit)
Ndërmjetësuesi	

**VENDIM**

Së bashku me dosjen e ndërmjetësimit nr. \_\_\_\_, kam pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar në rastin e lartcekur i cili i bashkëngjitet këtij vendimi dhe konfirmoj që ajo marrëveshje i plotëson kriteret e parapara në "ligjin për ndërmjetësim" nr. 03/L-057, të datës 18 Shtator 2008.

Prandaj, sipas nenit 12.5 dhe 14.4 të Ligjit për ndërmjetësim, marrëveshja e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar miratohet nga gjykata dhe është dokument i ekzekutueshëm.

Nëpunësi i gjykatës udhëzohet që ta mbyllë rastin dhe ta ruajë marrëveshjen për zgjidhje të ndërmjetësuar si dokument konfidencial, i cili mund të hapet vetëm me urdhër të gjykatës apo me marrëveshje të palëve.

Palët nuk kanë të drejtë apeli kundër vendimit të tillë për ekzekutimin e marrëveshjes për ndërmjetësim.

Data
Nënshkrimi
Gjyqtari

## Formulari 23 - Pajtimi i arritur në procedurën gjyqësore

C.nr. \_\_\_\_\_

### PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT PËRGATITOR

I përpiluar pranë Gjykatës Themelore në Prizren, me datën 28.08.2014

Gjyqtari

Paditësi: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Procesmbajtësja

I padituri: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Lënda e kontestit: kompensim dëmi

Filluar në orën 14,15 minuta

Seanca është publike

Gjyqtari e hap seancën, kumton lëndën e shqyrtimit dhe gjyqtarin e çështjes.

Palët pa vërejtje.

Konstatohet se në seancë janë prezent:

Për paditësin: E autorizuar \_\_\_\_\_ e cila në seancë gjykatës ja dorëzon një ekzemplar të autorizimit.

Për të paditurin: Personalisht identitetin e të cilit gjykata e vërteton përmes letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e R. K me numër personal \_\_\_\_\_, si dhe i autorizuari i tij av. \_\_\_\_\_ i cili në seancë gjykatës ja dorëzon një ekzemplar të autorizimit.

Paraprakisht e autorizuar e paditësit \_\_\_\_\_ dhe i autorizuari i të paditurit av. \_\_\_\_\_ deklarojnë se në mes vete kanë arritur dhe i propozojnë gjykatës për aprovim këtë:

### P A J T I M G J Y Q Ë S O R

I. Detyrohet i padituri \_\_\_\_\_ nga f.sh. \_\_\_\_\_ Komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar për gjatë kryerjes së veprës penale të konstatuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr. \_\_\_\_\_, të datës 01.11.2011, t'ia paguajë paditëses \_\_\_\_\_ shumën në lartësi prej 622.71 euro dhe atë në 6 këste mujore nga 103.78 euro, duke filluar nga muaji tetor të vitit 2014, me ç'rast pagesa do të bëhet çdo muaj, më së largu deri më datën 5 të muajit vijues, ku pagesa do të bëhet në arkën kryesore të paditësit në Prizren, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 15 euro, e cila shumë do të paguhet në xhironlogarinë e paditësit \_\_\_\_\_ me numër \_\_\_\_\_.

II. Shpenzimet e procedurës bien në barë të të paditurit.

E autorizuar e paditësit

I autorizuari i të paditurit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

I padituri

\_\_\_\_\_

Pas kësaj gjykata merr këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET në tërësi pajtimi gjyqësor i lartë propozuar i palëve ndërgjyqëse.

Pas pagimit të taksës gjyqësore lënda të procedohet në a/akta, si lëndë e përfunduar.

Përfunduar në ora 14,40 minuta.

Palët prezentë nënshkruajnë këtë procesverbal pa vërejtje.

E autorizuar e paditësit

\_\_\_\_\_

I autorizuari i të paditurit

\_\_\_\_\_

I padituri

\_\_\_\_\_

Procesmbajtësja

\_\_\_\_\_

Gjyqtari

\_\_\_\_\_

## Formulari 24 - Procesverbali i seancës gjyqësore në të cilën refuzohet pajtimi gjyqësor i propozuar nga palët

C.nr. \_\_\_\_\_

### PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT PËRGATITOR

I përpiluar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datën 18.08.2014

Gjyqtari

Paditësi: \_\_\_\_\_

Procesmbajtësja

I padituri: \_\_\_\_\_

Lënda e kontestit: kompensim dëmi

Filluar në orën 11,15 minuta

Seanca është publike.

Gjyqtari e hap seancën, kumton lëndën e shqyrtimit dhe gjyqtarin e çështjes.  
Palët pa vërejtje.

Konstatohet se në seancë janë prezent:

Për paditësin: E autorizuar av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, e cila në seancë gjykatës ia dorëzon një ekzemplar të autorizimit.

Për të paditurin: I autorizuar i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, i cili në seancë gjykatës ia dorëzon një ekzemplar të autorizimit.

Paraprakisht e autorizuar e paditësit av. \_\_\_\_\_ dhe i autorizuar i të paditurit av. \_\_\_\_\_ deklarojnë se në mes vete kanë arritur dhe i propozojnë gjykatës për aprovim këtë:

### P A J T I M G J Y Q Ë S O R

I. Detyrohet i padituri \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Milan Shuflaj" nr.56, që në emër të shitblerjes për paluajtshmërinë e cila në bazë të listës poseduese nr. 844, evidentohet si ngastra kadastrale nr.744 Zona Kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 54 ari, e cila gjendet në vendin e quajtur "Fusha e Prishtinës" me dimensione dhe shtrirje 45 m në veri, 54 m në lindje me thyerje, 46 m në jug dhe 55 m në perëndim, t'ia paguaj paditësit \_\_\_\_\_ shumën në lartësi prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, brenda afati prej 15 ditësh nga dita e arritjes së kësaj ujdje gjyqësore, e cila shumë do të paguhet në xhirollogarinë e paditësit \_\_\_\_\_ me numër 1501001001597197, si dhe që ta lejojë paditësin që brenda afatit të lartcekur, pranë organeve kompetente komunale - Drejtorisë Komunale për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prishtinës, të bëhet bartja e të drejtës së pronësisë në emër të paditësit.

II. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të të paditurit.

E autorizuar e paditësit

I autorizuar i të paditurit

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi pajtimi gjyqësor i lartë propozuar i palëve ndërgjyqëse.

Procedura në këtë çështje kontestimore do të vazhdojë pasi që aktvendimi përmes të cilit është refuzuar pajtimi gjyqësor, të merr formën e prerë.

Përfunduar në ora 11:40 minuta.

Palët prezentë nënshkruajnë procesverbalin pa vërejtje.

E autorizuar e paditësit

\_\_\_\_\_

I autorizuari i të paditurit

\_\_\_\_\_

Procesmbajtësja

\_\_\_\_\_

Gjyqtari

\_\_\_\_\_

## Formulari 25 - Aktvendimi i posaçëm mbi refuzimin e pajtimit gjyqësor të propozuar nga palët

C. nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_ me procesmbajtësen \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Milan Shuflaj" nr. \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson e autorizuar e tij av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, rr. "Milan Shuflaj" nr. \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuar i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 50.000 Euro, në seancën e datës \_\_\_\_\_, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET propozimi i paditësit dhe i të paditurit përmes të cilit kanë kërkuar nga gjykata që ta aprovojë pajtimin gjyqësor me përmbajtje si në vijim:

"Detyrohet i padituri \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Milan Shuflaj" nr. \_\_\_\_\_, që në emër të shitblerjes për paluajtshmërinë e cila në bazë të listës poseduese nr. 844, evidentohet si ngastra kadastrale nr.744 Zona Kadastrale Prizren, në sipërfaqe prej 54 ari, e cila gjendet në vendin e quajtur "Fusha e Prizrenit" me dimensione dhe shtrirje 45 m në veri, 54 m në lindje me thyerje, 46 m në jug dhe 55 m në perëndim, t'ia paguaj paditësit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Milan Shuflaj" nr. \_\_\_\_\_, shumën në lartësi prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, brenda afati prej 15 ditësh nga dita e arritjes së kësaj ujdj gjyqësore, e cila shumë do të paguhet në xhirollogarinë e paditësit \_\_\_\_\_ me numër, si dhe që ta lejojë paditësin që brenda afatit të lartcekur, pranë organeve kompetente komunale - Drejtorisë Komunale për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prizrenit, të bëhet bartja e të drejtës së pronësisë në emër të paditësit.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të të paditurit, si propozim tërësisht i pabazuar.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Milan Shuflaj" nr. \_\_\_\_\_ të cilin e përfaqëson e autorizuar e tij av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit \_\_\_\_\_ nga Prishtina rr. "Milan Shuflaj" nr. \_\_\_\_\_, të cilin e përfaqëson i autorizuar i tij av. \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë.

Në seancën e datës 18.08.2014, palët ndërgjyqëse përmes të autorizuarve të tyre, e kanë njoftuar gjykatën se në mes tyre kanë arritur pajtim sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, andaj edhe i janë drejtuar gjykatës me propozimin që këtë pajtim të tyre gjykata ta miratojë si të bazuar.

Duke vendosur sipas këtij propozimi të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka shqyrtuar me kujdes propozimin e lartcekur për pajtim gjyqësor, si dhe shkresat e tjera të lëndës, duke gjetur se propozimi për miratimin e pajtimit të lartcekur, është i pa bazuar.

Në fakt me shikim në shkresat e lëndës gjykata ka konstatuar se ngastra kadastrale e cila është objekt i këtij kontesti, evidentohet në emër të Komunës së Prizrenit si pronë shoqërore, e jo në emër të paditësit. Andaj duke qenë se kjo ngastër nuk evidentohet në emër të paditësit, del përfundimi se ky i fundit nuk mund të disponojë me të, sepse e njëjta nuk është pronë e tij por pronë e personit të tretë (Komuna e Prizrenit), e cila nuk është palë në këtë procedurë, gjykata gjen se në këtë kërkesëpadi e paditësit ka të bëjë me të drejtat me të cilat ata nuk mund të disponojnë, të parapara me nenin 3.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Nga se u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 414.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

C nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Gjyqtari

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.





KAPITULLI XVI  
**SHPENZIMET PROCEDURALE**

## 16 SHPENZIMET PROCEDURALE

### 16.1 Shpenzimet

Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë gjykimit dhe lidhur me të. Të tilla janë p.sh. taksa gjyqësore, harxhimet e bëra për sigurimin dhe marrjen e provave, për mbajtjen e seancave jashtë ndërtesës së gjykatës, për ardhjen e palëve dhe përfaqësuesve të tyre në gjykatë, për pagimin e shpërblimit që i takon avokatit për punën e kryer, shpenzimet nga këqyrja e drejtpërdrejt, ekspertimi, dëshmitarët dhe shpenzimet e procedurës për prokurorin publik dhe Ombudspersonin.

#### 16.1.1 Parapagimi i shpenzimeve procedurale

Secila nga palët i paguan vetë shpenzimet e shkaktuara me kryerjen e veprimeve procedurale.

Paditësi i parapaguan harxhimet lidhur me paraqitjen e padisë dhe parashtresave të tjera për të cilat është paraparë taksa gjyqësore, me ardhjen në gjykatë, me marrjen e provave që i ka propozuar si dhe ato lidhur me mjetin e goditjes.

I padituri i paguan shpenzimet lidhur me paraqitjen e përgjigjes në padi dhe parashtresave të tjera për të cilat është paraparë taksa gjyqësore, me ardhje në seancë dhe provave të propozuara nga ai.

Ombudspersoni dhe prokurori publik, kur në një proces gjyqësor marrin pjesë si palë apo në cilësi të ndërhyrësit në anën e ndonjërit nga palët, i bartin shpenzimet procedurale të cilat i kanë krijuar vet me veprimet procedurale.

Kur njëra nga palët ka propozuar një provë (nxjerrja e kësaj prove mund të jetë si: dëshmitarët, ekspertët dhe këqyrja e sendeve ose këqyrja në vend), gjykata me aktvendim cakton shumën dhe urdhëron palën që më parë ta deponojë me qëllim që të paguhet shpenzimet me rastin e marrjes së provës së tillë.

Në rastin kur marrjen e provës e kanë propozuar të dy palët bashkërisht, atëherë gjykata vendosë që shumën e nevojshme për parapagimin e shpenzimeve paraprakisht ta deponojnë të dy palët në pjesë të barabarta.

Në qoftë se pala e cila e ka propozuar nxjerrjen e një prove nuk e depoziton paradhënien në emër të shpenzimeve, gjykata heqë dorë nga marrja e provës së propozuar. Kjo sepse pala nuk është e detyruar që të jetë aktive në gjykim dhe as nuk mund të detyrohet që doemos të bëjë depozitimin.

Kjo rregull nuk vlen në rastet kur gjykata sipas detyrës zyrtare cakton nxjerrjen e ndonjë prove për vërtetimin e fakteve për të cilat zbatohen raportet civile të rregulluara me dispozitat e detyrueshme neni 3 paragrafi 3 i LPK. Në këto raste kur palët nuk e deponojnë shumën e caktuar nga gjykata për marrjen e asaj prove, atëherë shpenzimet për marrjen e kësaj prove do të paguhet nga mjetet e gjykatës.

#### 16.1.2 Pagimi definitiv i shpenzimeve procedurale

Pala e cila e ka humbur kontestin gjyqësor ka për obligim që palës që e ka fituar kontestin, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore. Konsiderohet se paditësi e ka humbur kontestin nëse me vendim përfundimtar është refuzuar kërkesëpadia e tij, kurse i padituri e ka humbur kontestin kur me vendim përfundimtar është aprovuar kërkesëpadia e paditësit.

Në rastet kur paditësi pjesërisht ka sukses në procedurë, gjykata mundet, varësisht nga sukcesi i arritur, të caktojë që secila palë ti bartë shpenzimet e veta ose që njëra palë t'ia kompensojë palës tjetër dhe ndërhyrësit pjesën e shpenzimeve të bëra. Në këtë rast kur vendoset për shpenzimet e procedurës kontestimore, si rregull, duhet të merret për bazë sukcesi i secilës palë në kontest (i paditësit dhe i të

paditurit). Kur vendoset për shpenzimet e procedurës, kur palët pjesërisht kanë sukses në kontest, gjykata duhet të ketë parasysh jo vetëm lartësinë e kërkesës së aprovuar apo të refuzuar por edhe bazën e kërkesës.

### 16.1.3 Vendimi për shpenzimet e procedurës në shkallë të parë

Për pagimin e shpenzimeve të procedurës gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës e cila duhet të paraqitet më së largu deri në përfundim të shqyrtimit që i paraprin dhënies së vendimit ose të rastet e dhënies së vendimit pa shqyrtim paraprak, p.sh. të kërkesa për dhënien e urdhërpagesës shpenzimet duhet të cekën në padi.

Pavarësisht se a është paraqitur me shkrim apo në seancë gjyqësore kërkesa e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, duhet të përmbajë:

- Në mënyrë specifike shpenzimet për të cilat kërkohet shpërblimi (lista e shpenzimeve)
- Provat për të argumentuar shpenzimet e kërkuara (p.sh. fatura, dëftesa, bileta për transport etj.)

Gjyqtari i çështjes është i autorizuar që duke i çmuar me kujdes të gjitha rrethanat të vlerësojë se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Që do të thotë se palës e cila ka sukses në kontest nuk i njihen të gjitha shpenzimet të cilat ajo i ka pasur në kontest apo lidhur me të, por vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të domosdoshme për realizimin apo mbrojtjen e të drejtës që ka qenë objekt i kontestit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata zakonisht e jep krahas vendimit me të cilin mbaron procedura në një instancë, qoftë ai vendim mbi çështjen kryesore qoftë vendim me të cilin përfundon procedura për shkaqe procedurale.<sup>286</sup>

Në rastet kur e drejta e kompensimit të shpenzimeve nuk varet nga rezultati i kontestit, gjykata lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës mund të vendos me aktvendim të veçantë. Ndërsa në rastin e dhënies së aktgjykimit të pjesshëm, gjykatës i është lënë mundësia që për shpenzimet e procedurës të vendos me vendim përfundimtar.

Vendimi për shpenzimet e procedurës gjithnjë trajtohet si aktvendim edhe kur është pjesë e aktgjykimit. Nëse gjykata me vendimin për çështjen kryesore nuk vendos edhe për shpenzimet e procedurës, pala mund të kërkojë që për shpenzimet e procedurës të sillet aktvendim plotësues.

Kundër vendimit mbi shpenzimet e procedurës lejohet ankimi i veçantë. Kurse vendimi për shpenzimet, i përmbajtur në aktgjykim, mund të goditet vetëm me ankesë kundër aktvendimit në qoftë se njëkohësisht nuk goditet edhe vendimi për kërkesëpadinë.

### 16.1.4 Vendimi për shpenzimet e procedurës në procesin sipas mjetit të goditjes

Neni 465 i LPK e ka paraparë mënyrën e caktimit të shpenzimeve të procedurës të cilat shkaktohen si pasojë e ngritjes së mjetit të goditjes kundër vendimeve gjyqësore.

Kur gjykata e shkallës së parë apo e shkallës së dytë e hedhë poshtë mjetin e goditjes (p.sh. kur mjeti i goditjes hudhet si i palejueshëm, si i paafatshëm ose jo i plotë) apo e refuzon (këtë mund ta bëjë vetëm gjykata e shkallës së dytë) mjetin e goditjes, për të lind detyra që të vendos edhe për shpenzimet e shkaktuara lidhur me mjetin e goditjes.

Në qoftë se gjykata më e lartë e ndryshon vendimin e goditur apo e anulon atë dhe e hedhë poshtë padinë si të palejueshme, atëherë për të lind detyra që të vendos për të gjitha shpenzimet procedurale, sepse me vendimin e tillë definitivisht përfundon gjykimi.

---

<sup>286</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit numër I.

Në rastin kur anulohet vendimi i goditur dhe çështja juridike i kthehet në rigjykim shkallës së parë, atëherë me aktgjykim të ri kjo vendos edhe për shpenzimet e procedurës së gjykatës më të lartë. Vendosja për shpenzimet e procedurës lidhur me mjetin e goditjes mund t'i lihet gjykatës më të ulët edhe kur vendimi i goditur është anuluar vetëm pjesërisht.

#### **16.1.5 Lirimi nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore**

Me qëllim të realizimit të parimit të barazisë së palëve gjatë mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të tyre, në procedurën kontestimore, janë paraparë dispozita sipas të cilave pala që nuk është në gjendje ekonomike të tillë që t'i bartë shpenzimet procedurale pa e dëmtuar ushqimin e domosdoshëm të saj dhe të familjes së saj të lirohet nga pagimi paraprak i tyre.

#### **16.1.6 Lirimi i plotë nga shpenzimet e procedurës**

Plotësisht lirohet pala e cila sipas gjendjes së saj të përgjithshme pasurore nuk ka mundësi që t'i bartë shpenzimet pa u dëmtuar ushqimi i domosdoshëm i saj dhe i familjes së saj. Pala e liruar plotësisht nuk ka për detyrë t'i paguaj taksat e as ta depozitoj paradhënien për shpenzimet e marrjes së provave me anë të dëshmitarëve, ekspertëve, këqyrjes në vend dhe shpenzimeve të shpalljeve të ndryshme gjyqësore. Nëse pala është liruar nga shpenzimet e procedurës gjatë zhvillimit të procedurës, nuk mund të kërkojë që t'i kthehen harxhimet e bëra.

Në rastet kur pala lirohet plotësisht nga të gjitha shpenzimet e procedurës, nga mjetet financiare të gjykatës bëhet parapagimi për shpenzimet e dëshmitarëve, ekspertëve, këqyrjesdirekte si dhe të publikimit të shpalljeve dhe harxhimeve faktike të përfaqësuesit të caktuar.

Në rastin kur taksa gjyqësore dhe shpenzimet e tjera janë paguar nga mjetet financiare të gjykatës, gjykata e shkallës së parë ka mundësi që sipas detyrës zyrtare ti arkëtojë ato mjete nga pala e cila ka për detyrë që t'i paguajë shpenzimet e procedurës. Mirëpo nëse pala kundërshtare që ka për obligim që t'i paguajë shpenzimet e procedurës nuk është në gjendje që t'i paguajë ato, atëherë gjykata mund të vendosë që mjetet e paguara në formë të paradhënies nga mjetet financiare të gjykatës, në tërësi ose pjesërisht t'i paguaj pala gjyqfituese, e cila më parë është liruar nga pagimi, dhe atë nga objekti i kontestit që i është pranuar.

#### **16.1.7 Lirimi i pjesshëm nga shpenzimet e procedurës**

Pjesërisht lirohet pala të cilës dukshëm do t'i zvogëloheshin mjetet për ushqim në rast se do t'i paguante paraprakisht shpenzimet procedurale në tërësi. Në këtë rast gjykata mund ta lirojë palën vetëm nga pagimi i taksave gjyqësore.

#### **16.1.8 Vendimi i gjykatës kompetente sipas propozimit të palës për lirim nga shpenzimet gjyqësore**

Pala e cila kërkon lirimin nga shpenzimet e procedurës ka për obligim që bashkë me propozimin të paraqes prova për gjendjen e saj pasurore, ku hyjnë provat për të ardhurat nga baza e punësimit, provat për të ardhurat nga paluajtshmëritë si dhe provat për të ardhurat nga burimet tjera. Në raste të caktuara, këtë e vlerëson gjyqtari i çështjes, gjykata mundet që sipas detyrës zyrtare të siguroj të dhëna të domosdoshme dhe njoftime për gjendjen pasurore të palës që kërkon lirim nga pagimi i taksave gjyqësore.

Pala duhet që kërkesën për lirim nga shpenzimet e procedurës ta paraqes në gjykatën e shkallës së parë ngase kjo gjykatë është kompetente për të vendosur lidhur me lirimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore. Gjukata e shkallës së parë është kompetente edhe për vendosje për lirim nga pagimi i shpenzimeve të krijuara në gjykatën e shkallës më të lartë.

Gjyqtari i çështjes duhet që brenda aftit prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së propozimit të palës për lirim nga shpenzimet e procedurës të vendos lidhur me të. Nëse gjyqtari, duke marrë për bazë të gjitha rrethanat, sidomos vlerën e objektit të kontestit, numrin e anëtarëve të familjes dhe të ardhurat që i ka pala dhe anëtarët e ngushtë të saj, vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për lirim nga shpenzimet e procedurës, atëherë merr aktvendim me të cilin aprovon kërkesën e palës dhe e liron pjesërisht ose plotësisht nga pagimi i shpenzimeve të procedurës.<sup>287</sup> Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, mirëpo nëse gjyqtari e refuzon propozimin për lirim nga shpenzimet e procedurës, atëherë ankesa kundër këtij vendimi është e lejuar.<sup>288</sup>

Nëse pala është liruar nga pagimi i të gjitha shpenzimeve gjyqësore, me kërkesën e saj, gjykata vendos që t'ia caktojë përfaqësuesin me pagesë, nëse e çmon se është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të saj. Në këto raste pala lirohet nga pagimi i shpenzimeve të parapara me nenin 450 të LPK por edhe nga pagimi i shpërblimit për përfaqësuesin e caktuar. Kryetari i gjykatës është ai që vendos për caktimin e përfaqësuesit të palës, sipas kërkesës së saj. Mirëpo, nëse avokati i paraqet shkaqe të arsyeshme për t'u liruar nga detyra e përfaqësimit të palës, lidhur me kërkesën e avokatit vendos gjyqtari i çështjes i cili e shkarkon avokatin nga detyra e përfaqësimit të palës.

Kundër aktvendimit të kryetarit të gjykatës me të cilin palës i është pranuar kërkesa për emërimin e përfaqësuesit dhe kundër aktvendimit të gjyqtarit të çështjes me të cilin është shkarkuar avokati nga detyra e përfaqësimit të palës nuk lejohet ankesa. Mirëpo, lejohet ankesa kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa e palës për caktimin e përfaqësuesit si dhe kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa e përfaqësuesit për lirim nga kjo detyrë.

#### **16.1.9 Mundësia e anulimit të aktvendimit për lirim nga shpenzimet e procedurës dhe mbi emërimin e përfaqësuesit**

Në rastet kur gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore vërtetohet se pala e cila është liruar nga shpenzimet e procedurës është në gjendje që t'i paguajë shpenzimet e tilla, (p.sh. ndërkohë pala ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëri me vlerë të konsiderueshme, nëse palës i është ngritur dukshëm paga apo realizon të hyra nga ndonjë burim tjetër etj.) gjykata do ta anulojë aktvendimin për lirim dhe palës nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore dhe mbi emërimin e përfaqësuesit.

Varësisht nga shkalla e ndryshimit të rrethanave pasurore të palës, gjykata në aktvendim për anulimin e lirim nga shpenzimet vendosë nëse pala që e ka gëzuar këtë të drejtë do t'i kompensojë krejtësisht apo pjesërisht shpenzimet dhe taksat gjyqësore nga të cilat është liruar më parë, si dhe harxhimet faktike dhe shpërblimin për përfaqësuesin e emëruar nga gjykata. Nëse gjykata vlerëson se edhe pas ndryshimit të rrethanave pasurore të palës prapë se prapë ajo nuk do të jetë në gjendje që t'i bartë të gjitha shpenzimet e procedurës, mund të vendos me aktvendim dhe ta detyrojë palën që vetëm pjesërisht t'i kompensojë shpenzimet e procedurës e para se gjithash t'i kompensojë shpenzimet që janë paguar nga mjetet financiare të gjykatës.

Mundësia e anulimit të këtij vendimi nga gjykata mund të vjen në shprehje edhe në rastet kur vërtetohet se nuk kanë ekzistuar arsye të justifikueshme për lirim nga shpenzimet e palës nga shpenzimet e procedurës, ngase gjendja ekonomike e palës nuk ka arsyetuar lirim, por lirim është ndikuar nga pala e cila e ka fshehur gjendjen reale pasurore (p.sh. pala ka heshtur faktin se realizon pension nga puna e bërë në botën e jashtme etj.). Anulimi i kësaj të drejte do të veprojë ndaj palës që nga fillimi i procedurës gjyqësore.

---

<sup>287</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit nr.II dhe III.

<sup>288</sup>Mënyra praktike e vendosjes në këtë situatë është paraqitur përmes formularit nr.IV.



# **FORMULARËT PRAKTIKË**



## 16.2 Formularët praktikë për shpenzimet procedurale

### Formulari 1 - Aktvendim me të cilin pranohen shpenzimet e procedurës

C.nr. \_\_\_\_\_  
GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës nga Prishtina, me bazë juridike të \_\_\_\_\_, duke vendosur sipas kërkesës së palës paditëse për shpenzimet e procedurës me dt. \_\_\_\_\_, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

APROVOHET kërkesa e paditësit \_\_\_\_\_, për shpenzime të procedurës, DETYROHET e paditura \_\_\_\_\_ nga Prishtina, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës t'i paguajë shumën prej 208 Euro, në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktvendimit nën kërcenim të përmbartimit me dhunë.

#### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_ përmes të autorizuarit \_\_\_\_\_, avokat nga Prishtina, më datë 15.07.2014, i ka parashtruar gjykatës kërkesë për vendosje lidhur me shpenzimet për përsëritjen e procedurës në lëndën C.nr. \_\_\_\_\_ për shkak se gjykata nuk ka vendosur lidhur me këto shpenzime.

Gjykata duke vlerësuar kërkesën e të autorizuarit të palës paditëse, gjeti se Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas kërkesës për përsëritje të procedurës të paraqitur nga i autorizuari i paditësit, me aktgjykimin CPP.nr.2/2014, i datës 06.03.2014, e ka lejuar përsëritjen e procedurës, e ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe e refuzuar revizionin e të paditurës.

Pasi që në rastin konkret vendimi i shkallës së parë me të cilin është aprovuar kërkesëpapia e paditësit është bërë i formës së prerë, e paditura në mënyrë vullnetare ka përmbushur detyrimin ndaj paditësit edhe për shpenzime të procedurës por vetëm për shpenzimet e gjykuara pa përfshirë edhe shpenzimet e përsëritjes së procedurës.

Gjykata duke e vlerësuar kërkesën për shpenzime të procedurës gjeti se paditësit i takojnë edhe shpenzimet e procedurës sa i përket propozimit për përsëritje të procedurës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nga neni 449 dhe 452 e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përsëritje të procedurës në shumë prej 208 Euro.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_, me dt. \_\_\_\_\_,

Gj y q t a r i,

#### KËSHILLA JURIDIKE

kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

## Formulari 2 - Aktvendim me të cilin refuzohen shpenzimet e procedurës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin \_\_\_\_\_, në çështjen kontestimore të paditësit \_\_\_\_\_, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurës --\_\_ nga Prishtina, me bazë juridike kompensim page, duke vendosur sipas kërkesës së palës paditëse për shpenzimet e procedurës, me dt. \_\_\_\_\_, merr këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, e datës 26.04.2012, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të vendosë lidhur me shpenzimet e procedurës në lëndën C.nr. \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Paditësi \_\_\_\_\_, përmes të autorizuarit të tij \_\_\_\_\_ avokat nga Prishtina, më datë 26. 04. 2012, i ka parashtruar gjykatës kërkesë për vendosje lidhur me shpenzimet për përsëritjen e procedurës në lëndën C.nr.2725/09 për shkak se gjykata nuk ka vendosur lidhur me këto shpenzime.

Gjykata për të vlerësuar kërkesën e të autorizuarit të palës paditëse i është referuar dispozitës së nenit 463 të LPK-së, ku me paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: "Për pagimin e shpenzimeve procedurale, gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën". Ndërsa neni 463.2 përcakton se: "Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar, t'i tregojë shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës".

Pasi që gjykata ka gjetur se i autorizuari i paditësit nuk ka bërë specifikimin e shpenzimeve të procedurës dhe nuk ka parashtruar prova për shpenzimet e bëra, në kuptim të nenit 463.1 dhe 2 të LPK-së të njëjtën kërkesë e refuzon si të pabazuar.

GJYKATA THEMELORE NË \_\_\_\_\_ Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_ me dt. \_\_\_\_\_

Gj y q t a r i,

KËSHILLA JURIDIKE;

kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

### Formulari 3 - Aktvendim për lirim nga shpenzimet e procedurës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtar \_\_\_\_\_ në kontestin e paditëses \_\_\_\_\_, kundër të paditurit \_\_\_\_\_, duke vendosur sipas propozimit të palës paditëse për lirim nga taksa gjyqësore, me dt. \_\_\_\_\_, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

APROVOHET propozimi i paditëses \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_, për lirim nga taksa dhe e njëjta LIROHET nga pagimi i taksës gjyqësore në shumën prej 30€ për ushtrimin e ankesës në lëndën me numër C.nr. \_\_\_\_\_.

#### A r s y e t i m

Paditësja me parashtresën e datës \_\_\_\_\_, ka paraqitur vërejtje e saj në kërkesën e gjykatës që në emër të ankesës të paguajë taksën gjyqësore në shumën prej 30€ e me arsyetim se është përfituese e ndihmës sociale. Si provë ka bashkangjitur dëshminë që është përfituese e ndihmës sociale.

Gjykata këtë parashtresë e ka vlerësuar si propozim të paditëses për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore për paraqitjen e ankesës.

Me nenin 7.2 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore është paraparë se personi mund të lirohet nga pagimi i taksës gjyqësore, vetëm atëherë kur vërtetohet se ai ose ajo, siguron dëshmi se është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social. Nga prova e prezantuar nga paditësja kartela e ndihmës sociale vërtetohet se ajo bën pjesë në kategorinë e parë të shfrytëzuesve të kësaj ndihme deri me datën \_\_\_\_\_, dhe se mbi këtë bazë i plotëson kushtet në pajtim me nenin 7.2 pika a. të udhëzimit të lartshënuar që të lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës.

Andaj, gjykata duke marrë parasysh provat e prezantuar ka vendosur që paditësen ta lirojë nga pagimi taksës gjyqësore në shumën prej 30€ në emër të paraqitjes së ankesës, në pajtim me nenin 468 të LPK-së, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/2.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. \_\_\_\_\_ me dt. \_\_\_\_\_,

Gjyqtari

KËSHILLA JURIDIKE;  
Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

## Formulari 4 -Aktvendimi me të cilin refuzohet kërkesa për lirim nga shpenzimet e procedurës

C.nr. \_\_\_\_\_

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtar \_\_\_\_\_, në kontestin e paditësit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson \_\_\_\_\_, kundër të paditurit/es \_\_\_\_\_, duke vendosur sipas propozimit të palës paditëse për lirim nga taksa gjyqësore me \_\_\_\_\_, merr këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET propozimi i paditësit \_\_\_\_\_, i datës \_\_\_\_\_, me të cilin ka kërkuar nga gjykata lirim nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore në lëndën C.nr. \_\_\_\_\_.

### A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.05.2014, ka parashtruar propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore ngase paditësi sipas gjendjes së përgjithshme pasurore nuk ka mundësi financiare ti përballojë shpenzimet e procedurës pa e dëmtuar ushqimin e domosdoshëm të familjes dhe të vet paditësit. Për faktin se paditësi është bartës i të drejtës në pension bazë dhe pension sipas kontributit prej 80€, ndërsa nga pasuria ka vetëm banesën ku jeton.

Gjykata ka vlerësuar propozimin e të autorizuarit të palës paditëse, ka bërë shikimin e provave të prezantuara dhe atë: Certifikatën nga zyra kadastrale Prishtinë, me nr. 7037, dt. 28.05.2012 si dhe vendimin mbi njohjen e të drejtës në pension bazë dhe kontributit.

Me nenin 7.2 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore është paraparë se personi mund të lirohet nga pagimi i taksës gjyqësore, vetëm atëherë kur vërtetohet se ai ose ajo, siguron dëshmi se është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose e Agjencisë pasardhëse ose nëse personi siguron dëshmi se ai ose ajo është duke marrë ndihmë ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndihmë Ligjore.

Nga provat e prezantuara nga paditësi nuk është dëshmuar se i plotëson kushtet konform nenit 7.2 të udhëzimit të lartshënuar që të lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës.

Andaj, gjykata duke marrë parasysh provat e prezantuara ka vendosur që ta refuzojë propozimin e paditësit për lirim nga shpenzimet e procedurës në pajtim të nenit 253 dhe 450 të LPK-së, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/2.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm,  
C.nr. \_\_\_\_\_ me dt. \_\_\_\_\_,

Gjyqtari

### KËSHILLA JURIDIKE;

kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.



**KAPITULLI XVII**  
**PROCEDURAT E POSAÇME**  
**KONTESTIMORE**

## **17 PROCEDURAT E POSAÇME KONTESTIMORE**

### **17.1 Llojet e procedurave**

Dispozita e LPK-së, janë të përshtatshme në rënd të parë për zgjidhjen e kontesteve thjesht pasurore-juridike. Në kontestet me veçori të posaçme dispozitat e tilla nuk mund të jenë instrument adekuat për zgjidhjen e tyre nga gjykata, prandaj LPK përbëhet edhe nga dispozitat e posaçme përkatësisht nga procedura të posaçme kontestimore. Disa nga procedurat e posaçme janë për shkak të llojit të raporteve materialo-juridike, kurse disa pasojë e rëndësisë shoqërore të cilën e kanë raportet e tilla. Duhet theksuar se edhe te procedurat e posaçme zbatohen rregullat e procedurës së përgjithshme kontestimore në qoftë se në procedurat e posaçme nuk janë paraparë rregulla specifike.

#### **17.1.1 Procedura në kontestet nga marrëdhënia e punës**

Për zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhënia e punës të cilat janë lënë në kompetencë të gjykatave të rregullta LPK parasheh disa rregulla të cilat dallohen nga rregullat procedurale të përgjithshme.

Rregullat e veçanta të kësaj procedure të veçantë i referohen prioritetit dhe urgjencës për vendosjen e këtyre kontesteve.

Në mënyrë taksative me dispozitën e nenit 475 të LPK-së, është përcaktuar se në kontestet nga marrëdhënia e punës e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.

Afati për përmbushjen e aktgjykimit me të cilin urdhërohet ndonjë detyrim është 7 ditor (afati partitiv), ndërsa afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit apo kundër aktvendimit është 7 ditor.

Në këtë kontest LPK afatet ligjore i ka përcaktuar si afate më të shkurtra për dallim nga procedura e përgjithshme kontestimore dhe gjithashtu ka përcaktuar edhe detyrimin për gjykatën që me rastin e caktimit të afateve gjyqësore këto afate të jenë më të shkurtra.

#### **17.1.2 Procedura në kontestet për shkak të pengimit të posedimit**

LPK me dispozitat nga nenet 478-483 e ka rregulluar procedurën e posaçme lidhur me kontestet për shkak të pengimit të posedimit, sipas të cilës i jepet mbrojtje gjyqësore personit të cilit i është marrë sendi nga posedimi apo të cilit i shkaktohen pengesa gjatë shfrytëzimit të tij. Më këto dispozita mundësohet rivendosja e shpejtë dhe efikase e gjendjes faktike të çrregulluar, pa u shqyrtuar vet e drejta e posedimit, baza juridike e tij apo mirëbesimi ose keqbesimi i posedimit.

Në këto konteste përcaktohet detyrimi për gjykatën që me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjithmonë t'i kushtohet kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast.

Shpeshherë ndodh në praktikën gjyqësore që gjatë shqyrtimit të kontesteve të pengim posedimit gjyqtarët e çështjeve të mos u përmbahen me saktësi detyrimeve specifike të kësaj procedure kontestimore.

Shqyrtimi i secilit rast të pengim posedimit duhet të bëhet duke u bazuar në disa kufizime ligjore që janë vendosur me nenin 480 të LPK-së për gjykatën.

Afatin për përmbushjen e detyrimeve që u janë caktuar palëve gjykata e cakton varësisht nga rrethanat e rastit. Është në diskrecionin e gjykatës që me rastin e caktimit të afateve gjyqësore të vlerësojë vetë urgjencën e përmbushjes së ndonjë detyrimi nga subjektet e përfshira në një procedurë kontestimore për shkak të pengimit të posedimit.

Në këto konteste vendoset me aktvendim ndërsa afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditor.

Në këtë konteste nuk lejohet revizioni si mjet i jashtëzakonshëm.

Nuk mund të përmbahet aktvendimi i dhënë në procedurën kontestimore për shkak të pengimit të posedimit në qoftë se procedura përmbahimore nuk është iniciuar në afat prej 30 ditësh nga dita kur ka kaluar afati parativ i përmbushjes së detyrimit sipas aktvendimit me të cilin është vendosur pengim posedimin.

### 17.1.3 Procedura në kontestet e vlerës së vogël

Më qëllim që mbrojtja juridike për të drejtat subjektive vlera e të cilave nuk është e madhe, të bëhet në mënyrë efikase dhe pa harxhime të mëdha, me ligj është paraparë kjo procedurë e posaçme kontestimore e cila është mjaft e thjeshtuar në raport me atë të përgjithshmen.

Sipas dispozitave të LPK-së neni 485, konteste me vlerë të vogël janë:

- kontestet në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesa në të holla, shuma e të cilave nuk është më e madhe se 500 Euro.
- konteste jo në të holla por në të cilat paditësi ka theksuar se pranon që t'i paguhet shuma e të hollave që nuk është më e lartë se 500 Euro, në vend të detyrimit jo në të holla, dhe
- konteste në të cilat objekt i kërkesëpadisë është dorëzimi i sendit të luajtshtëm, vlera e të cilit e treguar në padi nuk e kalon shumën prej 500 Euro.

Sipas dispozitave të LPK-së neni 486, nuk konsiderohen konteste me vlerë të vogël:

- kontestet lidhur me sendet e paluajtshme,
- kontestet nga marrëdhënia e punës, dhe
- konteste për shkak të pengimit të posedimit

Po qese pala paditëse e ndryshon kërkesëpadinë duke e zmadhuar përtej shumës prej 500 Euro, procedura e filluar do të vazhdohet sipas rregullave të procedurës së përgjithshme kontestimore.

Po që se paditësi në procedurën e rregullt kontestimore (të përgjithshmen) deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes e zvogëlon kërkesëpadinë nën shumën prej 500 Euro, procedura e mëtejme do të zhvillohet sipas rregullave për procedurën në konteste me vlerë të vogël.

Në procedurën e kontesteve me vlerë të vogël edhe procesverbali i seancës përmban specifika pasi që përveç të dhënave që duhet të përmbaj procesverbali sipas dispozitës së nenit 135 paragraf 1, në këtë kontest duhet të përmbaje edhe:

- deklarata e palëve me rëndësi esenciale, e sidomos ato me të cilat tërësisht apo pjesërisht pohohet kërkesëpadia, ose hiqet dorë nga kërkesëpadia, me të cilat ndryshohet apo tërhiqet padia, si dhe deklarata mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia,
- përmbajtjen esenciale të provave të marra,
- vendimet kundër të cilave lejohet ankimi dhe janë shpallur në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes,



- nëse palët kanë qenë të pranishme me rastin e shpalljes së aktgjykimit, e po që se kanë qenë të pranishme a janë udhëzuar në cilat kushte mund të bëjnë ankim.<sup>289</sup>

Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën e parë të shqyrtimit kryesor, pavarësisht se është thirrur në mënyrë të rregullt do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveç kur i padituri kërkon që të vazhdohet me shqyrtimin e çështjes në mungesë të paditësit.

Kjo dispozitë është identike me dispozitën e nenit 423 par 3 të LPK-së, me të cilën rregullohet situata e njëjtë në procedurën e rregullt përkatësisht të përgjithshme.

Në qoftë se në seancën e parë për shqyrtim kryesor mungojnë të dy palët ndërgjyqëse, përkundër thirrjes së rregullt, do të konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë.

Në procedurën sipas padisë për zgjidhjen e kontesteve me vlerë të vogël, ankimi i veçantë lejohet vetëm kundër aktvendimit me të cilin përfundon procesi gjyqësor në shkallë të parë. Aktvendimet tjera mund të goditen vetëm me anë të ankesës kundër vendimit me të cilin përfundon procedura.

Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata ka për detyrë që në pjesën e udhëzimit për mjetin juridik t'i përmend shkaqet në bazë të të cilave mund të bëhet ankimi.

Afati paritiv për përmbushjen e premtimit është 7 ditor , ndërsa afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit apo kundër aktvendimit është 7 ditor.

#### **17.1.4 Procedura e dhënies së urdhërpagesës**

Sipas rregullave të procedurës mandatore, gjykata në bazë të pretendimit të paditësit se i padituri ia ka borxh një shumë të hollash, jep vendim me të cilin urdhërohet i padituri që brenda afatit të caktuar ta paguajë borxhin. Vendimi i dhënë nëse nuk anulohet sipas mjeteve të goditjes e fiton cilësinë e dokumentit ekzekutiv.

Kur kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesë në të holla që është bërë e realizueshme, e që provohet me dokument të besueshëm që i është bashkangjitur padisë (në original ose kopje e legalizuar) atëherë gjykata do ta urdhërojë të paditurin që ta përmbush kërkesëpadinë (urdhërpagesa).

Kushte për dhënien e urdhërpagesës janë:

- kur kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesën në të holla,
- që kërkesa për pagesë të këtë arritur dhe që kjo të provohet me dokument të besueshëm,
- nëse kërkesa është mbi 500 Euro, ekzistimi i saj duhet të provohet me dokument të besueshëm,
- nëse kërkesa e padisë është me e vogël së 500 Euro, nuk ka nevojë që padisë t'i jetë bashkëngjitur dokumenti i besueshëm por vetëm të jetë përmend baza juridike e borxhit, lartësia e kërkesës, provat në bazë të të cilave mund të provohet vërtetësia e thënieve të paditësit dhe
- padia duhet t'i jetë paraqitur gjykatës kompetente.

Dokumente të besueshme konsiderohen:

---

<sup>289</sup> Neni 488 i LPK-së.

- dokumente publike,
- dokumentet private, në të cilat nënshkrimin e debitorit e ka verifikuar organi kompetent për verifikime,
- kambialet dhe çeket me protestë dhe fatura kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës,
- ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, faturat,
- dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike<sup>290</sup>

Gjykata do të jep urdhërpagesën edhe në qoftë se paditësi me padi nuk e ka kërkuar dhënien e urdhërpagesës, nëse gjykata ka gjetur se janë plotësuar kushtet për dhënien e saj.<sup>291</sup>

Urdhërpagesën gjykata e jep pa konvokuar fare seancë gjyqësore dhe vetëm në bazë të materialit procedural të përmbajtur në padi.

Në procedurën e dhënies së urdhërpagesës aktvendimi me të cilin aprovohet kërkesëpadija jepet në formën e urdhërpagesës.<sup>292</sup>

Nëse plotësohen kushtet që gjykata të jep urdhërpagesën atëherë në urdhërpagesë gjykata do të shënojë:

- se i padituri ka për detyrë, pasi t'i dorëzohet urdhërpagesa me shkrim ta përmbushë kërkesën e padisë bashkë me shpenzimet gjyqësore që i ka caktuar gjykata, ose
- që brenda shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet lidhur me kambialin dhe çekun brenda tri (3) ditësh të paraqes prapësim kundër urdhërpagesës, dhe
- e paralajmëron të paditurin së prapësimi i paraqitur me vonesë do të hedhet poshtë.

Urdhërpagesa u dërgohet të dy palëve, ndërsa të paditurit bashkë me urdhërpagesën i dërgohet edhe padia së bashku me shkresat që i janë bashkëngjitur padisë.

Në qoftë së gjykata nuk e aprovon propozimin për dhënien e urdhërpagesës, atëherë ajo do ta vazhdojë procedurën e përgjithshme sipas padisë.

Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet propozimi për dhënien e urdhërpagesës nuk lejohet ankimi.

Urdhërpagesën e dhënë kundër tij i padituri mund ta godas vetëm me anë të prapësimi, brenda afatit të caktuar.

Me prapësim i padituri mund të pretendojë:

- të vërtetohet se për dhënien e urdhërpagesës nuk kanë qenë të plotësuar prezumimet procedurale që i kërkon ligji për dhënien e urdhërpagesës,
- se paditësit apo të paditurit i mungon legjitimiteti real, apo
- se kërkesa e paditësit ende nuk është bërë e kërkueshme.

Nëse urdhërpagesa është godit vetëm lidhur me vendimin për shpenzimet procedurale atëherë ajo mund të goditet vetëm me ankesë.

Në qoftë se urdhërpagesa goditet pjesërisht, atëherë për pjesën e goditur do të vazhdoj procedura sipas rregullave të përgjithshme të procedurës kontestimore, ndërkaq në pjesën për të cilën nuk është goditur urdhërpagesa, bëhet e plotfuqishme.

---

<sup>290</sup> Neni 493 par 2, i LPK-së.

<sup>291</sup> Neni 493 par 3, i LPK-së.

<sup>292</sup> Neni 142 par 4 i LPK-së.

Prapësimin e vonuar, jo të plotë apo të palejueshëm gjykata e hedh poshtë pa mbajtur seancë gjyqësore. Në qoftë së prapësimi është paraqitur brenda afatit ligjor, gjykata do të vlerësoj se nevojitet më parë të konvokoj seancë përgatitore apo menjëherë të konvokoj seancë të shqyrtimit kryesor të çështjes.<sup>293</sup>

Në seancën e konvokuar palët kanë të drejtë të paraqesin fakte, prova, prapësime dhe kërkesa të cilat nuk i kanë parashtruar më parë, paditësi me padinë e tij ndërsa i padituri më prapësimin e tij.

Në qoftë së gjykata pas dhënies së urdhërpagesës shpallet in kompetente lëndore, atëherë e anulon urdhërpagesën dhe pasi aktvendimi mbi inkompetencën të bëhet i formës së prerë lëndën ja dërgon gjykatës kompetente.

Po që se gjykata pas dhënies së urdhërpagesës është shpallur inkompetente në pikëpamje territoriale, ajo nuk do ta anulojë urdhërpagesën dhe, pasi që të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi inkompetencën, lëndën do t'ia dërgoj gjykatës kompetente.

Në qoftë se i padituri pretendon se nuk kanë qenë të plotësuara kushtet ligjore për dhënien e urdhërpagesës, apo se ekzistojnë pengesa procedurale për procedim të mëtejshëm, atëherë gjykata së pari do të vendos mbi këtë pretendim. Në qoftë se konstaton se pretendimi i tillë është i bazuar, gjykata me aktvendim do ta prishë urdhërpagesën, dhe pasi të bëhet i formës së prerë ky aktvendim do të fillojë shqyrtimin e çështjes kryesore, po që se për një shqyrtim të tillë ka vend. Në qoftë se gjykata nuk e aprovon një pretendim të tillë, do të kaloj në shqyrtimin kryesor të çështjes, kurse aktvendimi i gjykatës do të inkorporohet në vendimin mbi çështjen kryesore.

Në aktgjykimin mbi çështjen kryesore gjykata do të vendosë nëse urdhërpagesa mbahet në fuqi tërësisht apo pjesërisht ose anulohet.

Po që se lidhur me prapësimin, me të cilin pretendohet se kërkesëpapia ende nuk është bërë e realizueshme, gjykata konstaton se ajo është bërë e realizueshme pas dhënies së urdhërpagesës, por para se të ketë përfunduar shqyrtimi kryesor, gjykata do ta anulojë me aktgjykim urdhërpagesën dhe do të vendos mbi kërkesëpadinë.

Në këtë procedurë paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit vetëm deri në momentin e paraqitjes së prapësimin. Po që se paditësi e tërheq padinë, atëherë gjykata me aktvendim e anulon urdhërpagesën.

### 17.1.5 Procedura në kontestet tregtare

Këtë procedurë e zbaton Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Gjykatës Themelore.

Në procedurën për zgjidhjen e kontesteve tregtare zbatohen dispozitat e LPK-së, për procedurën e përgjithshme kontestimore, po që se me dispozitat e procedurës së veçantë nuk është përcaktuar diç tjetër.<sup>294</sup>

Rregullat procedurale për procedurën e zgjidhjes së kontesteve tregtare zbatohen në të gjitha kontestet për të cilat sipas Ligjit mbi Gjykatat është kompetente gjykata tregtare, përveçse në kontestet për të cilat është kompetente sipas tërheqjes (atraksionit) së kompetencës lëndore.<sup>295</sup>

Sipas Ligjit për Gjykatat, me dispozitat e nenit 13 është përcaktuar rrethi i çështjeve të cilat bien në juridiksionin e departamentit për çështje ekonomike, siç janë:

- kontestet ndërmjet personave juridik vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste;
- riorganizimi, falimentimi dhe shuarja e personave juridik, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe;

---

<sup>293</sup> Neni 498 par 1 dhe 2, i LPK-së.

<sup>294</sup> Neni 505 par 1, i LPK-së.

<sup>295</sup> Neni 505 par 2, i LPK-së.

- kontestet lidhur me pengimin e posedimit, me përjashtim të pronës së paluajtshme, ndërmjet palëve të cekura në nën-paragrafi 1.1 të këtij paragrafi;
- kontestet lidhur me cenimin e konkurrencës, keqpërdorim apo monopolizim dhe pozitën dominuese në treg si dhe marrëveshjet monopoliste;
- mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe të pronës intelektuale;
- kontestet midis kompanive të aviacionit, për të cilat zbatohet Ligji mbi Kompanitë e Aviacionit, duke përjashtuar kontestet lidhur me të drejtat e udhëtarëve;
- çështje të tjera të parapara me ligj.

Për dallim nga kontestet e rregullta gjyqësore, në kontestet në të cilat revizioni lejohet nëse vlera e kontestit kalon shumë prej 3000 € në kontestet tregtare revizioni është i lejuar vetëm nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur e kalon shumë prej 10.000€

Sipas nenit 509 afatet të cilat vlejné në zgjidhjen e kontesteve tregtare;

- afati prej shtatë (7) ditësh për përgjigje në padi;
- afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme nga neni 130 paragrafi 3 i këtij ligji;
- afati prej shtatë (7) ditësh për ankesën kundër aktgjykimit apo aktvendimit;
- afati prej tri (3) ditësh për paraqitjen e përgjigjes në ankesë;
- afati prej shtatë (7) ditësh (afati paritiv) për përmbushjen e detyrimit në të holla, e për përmbushjen e premtimit jo në të holla gjykata mund të caktoj afat më të gjatë.

Në procedurën për zgjidhjen e kontesteve tregtare, konteste të vlerës së vogël konsiderohen konteste në të cilat kërkesëpadija ka të bëjë me kërkesën në të holla e cila nuk e kalon vlerën prej 3000€. Në këtë procedurë kontest i vlerës së vogël konsiderohen edhe kontestet në të cilat kërkesëpadija nuk ka të bëjë me kërkesën në të holla, por paditësi në padi ka parashtruar kërkesë alternative në të holla e cila nuk e kalon shumë prej 3000€



## 18 Biografia e autorëve



**Muharrem Shala**, ka përfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës në vitin 1974, kur edhe ka filluar punën në shërbimin pronësor-juridik në Kuvendin Komunal të Pejës. Në vitin 1975 ka filluar praktikën në Gjykatën Komunale në Pejë, ndërsa në vitin 1978 ka përfunduar Provimin e Jurisprudencës dhe ka filluar punë si bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Komunale në Pejë deri në vitin 1981. Në vitin 1981 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Komunale në Pejë, ndërsa në shkurt 1984 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Pejë në të cilën kam punuar deri në vitin 1992. Nga viti 1996-1999 ka punuar si avokat.

Nga viti 2000 – 2013 ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, ndërsa nga viti 2013 punon në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Gjatë tërë kësaj kohe kryesisht ka punuar në materien civile.

Nga viti 2010 është anëtarë i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ku ka ushtruar edhe funksionin e Zëvendës Kryesuesit të KGJK-së. Po ashtu ka ushtruar edhe funksione tjera si në Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, Kryetar i Komisionit Disiplinor në KGJK, anëtar i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe njëkohësisht është trajnues në Institutin Gjyqësor të Kosovës

Në kuadër të Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës ka punuar dhe publikuar shumë punime nga materia civile. Ka qenë anëtar i grupit punues për hartimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.



**Ma.Sc. Albert Zogaj**, nga viti 2005 e deri në 2010 ka punuar si avokat në Pejë, ndërsa nga viti 2010 vazhdon të ushtrij detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Është ligjërues-asistent në Universitetin AAB nga viti 2008 në lëndët civile.

Nga viti 2011 është angazhuar si trajnues në Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe mentor i kandidatëve për gjyqtar në tri gjeneratat e fundit. Ka marrë pjesë në disa projekte hulumtuese në kuadër të Qendrës Juridike të Kosovës dhe Qendrës për të Drejta e Njeriut të Universitetit të Prishtinës.



**Valon Totaj**, në vitin 2010 është dekretuar gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, post të cilin e ushtron edhe aktualisht. Nga viti 2015, ai është udhëheqës i Divizionit Civil të kësaj gjykate.

Gjatë viteve 2008-2010, ka qenë i emëruar në postin e Zëvendës Avokatit Publik të Komunës së Prizrenit, ndërsa para kësaj, përkatësisht në periudhën 2007-2008, ai e ka ushtruar detyrën e bashkëpunëtorit profesional të Bordit të Drejtorëve të Komunës së Prizrenit.

Gjyqtari Valon Totaj është bashkautor i moduleve-programeve trajnuese “E Drejta Familjare” dhe “Drejtësia për Fëmijë – Aspekti Civil”, pranë Institutit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, në kuadër të të cilit institucion që nga viti 2013, ai është angazhuar edhe si trajnues gjyqësor i lëndëve civile.



**Zenel Leku**, është gjyqtar i cili u dekretua në vitin 2010 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, funksion të cilin e ushtron edhe aktualisht.

Gjatë viteve 2007-2010, ai ka ushtruar detyrën e bashkëpunëtorit profesional në zyrën e Avokaturës Dobruna.

Që nga viti 2013 është i angazhuar edhe si trajnues gjyqësor i lëndëve civile në kuadër të Institutit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë.

## 19 LITERATURA E KONSULTUAR DHE E PËRDORUR

1. Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I dhe II, Prishtinë 2006.
2. Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile Ndërkombëtare, Prishtinë 2000.
3. Faik Brestovci, Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004.
4. Iset Morina & Selim Nikçi “Komentar” Ligji për Procedurën Kontestimore, Prishtinë 2012.
5. Enver Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009
6. Hajredin Kuçi & Asllan Bilalli, E Drejta Ndërkombëtare Private, Prishtinë 2008.
7. Hajredin Kuçi & Asllan Bilalli, Zanafilla, Zhvillimi Historik dhe Burimet e së Drejtës Ndërkombëtare Private, Prishtinë 2006.
8. Petraq Çuri, E Drejta Procedurale Civile & Noteria, Tiranë 2008.
9. Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë 2010.
10. Ardian Kalia, E Drejta Ndërkombëtare Private, Tiranë 2010.
11. Marek Antonio Noëicki, Rreth Konventës Evropiane, Tiranë 2003.
12. Michael A Cunniff & Albert Zogaj, Moduli-Shkathtësitë e Arsyetimit dhe Shkrimit Ligjor për Gjyqtarë, IGJ Prishtinë 2013.
13. Vukasin Ristic, Milosin Ristic, “Praktikum za Parnicu”, Beograd, 2000
14. Gjykata Supreme e Kosovës, Buletini i Praktikës Gjyqësore, Prishtinë, 2011, vëllimi 1.
15. Gjykata e Qarkut Kosovë, Buletini i Praktikës Gjyqësore, Prishtinë, 2011, vëllimi 2.
16. Gjykata Supreme e Kosovës, Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Rastet Pronësore, Prishtinë, 2011.



## **20 AKTE, KODE, LIGJE, RREGULLORE DHE RAPORTE**

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, 1950.
3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës- OKB, 20 nëntor 1989
4. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, shpallur me datën 09.08.2010, GZ.79/24.08.2010, që ka hy në fuqi me 01.01.2013.
5. Ligji për Procedurën Kontestimore
6. Ligji për Procedurën Përmbartimore
7. Ligji për procedurën Jokontestimore
8. Ligji për Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjeve me dispozita e shteteve tjera në marrëdhëniet e caktuara - Gazeta Zyrtare të RSFJ nr.43/82 dhe me përmirësimin në nr.72/82.
9. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
10. Ligji për Familjen i Kosovës.
11. Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve
12. Ligji nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.8, e datës 08.04.2013.
13. Ligjin për Noterinë
14. Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale
15. Ligji për Ndërmjetësimin
16. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, më 25 prill 2006
17. Udhëzimi Administrativ nr.2008/2, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore
18. Udhëzimi Administrativ për procedurat e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale dhe civile, nr.01-1265, i vitit 2009
19. Ligji për Procedurën Kontestimore, (i vjetri)
20. Ligji për Procedurën Përmbartimore, (i vjetri)
21. Ligji për Procedurën Jokontestimore, (i vjetri)
22. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.217/13, të datës 25.03.2013
23. Ligji për Avokaturën Publike (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.9/83).
24. Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.04L-118.